ME ZOTIN MES NJERËZVE

"Njeriu është bashkë me atë që do"
(Profeti Muhamed a.s.)

Titulli i librit
ME ZOTIN MES NJERËZVE

"Njeriu është bashkë me atë që do"
(Profeti Muhamed a.s.)

Botues
KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

Autor
DORIAN DEMETJA

Redaktor
DETIN KOTRRI
MEHMET DISHA

Redaktor Teknik
Prof. Asoc. Dr. RAHIM OMBASHI

Dizajner
HYSEN VOGLI

ISBN 978-9928-194-82-4

© Të drejtat e botimit janë të Autorit

Tiranë, 2020

Parathënie

Pakkush prej lexuesve të rregullt, por edhe prej intelektualëve që japin ndihmesën e tyre në lëmin e letërsisë islame, e ka ditur se Drejtori i Kulturës dhe Arsimit pranë KMSH-së veç detyrës administrative, ka pasion edhe shkrimtarinë brenda këtij stili funksional, që ka lexues të sinqertë e pasionantë. U deshën një sërë botimesh të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, që të zbulohej ky tipar, detaj që bën diferencën e autorit Dorian Demetja si besimtar i dëlirë, nëpunës i përkushtuar dhe studiues i letërsisë islame.

Pas artikujve te revistat zëmëdha "Zani i Naltë" dhe "Drita Islame", ku jepen informacione dhe qëndrime shkencore plot interes, duket natyrshëm që iu mblodh aq material, sa nuk kishte mundësi ta linte ashtu në heshtje, apo siç thuhet rëndom: ta mbante për vete. Ashtu siç pohon vetë, nëpërmjet atyre trajtesave është përpjekur të tregojë rrugët e fitimit të kënaqësisë së Zotit, mbi të cilat njeriu duhet të shkelë për t'u bërë një rob prej robërve që pëlqen Krijuesi. Në këtë lëmi vijon të çapitet, ndaj kësisoj kjo vepër, që i shtohet bibliotekës myslimane duke e pasuruar atë, është e mbushur me pikëpamjet joshëse të autorit për probleme dhe qasje të tij, që kanë lidhje me formimin shpirtëror, mendor dhe moral të gjithkujt, duke shkoqitur edhe kahjen nga duhet të priren.

Si profesionist i fushës, shpalos mes këtyre shkrimeve pikëpamjet vetjake për shumë probleme themelore, që lidhen me gjendjen e zhvillimin më tej të edukimit shpirtëror në përgjithësi dhe atij islam në veçanti, por dhe me rrugët efikase si ai mund e duhet të plotësohet.

Të përmbledhura në libër, autori Dorian Demetja fton lexuesin të bëhet me gjithë zemër rob i Zotit, që të mos e ndiejë kurrë veten të vetmuar, si dukuri e kohës moderne. I tregon se cili duhet të jetë qëllimi i jetës, e cila bëhet një sprovë, i jep atij armën e besimit, e fton të lexojë dhe të bëhet i dashuri i dijes, sepse edhe dituria është dashuri.

Si njohës dhe praktikues i Kuranit Fisnik e fton lexuesin të bëhet mik i librit hyjnor, por të mos ndalet vetëm aty. Që ta kuptojë dhe jo vetëm ta ndiejë dhuratën e shenjtë, i duhet të miqësohet edhe me porositë profetike, që vijnë të përcjella prej sahabeve, të cilët patën fatin e nderin të jetojnë në epokën e tij. Në të gjitha shpjegimet që bën, autori niset nga pikëpamja e drejtë se duke pranuar të jesh rob i Zotit, beson pa gjykuar, pa kushte, por vetëm me forcën e zemrës së dëlirë.

Me rëndësi janë porositë që përcjell Dorian Demetja për praktikimin e besimit islam, që kërkon përkushtim dhe sakrificë. Pyetja që ai i drejton vetes, i drejtohet edhe lexuesit, prandaj dhe libri largon distancën autor-lexues. Të dy e kërkojnë kënaqësinë e Zotit, që fitohet me përpjekje pa fund.

Me vlerë janë sqarimi i termave islame, që shërbejnë si gurë qemeri në formimin, forcimin dhe praktikimin e besimit prej gjithsecilit.

Duke shqyrtuar materialet publicistiko-shkencore dhe shpjegimet e botuara, apo të shtuara në këtë libër, bindemi se kemi mes nesh një besimtar të sprovuar me përgatitje të gjithanshme, njohës deri në thelb të Kuranit, të hadithëve profetike, po ashtu dhe zbatues i zellshëm i tyre, që punon jo vetëm si nëpunës i lartë, si teoricien, por dëshmohet dhe farkëtues bashkëkohor i kulturës islame.

Kur i vështrojmë me syrin e lexuesit dashamirës shkrimet e tij eseistike, konstatojmë se shumë prej ideve, që i kanë ngjizur ato, janë shqetësime për të gjithë shoqërinë shqiptare, jo vetëm për besimtarët e një besimi monoteist, madje shumë më gjerë.

Me dëshirën për të ngjallur interesin dhe kureshtjen për ta marrë në dorë këtë libër, ku predikohet me kujdes e dhembshuri, po i mbyll këto rreshta me gjykimin tërheqës së autorit, ku spikat dashuria pa kushte për Zotin, zbulesën e Tij, për Profetin e fundit të dërguar prej Tij, që janë njëherazi edhe pasioni i zjarrtë i autorit Dorian Demetja, i cili fton gjithsecilin në besim dhe adhurim:

> "E çel fjalën time me emrin e Zotit, i Cili më krijoi dhe më bëri prej besimtarëve. Falënderimet e panumërta qofshin për Allahun, Krijuesin e gjithësisë, të Gjithmëshirshmin, Mëshirëplotin. I dërgoj përshëndetje pa fund Profetit tim të shtrenjtë, Hz. Muhamedit (s.a.s.) si shembull unik për ymetin e Tij, si dhe të gjithë profetëve të tjerë, dërguar nga Zoti qysh me krijimin e kësaj bote. Përshëndetje të sinqerta u dërgoj gjithashtu familjes së Profetit të fundit dhe të gjithë atyre që ndjekin rrugën e tij deri në fundin e kësaj bote".

Prof. Asoc. Dr. Rahim OMBASHI
Dekan në Fakultetin e Shkencave Humane, BEDËR

Hyrje

E çel fjalën time me emrin e Zotit, i Cili më krijoi dhe më bëri prej besimtarëve. Falënderimet e panumërta qofshin për Allahun, Krijuesin e gjithësisë, të Gjithmëshirshmin, Mëshirëplotin. Dërgoj përshëndetje pa fund profetit tim të shtrenjtë, Hz. Muhamedit (s.a.s.) si shembull unik për umetin e tij, si dhe të gjithë profetëve të tjerë, dërguar nga Zoti qysh me krijimin e kësaj bote. Përshëndetje të sinqerta u dërgoj gjithashtu familjes së Profetit të fundit dhe të gjithë atyre që ndjekin rrugën e tij deri në fundin e kësaj bote.

Kurani thekson se qëllimi i krijimit të qenieve njerëzore është besimi dhe adhurimi i Zotit. Vetëm me anë të dritës së besimit ne mund të kuptojmë thelbin tonë, qëllimin e jetës, mund të bëhemi të vetëdijshëm rreth aspekteve të brendshme të fenomeneve, si dhe të arsyeve që qëndrojnë pas tyre. Në udhëtimin e tyre gjatë jetës, besimtarët e mirë dhe të vëmendshëm, e studiojnë ekzistencën dhe atë që ndodhet pas saj me mijëra herë, duke i dhënë kuptimin e vërtetë asaj. Ata i filtrojnë gjërat dhe ngjarjet pa pushim, duke u përpjekur të hapin çdo derë e duke u munduar të vendosin marrëdhënie me çdo objekt.

Njeriu në praktikën e përditshme bën përpjekje që të njohë fillimisht vetveten. Veçanërisht besimtari që i referohet fesë së tij, ka një vizion më të qartë për ta klasifikuar veten në raport me Zotin dhe me shoqërinë ku jeton.

Ai nevojitet të dallojë e të vlerësojë veten që me qëndrimin e tij të ndikojë tek të tjerët, po ashtu, nevojitet të kuptojë se çfarë vlerash pozitive mund të marrë edhe prej tyre. Prandaj, besimtari të gjithë veprimtarinë duhet ta shohë me syrin e përgjegjësisë te Zoti për të mos shkarë në rrugë të shtrembër, por të bëhet fener ndriçues për të tjerët.

Ashtu si mundohen shumë veta për të rënë nga mbipesha duke u privuar nga ushqime të ndryshme, apo duke u përpjekur me ushtrime fizike, shkurt pranojnë çdo vështirësi vetëm e vetëm të kenë një fizik dhe trup të bukur, ashtu edhe një besimtar i mirë duhet të pastrojë e rifreskojë vazhdimisht shpirtin e tij me pendim, lutje, bamirësi, përmendje të Zotit dhe sjellje të mirë, pra me adhurime të llojeve të ndryshme. Ai punon vazhdimisht që të jetë i ndërgjegjshëm për ndjenjat dhe gjendjen e tij të brendshme, si dhe për qëndrimet e opinionin e tij rreth çështjeve të ndryshme.

Shkak për botimin e këtij libri u bënë disa shokë, të cilët më sugjeruan t'i grumbulloj të gjitha shkrimet e mia dhe t'i botoj. Pikërisht, libri që keni në duar është i përbërë prej shkrimeve të përzgjedhura që kam shkruajtur gjatë viteve, kryesisht në revistat "Drita Islame" dhe "Zani i Naltë", botime periodike të KMSH-së. Të gjitha shkrimet e rënditura në këtë libër janë rishikuar e formatuar edhe njëherë për të marrë trajtën përfundimtare. Tematikat e shkrimeve janë të larmishme, duke prekur çështje të ndryshme përsa i përket besimit dhe jetës praktike të besimtarit. Në këto tematika jam përpjekur të tregoj rrugët e fitimit të kënaqësisë së Zotit, mbi të cilat njeriu duhet të shkelë për t'u bërë një rob nga robtë që pëlqen Krijuesi. Pra, synimi është që lexuesi të ndikohet dhe ky libër të shërbejë si një faktor nga faktorët e shumtë të Allahut, që ai të përmisojë diçka nga jeta e vet.

Suksesi vjen nga Zoti i Madhërishëm.

Dorian DEMETJA
Drejtor i Kulturës, KMSH

BËHU ROB I ZOTIT

Krijuesi i Lartë, ekzistenca e të cilit është shkaku i ekzistencës sonë, i ka rrethuar gjithë botërat me madhështinë e Tij. Qiejt dhe toka janë nga një përshndritje prej rrezatimeve të nurit të Tij. Ai është altari i amshuar i shpirtrave të përkryer që e kanë gjetur të vërtetën. Ai është e vetmja kible, i vetmi orientim. Ta lësh Atë për të vrapuar te dikush tjetër, është marrëzi, t'ia qash hallet dikujt tjetër veç Atij, një vetëmashtrim. Ata që largohen prej portës së Tij, pësojnë disfatë të madhe dhe mbeten në rrugë, zemrat që nuk ndriçohen dot me dritën e Tij, ndjekin iluzionin optik në shkretëtirë dhe lodhen më kot. Meqë feja e Allahut është e përhershme dhe Hz. Muhamedi (a.s.) është profeti i fundit, pas vdekjes së tij kujt do t'i takonte detyra për njoftimin e së vërtetës me fjalë dhe vepra, për ta jetuar e për ta mbajtur të gjallë atë? Çdo të bëhej pas perëndimit të këtij dielli nga rruzulli tokësor drejt botës së përjetshme? Nuk ka dyshim se kjo detyrë e shenjtë u përket njerëzve të fesë në veçanti dhe të gjithë myslimanëve në përgjithësi. Favori më i madh i Allahut, i Cili na bën të rrojmë në mes të mirave të pafundme, është përgjegjësia e amanetit që shprehet në Kuran:

"**Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari i Allahut të jetë dëshmitarë përmbi ju**"[1].

1. Bekare, 2:143

Të gjitha dituritë fillojnë nga dëshmia e njëshmërisë së Zotit. Të gjitha meritat e krijimtarive dhe të egos primare i takojnë Allahut. Kjo është dituria reale dhe nuk pranon marrëveshje, konsensus. Pas kësaj vjen raporti që ka besimtari me Profetin Muhamed (a.s.). Sa pjesë është ai te Profeti dhe sa pjesë është profeti tek ai. Sot dhe përherë kemi nevojë për njerëz që përpara fjalëve t'u flasin veprat, ashtu si bënin shokët e Profetit. Dhe jo për njerëz që i kushtojnë më shumë rëndësi aparencës, që vetëm dinë të flasin bukur e të bëjnë një diplomaci të mirë. Pikë së pari nga ne kërkohet të mendojmë, gjykojmë dhe të punojmë bukur, në përputhshmëri të plotë me kënaqësinë e Zotit. Dhe së dyti, të gjitha mjetet që do të përdorim drejt këtij qëllimi parësor, duhet të mos bien në kundërshtim me dispozitat islame. Vetëm atëherë do të kemi mirësinë dhe begatinë nga i Madhi Zot për të qenë të suksesshëm në punët tona.

Është i çuditshëm fakti që sa herë që njeriu bën përpara në rrugën drejt Zotit, djalli menjëherë reagon duke e sulmuar atë nga dobësitë e tij. Duke i njohur shumë mirë dobësitë e secilit, djalli vepron me dredhi për ta rrëzuar njeriun, madje kur përpiqet për këtë, dëshiron që ky rrëzim të jetë i fortë. Dredhitë e tij janë nga më të ndryshmet, sidomos kur luan me një kartë shumë të rrezikshme, siç është pesimizmi. Në çdo rrëzim që i bën, djalli sikur dëshiron t'i thotë njeriut që të dorëzohet; ai lë imazhin e vështirësisë dhe të pamundësisë së mbarimit të kësaj rruge.

Jeta që Zoti i ka dhënë njeriut në këtë botë është amanet. Prandaj njeriu këtë amanet duhet ta çojë në vendin e vet, duke u bërë rob i Zotit në kuptimin e plotë të fjalës. Gjithë jetën e vet, një mysliman i mirë përpiqet për të qenë një besimtar i denjë për Krijuesin. Shprehja e Profetit (a.s.):

"*Feja është këshillë*"[2],

do të thotë se feja është sinqeritet, ajo çfarë shpreh zemra, jo buzët. Këshilla jo vetëm që është prej feje, por është detyrë dhe mision i pejgamberëve, të cilët ishin dërguar t'ua tërhiqnin vëmendjen njerëzve duke i ftuar në adhurimin e

2. Muslim

sinqertë vetëm Allahut. Themi kështu, pasi njeriun e ndjekin nga pas shumë dëshira e pasione dhe, duke pasur parasysh fjalën e Zotit që njeriu është krijuar i dobët, ai shumë shpejt dhe shumë lehtë mund të bjerë në kurthin e kësaj bote. Në këtë mënyrë ai mund të bëhet rob i parasë, i postit, i famës, i pasioneve, i epshit etj. Çdo njeri ka dobësitë e veta dhe askush nuk mund ta refuzojë këtë, sepse kjo na bën të jemi njerëz të gabueshëm. Ajo që kërkohet prej nesh pas besimit, është të formojmë dhe të ndërtojmë mekanizmat e duhur për të ecur pa lëkundje në rrugën drejt Zotit. Kjo natyrisht duhet të shoqërohet me lutje e përgjërime ndaj Krijuesit që të na ndihmojë në rrugëtimin tonë drejt përmirësimit. Sigurisht rruga që të çon në xhenet është e gjatë, e lodhshme, me sakrifica pa fund… Ndërsa e kundërta ndodh me rrugën që të çon në xhehenem; ajo është si një autostradë pa pengesa, ku përbri gjen lëndina e mjedise të bukura. Aty shikon bukurinë dhe ngjyrat e natyrës që të bëjnë për vete.

Kurani i afrohet njeriut në të gjitha drejtimet si një i gjithi, duke iu referuar mendjes, zemrës, ndjenjave, emocioneve, që njerëzit me natyrë dhe karakter të ndryshëm ta marrin mesazhin hyjnor nga rruga e krijimit të tyre. Sot, për hir të Allahut është një punë për t'u bërë në vlerën e të gjithë botëve. Kjo punë është që botës t'ia bëjmë të njohur Allahun dhe t'i tregojmë për profetin Muhamed (a.s.). Atëherë le t'i lëmë pretendimet e mëdha, fjalët boshe dhe të përpiqemi për të përmbushur këtë detyrë fisnike. Të kërkojmë dhe të gjejmë rrugët që fenë tonë ta përcjellim tek të tjerët në mënyrën më të drejtë. Këto të vërteta të çmueshme që Allahu na dhuroi, vallë si mund t'ia përcjellim fëmijëve, të rinjve, grave, burrave, gjithë botës?! Ky është dhe duhet të jetë preokupimi ynë.

Si rrjedhojë, gjithmonë çështja më e rëndësishme te myslimanët është edhe një herë rizgjimi i shpirtit islam, rizgjimi i shpirtit të fesë. Kur do të harrohet vetvetja dhe do të mendohet lumturia e përhershme njerëzore?! Nëse ne kujtojmë dhe jetojmë vetëm për veten tonë, atëherë nuk mund të kujtojmë atë që duhet. A mos vallë nuk na shkatërrojnë ne, grupet e njerëzve që mendojnë vetëm për veten e tyre?!

QËLLIMI YNË, KËNAQËSIA E ZOTIT

Një aspekt i kënaqësisë së Zotit është pranimi me qetësi shpirtërore i çdo vendimi e gjykimi që merr Allahu për ne, dashuria për Të dhe ndërgjegjësimi për të kërkuar e pritur gjithçka prej Tij. Një njeri që vazhdimisht përjeton aspektin material të ekzistencës së tij, që vazhdimisht interesohet duke u marrë me jetën e tij trupore pa ia vënë veshin asnjëherë zërit të shpirtit dhe ndërgjegjes së vet, do të jetojë më kot, do ta konsumojë jetën e vet pa dobi dhe kurrsesi nuk do të mund të sigurojë rezultatin e siguruar prej njerëzve që e kanë rregulluar jetën e tyre sipas kënaqësisë së Zotit.

Njeriu, çdo veprim që bën duhet ta bëjë duke menduar kënaqësinë e Zotit, duke mos i shkuar nëpër mend asnjëfarë interesi apo përfitimi në lidhje me këtë botë. Kur të ndiqet një rrugë dhe kur të planifikohet një strategji, më përpara duhet të vlerësohet në aspektin e kënaqësisë së Zotit. Nëse përkon me këtë kënaqësi duhet të bëhet, nëse jo duhet të braktiset patjetër dhe të mos jepet mundësia të mashtrohet dikush. Në terminologjinë Islame ky virtyt quhet sinqeritet. Sinqeriteti është mënyra e jetesës drejt, pastër, larg hipokrizisë dhe çdo gjëje që mund të turbullojë zemrën. Në duatë tona mund të harrojmë kërkimin e xhenetit dhe mbrojtjen nga xhehenemi, por asnjëherë nuk duhet të harrojmë

kërkimin e sinqeritetit. Sepse kjo nuk mund të harrohet. Pa sinqeritet njerëzit jetojnë kot dhe asgjë nuk merr kuptim në mungesë të tij. Profeti ynë thotë:

"*Kujdes! Në trupin e njeriut është një copë mishi. Po të jetë mirë ajo, i gjithë trupi është mirë; po të prishet ajo, i gjithë trupi prishet. Kujdes, ajo është zemra*"[3].

Sinqeriteti imponon kryerjen e çdo detyre dhe përgjegjësie vetëm duke përmbushur urdhrin e Zotit, duke synuar kënaqësinë e Tij dhe duke e pritur shpërblimin vetëm prej Tij. Në Kuran thuhet:

"**Mua më shpërblen vetëm Allahu**"[4].

Duke menduar vetveten, "Le ta fitoj unë këtë shpërblim, le t'i udhëzoj unë këta njerëz, le të më dëgjojnë mua ata", njeriu merr një qëndrim rivaliteti ndaj vëllait të tij, i cili është në një nevojë reale për dashurinë, përkrahjen dhe vëllazërinë e tij. Ai bie pre e egoizmit, anon nga sëmundja e ambicies, humbet gjithë sinqeritetin dhe hap derën e hipokrizisë për veten e tij. Ilaçi i kësaj sëmundjeje është parimi se "kënaqësia e Zotit fitohet vetëm nëpërmjet sinqeritetit" dhe jo nëpërmjet pasjes sukses të madh apo shumë ndjekësve. Sepse këto të fundit janë një funksion i vullnetit të Zotit dhe i përkasin vetëm mirësisë e nderimit të Tij. Ato nuk mund të kërkohen, përkundrazi, Allahu ia jep ato atij që do. Ne duhet të shikojmë detyrën tonë duke bërë atë që na takon dhe të mos ngatërrohemi me çështjet e Krijuesit. Zoti dërgoi shumë profetë të nderuar, por shumë pak njerëz u besuan atyre. Megjithatë ata morën shpërblimin e pasosur të detyrës së shenjtë të profetësisë. Atëherë arritja e vërtetë nuk qëndron në fitimin e një numri të madh ndjekësish, por në fitimin e kënaqësisë së Zotit.

Ndonjëherë një fjalë e vetme do të rezultonte në shpëtimin e ndokujt dhe si rrjedhojë në kënaqësinë e Zotit. Sasisë nuk duhet t'i kushtohet shumë vëmendje, sepse ndonjëherë të udhëzosh një njeri të vetëm tek e

3. Buhari; Muslim

4. Hud, 11:29

vërteta mund të jetë aq e kënaqshme për Allahun, aq sa të drejtoje njëmijë njerëz. Për më tepër, sinqeriteti dhe bashkimi me të vërtetën kërkojnë që njeriu duhet të dëshirojë që myslimanët të përfitojnë nga njëri-tjetri, cilido që të jetë burimi i përfitimit dhe cilido të jetë personi nga i cili vjen ai përfitim.

Kjo botë është bota e shërbimit dhe jo e shpërblimit. Shpërblimi për punët e mira dhe për aktet e shërbimit jepen në botën e ndërmjetme dhe të përtejme. Meqenëse realiteti është ky, atëherë rezultatet e shërbimeve për hir të Zotit dhe e veprimeve që lidhen me botën e përtejme, nuk duhet të kërkohen në këtë dynja, madje as edhe me zemër. Dhe në qoftë se ato do të jepeshin, le të konsiderohen thjesht një mirësi hyjnore, duke mos mbetur nën obligimin e njerëzve. Sepse nuk është prej urtësisë t'i këpusim frutat e xhenetit në këtë jetë kalimtare. Asgjë materiale nuk duhet të kërkohet si shpërblim për shërbimin fetar, me qëllim që të mos humbasë sinqeriteti. Parë në këtë këndvështrim, çdo vështirësi, mundim dhe fatkeqësi në shërbim të kënaqësisë së Zotit, është e këndshme dhe pa u ankuar të falënderojmë Allahun duke thënë: "El hamdu lilahi ala kuli hal" – Lavdi Zotit në çdo gjendje qofshim.

Njeriu nuk duhet të jetë posaçërisht ambicioz, i pangopur, tepër kërkues, tepër i dhënë dhe i pasionuar pas diçkaje. Edhe kjo botë, edhe bota e përtejme Allahut i përkasin. Disa herë, humbjet në këtë botë bëhen shkak për fitime në atë botë. Zoti të merr këtu e të jep atje. Ndërkaq, ne nuk mund ta dimë se çdo të na japë si kundërvlerë të atyre që na ka marrë dhe se me ç'supriza do të përballemi. Në suren "Duha", Profetit i thuhet drejtpërdrejt duke ia bërë të ditur se bota e përtejme është më e dobishme se kjo e para. Atëherë, kur e fundit qenka më e dobishme se e fillimit, pse duhet të mërzitemi për humbjet?! A nuk duhet të falënderojmë e të gëzohemi duke menduar fitimin e nesërm?

Bëhet e qartë se "e dobishmja është ajo që ndodhet në zgjedhjen e Zotit". Duhet që të jemi dakord me atë që është "shkruar" dhe ka

miratuar Zoti. Kjo është një shprehje e tillë kënaqësie para Allahut, e cila mbart brenda saj shumë hollë kuptimet e adhurimit, nënshtrimit, sinqeritetit dhe principialitetit. I dërguari i Allahut na ka mësuar një lutje për ta kënduar në mëngjes e mbrëmje:

"*Jemi të kënaqur me Allahun, Zotin tonë, me Hz. Muhamedin (a.s.), profetin tonë dhe Islamin, fenë tonë*"[5].

Me që jemi të kënaqur me të gjitha këto, le t'u bindemi atyre dhe me gjithë qenien tonë të jemi dakord me Zotin dhe me atë që pëlqen Ai. Më e bukura dhe më e mira e të gjithave është ajo që bën Allahu. Jo dëshira jonë, por e Zotit, jo kërkesa jonë, por e Zotit (xh.sh.).

Ajo që mbetet të themi është: Duro ndaj sprovave me një durim të bukur. Besoji Allahut dhe mbështetu tek Ai. E vetmja monedhë e vlefshme në botë e në përjetësi është fitimi i kënaqësisë së Tij. Kërkoje Zotin dhe përpiqu ta gjesh Atë. E kur ta gjesh, bjer në sexhde, vëre ballin në tokë dhe falëndero sa të jesh gjallë.

5. Tirmidhi

BESIMI DHE RRUGA DREJT ORIENTIMIT

Në Islam, veprimi më i lartë pas besimit, siç dihet, është namazi. Në namazet që falim gjatë 24 orëve, bashkë me synetet, suren Fatiha e përsërisim 40 herë. Në përsëritjen që i bëjmë kësaj sureje të caktuar të Kuranit në çdo rekat të namazit, duhet të ketë shumë urtësi. Një nga këto urtësi është kuptimi i thellë që përmban ajeti "**Ihdinas-siratal mustekim**" (**Na udhëzo në rrugë të drejtë**). Kërkesa për të hyrë në "Sirati Mustakim", domethënë në rrugën e drejtë që të çon tek Allahu, do të thotë që, mbi gjithçka, të kërkosh të nderohesh me Islamin. Atëherë, ç'kuptim ka kjo lutje këmbëngulëse e përsëritur çdo ditë nga 40 herë, për një njeri që në fund të fundit është mysliman dhe fal namaz? Ajeti-argument i formës "**Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë "Ne besojmë", pa u vënë në provë?!**"[6], na bën të ditur në këtë çështje dhe na lajmëron se njeriun, qoftë edhe pasi të ketë besuar, e presin shumë rreziqe dhe ngatërresa.

Kjo botë plakë mbi të cilën jetojmë, është kthyer sot në një panair prej qindra idesh e rrymash ideore. Ekzistojnë miliona prezantues, propagandues të çdo ideje e rryme. Po të futeshin në hesap edhe mundësitë e komunikimit të epokës sonë, të cilat nuk njohin pengesë në përhapjen

6. Ankebut, 29:2

në botë të ideve dhe rrymave, nuk do të vononim të kuptonim se gjer në ç'shkallë janë ngatërruar me njëra-tjetrën e vërteta dhe e shtrembra dhe se si e shtrembra ka marrë pamjen e së vërtetës. Përballë gjithë kësaj rrëmuje idesh e bindjesh, sa kuptimplotë është fakti që një mysliman të kërkojë 40 herë në ditë në audiencën hyjnore rrugën e drejtë ose të lutet që të vazhdojë të ecë në rrugën e orientuar. Siç shprehet edhe në Kuran:

"**Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet Ti je Dhuruesi i Madh!**"[7]

Le të pranojmë se teknika dhe komforti që sollën shkencat eksperimentale deri në shekullin tonë, kanë siguruar rehatinë e disave. Mirëpo ato në asnjë mënyrë nuk kanë siguruar lumturinë e njerëzimit. A nuk e shohim se bota e qytetëruar që zotëron pamjen e jashtme të jetës tokësore, por që është plotësisht e paditur për jetën tjetër, përpëlitet nën dhimbjet therëse të padurueshme të imoralitetit dhe pamundësisë për të kënaqur vetveten? Çështë e drejta, as pasuria, as popullariteti, as komforti dhe as femra nuk ka mundur të qetësojë egon e njeriut. Përparimet e arritura në përmasa botërore, mundësitë që kemi shtënë në dorë, sikur të ishin armiq të jetës sonë shpirtërore, na kanë zhdukur prehjen e zemrës e na kanë rrëzuar në gjendjen e njeriut të hutuar që s'mund ta dijë se ç'duhet të bëjë. E ç'duhet të bëjë më në fund, njeriu i ndodhur mes rrymash perverse të shekullit tonë? Atëherë mbetet të themi se ne kemi nevojë për t'u orientuar, domethënë kemi nevojë për ta orientuar njëri-tjetrin dhe për ta ndihmuar në mënyrë reciproke në rrugët plot gjemba që të çojnë për në xhenet, që është simboli i lumturisë së amshuar.

Siç nuk ka asnjë rrugë tjetër për të shkuar te Zoti përveç qëndrimit besnikërisht në rrugën e Tij, nuk ka asnjë pozitë të lartë se sa ruajtja e kësaj rruge në çdo çështje, por dhe asnjë urdhër më të vështirë se sa zbatimi i saj siç duhet. Por, Allahu i përgëzon kështu njerëzit e kësaj rruge:

7. Al'Imran, 3:8

"**Ata që thanë: 'Zoti ynë është Allahu' dhe qëndruan besnikërisht, për ta nuk ka frikë dhe ata nuk do të pikëllohen. Ata do të jenë banorë të xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë, si shpërblim për atë që kanë punuar**"[8]. Sipas transmetimit të Enesit (r.a.), i dërguari i Allahut (s.a.s.) lexoi ajetin:

"**S'ka dyshim se ata që thanë: 'Zoti ynë është Allahu', pastaj vazhduan të vendosur në rrugë të drejtë, atyre u zbresin engjëjt (para vdekjes) dhe u thonë: Mos u frikësoni e mos u pikëlloni dhe gëzohuni me xhenetin që ju është premtuar**"[9]. Pastaj ai tha:

"*Njerëzit gjithmonë e kanë thënë këtë, por pastaj shumica e tyre ranë në kufër. Kush vdes mbi këtë fjalë, është nga ata të cilët janë në rrugë të drejtë*"[10].

Pra, të qëndrosh besnikërisht në rrugë të drejtë është i domosdoshëm për çdo besimtar, por është e vështirë ta mbash dhe ta ruash. Nderi i një rezultati që fitohet, ngaqë ka lidhje me vuajtjet me të cilat duhet përballur për ta mbërritur, njerëzit e kësaj rruge kanë fituar nder të madh dhe pozitë të lartë, si shpërblim i sakrificave të larta me të cilat e kanë paguar.

Detyra e falënderimit që duhet të kryejë robi që është mirënjohës ndaj Zotit, gjithsesi nuk duhet të mbetet vetëm me fjalë. Falënderimi i një njeriu që ia ka arritur rrugës së drejtë duke iu kushtëzuar rregullit 'falënderimi i çdo të mire bëhet me anë të llojit të saj', do të realizohet përmes rrugës së përpjekjeve të tij për t'i futur edhe të tjerët në rrugë të drejtë. Të qenit fetar, nuk është identiteti vetëm i këndimit të lutjeve të njohura ose i kryerjes së ceremonive të adhurimit. Ai është i nevojshëm vazhdimisht si uji që pimë, si ajri që thithim. Ai është çdo kohë i domosdoshëm si dielli që jep jetë. Njeriu fetar ka nevojë për një atmosferë fetare e për një mjedis islam. E pranoni dhe ju se krijimi i një atmosfere dhe zhvillimi i një mjedisi të tillë nuk është i mundur vetëm me zellin dhe përpjekjet e

8. Ahkaf, 46:13-14
9. Fussilet, 41:30
10. Tirmidhi

shërbyesit të fesë. Në këtë kuptim, të gjithë myslimanët janë orientues. Dhe një veprimtari orientuese e tillë nuk bëhet vetëm me fjalë, madje, disa herë më parë se me fjalë, mund të çohet përpara me akte dhe veprime. Njeriu i kauzës së lartë, një ideologji që e ka përqafuar dhe e jeton vetë, kërkon t'ua përjetojë edhe të tjerëve. Nëse nuk i shohim shenjat e kësaj kërkese dhe dëshire, mbetemi të detyruar të mendohemi mbi fisnikërinë dhe sinqeritetin e tij apo mbi drejtësinë e ideologjisë së tij.

Myslimani i vërtetë e kalon jetën e tij midis veprave të dobishme për dynjanë dhe ahiretin. Qoftë edhe një çast ai nuk i mendon fjalët dhe punët e pafrytshme. Ai është i detyruar të jetojë një jetë tepër të kujdesshme dhe nuk duhet të largojë asnjëherë nga kujtesa se një fjalë apo një veprim, mund ta fundosi njeriun thellë në kënetë. Atëherë le të lutemi: Zoti im, dhe në bëfsha pabesi duke ndenjur larg Teje, gjendja ime thërret me të madhe se nuk do të mund të rri pa Ty. E kërkoj favorin Tënd jo për të shpëtuar prej pabesisë sime, por se kam aq shumë nevojë për Ty!..

LEXO ME EMRIN E ZOTIT TË BOTËVE

Allahu (xh.sh.), përmes Kuranit dhe Profetit (a.s.), iu bën thirrje besimtarëve të kërkojnë diturinë, herë në formë këshille e nxitje dhe herë në formë urdhërore. Vetë fakti që fjala e parë e shpallur ishte "Lexo", tregon për vlerën dhe nivelin, në të cilin Islami e ngre diturinë. Në Kuran, fjala dituri përmendet në 660 vende, ndërsa në fjalët e Profetit ajo llogaritet me vlerën e adhurimeve të kryera ndaj Allahut të Madhërishëm. Me shpalljen e ajetit të parë:

"**Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi**"[11]

dhe në shumë ajete të tjera të ngjashme, Kurani fton për hulumtim të gjithësisë dhe të rolit të njeriut në gjithësi, në mënyrë që të zbulohet harmonia dhe ligjet e kësaj bote, duke i hapur kështu njeriut rrugën e mendjes dhe zemrës për kah Krijuesi. Ky është, sipas fesë islame, qëllimi i jetës në këtë botë kalimtare dhe parakusht i lumturisë për në botën e amshueshme.

"Ikra - Lexo", është një urdhër hyjnor, i shpallur njeriut si qenia më e nderuar. Ky urdhër është përgjegjësi dhe një ftesë e hapur për njeriun, për t'u bërë partner i përsosmërisë së pafundme dhe sakrifikues për arritjen

11. Alak, 96:1

e saj. Kështu pra, duke lexuar, njeriu do të arrijë të kuptojë, ndonjëherë do të kuptojë gabim, por mbi të gjitha do të fitojë përvojë, do t'i përftojë vetes bindje dhe besueshmëri, saktësi e siguri.

Tjetër gjë është të shohësh, tjetër të vëresh, tjetër gjë është të kuptosh, tjetër ta përvetësosh me vetëdije dhe zemër atë që e kuptove dhe, pas gjithë kësaj, është krejt tjetër ta praktikosh, ta vësh në zbatim dhe t'ua përçosh atë të tjerëve. Prandaj, të jesh mysliman, do të thotë të jesh në një këndvështrim, më përgjegjës sesa të tjerët, por edhe po aq i kujdesshëm dhe shpirtgjerë, sepse krahas respektimit të parimeve shoqërore, kërkohen dashuria dhe mirëkuptimi, dhembshuria dhe butësia; krahas durimit dhe tolerancës, kërkohen dituria, vullneti, urtësia, ekuilibri... pra, aftësitë përmbledhëse e plotësuese.

Të nxitur nga Kurani dhe porositë profetike, shumë myslimanë iu përkushtuan arritjeve të diturisë. Ata nuk studiuan vetëm shkencat islame, por edhe shkencat natyrore, humane e shoqërore. Në fund rezultatet nuk munguan, pasi arritjet e tyre kontribuuan në zhvillimin e shkencës moderne. Sot janë të njohur me qindra myslimanë që ndihmuan zhvillimin e shkencës. Falë kontributit të tyre janë ndërtuar edhe themelet e disa shkencave, siç është ajo e algjebrës. Fatkeqësisht, këtë stafetë, myslimanët e lanë në harresë dhe po t'i referohemi shekullit të kaluar, shumica e arritjeve shkencore, teknike e teknologjike, nuk i përkasin botës islame.

Qëndrimi larg shkencave pozitive, me frikën se çojnë drejt ateizmit, është një kujdes i tepruar. Po ashtu, edhe trajtimi i tyre si pretekst që shpie në mohim, duke i konsideruar ato në tërësi, si kontradiktore të fesë dhe besimit, është paragjykim dhe konservatorizëm. Shkencat janë të dobishme për aq sa kontribuojnë në lumturinë tonë dhe sjellin zhvillim për njerëzimin. Njeriu nëpërmjet arsimit dhe shkencës kupton esencën e ekzistencës së tij, pasi zbulon vetveten, kupton gjithësinë dhe njeh Krijuesin e tij. Kjo ishte arsyeja pse Profetit Muhamed (a.s.) ajetet e para i zbritën për studim e hulumtim, e jo për adhurim.

Dituria duhet patjetër t'i shërbejë njeriut. Po qe se nuk është në shërbim të tij, atëherë ajo është e padobishme dhe madje e rrezikshme. Asnjë fenomen, që ndodh në rruzullin tokësor, duke përfshirë natyrën, qiejt e tokën, nuk mund të kuptohet pa dije. Nëse dija nuk do të shfrytëzohej si duhet, atëherë nuk do të ishim në gjendje që të përfitonim prej favoreve të panumërta që Allahu i Madhërishëm na ka dhuruar e na dhuron pa ndërprerje.

Meqenëse jetëgjatësia e njeriut është e paracaktuar dhe mundësitë të kufizuara, është e pamundur që të mësohen të gjitha dituritë e shkencat, si dhe të përfitohet prej tyre. Nisur nga kjo, çdo individ duhet të mësojë dhe t'i vërë në punë dijet e përftuara, duke i vënë në shërbim të vetes, shoqërisë dhe kombit, pa qenë e nevojshme ta çojë dëm jetën me gjëra që nuk i vlejnë.

Qëllimi i të mësuarit, është që dija t'i bëhet njeriut prijës dhe udhërrëfyes, që t'i ndriçojë udhët që çojnë drejt përsosjes njerëzore. Për rrjedhojë, dituritë dhe shkencat që kanë anashkaluar aspektin shpirtëror, pse jo edhe duke e shmangur plotësisht atë, janë vetëm barrë mbi shpinë për njeriun. Ja se si shprehet për këtë poeti i njohur turk Junus Emre:

Dituri do të thotë të dish,
Do të thotë veten të kuptosh;
E nëse ti veten s'e kupton,
Ç'të vlen kaq shumë të lexosh?

VLERA E NIJETIT NË FENË ISLAME

Profeti (a.s.) thotë: "*Veprat vlerësohen sipas nijetit (qëllimit) dhe çdo njeriut i takon ajo që ka për nijet*"[12]

Njeriu është krijuar në formën më të bukur nga Zoti dhe si i tillë, kërkohet prej tij që punët ti ketë të bukura me qëllim të patër dhe në përputhje me kënaqësinë e Zotit. Për të arritur këtë, fillimisht duhet një përkushtim dhe nijet i pastër, pastaj purifikimi nga çdo interes vetjak dhe dëshira materiale, duke u ngjitur gjithmonë pas idealeve të larta morale e shpirtërore.

Nijet do të thotë qëllim, vetëdije dhe vendosmëri. Nijeti që e drejton njeriun në një punë ose veprimtari praktike, patjetër që në përfundim mund të bëhet edhe shpëtuesi i tij. Nijeti është shpirti i veprës dhe veprat pa nijet quhen të vdekura. Që vepra të ketë vlerë, varet nga nijeti nëse bëhet për hir të Allahut. Hixhreti pa një nijet të tillë është një shëtitje turistike, xhihadi është dhunë e padrejtësi, haxhi është një udhëtim mashtrues, namazi është fizkulturë dhe agjërimi dietë ose perhiz. Shndërrimi i këtyre adhurimeve për njeriun në fitimin e kënaqësisë së Zotit, mund të bëhet vetën nëse ato prihen nga nijeti për adhurim. Në një hadith Profeti Muhamed (a.s.) thotë:

12. Buhari; Muslim

"*Nijeti i besimtarit është më i dobishëm sesa vepra e tij*"[13].

Sepse sado që të përpiqet, njeriu nuk mundet ta arrijë ta kryejë punën e menduar në nijetin e tij. Është mëshira e gjërë e Zotit që më shumë se për punën e kryer, njeriu trajtohet për nijetin në brendësi të tij. Për rrjedhojë, ato që i ka përftuar nijeti njeriut, janë shumë më tepër se ato që i ka përftuar puna apo vepra e tij. Ja, në këtë aspekt, nijeti i besimtarit është më i dobishëm se sa vepra e tij.

Në sajë të nijetit, njeriu mund të shtjerë në dorë gjëra shumë të mëdha e shumë të vlefshme me një përpjekje të vogël dhe me shpenzime shumë të pakta. Nijeti është një eliksir i bukur e enigmatik, që e shndërron të mirën në të keqe dhe të keqen në të mirë. Lidhur me këtë Profeti ynë thotë:

"*Kush don që të bëjë një të mirë e nuk e bën, Allahu i Lartësuar i shkruan një të mirë (sevap) të plotë. Por kur don që ta bëjë atë dhe e bën, Allahu atij do t'ia shkruajë dhjetë deri në shtatëqind e më shumë të mira. E nëse ka dashur të bëjë një të keqe, por nuk e ka bërë, Allahu i shkruan atij një të mirë të plotë. Nëse ka dashur ta bëjë atë (të keqe) dhe e bën, Allahu atij do t'i shkruajë një të keqe*"[14] .

Çfarëdo veprimi që ndërmerret për hir të Zotit, nuk mund të ndahet në sasira të vogla apo të mëdha, të vlefshme apo të pavlefshme. Sa gjëra të vogla në dukje ka, që në sajë të nijetit rriten e fitojnë përmasa; kokrra bëhet kalli dhe pika e ujit, det. Dhe ç'energji e ç'favore në përmasat e një mali, shumë herë mbeten shterpë, thjesht si pasojë e një nijeti të ligë. Një veprim i vogël sa një atom që kryhet me nijet për kënaqësinë e Zotit, zmadhohet e bëhet shumë e shtrenjtë tek Krijuesi ynë. Një gram nga veprat e mira që kryhet me nijet, është më e preferueshme se sa një ton nga veprat që kryhen pa nijet. Shprehitë dhe zakonet e njeriut marrin vlerën e adhurimeve sipas nijetit. Për një njeri që bie të flejë me nijetin e adhurimit, edhe frymëmarjet në gjumë madje, marrin vlerën e zikrit,

13. Taberani
14. Buhari; Muslim

përmendjes së Zotit. Fundja, po të mos ishte kështu, si mund të fitohej xheneti në një kohë kaq të shkurtër, me kaq pak vepra?! Në Musnedin e Ebu Ja'lës tregohet se i dërguari i Allahut ka thënë:

"*Ditën e kijametit, Allahu i Madhëruar do t'u thotë engjëjve që regjistronin veprat e njerëzve: Shkruajini robit tim kaq e kaq shpërblim. Engjëjt thonë: O Zoti ynë, ne nuk e kemi regjistruar këtë punë në librin e tij?! Ndërsa Allahu u përgjigjet: Ai e kishte ndërmend ta bënte*"[15] .

Në një hadith tjetër të transmetuar nga Ebu Hurejre thuhet se ditën e kijametit, njeriu merr një libër nga e djathta. Aty lexon se ai ka bërë haxh, xhihad, ka dhënë sadaka, të cilat në të vërtetë nuk i kishte kryer, prandaj thotë:

"*O Zot! Ky nuk është libri im, sepse unë nuk kam bërë asnjë prej këtyre punëve! Ndërsa Allahu i Madhëruar përgjigjet: Ky është libri yt, sepse ti jetove gjatë pa bërë asgjë nga këto, por duke thënë: Sikur të kisha para do të shkoja në haxh dhe do të jepja sadaka. Unë e dija që ti ishe i sinqertë dhe të dhashë shpërblimin e plotë të këtyre punëve*"[16].

Si përfundim, mund të themi se nijeti është gjithçka në jetën e besimtarit. Ashtu siç është ai që u jep gjallëri veprimtarive të vdekura të individit, është prapë ai që e shndërron komplet jetën e një bote të kufizuar. Është ky nijet që hap të gjitha dyert e dritaret që shohin drejt lumturisë së amshuar, ashtu siç është po ai që përgatit fatkeqësinë e amshuar dhe humbjen e përjetshme.

15. Darekutni
16. Ahmed

KURANI OFRON SISTEMIN MË TË PËRKRYER PËR NJERËZIMIN

Për Kuranin Famëlartë janë shprehur shumë njerëz me fjalë të mrekullueshme gjatë 14 shekujve. Ajo që na takon neve sot, është që t'i përcjellim këto të vërteta në mënyrën më të kuptueshme dhe më të vlefshme për shoqërinë shqiptare. Ndryshe nga sistemet e tjera, që janë ndërtuar nga dora e njeriut, Kurani është një kushtetutë hyjnore, që ofron sistemin më të përkryer, duke i dhënë njeriut orientime për të kuptuar e ndërtuar jetën personale, familjare e shoqërore në tokë. Zoti e ka bërë këtë nëpërmjet njerëzve të zgjedhur nga Ai, profetëve, duke dërguar libra e broshura edhe përpara zbritjes së Kuranit.

Kurani, si libri i fundit hyjnor, është i pacenueshëm dhe i pandryshueshëm deri në ditën e fundit të kësaj bote, kjo për faktin se vetë Zoti e ka marrë nën mbrojtje prej armiqve të mundshëm. Nëse do ta shprehnim me një fjali gjithëpërfshirjen e tij, do të thonim se Kurani krijon raportin mes individit dhe Krijuesit, individit me veten e tij dhe individit me shoqërinë. Kurani na tregon se çfarë është feja, dashuria, bukuria, virtyti e keqja dhe e mira. Aty do të gjejmë dispozita të mjaftueshme se si të rregullojmë moralin dhe marrëdhëniet në mes njerëzve, si dhe të drejtat për të gëzuar të mirat materiale e shpirtërore.

Kurani është i vetmi libër që urdhëron drejtësinë e vërtetë, lirinë e vërtetë, barazinë e drejtpeshuar, dobinë, nderin, virtytin, dhembshurinë ndaj të gjitha qenieve gjer te kafshët, që ndalon hapur dhunën, politeizmin, padrejtësinë, injorancën, mitet, fajdenë, gënjeshtrën, dëshminë e rreme... Përsëri është vetëm Kurani libri, i cili, duke marrë nën mbrojtje bonjakun, të varfrin dhe viktimën, i barazon mbretin me shërbëtorin, komandantin me ushtarin, akuzuesin me të akuzuarin dhe i gjykon...

Kurani Fisnik, i cili, pasi në krye, thekson se të gjithë njerëzit janë të ndarë në fise prej një familjeje që është e bashkuar në një unitet fillestar, vë në dukje se nderi dhe fama e të gjithë individëve, të cilët janë të barabartë në pikëpamjen e krijimit, gjendet vetëm në devotshmëri dhe se nuk ka asnjë individ apo grup më të lartë se të tjerët. Bashkë me këtë, ky libër i madhërishëm, zgjon në zemra e shpirtra idenë e virtytit dhe shpall se nuk kanë ndonjë vlerë apo meritë lavdërimi ata, të cilët nuk e pajisin ndërgjegjen e tyre me mesazhin e tij universal. Këto mesazhe të larta, tregojnë se themelimi dhe stabilizimi i një sistemi, si dhe mbarëvajtja e tij, janë kushtet thelbësore për të pasur një jetë të rregullt që garanton lumturinë e njerëzimit.

Kurani është fjalë hyjnore e zbritur për njeriun, për t'i dhënë atij mundësinë që të jetë bashkëbisedues me Zotin dhe meritor i emërtimit "krijim i bukur". Në klimën e ndritshme të Kuranit, njeriu bëhet pjesë e realitetit fizik e shpirtëror, sheh ringjalljen dhe Siratin, mendon për dënimin e shpërblimin dhe aspiron të shëtisë në majat e gëzuara të parajsës... Zoti urdhëron e thotë:

"**Sikur këtë Kuran t'ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (malin) të përulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut. Shembuj të tillë Ne ua japim njerëzve që ata të meditojnë**"[17].

Po qe se, duke iu marrë parasysh madhështia, do t'u ishte zbritur maleve, do të shihnit se si malet do të bëheshin copë-copë. Sigurisht, nga

17. Hashr, 59:21

impresionimi dhe tronditja para Allahut, malet do të rrënoheshin, kurse njeriu s'pëson gjë, sepse e mban mendjen dhe zemrën larg Kuranit. Njeriu, i cili nuk i bën vend Kuranit në mendje dhe në botën e vet të brendshme, gjithsesi nuk do të ketë pjesë prej tij. Myslimanët kanë mundur të arrijnë unitetin mes tyre vetëm me anë të besimit dhe besnikërisë ndaj Kuranit dhe kështu ka për të ndodhur edhe në të ardhmen. Ata që nuk i qëndrojnë besnikë Kuranit, jo vetëm që s'mund të jenë besimtarë të mirë, por edhe as që mund të ngrenë një unitet të qëndrueshëm mes tyre.

Problemi qëndron në qasjen ndaj metodologjisë hyjnore, me ç'rast myslimani i mëhershëm bashkëvepronte me Kuranin në sajë të faktit se është sistem i vlerave, udhërrëfyes, kandil ndriçues, ushqyes i mendjes dhe shpirtit, platformë e shëndoshë për ndërtimin e institucioneve të sistemit, frymëzues, që njeriut i ofron përgjigje për pyetjet më enigmatike: kush është ai, nga erdhi dhe si do të jetë fundi i tij dhe botës që e rrethon, kush e krijoi universin, cila është zanafilla e tij, etj. Libër, i cili myslimanëve ua mësoi parimet për projektin madhështor për ngritjen e një qytetërimi të paparë deri atëherë. Praktikisht kjo ndikonte pozitivisht në lidhjen dhe qasjen serioze ndaj Kuranit Fisnik.

Qasja jonë e gabuar manifestohet në faktin e anashkalimit të njohurive dhe të vërtetave kuranore, ku kryesisht bëhet lexim sipërfaqësor larg meditimit, analizimit të argumenteve racionale, që i drejtohen njeriut, porosive për ngritje morale e shpirtërore. Sistem, të cilin e kishte praktikuar vetë Profeti (a.s.) duke i mësuar shokët e tij, që raporti i tyre ndaj Kuranit të jetë raport bashkëveprimi, i cili duhet materializuar në jetën e përditshme, sikur janë porositë, udhëzimet, urdhëresat e ndalesat kuranore.

Por, sot, raporti ynë me Kuranin është sipërfaqësor. Sa për ilustrim, më tepër na intereson sa ishte i gjatë Ademi (a.s.), sa gërma ka Kurani, kush i lidhi në martesë Ademin me Havën, etj. Para nesh kalojnë një numër i madh ajetesh, të cilat ftojnë në logjikë, meditim, që dëshmojnë për përsosurinë e krijimit të njeriut, për marrëdhëniet njerëzore, etj. Jo më kot thotë Zoti në Kuran:

"**A nuk e studiojnë me vëmendje Kuranin? Por jo, ata i kanë zemrat e kyçura**"[18].

Si përfundim, me gjithë problematikat e veta, shoqëria njerëzore, sot e gjithmonë, gjen në Kuran mesazhin e Krijuesit, i Cili e udhëzon njerëzimin se si të gjejë rrugën e shpëtimit dhe çelësat e lumturisë. Kurani i nxit të gjithë njerëzit, femra e meshkuj, që të kërkojnë diturinë e dobishme, të dallojnë të mirën nga e keqja, të punojnë e të fitojnë me djersën e ballit. Meqenëse Kurani është një libër formues e orientues, që kultivon dashuri dhe mbjell frymë paqeje, njerëzit duhet të jetojnë me të, sepse ai është udhërrëfyes për të gjithë ata, të cilët iu përmbahen këshillave dhe mësimeve të tij.

18. Muhamed, 47:24

AI (A.S.), DHURATË E MADHE PËR BESIMTARËT

Në sajë të "dritës", që Zoti e krijoi në cilësinë e një dielli dhe që e zbriti si një kandil në qiellin e njerëzimit, të gjitha errësirat e injorancës u grisën dhe gjithësia u përfshi nga ndriçimi. Kjo "dritë" është mirësia më e gjerë dhe favori më i madh i Zotit për xhindet e njerëzit. Që kjo është kështu, na e thotë vetë Zoti ynë në Kuran:

"**Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjirir i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) dhe urtësinë (diturinë e thellë fetare)**"[19].

Profeti Muhamed (a.s.) është profeti i fundit që Allahu i dërgoi njerëzimit. Ai është njeriu më i lartë, më me vlerë dhe më i respektuari nga të gjitha krijesat e tjera. Ai është profeti i mëshirës dhe i dashurisë. Allahu e dërgoi atë si mëshirë për gjynahqarët e të devotshmit, për gratë e fëmijët, për besimtarët e mohuesit, për njerëzit e xhindet. Madje, Allahu praninë dhe ekzistencën e Muhamedit (a.s.) në tokë, e bëri garanci dhe siguri për të gjitha krijesat, kur thotë:

"**Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty, veçse si mëshirë për botët**"[20].

19. Al'Imran, 3:164

20. Enbija, 21:107

18. Muhamed, 47:24

Kush nis të kërkojë në shkrimet e shenjta, gjen se qëllimi më i madh i tyre është mëshira, njohja e njëri-tjetrit, ruajtja e marrëdhënieve etj. Kurani Famëlartë dhe suneti i Profetit janë ftesë e hapur për largimin e përçarjeve, urrejtjes dhe smirës. Në shpalljen hyjnore Allahu lavdëron mëshirën dhe butësinë. Ai në Kuranin Famëlartë thotë:

"**Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje**"[21].

Kur lexojmë me kujdes jetën e Profetit (a.s.), del në pah ana e tij e butësisë, faljes dhe mëshirës. Po të na shohësh sot, nëse krijojmë armiqësi me dikë, nuk lëmë vend për paqe e afrim, e as shans për bisedim, por i presim të gjitha mundësitë e mëshirës dhe shkatërrojmë të gjitha urat e bashkëbisedimit dhe faljes. Kush sheh shoqërinë tonë, gjen se ne jemi të ashpër me njëri-tjetrin, jemi të ashpër me ata që kemi kontradikta, nuk jemi të drejtë kur gjykojmë, veprojmë pa menduar, nëse nuk na pëlqen mendimi sulmojmë të zotin e tij pa kufi. Sikur u kërkohet njerëzve që të bien dakord me ne për gjithçka, të na e bëjnë qejfin për gjithçka, sikur mendimet tona të ishin shpallje hyjnore dhe sikur e drejta të na shoqëronte kudo. Në legjislacionin islam, ka ura bashkëpunimi dhe afrimi më shumë nga ç'mund të përshkruhet. Ne jemi të mëshirshëm e të mirë me vetet tona, lavdërojmë çdo gjë që bëjmë, justifikojmë çdo gabim tonin, e mbrojmë veten prej çdo veprimi, kurse nga ana tjetër gjykojmë gabimet e të tjerëve, qortojmë me të madhe çdo gabim të tjetrit, e nganjëherë s'e pranojmë pendimin, e aq më pak justifikimin e tyre.

Duke qenë se Profeti (a.s.) është krijesa më e dashur tek Allahu (xh. sh.), ashtu duhet të jetë edhe për ne që pretendojmë se ndjekim rrugën e tij. Dashuria për profetin (a.s.) është njëkohësisht dhe dashuri për bukurinë dhe fisnikërinë e karakterit të tij, për drejtësinë, modestinë dhe forcën e brendshme të njeriut dhe që profeti e zotëroi në shkallën më të lartë. Myslimanët obligohen që dashurinë ndaj tij ta vendosin mbi

21. Al'Imran, 3:159

dashurinë ndaj çdo krijese tjetër, përfshi këtu veten dhe të dashurit e tyre. Për këtë, në hadithin e transmetuar nga Enesi (r.a.), Profeti (a.s.) ka thënë:

"*Askush prej jush nuk do të jetë besimtar i vërtetë, derisa të bëhem për ju më i dashur se prindërit tuaj, fëmijët tuaj dhe të gjithë njerëzit e tjerë*"[22].

Jetesa e Profetit (a.s.) nga njëra anë na nxit të lakmojmë arritjen e përsosmërisë dhe nga ana tjetër na ndihmon të pranojmë paaftësinë tonë për të qenë të pagabueshëm duke na shtyrë të jetojmë në paqe me veten si robër të penduar të Zotit, me shpresë në mëshirën e madhe të Tij. Që besimi ynë të jetë i shëndoshë dhe i plotësuar, duhet ta duam Profetin tonë duke ndjekur rrugën e tij dhe duke u lutur për të sipas urdhrit kuranor:

"**Vërtetë, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me selam**!"[23]

22. Buhari; Muslim
23. Ahzab, 33:56

HUMANIZMI I PROFETIT MUHAMED (A.S.)

Në të vërtetë, lindja e këtij njeriu madhështor ishte shpëtim për mbarë njerëzimin, për sa i përket besimit, adhurimit, moralit, drejtësisë, thjeshtësisë, etj. Këtë njeri e zgjodhi vetë Krijuesi i gjithësisë me dëshirën e Tij absolute, sipas parametrave hyjnorë dhe jo atyre njerëzorë. Muhamedi, i biri i Abdullahut (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të), duke qenë vula e mbarë të Dërguarve dhe Pejgamberëve, shndriti gjithë rruzullin tokësor me shembullin e tij konkret në të gjitha aspektet e kësaj jete materiale.

Ai zotëri, jo vetëm që është nderuar, respektuar dhe rruga e tij profetike është ndjekur nga myslimanët në përgjithësi, por, siç dihet realisht, ai nderohet e vlerësohet edhe nga ithtarë të besimeve të ndryshme, të cilët i japin merita për të gjitha çështjet dhe respektohet me nderim nga dijetarë e shkencëtarë të mëdhenj, nga politikanë e filozofë të shquar, nga akademikë e letrarë të njohur të botës.

Në arabinë e asaj kohe, në Romën Lindore e në Iran, njeriu ishte ose një krijesë e egër, dhunuese, e trashë dhe e pamëshirshme, ose një qenie e robëruar, e dhunuar dhe e mjerë. Profeti Muhamed (a.s.) gjeti para vetes sundimtarë që krijesat e Zotit i kishin bërë shërbëtorë dhe skllevër, pa

gëzuar asnjë të drejtë njerëzore. Ai erdhi në një kohë kur morali kishte rënë përtokë, luftërat dhe konfliktet ishin përhapur tej mase, i forti mundte të dobëtin, i pasuri shfrytëzonte të varfrin, pra me një fjalë nuk ekzistonte asgjë njerëzore dhe asnjë ndjenjë shpirtërore. Hz. Muhamedi (a.s.) i qe dërguar profet një turme njerëzore, që, copën e drurit të sjellë nga mali, e gdhendte dhe e adhuronte si "Zot", që, pasi e gatuante hallvën me duart e veta dhe i jepte formë, e kthente në statujë dhe i përulej, pastaj kthehej dhe e hante kur të uritej. Ky profet, i cili u dërgua te një grup njerëzish që e groposnin vajzën të gjallë dhe nga ky veprim nuk ndjenin hidhërim e turp, por ngazëllim e krenari, nxori në shesh një komb të tillë, individët e të cilit u bënë model i gjallë i mëshirës e i delikatesës! Ai nxori nga çobanët e deveve, zotërinjtë e njerëzimit.

Ai ishte njeriu i paqes e i qetësisë. Ne e dimë dhe e besojmë kategorikisht se mesazhi që ai solli, ishte gjithashtu një burim paqeje e qetësie dhe për këtë, historia është dëshmitarja më e madhe. Ja pra, e vetmja zgjidhje për ta bërë njerëzimin që ta shijojë përsëri këtë paqe e qetësi, është që t'ua bëjmë të njohur njerëzve atë dhe dritën që solli ai, sepse në raport me sa do të njihet ai dhe në sajë të asaj dashurie, do të ndërrojë fytyra e shoqërisë.

Po të kishte dashur, ai mund të bëhej njeriu më i pasur i botës. A nuk ia patën propozuar këtë Kurejshët qysh në ditët e para të shpalljes së profetësisë së tij me kusht që të hiqte dorë prej çështjes së vet?! Edhe më pas, gjërat që jepnin myslimanët në rrugën e Allahut, të gjitha nëpër duart e tij kalonin. Dhuratat e ardhura prej sundimtarëve nuk kishin të llogaritur. Mirëpo ai kurrë nuk mori prej tyre ndonjë gjë për vete, madje as nuk i pati shkuar ndërmend një gjë e tillë!

Në qe kështu, atëherë duhej ta preokuponte zemrën me gjërat specifike që me të vërtetë u duhej dhënë rëndësi. Gjithashtu duhej t'u mësonte njerëzve rrugët që çonin tek të qenët njeri. Afrimi te Zoti ishte qëllimi i tij parësor dhe detyra për t'i çuar njerëzit tek i njëjti objektiv. Ja,

për këtë vuante e digjej ai! E ç'rëndësi mund të kishte pasuria e kësaj bote për një njeri në një pozicion të tillë?! Sigurisht, asnjë rëndësi. Atëherë, s'ia vlente të sakrifikoheshe për të…

Dërgimi i Muhamedit (a.s.) është mëshirë nga Allahu, që njerëzit t'i zgjidhin problemet e tyre në mënyrën më të drejtë e më humane, sepse Ai që na krijoi më së miri i di nevojat e krijesave, prandaj përmes Kuranit ofron udhëzime afatgjatë dhe të përsosur. Kush dëshiron nga ky shembull i humanizmit, le të mobilizohet dhe le të aktivizojë karakterin e vet njerëzor. Kjo do ta ndihmojë që të kuptojë dhe të bëhet qënie humane sipas shembullit të Muhamedit (a.s.) dhe vëllezërve të tij, pejgamberëve të tjerë.

PËRKUJTIMI I HIXHRETIT PROFETIK

Koha në të cilën jetojmë është e mbushur me ndodhi, raste e fenomene që na i kanë lodhur sytë duke i parë, veshët duke i dëgjuar, mendjen duke i menduar dhe në fund, asgjë për njeriun. E ç'është më e keqja, nga kjo lodhje ende nuk ka shpresë se njeriu do të arrijë momentin e qetësisë. Ky presion, ky stres dhe kjo torturë amorale, shihet në mosarritjen e një integrimi të nevojshëm, gjerësisht të dobishëm, të një bashkimi mbarënjerëzor, të një respekti reciprok dhe kështu me radhë, e cila do të ketë për bazë hyjnoren dhe të shenjtën. Për këtë arsye, duhet të jemi plotësisht të bindur se përkujtimi dhe rikujtimi i gjërave me vlerë të madhe në historinë islame, sikurse është hixhreti (emigrimi) i Muhamedit (s.a.s.), janë më se të nevojshme. Kjo ngjarje e madhe me rëndësi në historinë Islame njihet me emrin Hixhreti Profetik. Nisur nga rëndësia dhe roli i tij, myslimanët e kanë përcaktuar hixhretin si fillimin e kalendarit të tyre. Të gjitha ngjarjet historike më pas në fenë Islame, u renditën në bazë të kësaj pikënisjeje.

Hixhreti i Profetit Muhamed (s.a.s.) dhe i myslimanëve në vitin 622 drejt Medines, nuk ishte ikje nga frika për jetën e tyre, por një sakrificë e madhe realizuar vetëm për hir të Allahut dhe në shërbim të besimit. Myslimanët mekas lanë pas pjesëtarë të familjes, shtëpi, kopshte, pasuri

e tregti. Kjo përveç se pasqyron qartazi se hixhreti nuk është thjeshtë zhvendosje fizike nga një vend në një tjetër, shpjegon edhe se ai pasohet nga "pse"-të e braktisjes së gjërave. Njeriut i takon ajo çfarë ai synon dhe ka për qëllim.

Pa dyshim, emigrimi i myslimanëve nuk është as i pari dhe as i fundit emigrim në historinë e popujve. Emigrime janë bërë edhe para, edhe pas tij. Por duhet theksuar që, ato emigrime janë bërë për shkaqe materiale si thatësirë apo zi, fatkeqësi natyrore, luftë, frikë nga armiku ose për arsye ushtarake. Ndërsa hixhreti në esencë, ishte shpërngulje nga dobësia në fuqi dhe nga pesimizmi në shpresë, për një ardhmëri më të lumtur e më të ndritshme të Islamit. Për këtë arsye Allahu i madhëruar ia lejoi hixhretin të dërguarit të Tij. Nëpërmjet hixhretit, profeti (a.s.) ngriti shtetin Islam, shtetin e drejtësisë dhe të mirësisë, shtetin e dijes dhe të besimit, shtetin e virtytit dhe të moralit, shtetin e të drejtës dhe të devotshmërisë. Jo vetëm kaq, por thirrja e re e Profetit (a.s.) pas hixhretit, solli njeriun e ri, njeriun e nderuar dhe të lirë.

Përkujtimi i hixhretit në fillimin e çdo viti hënor, na bën më të ndërgjegjshëm dhe më të përgjegjshëm për rëndësinë e përpjekjes në rrugën e Zotit, në rrugën e shërbimit, në rrugën e paqes dhe tolerancës, dashurisë dhe respektit të thellë ndaj çdo njeriu. Prandaj besimtarët e ndershëm, duhet ta jetojnë hixhretin duke ruajtur me kujdesin më të madh mesazhin e tij, duke bërë hixhret të vazhdueshëm nga e keqja në të mirë, nga e shtrembëra tek e vërteta, nga ngushtësia në zemërgjerësi, nga tradhtia në besnikëri, nga dyfytyrësia në sinqeritet dhe çiltërsi shpirtërore.

KREMTIMI I FESTAVE NË ISLAM DHE RASTI I MEVLUDIT

Të treguarit interesim, qoftë në mënyrë individuale ose kolektive lidhur me ndonjë çështje, është diçka që ndodh nga natyra e njeriut. Rasti që festohet mund të jetë një ngjarje që ndodh në të tashmen ose që ka ndodhur në të shkuarën. Nga festimet për një ngjarje të tashme, bëjnë pjesë gëzimi kur ai bëhet synet, gëzimi i martesës që kur ajo lidhet e deri në ceremoninë përmbyllëse të saj, gëzimi që shfaqet për pritjen e një miku dhe për ardhjen e dikujt, gëzimi për suksesin në provime ose për fitoren në betejë, për begati në prodhime dhe të korra etj. Pra, këto ngjarje e të tjera të ngjashme me këto, mund të kremtohen e festohen. Nga festimet e të shkuarës është të kujtosh ato ngjarje që kanë ndodhur në vende dhe në kohë të caktuara. Kujtesa i sjell ndërmend ato ngjarje me qëllim që të përtërihet gëzimi e kënaqësia për to, ose që të nxirren mësime e këshilla prej atyre ngjarjeve.

Këto raste të cilat festohen, mund të jenë thjesht raste që lidhen me këtë botë, mund të jenë fetare, ose te ato ka ndonjë damar feje si domosdoshmëri e mos ndarjes së plotë midis çështjeve të dynjasë dhe atyre të fesë. Islami në lidhje me ato festime që i përket dynjasë nuk të ndalon. Islami ndalon ato raste, kremtimi i të cilave nuk ka motive e qëllime të mira, kur në to ka shfaqje që dalin nga caqet e legjislacionit

Islam ose shkaktojnë rezultate negative. Në kushtet e zakonshme, mes kohëve të ndryshme nuk ka ndonjë dallim dhe përparësi. Ndërkaq, disa data në historinë Islame kanë fituar veçanti dhe vlerë, ngaqë janë bërë skenë e disa ngjarjeve me rëndësi. Megjithëse këto kohë mbështeten në pretekste të ndryshme, janë raste shumë me vlerë që kanë një funksion të përbashkët në sigurimin e fuqizimit të besimit e të jetës besimore te myslimanët.

Ditët dhe netët e mira, ashtu siç i quan populli ynë, janë prej shenjave të Islamit dhe festohen prej shekujsh me radhë. Koha e këtyre është e përcaktuar sipas kalendarit hënor, e cila përmban 355 ditë, pra, 10 ditë më pak sesa kalendari ynë diellor. Për rrjedhojë, ditët dhe netët e mira si dhe festat fetare në Islam nuk fiksohen në një datë dhe muaj të caktuar, por lëvizin duke i përshkruar të gjithë muajt me radhë, e cila përbën një bukuri krejt të veçantë dhuruar nga Allahu Fuqiplotë. Ditët dhe netët e shënuara në fenë Islame janë kohë shumë të begata, ku dhuntitë dhe dhuratat hyjnore shfaqen në sasinë më të madhe nga ana ideore dhe shpirtërore. Entuziazmi ideor dhe shpirtëror i ditëve dhe netëve të mrekullueshme që shtrihen si rrugëlidhje, porta apo katapulta, të cilat formojnë tek njeriu një ndjesi krejt ndryshe, i bashkon e i bën një myslimanët.

Për çdo sëmundje apo dhembje që mund të kemi në trupin tonë, ne menjëherë interesohemi dhe shkojmë për vizitë tek mjeku. A nuk është e drejtë të përpiqemi me po aq forcë për të shpëtuar nga gjynahet që na errësojnë botën, na ngushtojnë shpirtin dhe na hapin plagë në zemër? Nëse jemi të bindur për këtë, atëherë le të mendojmë pak ç'mund të bëjmë! Përpjekja për të shpëtuar nga gjynahet në literaturën Islame e merr emrin teube dhe istigfar (pendim dhe falje). Ky veprim përveç se bëhet me gjuhë dhe me zemër, ka edhe disa kohë të veçanta ku fokusimi është akoma më i madh dhe më i përshtatshëm. Ne e dimë se falje mund të kërkohet në çdo kohë, por ekzistojnë disa intervale kohore në të cilat ne e kemi më të lehtë të fokusohemi me gjithë shpirtin tonë. Këto kohë janë pikërisht ditët dhe netët e mira, në të cilat ne kemi mundësinë të

drejtohemi të vetëdijshëm në maksimum drejt faljes. Ky është vërtet një rast mjaft i volitshëm për të gjithë besimtarët myslimanë, që të largohen nga gjynahet dhe të hedhin hapa të rëndësishëm drejt mirësive. Ato kohë janë me të vërtetë momente mjaft të vyera për njeriun, sepse gjen rastin për t'iu lutur Zotit më afër, e përmend Atë dhe kërkon falje për gjynahet, që i kanë shkatërruar qetësinë shpirtërore. Kështu, ditët dhe netët e mira janë për ne si doktorët më të mirë që mjekojnë me ilaçet e tyre shpirtërore, shpirtin tonë.

Vlerat dhe përparësitë e ditëve dhe netëve të mira ndaj ditëve dhe netëve të tjera të zakonshme janë të shumta. Nuk duhet menduar se ngjarja e ndodhur i përket vetëm ditës apo natës kur ka ndodhur për herë të parë dhe kështu, më pas, ditës apo natës në fjalë nuk i mbetet ndonjë vlerë e veçantë. Edhe pse ngjarjet përkatëse nuk përsëriten, dita apo nata e mirë përsëritet çdo herë së bashku me të gjitha vlerat dhe përparësitë. Prandaj, në çdo përsëritje duhen bërë përpjekje për t'i përjetuar dhe gjallëruar ato. Ka shumë rëndësi që në këto ditë dhe net, besimtari të jetë i ndërgjegjshëm dhe t'i kalojë ato me adhurim e lutje. Adhurimi dhe lutja e bërë në këto kohë, bëhet shkak për më shumë mirësi, gjë që u jep atyre një vlerë të veçantë. Nga ana tjetër duhet te theksohet se një ndërgjegje të tillë ndaj Allahut, Krijuesit të gjithësisë, besimtari duhet të përpiqet ta gjejë në çdo ditë apo natë të jetës së tij.

Koha e një pjese ditësh dhe netësh të mira është saktësisht e ditur, kurse e një pjese tjetër, jo. Dita e Xhuma është një ditë e mirë dhe e bekuar. Mirëpo "ora e pranueshme e lutjeve", nuk është e përcaktuar dhe është e fshehur në atë ditë. Edhe nata e Kadrit është e fshehur në dhjetë ditët e fundit të muajit të Ramazanit, sikurse Ismi Adham, i cili është i fshehur në Esmau'l Husna. Ndërkaq, edhe kohët e shënuara të papërcaktuara, ashtu si kohët e përcaktuara, i nxisin myslimanët për syçelësi, adhurim dhe shfrytëzim të dobishëm të tyre. Veçanërisht kohët e shënuara të papërcaktuara bëhen pretekst për vlerësimin dhe shfrytëzimin e një kohe më të gjatë.

Njeriu në jetën e tij herë pas here hyn në një proces ndryshimi. Dhe është tepër e rëndësishme që drejtimi i këtij ndryshimi të kthehet kah e mira, e dobishmja dhe e drejta. Parë në këtë këndvështrim, ditët dhe netët e mira u japin mundësi dhe u ndihmojnë njerëzve në këtë drejtim, duke u bërë faktor për një ndryshim pozitiv në jetën e tyre. Festimi i datave të shënuara në historinë Islame mund të jenë të përcaktuar me ndonjë citat nga legjislacioni Islam ose mund të mos jenë të papërcaktuar nga ai. Ato që janë të përcaktuara nga legjislacioni Islam, duhet të kryhen në mënyrën që janë përcaktuar dhe të mos dalin nga caqet e përgjithshme të fesë. Ndërsa për ato raste që nuk janë përcaktuar nga legjislacioni Islam, njerëzit në lidhje me këtë aspekt kanë dy qëndrime: Njëri qëndrim i ndalon duke thënë se janë bidate (risi), kurse qëndrimi tjetër i lejon festimet e atyre rasteve meqenëse nuk ka ardhur ndonjë verset Kuranor ose ndonjë hadith që t'i ndalojë ato.

Le ta sqarojmë këtë që po themi: Nuk ka dyshim se në Islam, si nga legjislacioni Islam ashtu dhe nga aspekti historik, ndodhen raste të shumta që duhet t'u jepet rëndësi kremtimeve, pavarësisht nga emërtimi i tyre - festa. Islami ka ligjëruar gëzimin në rastin e lindjes së fëmijës, therjen e një kurbani ose dy kur lind fëmija dhe kur i vihet emri, ai ka ligjëruar e lejuar të kënduarit në raste martesash dhe përgatitjen e gostive; ka lejuar të kënduarit e këngëve për pritjen e ndonjë miku siç e pritën Profetin (a.s.) kur emigroi në Medine dhe siç e pritën atë kur u kthye nga beteja e Tebukut. Në legjislacionin Islam vlerësohej gëzimi për ardhjen e muajit të bekuar të Ramazanit, vlerësohej urimi i ndërsjellët i myslimanëve me njëri-tjetrin. Në Kuran shfaqet interesim për të ardhmen duke punuar për botën e përtejme, për t'u përpjekur në adhurime për hir të fitimit të xhenetit. Në të tregohet për të shkuarën me qëllim që të studiohet jetesa e profetëve dhe e popujve të mëparshëm. Në tregimin e tyre ka mësime e këshilla për ata që mendojnë. Në Kuran ka udhëzim e orientim për të ecur në tokë dhe për të shikuar e studiuar gjurmët dhe veprat e të parëve. Madje në të ka legjislacione që lidhen me përkujtime që nuk harrohen. Ato me gjuhën e kohës quhen festa, të cilat shërbejnë për t'i përjetuar këto përkujtime. Këto festa përsëriten në ditë të ndryshme të cilave u jepet emërtimi 'Id' (festë). Tregohet në një hadith të saktë se Enesi

ka thënë: "Erdhi Profeti Muhamed (a.s.) në Medine. Ata (njerëzit e Medines) kishin dy ditë në të cilat luanin e argëtoheshin. Atëherë Profeti (a.s.) tha:

"*Zoti (xh.sh.) ua ka zëvendësuar ato me dy të tjera më të mira. Ata janë dita e çeljes dhe dita e sakrificës* (dy Bajramet)"[24].

Këto dy ditë u quajtën ditë feste "Id". Gjithashtu edhe dita e xhumasë u quajt "Id", festë. Tregohet se Ebu Bekri hyri tek Aisheja (Zoti qoftë i kënaqur me të), në ditën e Minasë. Ndërkohë tek ajo gjen dy vajza duke kënduar. Kur Ebu Bekri e dënoi këtë veprim, Profeti (a.s.) i tha atij:

"*O Ebu Bekër! Çdo popull ka festë, dhe kjo është festa jonë*"[25].

Në këto hadithe vërehen disa çështje: Profeti (a.s.) nuk i përkufizoi festat islame vetëm me dy Bajramet (festa e çeljes dhe festa e sakrificës), por përmendi vlerat e atyre të dyjave mbi vlerat e festave që festonte populli i Medines. Pra të dyja këto festa (Bajramet) u quajtën "Id". Gjithashtu është edhe argumenti se Profeti (a.s.) e quajti ditën e Xhumasë me emrin "Id" festë. Kështu, festat islame nuk ngushtohen vetëm tek dy Bajramet. Gëzimi dhe hareja janë prej dukurive të festave. Atëherë, përkrah faljes së posaçme, përmendjes së Zotit, sadaka-i fitrit dhe therjes së kurbaneve, gëzimi shfaqet edhe me argëtime të lejueshme nga të gjithë myslimanët. Meqenëse nuk ka ardhur ndonjë citat nga Kurani apo suneti që të ndalojë shprehjen e gëzimit dhe të haresë në raste të tjera përveç këtyre dy festave të Bajrameve, atëherë shprehja e gëzimeve në raste të tjera është një veprim i pakundërshtueshëm, si do që të jetë shprehja e gëzimit, individualisht apo kolektivisht, i përkohshëm apo i vazhdueshëm.

Profeti Muhamed (a.s.) kur i gjeti hebrenjtë duke festuar ditën e Ashuras si shenjë respekti, meqë Zoti (xh.sh.) atë ditë shpëtoi Musain (a.s.) dhe dënoi faraonin, tha:

"*Ne jemi më të afërt me Musain (a.s.) se sa ata*"[26].

24. Nesai; Ibn Hiban
25. Muslim
26. Muslim

Pastaj Profeti Muhamed (a.s.) e agjëroi atë ditë dhe i urdhëroi myslimanët që ta agjëronin. Ky ishte një lloj këshille për të përvetësuar përkujtimin e ngjarjes dhe ishte me një legjimitet të përhershëm Islam. Gjithashtu Profeti Muhamed (a.s.) e ndjente mirësinë e Zotit që bëri në lidhje me lindjen dhe dërgimin e tij me misionin profetik, saqë Profeti (a.s.) e festonte në shenjë përkujtimi duke e agjëruar ditën kur Zoti (xh.sh.) e nderoi atë me lindjen, e cila ishte dita e hënë[27].

A nuk është hixhreti nga Meka në Medine një ngjarje e madhe historike me të cilën Zoti (xh.sh.) bëri ndarjen midis të vërtetës dhe të shtrembrës, si dhe e përjetoi atë Hz. Omeri duke e bërë fillimin e kalendarit Islam? Pasi iu bënë atij disa propozime për ngjarje të tjera, a nuk e dalloi ai hixhretin si ngjarjen më të përshtatshme e më të denjë për kalendarin islam? Hz. Omeri kur pa grumbullimin e njerëzve duke falur namazin e teravisë me xhemat pas një imami tha: "Sa bidat i mirë është ky"! Dhe askush nuk e kundërshtoi atë.

Le të shpresohet se në kremtimin e këtyre rasteve të nxirren mësime prej tyre me qëllim që të lidhen zemrat e myslimanëve me fenë, me historinë dhe me lavditë e saj, si dhe të mos harrohen ato në bollëkun e festave të tjera të kësaj bote. Atëherë nuk vërejmë asgjë të keqe e të kundërshtueshme lidhur me kremtimin dhe festimin e çfarëdo rasti fetar apo jo fetar, me kusht që mënyra e festimit të mos dalë nga limitet e legjislacionit Islam dhe objektivi e motivi të jenë të shëndosha.

Adhurimet dhe lutjet që bëhen në ditët dhe netët e mira

Dijetarët myslimanë janë të mendimit që ditët dhe netët e mira të kalohen me adhurime dhe lutje të llojeve të ndryshme. Në këto kohë myslimanët falënderojnë Allahun që u ka dhënë mundësi t'i respektojnë dhe përjetojnë ato me shëndet, falin namaz, këndojnë ose dëgjojnë Kuran, e përmendin Allahun dhe meditojnë, luten për mëshirë dhe paqe për Profetin, ndjekin

27. Muslim

predikime e këshilla, bëjnë vetëllogari dhe kalojnë nëpër sy të metat e gabimet, bëjnë pendesë për mëkatet; mes myslimanëve bëhen urime, agjërimi i ditëve përkatëse të këtyre kohëve është sevap dhe e këshillueshme. Kurse ata që kanë mundësi, i japin iftar agjëruesve në shtëpitë e tyre.

Adhurimet që bëhen në ditët dhe netët e mira mund t'i përmbledhim si më poshtë:

1) Pendesë, zikër dhe përpjekje për të hequr dorë nga veset dhe shprehitë e këqija.

2) Këndim Kurani; meditim mbi jetën, vdekjen dhe botën e amshueshme.

3) Përpjekje për kryerjen e kazave të farzeve të lëna në të kaluarën dhe shlyerja e detyrimeve.

4) Agjërim dhe salat e selam për Profetin.

5) Dhurata për fëmijët, ndihmë për të varfrit, vizita në varreza, dhurata për veprimtari të dobishme dhe për institucionet bamirëse.

6) Lutje për falje, për veten, për prindërit dhe të gjithë myslimanët.

Nata e mirë e Mevludit

Të gjithë kombet e popujt e ndryshëm, sipas rastit e vendit, festojnë ditëlindjen e njerëzve të tyre me zë, të dalluar për vepra trimërie, bamirësie, letrare, filozofike e shkencore, duke i shërbyer jo vetëm kombeve përkatëse, por edhe mbarë njerëzimit. Këta njerëz të mëdhenj, jo vetëm i kanë sjellë dobi e përfitim popujve të ndryshëm, por bëhen më vonë shembuj për brezat e ardhshëm që të shkelin në gjurmët e tyre. Po, nëse ka një ngjarje, e cila mund të shkaktojë me të vërtetë gëzim dhe pjesëmarrje të përbotshme, ajo është pa dyshim, lindja e Profetit të bekuar, Muhamed Mustafasë. Ai i solli mbarë botës mesazhin e paqes dhe harmonisë në atë kohë, kur ajo botë kishte nevojën më të madhe për të.

Fjala "mevlud" do të thotë lindje, i lindur, ditëlindje, jetëshkrim. Është fjala për vulën e profetëve, Hz. Muhamed (s.a.s.). Mëngjesi i asaj nate u bë i begatë sepse kishte lindur një ditë krejt e re, ishte hapur një periudhë drite për njerëzimin. Natën kur lindi Profeti, në pallatin e Kisras, perandorit të Iranit, janë shembur katërmbëdhjetë kolona, liqeni i shenjtëruar dhe shumë i njohur i quajtur Save u tha menjëherë, zjarri i pashuar qysh prej njëmijë viteve i zoroastrianëve është shuar dhe disa ngjarje të tjera interesante kanë ndodhur në botë. Të gjitha këto janë komentuar si shenja se në të ardhmen zjarri i mohimit dhe hipokrizisë do të shuhej me duart e Profetit, se do të përhapeshin drejtësia dhe virtytshmëria.

Kjo natë, domethënë kjo lindje, është një favor i Allahut për të gjithë njerëzimin. Lidhur me këtë, Zoti ynë i Lartë urdhëron e thotë në Kuran:

"**Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare)**"[28] "**Dhe Ne nuk të dërguam ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët**"[29].

Fjala "mevlud" ka dhe kuptimin e festës fetare të myslimanëve në përvjetorin e lindjes së pejgamberit Muhamed (s.a.s.). Dhe prej saj kanë lindur shprehjet nata e mevludit, këndoj mevlud, ju ftoj për mevlud, etj. Me këtë rast organizohet ceremoni fetare festive popullore. Kjo festë jubilare kremtohet në mbarë botën myslimane në mënyrë të shkëlqyeshme. Në këtë ditë madhështore organizohen biseda dhe kumtesa rreth jetës së ndritshme të Muhamedit (a.s.), zhvillohen tubime e takime duke trajtuar probleme rreth personalitetit të të dërguarit të Zotit (xh.sh.), këndohen ajete të Kuranit Fisnik, lirika fetare të quajtura ilahi, si dhe këndohen nga secili popull në gjuhën e vet poezitë liriko-epike të quajtura "Mevlud", duke përzgjedhur ata që e kanë zërin e bukur dhe melodioz. Edhe këtu

28. Al'Imran, 3:164
29. Enbija, 21:107

në Shqipëri të mëdhenj e të vegjël, të gjithë myslimanët mblidhen bashkë për të kremtuar këtë festë ndërkombëtare të ditëlindjes së Profetit me anë të aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe ceremonive të mevludit, duke rënë në salavat dhe duke u lutur për Profetin për paqe e mëshirë.

Ndërkaq duhet të përmendim se festimi dhe përkujtimi i këtij përvjetori, i kësaj ngjarjeje të shënuar për të gjithë myslimanët, nuk është domosdoshmëri fetare. Ky eveniment mbeti një vepër e mirë dhe e dobishme për mbarë besimtarët myslimanë, duke qenë se na kujton të Dërguarin e Allahut dhe na e forcon lidhjen me të. Rreth kësaj në një hadith që e transmeton Abdullah Ibn Mesud thuhet:

"*Atë që myslimanët e shohin se është vepër e mirë, që duhet të bëhet, do të konsiderohet e mirë edhe tek Allahu, edhe atë që myslimanët e shohin të keqe, që nuk duhet të bëhet, edhe tek Allahu konsiderohet e keqe*"[30].

Duke u nisur nga ky hadith dhe të tjerë të ngjashëm me këtë, themi se festimi i mevludit është një vepër e mirë, që sjell shumë dobi dhe efekte të mira për besimtarët myslimanë. Duke marrë pjesë në evenimente të tilla, ku pjesëmarrja e myslimanëve është tepër e madhe, është arritur që njerëzit jo vetëm kanë shtuar njohuritë rreth fesë Islame, jetës dhe veprës së pejgamberit të fundit, por me kohë kanë frekuentuar edhe xhamitë për të kryer adhurimet obliguese.

Këndimi i Mevludit duhet të ketë për qëllim kujtimin e Profetit dhe përjetimin e ndjenjave të dashurisë dhe respektit për të si rob dhe i dërguar i Allahut. Në kohën tonë ka marrë një formë shumë të përhapur këndimi i Mevludit me pretekste të ndryshme. Në të vërtetë, kjo është një gjë e mirë. Nuk ka dyshim se për ne është e mirë dhe e bukur çdo gjë që do të na e kujtonte e do ta bënte që ta donim Pejgamberin tonë. Mirëpo, në zhvillimet që ka pësuar kuptimi mbi këtë ceremoni përkujtimore si dhe praktika e saj, vihen re koncepte e qëndrime të skajshme e të padrejta. Në njërën anë, është gabim që Mevludi, duke e kapërcyer përmbajtjen

30. Ahmed

dhe kuptimin e tij si ceremoni përkujtimore, të shndërrohet në një formë adhurimi. Në anën tjetër, është gabim edhe mohimi kategorik i Mevludit duke e quajtur risi (bidat). Nëse në një drejtim janë bërë gabime, ato duhen rregulluar pa shkaktuar çorientim në drejtime të tjera. E rëndësishme është që të bëhen vlerësimet dhe rregullimet e duhura nga njerëzit dhe organet kompetente të fesë.

Për shekuj me radhë ne nuk e kemi respektuar Profetin aq sa e meriton dhe nuk mund t'ia festojmë siç duhet një ditëlindje, një javë apo një muaj të dedikuar vetëm kësaj lindjeje të bekuar. Kjo nuk do të jetë e mjaftueshme edhe sikur ta bëjmë për vite me radhë, megjithatë, "një mbret sillet ashtu siç i takon një mbreti dhe një shërbyes kryen punën e tij prej shërbëtori." Prandaj, ne duhet të bëjmë çfarë të mundemi në këtë drejtim, çfarëdo që është brenda mundësive tona duke thënë: "më mirë kaq se asgjë."

Rreth tekstit të Mevludit

Ceremonitë e para përkujtimore të quajtura "Mevlud" ndeshen për herë të parë në Egjipt, ndërsa në shtetin Osman ceremonitë e Mevludit kanë filluar të praktikohen pas periudhës së Muratit II. Sipas mendimit të njëzëshëm të autoriteteve myslimanë, mevludi i parë është shkruar në gjuhën arabe në kohën e Ebu Said Muzaferudin Kokboriut, i cili vdiq më 1233 në Erbil. Ndërsa tekstin e mevludit, një poemë e gjatë 800 vargëshe në gjuhën turke, e përpiloi poeti i shquar turk Sulejman Çelebiu me titull "Vesiletu'n-Nexhat" (Shkaku i shpëtimit), të cilën e pati përfunduar në vitin 1409 në Bursa. Mevludi bën fjalë për jetën e pejgamberit tonë plot ndjenja dashurie e respekti me një shprehje shumë të sinqertë e intime. Ai përmban nëntema të tilla si nderi që i solli botës Pejgamberi (a.s.) me lindjen e tij, ardhja e profetësisë, ngjarja e Miraxhit, shpërngulja në botën tjetër etj., si dhe pjesë me lavdërime për të, përgjërime dhe lutje. Në këtë kontekst, Mevludi ka një vlerë që nuk mund të krahasohet kurrë me asnjë

poemë tjetër në botë. Greku Homer, Francezi La Fonten, Anglezi Shekspir, Gjermani Gëte, Rusi Pushkin; asnjë nga veprat e këtyre poetëve nuk është recituar më shumë se Mevludi Sherif.

Hartimi i mevludeve në gjuhën shqipe ka një traditë të hershme mbi 250 vjeçare, ku njihen mbi 15 autorë. Mevludet e para në gjuhën shqipe nisin me Mevludin e parë të Hasan Zyko Kamberit, e vazhdojnë deri në ditët tona. Më 1878 Hafiz Ali Riza Ulqinaku bëri një përkthim të përsosur të Mevludit të Sulejman Çelebiut. Ky nuk ishte vetëm një përkthim nga Mevludi në fjalë, por edhe një përshtatje famoze në poezinë epike shqiptare.

Mevludet e para në gjuhën shqipe kanë qenë të shkruara me alfabetin turko-arab e më vonë në alfabetin shqip. (Mevludi në Shqipëri këndohej në gjuhën turke dhe sipas zakonit lutjet bëheshin në gjuhën arabe). Këto mevlude kanë qenë përkthime, përshtatje dhe origjinale, si dhe kanë përfshirë të gjitha zonat e Shqipërisë, trojet shqiptare dhe diasporën. Në gjuhën shqipe sot mund të numërojmë më shumë se njëzet Mevlude të botuara në kohë të ndryshme, të cilat janë trajtuar edhe në veprën "Mevludet në gjuhën shqipe" të autorëve Faik Luli dhe Islam Dizdari.

Mevludet në gjuhën shqipe kanë pasur përhapjen e tyre në zona të ndryshme. Shumë prej tyre janë ribotuar disa herë në Shqipëri, në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni, në Turqi, në Amerikë, Belgjikë e kudo ku ka shqiptarë. Nga Mevludet më të njohura të autorëve shqiptarë mund të veçojmë Mevludet e Hafiz Ali Ulqinakut, Hafiz Ali Korçës, Fahrudin Osmanit, Hafiz Abdullah Zemblakut dhe Tahir Efendi Popovës.

Mevludi, një vepër e cila i prezantoi botës poemën më të recituar në botë, është e rëndësishme sepse pasqyron në mënyrë objektive ndjenjat fetare të shoqërisë myslimane. Shpresojmë që vepra të tilla të rrënjosura në kulturën e popullit tonë do të ndihmojnë ata që duan të dinë rreth Islamit, të kuptojnë botën e brendshme të myslimanëve, dashurinë që ata ushqejnë për Profetin dhe lidhjet shpirtërore midis tyre dhe atij në mënyrë korrekte.

Disa vargje nga Mevludi i Hafiz Ali Korçës:

Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!
Për nder të Muhamedit mos kurse rahmetin,
na dhuro neve o Zot bukurinë e xhenetit.
Sado faje të kemi shpresën nuk e presim,
Zot i madh prej Teje shumë mëshirë presim.
Madhështia Jote na jep shumë shpresë,
mëshira që ke, nuk na lë pa pjesë.
Nëse na i fal gabimet tregona bukurinë,
nëse na përzë, prapë tek Ti ne vijmë.
Me zemër të djegur Allah të thërresim,
me Allah në gojë Zot, edhe kur të vdesim!

TRE MUAJT E BEGATË

Profeti (a.s.) thotë: "*Allahu im! Na i bëj të bekuara Rexhepin dhe Shabanin dhe na e bëj të bekuar muajin e Ramazanit*"[31]

Begatitë e Allahut ndaj robërve të tij janë të mëdha e të panumërta, siç thotë edhe në Kuran:

"**Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni dot**"[32].

Ndër këto begati të panumërta ekzistojnë edhe periudha të veçanta në të cilat njerëzit vepërmirë i shtojnë veprat e mira. Në kushtet e zakonshme, mes kohëve të ndryshme nuk ka ndonjë dallim dhe përparësi. Ndërkaq, disa kohë kanë fituar veçanti dhe vlerë ngaqë janë bërë skenë e disa ngjarjeve me rëndësi në fenë Islame. Vlerësimi i disa aspekteve të kohës në Islam është një mënyrë që begatia dhe mirësia e pafund e Zotit të mbërrijë tek myslimanët.

Sipas kalendarit hënor, që ka si pikënisje hixhretin e profetit Muhamed (s.a.s.) (hixhri), muajt Rexhep, Shaban dhe Ramazan janë muaj shumë të dobishëm dhe të bekuar. Të gjitha netët e mira veç Natës së Mevludit,

31. Ahmed
32. Ibrahim, 14:34

si Nata e Regaibit, Nata e Israsë dhe Miraxhit, Nata e Beraetit dhe Nata e Kadrit, ndodhen brenda këtyre tre muajve. Allahu i Lartë ndër muajt ka zgjedhur muajin e Ramazanit, ndër netët natën e Kadrit, ndër vendet Mekën, ndër njerëzit Hz. Muhamedin (a.s.) dhe ndër ditët ditën e Xhuma. Muaji Rexhep cilësohet si muaji i mbjelljes, muaji Shaban si muaji i ujitjes dhe muaji i Ramazanit si muaji i korrjes apo mbledhjes së prodhimeve. Profeti Muhamed (a.s.) në lidhje me këta muaj ka thënë:

"*Rexhepi është një muaj i madh. Të mirat në këtë muaj Allahu i shumfishon*"[33].

Pas muajit të Rexhepit vjen muaji i Shabanit. Hz. Aishe (r.a.) thotë:

"*Nuk e kam parë të dërguarin e Allahut të mbajë më shumë agjërim se sa në muajin e Shabanit*"[34].

Transmetohet nga Enes b. Malik se Profeti (a.s.) pyetet: O i dërguari i Allahut! Në cilin muaj është agjërimi më i mirë përveç Ramazanit? Pejgamberi përgjigjet:

"*Për nder dhe respekt të Ramazanit është agjërimi i mbajtur në muajin Shaban*"[35].

Ndërsa Allahu (xh.sh.) për muajin e Ramazanit ka thënë:

"**Ramazani është muaji në të cilin u zbrit Kurani, si një udhëzim për njerëzimin dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra)**"[36].

Profeti Muhamed (s.a.s.) në lidhje për këtë muaj të bekuar thotë:

"*Kush agjëron muajin e Ramazanit me besim dhe bindje, i falen të gjitha mëkatet e tij*"[37].

33. Taberani
34. Muslim
35. Tirmidhi
36. Bekare, 2:185
37. Buhari; Muslim

Dijetari i madh dhe i shquar Bediuzaman Said Nursi për këta muaj thotë: "Shpërblimi i çdo të mire, nëse në kohë të tjera është dhjetë, në muajin Rexhep është njëqind, në muajin Shaban më shumë se treqind, në Ramazan ngjitet në njëmijë, në netët e Xhumave shkon me mijëra dhe në natën e Kadrit ngjitet në tridhjetëmijë"[38].

Tre muajt e bekuar na hapin dyert dhe na ndihmojnë duke u bërë shkas për një ndryshim pozitiv në jetën tonë. Ata kanë një shije të vetën, e cila i veçon ata nga muajt e tjerë. Secili nga muajt ndjehet me ndjenjat tona të dukshme, ndërsa këta të tre, ndjehen me zemër dhe ndjenja mjaft të thella. Jo më kot Profeti (a.s.) e cilëson muajin Rexhep të Allahut, sepse është muaji i faljes, amnistisë nga Zoti. Ndërsa muajin Shaban e cilëson të tijin, sepse është muaji i shefaatit, ndërmjetësimit të Profetit për falje. Dhe muajin e Ramazanit e cilëson të ymetit të tij, sepse është muaji i shtimit të mirësive të Zotit.

Dijetarët myslimanë janë të mendimit që këto kohë të bekuara të kalohen me adhurime dhe lutje të llojeve të ndryshme. Gjatë këtyre muajve myslimanët falenderojnë Allahun që u ka dhënë mundësi t'i vlerësojnë dhe t'i përjetojnë ato me shëndet, falin namaz, agjërojnë, këndojnë ose dëgjojnë Kuran, e përmendin Allahun dhe meditojnë, luten për mëshirë dhe paqe për Profetin (a.s.). Ata ndjekin predikime e këshilla, bëjnë vetëllogari dhe kalojnë nëpër sy të metat e gabimet duke bërë pendesë për mëkatet. Me këtë rast myslimanët u japin fund zemërimeve dhe mërive që mund të kenë me të tjerët dhe ndjenjat vëllazërore i zhvillojnë më tej.

38. Said Nursi, Şualar, f. 416

NAMAZI ËSHTË DRITA E SYVE

Profeti (a.s.) thotë: "*Allahu ua ka bërë farz robve pesë kohë namaz. Atij që i fal këto namaze plotësisht pa i nënvleftësuar, Allahu i ka dhënë fjalën se do ta çojë në xhenet. Kurse për atë që i nënvleftëson ato dhe i fal me mungesa, nuk ka ndonjë premtim të tillë. Po të dojë Allahu e ndëshkon atë, po të dojë, e falë*"[39].

Namazi, duke qenë se shërben si kujtim i vazhdueshëm i Allahut dhe, duke qenë se përmbledh të gjitha llojet e falenderimeve së bashku me elementet përbërësë të tij, ka qenë prezent edhe te profetët para Hz. Muhamedit (a.s.). Këtë e bën të ditur edhe Kurani[40]. Ashtu si shprehet edhe Profeti (a.s.) në hadithin e sipërcituar, namazi me të vërtetë është çelës për në xhenet. Sepse namazi është madhërim, lavdërim dhe falenderim, këndim Kurani dhe lutje. Shkurt, tërësia e të gjitha akteve të çmuara e të virtytshme, është në namazin e falur në kohë. Fakti që urdhrin për namaz Allahu nuk e dërgoi mbi tokë me anë të një engjëlli, por ia njoftoi Profetit (a.s.) vetë natën e miraxhit kur ai doli para Tij[41], tregon rëndësinë dhe kuptimin e këtij adhurimi për jetën fetare dhe

39. Ibn Maxhe
40. Bekare, 2:83; Junus, 10:87; Hud, 11:87; Ibrahim, 14:37, 40; Merjem, 19:30-31, 54-55; Taha, 20:14
41. Buhari; Muslim

shpirtërore të myslimanit. Sepse nuk ka asnjë adhurim që t'i përngjasë namazit. Personi që fal namaz, nuk merret me asgjë tjetër veçse me namazin e vet. Namazi ia pret atij të gjitha lidhjet. E bën të jetojë një afrim të papërshkrueshëm kokë më kokë me Zotin. Kurse me adhurimet e tjera nuk ndodh kështu. Për shembull, njeriu i agjëruar mund të jetë në treg edhe shitës, edhe blerës. Po kështu edhe ai që bën haxh. Kurse ai që falet, nuk mund të bëjë asnjë veprim tjetër veç namazit. Allahu (xh.sh.) urdhëron e thotë në Kuran:

"**Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar**"[42].

Pra, nëse namazi falet i plotë, pa nënvleftësime, në përshtatje me kuptimin e vërtetë dhe frymën e tij, ai do ta pengojë njeriun nga çdo lloj e keqe, paturpësi dhe teprim. Kurse në adhurimin e kryer në mënyrë të pavetëdijshme, nuk mund të bëhet fjalë për një fuqi të tillë parandaluese.

"**Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujsshëm për namazet**"[43],

thotë Zoti në Kuran. Domethënë se në namaz, është një fuqi që e mbron njeriun nga të këqijat dhe se, kur namazi nuk falet si duhet, njeriu e ekspozon veten ndaj mëkateve. Profeti Muhamed (s.a.s.) ka thënë:

"*Pesë namazet dhe xhumaja nga xhumaja janë shlyerje mëkatesh ndërmjet tyre, nëse nuk bën mëkate të mëdha*"[44]. Ose në një thënie tjetër:

"*Po qe se një mysliman, kur të vijë koha e namazit, merr abdest mirë e bukur dhe e fal namazin plotësisht dhe me tërë shpirtin, ky namaz, nëse ai nuk bën ndonjë gjynah të madh, i shlyen të gjitha gjynahet para tij. Kjo është kështu gjithmonë*"[45].

42. Ankebut, 29:45
43. Maun, 107:4-5
44. Muslim

45. Muslim

41. Buhari; Muslim

Pra siç shikohet, rruga për të qenë në ditën e kiametit, me ballin e larë, me vështrimin e ndriçuar, me shenjat e abdestit dhe sexhdes nëpër gjymtyrë, me duart dhe fytyrën krej të pastër, kalon nëpër namaz dhe veprimet e paranamazit. Duhet pohuar edhe kjo që, secili prej namazeve farz të pesë kohëve, përbajnë rëndësi dhe vlera të veçanta. Edhe shpërndarja e tyre në kohë të caktuara të ditës e natës, përmban një mijë e një urtësi e dobi si për trupin, ashtu edhe për shpirtin. Prandaj nuk duhet treguar indiferentizëm për kryerjen e secilit namaz, por u duhet kushtuar kujdes dhe interesim i plotë. Allahu i Lartësuar ka thënë:

"**Ata të cilët ndaj faljes së namazit janë të kujdesshëm, do të jenë të nderuar në kopshtet e xhenetit**"[46].

Në këtë ajet Kuranor ka një përgëzim të madh për besimtarët, pasi Allahu i Lartësuar përfshin në faljen e Tij ata, të cilët janë të kujdesshëm ndaj namazit dhe të cilët tregojnë përkushtim në faljen e tij. Fjala 'kujdes' ndaj namazit ka për qëllim pikat e mëposhtme:

1- Kryerja e namazit në formën e plotë duke plotësuar kushtet dhe shtyllat e tij. Zbatimi me përpikmëri i rregullave të tij duke pasur parasysh plotësimin e pastërtisë dhe të abdesit.

2- Kryerja e namazeve në kohën e duhur pa u vonuar, neglizhuar apo pa përtuar.

3- Përkushtimi, meditimi dhe prezenca e zemrës.

Më e rëndësishmja e të gjitha këtyre është shërimi i zemrës, pastrimi i saj nga gjynahet dhe kontrolli ndaj pasioneve. Për atë zemrër, që është e zënë me dashurinë e dynjasë dhe interesimin pas punëve të saj, nuk mund të pretendohet që të ketë përkushtimin e kërkuar. Nëse ka diçka tonën që ka vlerë para Allahut, ajo është zemra. Ju do t'ia jepni zemrën Allahut dhe si shpërblim, do të merrni mëshirën dhe pëlqimin e Tij.

46. Mearixh, 70:34-35

Për ta kuptuar më mirë rëndësinë e pesë kohëve të namazit, po e mbyllim me këtë hadith të Profetit tonë (a.s.):

"*Puna e parë, për të cilin do t'i kërkohet llogari njeriut ditën e kiametit, është namazi. Po qe se namazi i tij është i mirë e i rregullt, ai ka shpëtuar dhe ka arritur sukses. Po qe se namazi i tij është i pavlerë, personi ka humbur dhe ka pësuar disfatë...*"[47].

55 Tirmidhi

AGJËRIMI I RAMAZANIT ME BESIM DHE BINDJE

Profeti (a.s.) thotë: *"Kush agjëron muajin e Ramazanit me besim dhe bindje, i falen të gjitha mëkatet e tij"*[48]

Profeti Muhamed (a.s.) kur thotë për agjërimin e Ramazanit me besim dhe bindje, nënkupton që agjërimi duhet të mbahet me ndërgjegje dhe dëshirë të plotë. Obligimet Islame të çdo lloji qofshin, duke futur këtu përveç agjërimit edhe faljen, zekatin, haxhin etj., kryhen në emër të Zotit dhe për hir të Tij. Ka njerëz që e kanë të nevojshme të mbajnë dietë për shkak të mbipeshës. Kjo lloj diete e mbajtur në Ramazan, e ndihmon njeriun në pakësimin e dhjamërave, por nuk ka asnjë ndikim në kalitjen shpirtërore të ndërgjegjes. Agjërimi i Ramazanit që bëhet në emër të Zotit ka shpërblim të madh, sepse shoqërohet me një cikël veprimtarish gjatë gjithë ditës që nga agimi deri në perëndimin e diellit. Qëllimi i agjërimit është kalitja e ndërgjegjes së njeriut, përsosja e vazhdueshme dhe e pandërprerë e saj, pajisja e myslimanit me virtyte humanitare, me synim që kjo sjellje të praktikohet me ndërgjegje e bindje të plotë dhe me dashuri.

Muaji i Ramazanit është një pastrim për njeriun nga ndotësitë e mëkateve që ka bërë gjatë gjithë vitit, pasi agjërimi në Ramazan është si një dush

48. Buhari; Muslim

shpirtëror, në të cilën njeriu hyn një herë në vit për të larë njollat e mëkateve të tij, e për të dalë prej tij më pas krejtësisht i pastër. Ky muaj i bekuar është muaji ku Allahu i shumfishon shpërblimet për agjëruesit dhe i ngre ata në shkallët e larta të devotshmërisë. Me agjërimin e Ramazanit më së miri shprehet besimi, bindja, sinqeriteti, solidariteti.. virtyte këto të cilat duhet të stolisin çdo besimtar. Me anë të agjërimit në këtë muaj, arrijmë të krijojmë jetë më të ngritur shpirtërore, një atmosferë mirëkuptimi, mirësjelljeje, devocioni, një atmosferë bujarie, ndershmërie dhe përgjegjësie, duke i pranuar gabimet dhe duke kërkuar faljen e Zotit. Kjo kohë është kaq e begatë, sa gjumi i agjëruesit vlerësohet si adhurim, kurse heshtja e tij si madhërim i Zotit. Mirësive dhe adhurimeve që bën agjëruesi u jepen shpërblime të shumëfishta. Allahu ia pranon lutjet dhe ia fal mëkatet. Lidhur me këtë Profeti Muhamed (a.s.) thotë:

"Ai që bën një të mirë gjatë këtij muaji është sikur të ketë kryer një farz (detyrim) në muajt e tjerë. Dhe ai që zbaton një farz këtë muaj, është sikur të kishte kryer shtatëdhjetë farze gjatë muajve të tjerë. Gjesti i dikujt që i servir iftar një të agjëruari mund të bëhet pretekst për faljen e mëkateve të tij dhe për shpëtimin nga xhehenemi. Në të njëjtën kohë, ky është edhe një pretekst për fitimin e shpërblimit të një agjërimi, pa iu pakësuar shpërblimi aspak ngrënësit të iftarit"[49].

Islami i shikon intresat e shoqërisë mbi interesat e individit. Shërbimi ndaj Zotit bëhet nëpërmjet një jete të pastër në shumëllojshmërinë e shoqërisë. Zoti i ka krijuar njerëzit me kapacitete të ndryshme fizike, emocionale, intelektuale dhe shpirtërore. Ai na ka bërë të gjithëve të kemi nevojë për njëri-tjetrin për përfitime të dyanshme. Nga kjo, nënkuptohet që Ramazani dhe respektivisht agjërimi në këtë muaj ka rëndësi sociale, sepse secili person kërkon me veprimet e tij të dalë në dritë e gjithë shoqëria Islame, duke u bërë kështu të devotshëm, të mirëorganizuar dhe të mirëdisiplinuar. Pra, kjo shoqëri myslimane gjatë këtij muaji, jeton dhe punon sipas kodit hyjnor moral të shkruar në Kuranin e shenjtë që ka zbritur në këtë muaj. Duke agjëruar, njeriu mënjanon me ndërgjegje ushqimin sipas orarit të caktuar nga agimi deri në perëndim të diellit,

57 Tirmidhi

largon mendimet dhe sjelljet e pahijshme dhe shton ndjenjën e tolerancës aq të nevojshme për shoqërinë ku jetojmë, duke kontribuar kështu për harmonizimin e raporteve në familje, punë dhe shoqëri.

Të privosh vetveten nga gjërat thelbësore të jetës, nuk është një akt i lehtë. Kjo kërkon një personalitet të fortë për të patur një vetkontroll, vetëdisiplinë dhe vetëpërmbajtje. Ky program vetushtrues gjatë muajit të Ramazanit ka rëndësi të veçantë në jetën e përditshme. Një besimtar që mund të përmbajë veten nga gjërat thelbësore të jetës për një kohë të caktuar dhe kur këtë e bën për hir të dashurisë për Allahun, meriton një shpërblim nga vetë Krijuesi. Prandaj Zoti e konsideron agjërimin të Tijin, në një hadith kudsi të transmetuar nga Ebu Hurejre ku thuhet:

"Çdo punë e njeriut është e tija, përveç agjërimit. Ai është i Imi dhe vetëm Unë e jap shpërblimin për të. Besimtari e lë ushqimin për Mua, largohet nga gruaja e tij vetëm për Mua dhe braktis dëshirat e tij vetëm për Mua"[50].

Krijuesi i Lartë në një tjetër hadith kudsi thotë:

"Kush agjëron një ditë për Mua, shpërblimin e tij do e jap Unë"[51].

Kjo do të thotë se ky shpërblim i Allahut, nuk llogaritet me njësi matëse apo peshore, por jipet drejpërdrejt nga Ai, në masën që e di vetëm Ai.

50. Sahihu ibn Huzejme
51. Buhari

LAMTUMIRË RAMAZAN

Allahu (xh.sh.) thotë: "**Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Zoti yt, plot Madhëri e Nderim**"[52].

Shkoi edhe muaji më i dashur dhe miku më i njohur ndër myslimanët-Ramazani, muaji i agjërimit, mëshirës, lutjeve; muaji i shpalljes së Kuranit, muaji në të cilin nuk u kursye ndihma dhe favori hyjnor.

A nuk ishe në mesin tonë deri para disa momenteve? A nuk ishe gjallërim e zbukurim i jetës dhe xhamive tona? I vizitonim të afërmit dhe miqtë, përgatitnim iftare, kërkonim falje për mëkatet, bënim lutje, adhurim… Në gjithçka ndihej një gëzim i fshehtë, në shtëpi, në njerëz, në rrugë, në natyrë. E ku është tani? Ah sa mysafir i mirë dhe i vërtetë!!! Asnjë vit, nuk na harron.

Na mundësove o Ramazan që një e mirë e jona në këtë muaj, të jetë e barabartë me një obligim në muajt e tjerë dhe një obligim të jetë shtatëdhjetë herë më i vlefshëm se i njëjti në muajt e tjerë. Na mundësove që frymëmarrja jonë të jetë lavdi dhe fjetja lutje. Na mundësove që të njihemi më gjerësisht me Kuranin dhe na tregove se në fjalë askush nuk mund të jetë më i saktë se Allahu. Na njoftove se Kurani është burimi i diturisë dhe udhëzues për çdo njeri.

52. Rrahman, 55:26-27

Ti shkove duke zbatuar ligjin e Zotit, e për përshëndetje të fundit po na lë festën e Bajramit, por a thua i ke pranuar lutjet, faljet e namazeve, agjërimin, pendimet, të mirat dhe bisedat tona?! Megjithatë, dyert për pendim i ke lënë të hapura, duke na treguar se si thotë Allahu (xh.sh.) në Kuran:

"**Thuaj: O robërit e Mi, që e keni ngarkuar veten tuaj me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Me të vërtetë Allahu i falë të gjitha gjynahet. Ai është Falësi i madh dhe mëshirëploti**"[53].

Edhe për ne, shqiptarët, ishe i mirëseardhur sepse na ofrove durim, bekim, pastërti e njohuri të pafund. Na bëre me dije se në Kuran është dituria, mençuria, pasuria e pafund dhe e vërteta absolute. Na tregove se ai është shërues shpirtëror, trupor dhe nervor i njeriut. Ishe prej atyre që së pari i ftove ata të agjërojnë, të mbjellin virtytin e dashurisë dhe të largojnë nga zemrat e tyre ligësitë, zilinë, smirën, hidhërimin, inatin, gjaknxehtësinë, etj. Pastaj i ftove që të bëhen dinjitozë, të sinqertë, të butë, të mëshirshëm, të pastër, duke na bërë të heqim dorë nga punët e ndaluara. Na mësove të duam njëri-tjetrin për Allahun (xh.sh.) dhe na bëre të kuptojmë më thellë se ç'është vllazërimi Islam.

Krahas popujve të tjerë edhe ne shqiptarët kemi nevojë për prehje shpirtërore, për pastrim shpirtëror, për qëndrueshmëri, durim, mbisundim të epsheve, për çlirim nga kultura e huaj, për stabilitet, drejtësi, barazi e marrëdhënie të mira të mbështetura në parimet e Ramazanit. Drejtimin që morëm në Ramazan, suksesin e sjelljeve dhe jetën e përparuar fetare që arritëm, është e nevojshme t'i vazhdojmë më tej. Kështu pra, duke i dhënë lamtumirën Ramazanit, është shumë gabim që t'u japim lamtumirën edhe xhamisë, adhurimit dhe portës së Allahut. Me begatinë dhe vrullin që morëm nga ky muaj i bekuar, ndërsa çdo ditë këpusim nga një fletë prej kalendarit tonë dhe largohemi prej botës së vdekshme, duhet që, duke u

53. Zumer, 39:53

lartësuar shpirtërisht, të përgatitemi për t'iu afruar edhe pak më shumë Allahut, për të arritur tek Ai, për të dalë në audiencë para Tij! Po qe se ditët tona do t'i kemi të njëjta me njëra-tjetrën, po të mos përparojmë çdo ditë sadopak në jetën fetare, do të thotë se gënjejmë veten. Duhet medoemos që çdo ditë të përparojmë vijimisht drejt përjetësisë, në raport me të shkuarën duhet të jemi më të përgatitur e më të fuqishëm.

Mbetet të themi se Allahu nuk është nevojtar për adhurimin e askujt. Adhurimet, lufta me nefsin, egon dhe armiqtë tanë të tjerë, janë për ne, për formimin tonë dhe për jetën tjetër që është perspektiva e përjetshme! Nuk ka rrugë tjetër për t'u formuar dhe për t'iu afruar Allahut. Fjalë të tilla si "unë nuk falem, nuk jam fetar, por zemrën e kam të pastër", janë fjalë boshe që s'shprehin asgjë, madje edhe ai vetë nuk i beson. E vetmja rrugë e drejtë që të çon te Zoti, është "të besosh" dhe "të veprosh". Të tjerat që mbeten janë dredhi e djallit, gënjeshtër e egos…

Tashmë po dalim nga muaji i bekuar i Ramazanit me fuqi, energji dhe vullnet të akumuluar për gjatë gjithë vitit vijues. Jemi më të bindur dhe e ndjejmë veten më të përgatitur shpirtërisht, psiqikisht, moralisht të mobilizuar dhe të gatshëm për Ramazanin tjetër. Së fundi e lusim Allahun të na i pranojë të tëra adhurimet që i kemi bërë gjatë këtij muaji; agjërimin, lutjet, faljet e namazeve, leximin e dëgjimin e Kuranit, sadaka-i fitrin dhe të gjitha veprat e tjera të mira.

BAJRAMET, FESTA TË VYERA PËR MYSLIMANËT

Kremtimi i festave në shumë popuj të botës, është shndërruar në formalitet, duke mos përfillur qëllimin e tyre moral dhe ngjalljen e ndjenjave humanitare. Në traditat e mira edukative të festës, infiltruan edhe shumë tradita të këqija, të cilat s'postuan të mirat dhe kështu festave u humbi qëllimi fisnik i kremtimit. Tekat e pakufishme në ushqim, në argëtim dhe në veshje luksoze, u sollën njerëzve më shumë dëm sesa dobi. Edhe bashkësitë fetare kanë festat e tyre javore apo vjetore, të cilat sadopak i ringjallin ndjenjat e besimtarëve, u japin vrull e forcë të re për jetën e tyre fetare më të fortë.

Kur Profeti (a.s.) emigroi në Medine vuri re se populli atje kremtonte dy festa në vit. Në ditët e festave organizoheshin lojëra e dëfrime të ndryshme. Kur pa këto Profeti (a.s.) tha:

"*Allahu i Lartë ka dhënë dy festa të tjera më të dobishme dhe më të bekuara se këto, Bajramin e Ramazanit dhe Bajramin e Kurbanit*"[54].

Bajrami i Ramazanit nis me përfundimin e agjërimit njëmujor dhe vazhdon tri ditë. Ky quhet edhe Bajrami i Fitrit meqë gjatë muajit të Ramazanit jepet sadakaja e fitrit si detyrim falënderimi për arritjen e

54. Nesai; Ibn Hiban; Et-Taxh, I, 309

këtij muaji shëndosh e gëzuar. Myslimanët përjetojnë në këtë festë gëzimin dhe lumturinë e agjërimit gjatë një muaji me radhë për hir të Allahut, e kapërcimit të vështirësive dhe të çuarjes në vend të urdhrit të Zotit Fuqiplotë. Bajrami i Ramazanit është i lidhur me përfundimin e suksesshëm të agjërimit dhe me fillimin e shpalljes së Kuranit, ndërsa Bajrami i Kurbanit me përfundimin e shpalljes së tij dhe me Haxhin.

Kremtimi i Bajrameve në trevat shqiptare

Ditët e bajramit shëmbëllejnë në ditë paqeje dhe gëzimi. Vetë fjala bajram do të thotë gëzim, begati, kënaqësi, hare. Kjo festë e madhe e gëzimit, mëshirës, faljes, mirëkuptimit, vëllazërimit dhe paqes, i bekon të gjithë besimtarët shqiptarë me më shumë dashuri e respekt për njëri-tjetrin, me më shumë dëshirë e përkushtim për të shfaqur vlerat e mirësisë e të solidaritetit njerëzor, si dhe për të kryer vepra të dobishme në shërbim të vendit dhe të ardhmes së tij. Profeti ynë i nderuar i porosiste shokët e tij që të mos i harrojnë të varfrit dhe nevojtarët në këto ditë feste, sepse bajramet janë gëzimi i individit dhe i shoqërisë, janë ndarja e këtij gëzimi mes njerëzve, janë hyrje në klimën e ndjenjave, janë mundësia që të gjithë myslimanët ta ndjejnë veten vëllezër. Nuk mund të mendohet që të ketë gëzim dhe kënaqësi bajrami për ata, që u kthejnë shpinën miqve, të afërmeve, fukarenjve dhe vëllait të mbetur mënjanë. Në një hadith thuhet:

"*Veprimi më i dashur për Zotin pas kryerjes së farzeve, është kur një mysliman e gëzon vëllain e tij*"[55].

Në trevat tona bajramet janë festuar gjithmonë solemnisht. Bajrami ka lënë gjurmë të thella e të pashlyeshme tek besimtarët shqiptarë edhe në çastet më kritike. Ai është freski për familjen, madje edhe besimtarët më të dobët bajramit i kushtojnë kujdes e rëndësi të veçantë. Pas namazit të bajramit, kudo, në qytete e fshatra, në lagje e në rrugë, të njohur dhe të panjohur takohen, përqafohen dhe urojnë bajramin me gjithë zemër

55. Sujuti, Xhamiu Sagir

54. Nesai; Ibn Hiban; Et-Taxh, I, 309

njëri-tjetrit. Urimi i bajramit nuk harrohet edhe për ata që janë larg. Atyre u telefonohet ose u dërgohen mesazhe telefonike. Urimet e bukura vazhdojnë edhe me postimet në rrjetet sociale. Është traditë e bukur që fëmijëve që trokasin në dyert e shtëpive për të uruar bajramin, i gëzojmë duke iu dhënë ëmbëlsira. Pasi shtrohet në shtëpi tryeza me ushqimet më të mira, hahet dhe festohet duke e falënderuar në fund Allahun për begatitë e dhuruara. Hasan Es-Sibti tregon:

"*I dërguari i Allahut na urdhëroi të vishnim rrobat më të mira që mund të gjenim në dy bajramet, të lyheshim me parfumin më të mirë dhe të bënim kurban kafshën më të mirë që mund të gjenim*"[56].

Është sunet për personin që të hajë vetë nga mishi i kurbanit dhe t'i japë kushërinjve të tij dhe fukarenjve. Ndërsa pasdite ose të nesërmen nisin vizitat nëpër shtëpi, në të afërm, fqinj, shokë e miq etj.Profeti Muhamed (s.a.s.) porosit:

"*Nga kurbanet, hani, shpërndani dhe ruani*"[57].

Në këtë drejtim, profeti Muhamed (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) na këshillon se, në bajrame të hahet, pihet dhe të shkëmbehen vizita, si dhe të tregohet gëzim e hare me qëllim që të manifestohet uniteti, toleranca, forca dhe vëllazërimi. Ditët e bajramit janë ditë gëzimi ku i madh e i vogël kënaqen dhe dëfrehen. Në këtë ditë ndërmjetësohet për të pajtuar të zemëruarit, mëritë dhe armiqësitë marrin fund, miqësitë forcohen, të vegjëlve u jepen dhurata, vizitohen të sëmurët; sepse kjo është dita e gëzimit dhe e lumturisë së përbashkët. Kremtimi i kësaj feste u jep myslimanëve një emocion të veçantë, një frymë të re, një zell të ri në punët e tyre fetare dhe të kësaj bote. Gjatë kësaj feste myslimanët japin shembullin më të bukur të bashkimit dhe unitetit Islam. Në këtë festë nuk mungojnë gjithashtu argëtimet, programet artistike dhe aktivitetet e ndryshme kulturore.

56. Hakimi
57. Buhari

Le të shërbejnë këto ditë feste në kalendarin islam, si një mundësi reflektimi për të gjithë ne, për të rishikuar e vlerësuar harmoninë dhe tolerancën fetare, si vlerën më të arrirë të shoqërisë shqiptare, për të na mundësuar që të kapërcejmë të gjitha vështirësitë e të sotmes dhe realizuar të gjitha dëshirat dhe aspiratat e së nesërmes.

Historiku i kurbanit

Që në fillim të jetës së tij në tokë, njeriu ndjente një falënderim ndaj një fuqie të lartë, si dhe nevojë që asaj fuqie t'i drejtohet për t'i kërkuar ndihmë dhe mbrojtje, ngushëllim dhe guxim, siguri dhe plotësim nevojash. Të drejtuarit e tillë, shprehej përmes ceremonive dhe ritualeve të ndryshme, duke filluar nga lutjet e falënderimet, e deri te flijimet në pasuri e ndonjëherë edhe në njerëz.

Ky fenomen, ka ekzistuar duke adhuruar edhe diellin, hënën, yjet, zjarrin apo idhujt. Njeriu është orvatur që nëpërmjet tyre të fitojë simpatinë e Zotit, ose së paku të zbusë dhe t'i shmanget hidhërimit të tij. Këtë fakt na e bën të qartë edhe Kurani kur shpreh mendimin e idhujtarëve, përsa i përket arsyes së adhurimit të idhujve:

"**Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Zoti**"[58].

Duke shpresuar simpatinë e Zotit, njeriu flijonte dhe shpresonte që në këtë mënyrë, më së miri do të kënaqte dhe do t'i afrohej Atij. Të flijuarit dhe ceremonitë e flijimit, ndryshonin në popuj të ndryshëm dhe në periudha kohore të ndryshme. Megjithatë, ata kishin një segment të përbashkët, të cilën e ndeshim te të gjitha traditat; si tek ato që mbështesin shpalljen autentike edhe tek ato që kanë origjinë mistike e tipare pagane. Kurbani ka ekzistuar pothuajse në të gjitha fetë si shprehje adhurimi. Në Kuran tregohet në këtë formë ekzistenca e kurbanit në të gjitha fetë:

58. Zumer, 39:3

"**Ne i caktuam çdo populli një ritual, që ata të përmendin emrin e Allahut gjatë flijimit të kafshëve**"[59].

Kurban, në kuptimin gjuhësor do të thotë "të afrohesh, mjet që të afron me Zotin". Ndërsa në literaturën islame ka kuptimin "të therësh një kafshë të përshtatshme sipas kushteve të caktuara me qëllim adhurimi". Prerja e kurbanit është një institucion shumë i vjetër, zanafilla e të cilit lidhet me ngjarjen e bijve të Ademit, Kabilin dhe Habilin. Në Kuran, Allahu (xh.sh.) urdhëron e thotë:

"**Lexoju (o Muhamed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata flijuan nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo**"[60].

Më pas ballafaqohemi me ngjarjen e profetit Ibrahimi (a.s.), kur ky vendosi të flijojë djalin e tij Ismailin, duke iu bindur urdhrit të Zotit, që iu transmetua në ëndërr. Këtë episod Kurani e shpjegon kështu, (Ibrahimi u lut):

"**O Zoti im, dhuromë një fëmijë prej të mirëve! Dhe Ne e përgëzuam Ibrahimin me një djalë të mbarë! Kur fëmija u rrit aq sa ta ndihmonte në punë, Ibrahimi i tha: - O biri im, kam parë ëndërr se duhet të të flijoj. Çfarë mendon ti? I biri tha: - O babai im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm! Pasi iu nënshtruan që të dy urdhërit dhe (Ibrahimi) e vuri (Ismailin) me ballë përtokë, Ne e thirrëm: - O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën. Vërtetë, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë! Ne e zëvendësuam atë (Ismailin) me një kurban të madh**"[61].

Profeti ynë na mëson që Allahu në vend të djalit, nëpërmjet engjëllit Xhebrail i sjellë Ibrahimit (a.s.) një dash për kurban. Në këtë ngjarje tregohet qartë devotshmëria e profetit Ibrahim dhe bindja e patundshme e birit të tij Ismailit.

59. Haxh, 22:34
60. Maide, 5:27
61. Safvat, 37:100-107

Duke u nisur nga ky parim edhe profeti ynë i nderuar vazhdoi këtë traditë të prerjes së kurbanit, duke mbjellur e kultivuar tek populli i tij ndjenjën e sakrificës dhe të flijimit për të vetmin qëllim të lartë e të shenjtë, afrimin tek Allahu. Urdhri i drejtpërdrejtë për therjen e kurbanit ymetit të Muhamedit (a.s.) i erdhi në Mekë me shpalljen e sures "Keuther" ku thuhet:

"**Ne vërtetë të dhamë ty shumë të mira. Prandaj falu dhe pre kurban për hir të Zotit tënd**".

Urtësitë e therjes së kurbanit të Bajramit

Është fakt i pamohueshëm se Allahu nuk ka nevojë për asgjë dhe për askënd, por ne kemi nevojë për mëshirën e tij. Atij nuk i shtohet as nuk i pakësohet asgjë nga qenia e tij hyjnore, premë apo nuk premë ne kurban për Të, por Atij i intereson devotshmëria e zemrave tona, siç thotë në Kuran:

"**Tek Allahu nuk arrin as mishi, e as gjaku i kurbaneve, por arrin përkushtimi juaj**"[62].

Dëshmia e sakrificës na bën t'i jemi Zotit mirënjohës që na mundësoi që të sakrifikojmë dhe ndërkohë të ndjejmë kënaqësi që duke shpërndarë mish, gëzojmë vëllezërit tanë për të festuar së bashku festën. Kjo na nxit që të jemi gjithmonë të gatshëm të bëjmë sakrifica për të mirën e përgjithshme, për fe e atdhe.

Kurbani është shprehje e heroizmit, sakrificës dhe bindjes së njeriut në rrugën për fitimin e kënaqësisë së Zotit. Kjo bindje dhe sakrificë është simbolizuar me profetin Ibrahim dhe djalin e tij Ismail duke arritur majat. Kurbani rrit shpirtin bindës ndaj Allahut dhe kryen rolin e afrimit të njeriut me Krijuesin. Në këtë mënyrë njeriu shfaq adhurimin e tij të vërtetë dhe mundohet të kryejë detyrën e falënderimit.

62. Haxh, 22:37

Gjithashtu kurbani ka shumë urtësi përsa i përket jetës sociale. Ai mbjell në shoqëri shpirtin vëllazëror, bashkëpunimin, ndihmesën dhe shpirtin e sakrificës, ndihmon në zhvillimin e barazisë në shoqëri dhe ndikon në kalimin e hendekut midis shtresave të ndryshme shoqërore, duke i nxitur ata drejt bashkëpunimit.

Në shoqëri, krahas të pasurve dhe atyre me gjendje mesatare, ka edhe njerëz apo familje me të ardhura të pakta ose të varfër, që nuk munden të marrin mish për periudha të gjata. Shumica e këtyre, duke qenë me sedër, nuk e bëjnë veten të kërkojnë. Ja pra, bajrami i kurbanit është një gosti e Allahut për të gjithë këta. Therja e kurbanit dhe ndihma për nevojtarët duke i gëzuar ata, i shërben zgjerimit të drejtësisë shoqërore dhe fuqizimit të dashurisë midis njerëzve.

Gjithashtu nga ana tjetër kurbani e mëson njeriun e pasur të japë nga pasuria e tij për të fituar kënaqësinë e Zotit. E nxit atë të ndihmojë të tjerët dhe të ndjejë thellë në ndërgjegje kënaqësinë që të jep kjo ndihmë që u ofrohet të tjerëve. Kështu e shpëton atë nga sëmundja e koprracisë dhe pasioni i tepërt për pasurinë e kësaj bote.

VIZITA E QABES SË MADHNUESHME

Kur viziton Qaben, shtëpinë e parë të adhurimit, të ndërtuar me urdhrin e Allahut, një pelegrin bëhet dëshmitar i faktit se cilësitë tokësore si raca, prejardhja, statusi, bukuria dhe rinia, nuk janë asgjë tjetër përveçse emërtime të përkohshëm, të destinuara të humbasin. Ai përjeton në ato momente një episod nga shfaqja e madhe e ditës së ringjalljes, ditë në të cilën atij do t'i duhet të japë llogari përpara Zotit për gjithçka ka bërë në jetë.

Zbatimi i ritualeve të haxhit është përgjigjja e duhur ndaj kërkesës, të cilën njeriu e kërkon gjatë gjithë jetës së tij. Kjo kërkesë është të fituarit e kuptimit. Njerëzit e kohës sonë po vuajnë mungesën e dhënies së një kuptim mendimeve dhe sjelljeve të tyre. Ndërkohë, haxhi posedon fuqinë dhe kapacitetin që t'i japë kuptim të gjitha veprave dhe mendimeve të njeriut. Shumë dijetarë janë të mendimit se udhëtimi për në haxh, është një nga mënyrat më të mira për përparimin shpirtëror të njeriut. Sipas tyre, problemet si depresioni dhe sëmundjet shpirtërore si urrejtja, xhelozia, hipokrizia, gënjeshtra dhe shumë ndjenja të tjera negative, pengojnë udhëtimin shpirtëror të njeriut dhe një gjë e tillë mund të largohet gjatë ritualeve të haxhit. Prania në vendet e shenjta dhe kryerja e ritualeve fetare bashkërisht, ndihmojnë në paqtimin fizik dhe shpirtëror të njeriut.

Islami sot është i përhapur në të gjithë botën, në qindra vende të ndryshme, në etni dhe grupe racore të ndryshme. Myslimanët, si asnjëherë tjetër, të bashkuar, e mirëpresin njëri-tjetrin si pjesëtarë të së njëjtës familje. Pavarësisht aderimit në disa kultura të ndryshme, ata mbeten thelbësisht të lidhur nëpërmjet të njëjtit sistem besimi e të njëjtave vlera. Dhe kjo vihet re më së miri në haxh, ku duket qartë një solidaritet mes gjithë myslimanëve. Haxhi bashkon në një qëllim të vetëm miliona myslimanë, duke u bërë shkak për krijimin e një tabloje të gjallë të barazisë dhe të vëllazërisë.

Haxhi, si një nga detyrat e Islamit, që lartëson e shpalos bashkimin shoqëror mes myslimanëve, është aq madhështor e gjithëpërfshirës, saqë gjerësia dhe hapësira e tij nuk është e mundur të vërehet në asnjë tjetër vend apo bashkësi në faqe të dheut. Në një kohë kur bota në të cilën jetojmë është e mbushur me ngatërresa, përçarje dhe konflikte, haxhi duhet të konsiderohet si një rast i volitshëm për vendosjen e paqes dhe qetësisë nëpër vende të ndryshme të botës. Në haxh, largimi e përçarja shndërrohet në unitet e bashkim dhe haxhiu e shijon tolerancën e mirëkuptimin në kulmin e saj.

Haxhi është adhurimi i fundit i obliguar për besimtarët myslimanë në vitin e 9 të hixhretit me ajetin, i cili thotë:

"**Vizita e shtëpisë (Qabes) për hir të Allahut është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo**"[63].

Haxhi i parë në historinë islame u krye nën vëzhgimin e Ebu Bekrit, ndërsa Profeti a.s. e kreu detyrën e vet të haxhit një vit më pas, në vitin e 10 të hixhretit (632). Ky qe haxhi i parë dhe i fundit i Profetit (a.s.), prandaj u quajt haxhi i lamtumirës. Haxhi përmban në vetvete vlera të shumta. Ai është rasti më ideal që myslimani të pastrohet nga gjynahet dhe gabimet e tij. Transmetohet nga Ebu Hurejra se i dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

63 Al'Imran, 3:97

"*Kush e viziton Qaben dhe nuk flet fjalë të ndyra, nuk i kapërcen kufijtë e sheriatit, kthehet nga ajo ashtu si ditën që ai lindi nga nëna*"[64].

Haxhi është një bashkësi ritualesh të kryera në Mekë dhe e vendeve të bekuara përreth saj. Pelegrinët hyjnë në vendin e shenjtë me ihram, me qëllimin për të kryer vizitën duke zbatuar disa rregulla të caktuara. Vizita e atyre vendeve të bekuara, që ndodhen në një pjesë të nxehtë të botës, e skenave të lindjes dhe përhapjes së Islamit, duke kaluar shumë vështirësi dhe duke bërë sakrifica fizike e materiale, është argument që tregon sinqeritetin e të qenët rob i Allahut.

Gjurmë të adhurimit të haxhit, mund të hasen në të gjitha kulturat religjioze. Gjatë historisë, njerëzit u kanë dhënë disa vendeve të caktuara shenjtëri dhe kanë ndjerë nevojën t'i vizitojnë ato qoftë edhe një herë të vetme. Në shumicën e feve, qendrat e shenjta të vizitave bartin pothuaj të njëjtat veçori. Krahas adhurimit, pelegrinit i jepet mundësia për të parë vende të ndryshme dhe për t'u takuar me njerëz të ndryshëm.

Në të gjitha fetë, pelegrinazhi ka një sërë funksionesh. Por në asnjë fe, pelegrinazhi nuk është aq ndikues dhe veprues sa haxhi në Islam, ku njerëz nga të katër anët e botës, të pasur e të varfër, pa dallim ngjyre, gjuhe, race, kombësie, kulture dhe pozite shoqërore, vishen njëlloj, ndjekin të njëjtat rregulla duke lëvizur në të njëjtat kushte; mblidhen në të njëjtin vend e në të njëjtën kohë duke krijuar një unitet ndjenjash. Në këtë drejtim, jemi të bindur se kuptimin më të plotë e të përsosur në të gjitha aspektet, haxhi e ka gjetur në fenë islame.

64. Buhari; Muslim

65 Al'Imran, 3:97

KUPTIMI I RITUALEVE TË HAXHIT

Qabja, e cila cilësohet si bejtullah, shtëpia e Allahut, është një faltore e shenjtë, e tillë qysh në kohën e profetit Adem (a.s.). Zoti e cilëson në Kuran në këtë mënyrë:

"**Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt**"[65].

Qabja, me atë domethënie e shenjtëri të thellë, është një vatër e pashoqe monoteizmi, e tillë që, prej veçantive që mbart, nuk mund të gjëndet një ndërtesë e dytë që barabart me të, të mund t'i thuhet shtëpi e Allahut. Ajo dhe rrethinat e saj përbëjnë një vend plot magjepsje e joshje që nuk gjendet kurrkund tjetër në botë.

Në tavaf (rrotullimin rreth Qabes) gjithsecili e ndjen veten si një fëmijë i dobët që, i kapur fort për dore, vrapon në siguri plot ngazëllim. Njeriu rend sikur të jetë duke ecur vërtet drejt Allahut dhe nuk vetkontrollohet më. Me trupat gjysmë të zhveshur, me rrobën në supe, përjetojmë emocionin e të rendurit përpara në një rrugë sa të lodhshme e të trazuar, po aq edhe shpresdhënëse e të sigurt.

65 Al'Imran, 3:96

Arafati është një pozitë falleje e përgjërimi. Arafati na kujton ngritjen nga varret ditën e gjykimit dhe mbledhjen grumbuj-grumbuj në sheshin e grumbullimit. Ai është një shesh mahsheri i mbushur me shqetësimin e llogaridhënies, ku mëshira e Zotit zbazet plot bujari në shpirtrat tanë. Të gjithë robtë presin para Allahut të dobët, të pafuqishëm, nevojtarë e me shpresë. Zemrat dhe sytë njomen me lotët e pendimit, lutje përgjërimi të panumërta që i drejtohen Zotit. Të zhveshur dhe të larguar prej gjithçkaje të kësaj bote, me shqetësimin e peshores e të llogaridhënies dhe me shpresën e mëshirës, njerëzit këtë ditë të vetme e vlerësojnë sikur të duan të nxjerrin prej saj fitimin e viteve të tëra. Në librin e jetës hapen faqe të pastërta dhe Zotit i jepet besa se pjesa e mbetur e jetës do të jetohet me bindje ndaj Tij. Këta mysafirë të Zotit vihen në pritje me dëshirën për një mundësi e fillim të ri, për një epokë të re.

Nga ana tjetër, Arafati na çon edhe në kujtime të vjetra kur Ademi (a.s.) dhe nëna jonë Havaja u zbritën në tokë larg njëri-tjetrit. Dhe Zoti pasi pranoi lutjen e tyre i bashkoi në Arafat, të cilët qanë dhe u penduan përsëri.

Muzdelife është një mjedis i bekuar i mbushur plot me shfaqje mëshire, që mbart namin e të qënit më afër Allahut në nivelin që sexhdja është kundrejt rukusë. Ibn Abasi thotë se Profeti ynë i dashur arriti në Muzdelife për umetin e vet, të merrte një rrecetë ndihme e çlirimi që nuk e mori dot në Arafat. Muzdelifenë, sidomos pasi nata thellohet, çdo anë e mbulojnë mistere edhe më të fshehta. Ndërsa disa çlodhen për detyrat e vështira që i presin ditën e nesërme, ka njerëz që gjer në mëngjes mbeten të ulur me duar të hapura duke iu lutur Zotit. Këta shpirtra të gjërë, e tërheqin zërin e tyre në zemër dhe kushedi se ç'mendojnë e ç'u shkon ndër mend. Lutje papushim drejtuar Zotit jashtë namazit, dashuri e përkushtim shprehur brenda namazit...

Mina ka vlerën e një mjedisi nënshtrimi dhe dorëzimi, ku Profeti Ibrahim (a.s.) dhe djali i tij Ismaili (a.s.) e gjuajtën shejtanin me gurë dhe dolën fitues ndaj tij. Ajo është vërtetë si një koshere nënshtrimi e si një

çerdhe përkushtimi të pakushtëzuar. Ky vend është aq i mistershëm, saqë çdo shpirt që nuk është krejtësisht i mbyllur ndaj botës së amshuar, ç'nuk ndien në atë vendpushim mes atyre maleve e luginave! Mina, me të gjitha anët e saj, na duket aq e njësuar në shpirtin tonë, saqë na bëhet sikur e ndjejmë se si ajo rreh në zemrën tonë, rrjedh në venat tona, gjallon në nervat tona.

Ndërkaq goditja e shejtanit me gurë është mallkimi i tij dhe orientimi i zemrës drejt Allahut, i zemrës së çliruar prej çdo lloj indiferentizmi, paqartësie, përgjumësie dhe lëkundjeje e dyshimi. Prandaj Profeti ynë thotë:

"*Synimi i goditjes me këta gurë s'është gjë tjetër veçse përmendja dhe pohimi i emrit të Zotit*"[66].

Safa dhe Merve janë dy kodrat mes të cilave ndodhet burimi i Zemzemit. E shqetësuar për fëmijën e saj dhe veten nga etja e madhe dhe mungesa e ujit, nëna Haxherja pati vrapuar nga një kodër në tjetrën disa herë gjersa pati zbuluar burimin e Zemzemit. Tani ky vrapim, si pjesë e haxhit, e që emërtohet Sa'j (përpjekje) na kujton dobësinë njerëzore dhe nevojën e mbështetjes te Zoti. Rëndësinë e këtyre dy kodrave Zoti e shpreh kështu:

"**Pa dyshim Safa dhe Merva janë nga shenjat e Allahut**"[67].

Udhëtari i haxhit, që nga çasti që largohet nga shtëpia, gjatë rrugës, çlirohet hap pas hapi prej egos dhe unit, në drejtim të jetës së zemrës e të shpirtit. Njeriu në këtë udhëtim bëhet pjesë e të vërtetave të vjetra, por që nuk vjetërohen dhe mbeten kurdoherë të freskëta. Allahu në Kuran thotë:

"**Kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij**"[68].

66. Tirmidhi
67. Bekare, 2:158
68. Haxh, 22:32

E ndërsa ditët shkasin drejt Bajramit, vendi i tavafit, zemzemi dhe vajtja e ardhja mes Safasë dhe Merves shkojnë me ndjenjën e një kurbeti e përmallimi. Qabja nis të na i mbyllë dalëngadalë perdet e dritareve që na kishte çelë... dhe njeriu që në çdo ngjarje sheh që është i përkohshëm, siç kupton se po afron koha për t'u larguar nga këtu, mendon se një ditë do të ndahet edhe nga kjo botë kalimtare. Tashmë Haxhiu, i brengosur, por i përmbajtur, i shqetësuar, por plot shpresë, për kënaqësi të Zotit tendoset me zellin për të jetuar për të tjerët, për të qeshur e qarë për të tjerët, madje edhe për t'i shërbyer të tjerëve.

NJERIU ËSHTË BASHKË ME ATË QË DO

Kur profeti Muhamed (s.a.s.) ishte nisur për luftë, Theubani nuk mundi të ishte me të. Në kthim të gjithë vinin ta vizitonin profetin dhe Theubani ishte mes tyre. Ai dukej i verdhë dhe i dobësuar shumë. Profeti i mëshirës e pyet: *"Ç'është kjo gjëndje o Theuban?"* Theubani i përgjigjet: "O i dërguari i Allahut, një mendim më bren trurin, prandaj jam kështu. Mendova me vete. Unë nuk arrita dot të rezistoj për vetëm tre ditë larg nga i dërguari i Allahut, si mund të qëndroj larg në një botë të përjetshme (Ahireti)?! Sepse vendi i të dërguarit të Allahut në xhenet është i lartë, kurse unë jam një rob i thjeshtë. Edhe sikur të hyjë në xhenet, nuk mund të hyj në xhenetin ku është i dërguari i Allahut. Atëhere unë do të qëndroj përjetësisht i ndarë prej tij. Këtë mendova dhe jam në këtë gjëndje". I dërguari i Allahut i përgjigjet me një sihariq të pavdekshëm këtij njeriu që vuan nga kjo:

"Njeriu është bashkë me atë që do"[69]

Në këtë hadith Profeti ynë shpjegon më së miri se njeriu si në këtë botë, por edhe atje do të jetë vazhdimisht me ata që do, në cilindo skaj qoftë, pozitiv apo negativ. Ai që don të jetë së bashku me profetët, me

69. Buhari; Muslim

njerëzit besnik dhe të drejtë, më parë duhet t'i dojë ata, pastaj duhet ta bëjë natyrë brenda vetes karakteristikat e atributet e tyre. Kuptimi dhe konkluzioni i hadithit vlen edhe për njerëzit që përfaqësojnë të keqen.

Nuajmani pinte ndonjëherë dhe i dërguari i Allahut zbatonte atë kohë ndaj tij distancimin. Veprimi i personit ishte një mëkat. Por, kur sahabët i drejtuan atij fjalë të rënda për shkak të këtij veprimi, Profeti vërenjti vetullat dhe urdhëroi:

"*Mos e ndihmoni shejtanin kundër vëllait tuaj. Betohem në Allahun se ai e do Zotin dhe të dërguarin e Tij*"[70].

Kështu që, sado mëkate të bëjë njeriu te i cili dashuria për Allahun dhe Profetin jep si rezultat bashkimin e tij me ta, nuk e meriton fjalën e keqe dhe ofendimet. Njeriu atë që do dhe atë gjë për të cilën ndjen një lidhje të veçantë, e mendon dhe e përmend ditë e natë, e ka në mendje dhe në imagjinatën e tij, madje e mendon atë edhe në ëndërr. E vërteta e të qënit bashkë vazhdon edhe në varr, në ringjallje dhe më tutje. Atëhere njeriu duhet të shikojë rreth e rrotull vetes. Kë do më shumë dhe kush e bën të mendojë më shumë për të? Me kë ndjehet më shumë i lidhur dhe çfarë shikon më shumë në ëndërr? Për cilat gjëra mërzitet dhe për cilat gjëra gëzohet më tepër?

Duke qenë se njeriu do të jetë bashkë me atë që do, atëhere duhet të dojë ata të cilët do t'i bëhen shokë në jetën e përtejme, që do ta ndihmojnë, që do ta kapin për dore dhe do ta qetësojnë. Duke bërë punë të mira që t'i arrijë ata, duhet të gjallërojë zemrën dhe mendjen e tij me të vërtetat rreth tyre. Në rast të kundërt njeriu do të heqë shumë dhe do të marrë të barasvlefshmen e atyre që ka dash e që ka bërë si në këtë jetë, ashtu edhe në tjetrën.

Të gjithë Profetët kanë menduar gjithmonë Atë që është i Vërtetë dhe i Përhershëm, Allahun e Madhëruar. Kanë jetuar për hir të Allahut

70. Buhari

dhe qëllimi i jetës së tyre ka qenë të hyjnë në rrethin e njerëzve të dashur prej Zotit. Hz. Muhamedi (s.a.s.) para se të shpërngulej për në jetën e përhershme, thoshte me gjithë fuqinë e tij pa pushuar: "Për te miku i lartë, te miku i lartë..." Kjo ishte shprehje e kërkesës për t'i dorëzuar shpirtin Allahut të Madhëruar, me kënaqësinë për të qenë bashkë me Mikun e Lartësuar, shoqërinë e të cilit e kish ndjerë në çdo minutë të jetës së tij. Kur hazreti Asija (r.anha) po qante nën shtypjen dhe padrejtësinë e pashembullt të faraonit të pamëshirshëm, së shpejti e kuptoi që do të binte dëshmore. Duke u shtypur me atë gur që mezi e ngrinin 4-5 veta, në një moment ngriti sytë dhe filloi të lutej: "O Zoti im, më bëj mua në xhenet një shtëpi pranë Teje...". Lutja "pranë Teje", na flet për dëshirën e saj për të qenë pranë Allahut.

Nën dritën e Kuranit dhe të hadithit është shumë e mundur që të shtosh numrin e shembujve të tillë. Të gjitha këto na kujtojnë që njeriu duhet të dijë se kë të dojë dhe çfarë të kërkojë. Të gjitha këto na tregojnë që pas jetës së varrit ka një kënaqësi të vazhdueshme dhe të përjetëshme, shumë më të bukur dhe tërheqëse se kënaqësitë e kësaj bote. Dhe nga kjo kuptojmë haptazi se çdo gjë që nuk është për hir të Allahut, është kalimtare dhe e dëmshme.

FALËNDERIMI, VIRTYT I PAÇMUAR

Transmetohet nga Mugire: Profeti (a.s.) ka qëndruar aq gjatë duke falur namaz, derisa i janë enjtur këmbët dhe Aishja i tha: Allahu t'i ka falur gabimet e kaluara dhe të ardhshmet, pse e bën këtë? Ai është përgjigjur:

"*A nuk duhet të jem një rob falënderues*?!"[71]

Jeta dhe gjithçka që i ka dhënë Zoti njeriut në këtë botë është amanet. Dhe njeriu këtë amanet duhet ta çojë në vendin e vet duke u bërë rob i Zotit në kuptimin e plotë të fjalës. Për këtë arsye njeriu duhet të përpiqet gjatë gjithë jetës së vet për t'u bërë një besimtar i denjë për Krijuesin e tij. Një ndër elementët që duhet ta shoqërojë njeriun në rrugëtimin e tij për t'iu afruar Zotit, është të jetë mirënjohës dhe falënderues. Jo më kot në hadithin e lartëpërmendur Profeti e shpreh në mënyrën më të bukur rëndësinë e falënderimit. Ndërsa në suren e dytë të Kuranit Allahu (xh.sh.) urdhëron e thotë:

"**Pra, më kujtoni Mua (me adhurime) që Unë t'ju kujtoj (me shpërblime), më falënderoni e mos më mohoni**"[72].

Dijetarët myslimanë e kanë grupuar konceptin e falënderimit në tri çështje:

71. Buhari; Muslim; Tirmidhi; Nesai; Ibn Maxhe
72. Bekare, 2:152

a) Çështja e parë është të dihet dhe të kuptohet mirë që të gjitha begatitë vijnë prej Allahut dhe vetëm me lejen e dëshirën e Tij. Të gjithë faktorët si njerëzit, vendi, rrethanat, dukuritë natyrore etj., janë vetëm shkaqe që kjo begati të mbërrijë në destinacionin e vet. Transmetohet se Hz. Musa (a.s.) ka thënë: O Zot, si mundi Ademi të japë falënderimin e asaj që bëre për të? E krijove me fuqinë Tënde, fryve në të prej shpirtit Tënd, e vure atë të banojë në xhenetin Tënd, urdhërove engjujt që t'i bënin sexhde. Allahu iu përgjigj: O Musa, ai e kuptoi se kjo është prej Meje dhe më falënderoi. Dhe ky ishte falënderimi për atë që i bëra.

b) Çështja e dytë është që ta shohim këtë begati si mjet, i cili do të na afrojë më shumë me Allahun. Në këtë mënyrë kjo do të shërbejë që të jemi më të përkushtuar ndaj Zotit. Ebu Xhild transmeton: Kam lexuar për Musain (a.s.) se ai i është drejtuar Allahut: O Zot, si mund të të falënderoj Ty, kur mirësinë më të vogël që më ke dhënë nuk arrin ta shlyejë dhe ta shpërblejë e gjithë puna ime?! Atij i erdhi shpallja: O Musa, tani më falënderove Mua.

c) Çështja e tretë është që të veprosh me zemër, fjalë dhe fizikisht duke iu bindur urdhrave të Zotit e duke iu larguar rrebelimit. Profeti (a.s.) pyet një njeri, si u gdhive? Mirë, i përgjigjet ai. Profeti (a.s.) e përsërit pyetjen dhe merr të njëjtën përgjigje. Kur të njëjtën pyetje Profeti e përsërit për herë të tretë, ai i përgjigjet: Falënderoj Zotin jam mirë. Profeti (a.s.) i tha: Këtë përgjigje prisja prej teje, prandaj e përsërita pyetjen.

Falënderimi që i bëhet Zotit të botërave në namaz është më i miri, sepse namazi përfshin të gjitha llojet e falënderimeve. Çdo pasuri mbi dhe nën sipërfaqen e tokës është krijuar nga Allahu i Lartmadhëruar për t'i shërbyer njeriut dhe jetësës së tij në tokë. Për të gjitha këto dhe të tjera duhet të falënderojmë Krijuesin tonë që megjithëse mëkatojmë, Ai vazhdimisht nuk e kursen ndihmën dhe begatitë e Veta për ne. Sa herë që Allahu e begaton një njeri me mirësi dhe ai e falënderon për këtë, falendërimi i tij është më i mirë se mirësia. Jo më kot në Kuran thuhet:

"**Ne i patëm dhënë Daudit dhe Sulejmanit dituri dhe ata të dy thanë: Falënderojmë vetëm Allahun që na dalloi (me të mira) nga shumë robër të Tij besimtarë**"[73].

Nëse Allahu i jep sukses njeriut për të falenderuar begatitë e Tij të kësaj bote, kjo mirësi është më e mirë dhe më e dashur te Zoti se begatitë. Sepse begatitë e kësaj bote nëse nuk shoqërohen me falënderim, atëherë janë bela dhe sprovë për njeriun. Nga ana tjetër mirënjohja që tregon robi i shton më tepër begatitë dhe mohimi tyre ndëshkohet nga Zoti.

"**Dhe (kujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: Nëse falënderoni do t'ua shtoj të mirat, e nëse përbuzni, s'ka dyshim dënimi Im është i vështirë**"[74].

Njëkohësisht duhet t'u jemi mirënjohës e t'i falënderojmë edhe njerëzit kur ata bëhen sebep për mirë, sepse në këtë mënyrë tregojmë moralin e bukur të fesë sonë që përfaqësojmë. Duke vepruar në këtë mënyrë kënaqim Krijuesin tonë, në të kundërt nuk kemi falënderuar edhe Atë. Kështu shprehet Profeti ynë në fjalën e tij kur thotë:

"*Kush nuk falënderon njerëzit nuk falënderon Zotin*"[75].

73. Neml, 27:15
74. Ibrahim, 14:7
75. Ahmed

DURIMI, DHUNTIA MË E MADHE

Profeti (a.s.) thotë: "*Kush kërkon të durojë, Allahu i jep durim dhe askujt nuk i është dhënë dhunti më e mirë dhe më e madhe, se sa durimi*"[76].

Të bësh durim, do të thotë të shtrëngosh dhëmbët, të parandalosh trupin që të mos bëjë mëkate, të mposhtësh shpirtin e lakmisë, të tregosh zell, të mos të paralizohet vullneti. Si vlerë dhe virtyt i besimtarit, durimi është mekanizmi i disiplinimit të shpirtit, egos dhe trupit të tij. Ai shërben për frenimin e shpirtit ndaj shqetësimeve, provokimeve, depresionit dhe të gjitha sprovave të kësaj bote. Durimi është elementi më i përshtatshëm për kapërcimin e vështirësive dhe ngritjes shpirtërore. Koncepti i durimit është gjithëpërfshirës dhe është virtyti më i përmendur në Kuran (mbi 90 herë). Si për shembull:

"**Allahu është me durimtarët**"[77], "**Allahu i do durimtarët**"[78], "**Bëni durim dhe garoni në durim**"[79].

Ajo që e bën të veçantë dhe ia lartëson vlerën durimit edhe më shumë, është fakti se Zoti me atë cilësi ka përshkruar Vetveten. Ndër emrat dhe cilësitë e Allahut është "Es-Sabur – I Durueshmi, Durimtari."

76. Buhari; Muslim
77. Bekare, 2:153
78. Al'Imran, 3:146
79. Al'Imran, 3:200

Zoti në Kuranin Fisnik na premton shumë të mira që burojnë nga durimi, nëse e zbatojmë brenda kuadrit dhe disiplinës hyjnore. Allahu na e ka bërë të qartë se çdo njeri do të sprovohet në këtë botë me diçka që Ai (xh.sh.) e ka përcaktuar më parë.

"**Ne do t'ju sprovojmë me diçka nga frika, uria, me humbje të pasurisë dhe të jetës e të fryteve. Dhe përgëzoji durimtarët. Të cilët kur i godet ndonjë fatkeqësi ata thonë: Ne jemi të Allahut dhe te Ai do të kthehemi! Të tillët kanë prej Zotit të tyre bekim e mëshirë dhe ata janë me të vërtetë të udhëzuarit**"[80]. Në një ajet tjetër Kuranor urdhëron e thotë: "**Vetëm ata që janë të durueshëm do të shpërblehen pa masë**"[81].

Ndërsa Profeti Muhamed (a.s.) thotë se durimi për hir të Allahut, i treguar përgjatë vështirësive të jetës është pastrim prej gjynaheve.

"*Çfarëdo që e godet myslimanin, qoftë lodhje, pikëllim, brengë, hidhërim, mundim nga sëmundje a fatkeqësi, madje edhe ferra që e shpon, me cilëndo prej këtyre, Allahu e pastron prej gjynaheve që ka bërë*"[82].

Njeriu, për nga vetë natyra e krijimit, kërkon rehati, qetësi dhe është i prirur për të ndjekur dëshirat e tij. Atij nuk i pëlqen nënshtrimi, disiplina dhe puna e vështirë. Gjumi, ushqimi dhe pasuria janë ndër thesaret që njeriu i ruan fort. Për këtë arsye njeriu është urdhëruar për durim, i cili duhet të ushtrohet në raste dhe situata të ndryshme. Si për shembull, durimi i treguar kundrejt kohëzgjatjes së madhe në punët që kërkojnë kohë dhe përqëndrim të lartë, durim duke mos e prishur edukatën kundrejt gjërave që mund të na ndodhin, durim duke mos i cilësuar ngjarjet ca të këqija e ca të mira, por të jemi mirënjohës njëlloj ndaj Allahut. Durim ndaj fatkeqësive dhe ngjarjeve të hidhura, por kjo kërkohet vetëm në goditjen e parë të së keqes, sepse ndërrimi i vendit dhe i gjëndjes krijojnë gjithmonë ndryshime psikologjike dhe bëjnë që të harrohen ngjarjet e hidhura. Ashtu siç i thotë edhe Profeti (a.s.) një gruaje:

80. Bekare, 2:155-157
81. Zumer, 39:10
82. Buhari; Muslim

"*Durimi është ai i goditjes së parë*"[83].

Durim ndaj harameve. Një qëndrim i tillë ndaj harameve, me kohë kthehet në shprehi e në karakter për njeriun dhe bëhet ndër sjelljet e natyrshme të tij. Për një njeri që ka arritur në këtë nivel, nuk mund të mendohet lehtë se do të bjerë vullnetarisht në gjynah. Durim ndaj adhurimeve të obliguara. Pesë kohë namaz çdo ditë, një muaj në vit agjërim, zekat në një masë të caktuar dhe zbatimi i të gjitha urdhrave të tjera lidhur me detyrën e robit ndaj Zotit, mund të çohen në vend vetëm me durim. Këto e disiplinojnë dhe e begatojnë jetën e njeriut në këtë botë duke dhënë në fund si rezultat, xhenetin. Prandaj njeriu do të shtrëngojë dhëmbët, do të bëjë durim dhe në këtë mënyrë do ta ndriçojë e zbukurojë jetën e tij.

83. Buhari; Muslim

82. Buhari; Muslim

QËNDRIMI I EKUILIBRUAR DHE RUAJTJA E BARASPESHËS

Për ta jetuar fenë ashtu si kërkon Krijuesi ynë, është shumë e rëndësishme që të jemi të ekuilibruar dhe ta ruajmë gjithnjë baraspeshën në gjykimet, ndjenjat dhe veprimet tona. Bëhet fjalë për marrëdhëniet tona me veten, Zotin dhe të tjerët. Është një fakt i pamohueshëm dhe i njohur nga të gjithë besimtarët se kjo botë është e vetmja mundësi që na jepet nga i Madhi Zot për të fituar botën e amshuar. Kjo është edhe arsyeja e lidhjes së fortë që ekziston mes kësaj bote dhe tjetrës. Pra, kjo botë, është vendi ku ne mbjellim punët për aq kohë sa jetojmë, kurse tjetra është bota e përjetshme, ku do të korrim ato që kemi mbjellë. Për këtë arsye, secilës botë ne duhet t'i japim rëndësinë dhe vlerën që i takon. Allahu (xh.sh.) në Kuran na jep disa kritere të rëndësishme për raportin dynja-ahiret:

"**Por përpiqu me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës tjetër, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë**"[84].

Nga ky ajet kuptojmë se duhet të përpiqemi për mirëqenie, duke bërë të pamundurën në çdo fushë të jetës, dhe këtë botë mos ta braktisim në drejtimin material, por me zemër. Madje, sukseset e ndryshme materiale në këtë botë, t'i shijojmë si dhurata të Zotit, por pa i lejuar që të na pushtojnë zemrën dhe shpirtin.

85. Hud, 11:112

Të kalojmë tek ekuilibri në jetën tonë të përditshme të përçimit të ftesës në islam, pra të përpiqemi t'i shfaqim njerëzimit realitetin ndriçues të Islamit, duke ekspozuar një përfaqësim dinjitoz të fesë, mbështetur në një përpjesëtim të drejtë të fjalës që themi me veprën që kryejmë. Vetëm kështu, me lejen e Zotit, do të kemi sukses në këtë drejtim dhe do të na lehtësohen punët e dynjasë. Pas kësaj, ato çfarë i kanë hije besimtarit kundrejt këtyre arritjeve e sukseseve, janë thjeshtësia, modestia dhe përulësia, si dhe duke ia atribuuar ato arritje Zotit, si dhurata të Tij. Pra, për një qëndrim të ekuilibruar, është shumë e rëndësishme që njeriu, rezultatet dhe frytet e arritura, të mos ia atribuojë vetes si merita dhe të mos pre e egos apo në ndjesi vetëkënaqësie për shkak të shërbimeve të kryera e të përpjekjeve të realizuara. Madje, duke mos e nxjerrë asnjëherë nga mendja se edhe ato shërbime apo suksese të arritura mund të jenë një tjetër trajtë e sprovimit, besimtari duhet ta ndjejë shqetësimin se kjo mund të jetë sprovë që shpie në pasoja të rrezikshme. Pra, kundrejt lëvdatave, admirimit dhe vlerësimeve, njeriu mund të shkasë nga trualli i nënshtrimit e bindjes drejt egos së sëmurë. Për pasojë, mund të ketë spostim të qëndrimit të ekuilibruar.

Ata që bien në të tilla vlerësime e admirime, duhet t'i kthehen Zotit që të mos i ngarkojnë vetët e tyre me mëkate. Por nëse personi që i përfiton këto lëvdata dhe - Zoti na ruajttë! - kaplohet nga mendime si "vlerësimi është me vend", atëherë do të thotë që, në të vërtetë, ai është duke e humbur rrugën e fitores. Për këtë arsye, për aq kohë sa ndiqet rruga e mesme, e ekuilibrit dhe e baraspeshës, edhe egoja, që i është pjesë e natyrës njerëzore, e cila në pamje të parë duket si diçka negative, kthehet në favor për besimtarin. Zoti i Madhëruar na ruajttë prej asaj sjelljeje të rëndë të të krenuarit me shërbimet që kryejmë, sepse kjo do të ishte mungesë vetëpërmbajtjeje dhe mungesë ekuilibrimi kundrejt asaj që na kërkohet. Në këtë çështje, ekuilibër do të thotë që gjithçka t'ia njohim Zotit. Allahu (xh.sh.) me ajetin:

"**Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar!**"[85],

84. Kasas, 28:77

i ka thirrur myslimanët, drejt rrugës së drejtë. Duke u mbështetur edhe në stilin e të shprehurit që zotëron ajeti, kuptojmë se marrësi i vërtetë i mesazhit është tërësia e gjithë umetit. Njeriu që humb ekuilibrin, fillon të çorientohet me ngadalë, derisa, pa e kuptuar, "fundoset gropave" të kryeneçësisë e devijimit. Prandaj, qenia njerëzore, që sprovat janë pjesë e realitetit të saj, teksa thirret për të qenë në rrugë të drejtë (në të mesmen e artë), këshillohet me njëfarë paralajmërimi "Kujdes se mos çorientohesh!"

Njëlloj siç qëndrojmë larg çdo virusi material, që mund të na dëmtojë rëndë shëndetin tonë fizik, ashtu duhet të qëndrojmë sa më larg prej viruseve që mund të na çojnë në "anim", drejt padrejtësisë, dhe në fund drejt humbjes së orientimit të rrugës së drejtë. Ata që ruajnë balancën dhe nuk rendin drejt "animit", do ta marrin shpërblimin nga Zoti dhe do të përgëzohen nga engjëjt.

Në një ajet kuranor, Allahu (xh.sh.) tregon qartë për shpërblimin që do marrin ata që ruajnë baraspeshën dhe janë përherë përfaqësues të denjë të ekuilibrit në objektiva, fjalë, sjellje dhe veprime:

"**Me të vërtetë atyre që thonë: Zoti ynë është Allahu, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t'u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t'u thonë: Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni xhenetit që ju është premtuar**"[86].

87. Ibn Manzur, Lisanu'l-Arab

RËNDËSIA E KONSULTËS NË FENË ISLAME

Konsultë do të thotë të orientohesh, të marrësh mendimin dhe të këshillohesh rreth një çështjeje me një person apo me një grup personash. Fjalët në gjuhën arabe që shprehin kuptimin e fjalës konsultë janë: mushavere, shivar, meshvure, meshvere, meshure dhe istishare[87].

Kushti i parë i konsultës është që vendimet që do të merren, të jenë të sakta dhe të qëlluara. Shumë herë vendimet e marra rreth një çështjeje që nuk mendohen mirë dhe pa kërkuar sugjerimet e vërejtjet e ndonjërit, përfundojnë në gabime. Një person i mbyllur në mendime dhe që nuk respekton mendimin e të tjerëve, edhe sikur të ketë temperament të lartë apo të jetë gjeni, do të shikojmë që gabohet më shumë në krahasim me një person, i cili e konsulton mendimin e tij. Njeriu më i zgjuar është ai, i cili respekton më shumë konsultën dhe përfiton më shumë nga mendimet e të tjerëve. Ato shpirtra të trazuar që në punët që do të kryejnë mjaftohen me mendimet e veta, për më tepër, që mendimet e tyre ia imponojnë të tjerëve, ndeshen gjithnjë me ftohtësi dhe përbuzje.

Siç është konsulta kushti i parë i përfundimit mirë të një pune, një faktor i rëndësishëm për t'u mbrojtur nga humbja dhe fundi i keq, është edhe përfitimi

86. Fussilet, 41:30

nga mendimet e ndritura të miqve. Konsulta është një rrugë e rëndësishme për t'i përftuar pafundësi mendimit të kufizuar. Nuk ka shtet më të pasur dhe ushtri më të fortë se sa konsulta. Sahabët e lavdëruar janë përkujtuar edhe në Kuran për konsultat e tyre:

"...**Dhe konsultohen për punët e veta me njëri-tjetrin**"[88].

Ndërsa Profeti (a.s.) thotë: "*Dijeni se Zoti dhe i dërguari i Tij nuk kanë nevojë për konsultë, por Allahu i Madhëruar e zbriti atë si mëshirë mbi umetin tim. Nga ata kush konsultohet nuk humbet nga e drejta. Dhe kush e braktis, nuk shpëton nga gabimi*"[89].

Ata drejtues të shtetit në historinë islame që kanë kërkuar gjithmonë të drejtën, nuk e kanë ndarë për asnjë çast dhe e kanë bërë kusht të domosdoshëm konsultën. Disa hapa më tepër i zgjuar se sa i zgjuari, është ai që e vlerëson mendjen dhe mendimet e të tjerëve. Ilaçi më i efektshëm për zgjidhjen e ndryshkut në mendime është konsulta. Nëse dy mendje janë më të mira se një, sigurisht shumë mendje janë më të mira se një. Ata që i besojnë mendjeve të tyre pa u konsultuar me mendimet e të tjerëve, edhe sikur të jenë gjeni, duke qenë se braktisën konsultën, e cila i përfton një thellim të rëndësishëm gjykimit, konsiderohen si mendjeshkurtër.

Para se të niset një punë duhet të merren të gjitha masat e duhura duke bërë çdo konsultë të nevojshme, në mënyrë që të mos shkohet në rrugë të gabuar dhe më pas të fajësohet dikush apo të kritikohet përcaktimi i Zotit. Para se të vendoset për një çështje, nëse fundi nuk mendohet mirë dhe nëse nuk bëhet konsulenca me personat e duhur, zhgënjimi dhe pendesa janë të pashmangshme. Është e drejta dhe domosdoshmëria e konsultës që personi në asnjë mënyrë të mos veprojë individualisht, por çështjet e mëdha të së ardhmes t'i bluajë brenda në mekanizmin e konsultës. Profeti Muhamed (a.s.) është shembulli më i mirë i kësaj. Ai e ka inkurajuar konsultën dhe e ka aplikuar atë në shumë raste si: në Bedër është konsultuar me sahabët për masat që do të merrte me ardhjen e Ebu Sufjanit, për pengjet e luftës

88. Shura, 42:38
89. Bejhaki

së Bedrit, në luftërat e Uhudit dhe Hendekut, në Hudejbije, gjatë udhëtimit për në Taif, rreth ezanit etj. Ebu Hurejre thotë se nuk ka parë njeri që të konsultohet më shumë se i dërguari i Allahut. Edhe sahabët, si shokë besnikë të Profetit (a.s.), i kanë dhënë një rëndësi të madhe konsultës. Ebu Bekri dhe Omeri (r.a.) patën formuar një këshill konsultativ me shokët e tjerë si Osmanin, Aliun, Abdurrahman b. Aufin, Muadh b. Xhebelin, Ubej b.Ka'bin, Zejd b. Thabitin etj.

Është e nevojshme të thuhet se këshilli konsultativ me këdo që të formohet, vendimet që do të marrë nuk duhet të bien ndesh me principet e përgjithshme të Islamit, si dhe nuk duhet të jenë të padrejta. Sepse Islami është ngritur mbi një sistem të drejtë. Gjithashtu është mjaft e rëndësishme që personi të dijë se si dhe me kë duhet të konsultohet. Kriteret bazë për personin nga i cili do të merret konsulta është që ai të jetë fetar, i ditur, i zgjuar dhe me përvojë. Për të zbritur më në detaje, personi në fjalë duhet të jetë i sinqertë, largpamës, kompetent, i besueshëm, i drejtë dhe i aftë për të analizuar psikologjinë e njeriut. Pejgamberi (a.s.) madje edhe në çështje personale e familjare është konsultuar me shokët e tij. Vetë Allahu (xh.sh.) e ka urdhëruar të veprojë kështu.

"**Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe konsultohu me ta për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai**"[90].

Për ta përmbledhur, konsulta është urdhri i Allahut dhe tradita e të dërguarit të Tij. Ajo është një rrugë e pashmangshme si në jetën individuale e familjare, ashtu edhe në atë kolektive. Këshillohuni me njëri-tjetrin për punët tuaja, sepse në këtë mënyrë ndiqni shembullin e profetëve dhe arrini përfundim të kënaqshëm!

90 Al'Imran, 3:159

DEVOTSHMËRIA DHE SJELLJA E MIRË

Profeti (a.s.) thotë: "*Frikësoju Allahut kudo që të jesh. Veprën e keqe pasoje me vepër të mirë që ta fshijë atë (të keqen) dhe sillu mirë me njerëzit.*"[91]

Shprehja 'Frikësoju Allahut kudo që të jesh' tregon detyrimin tonë që kemi para Krijuesit Fuqiplotë kudo që të ndodhemi dhe në çdo gjëndje qofshim, me njerëz përreth apo vetëm, në pasuri apo në varfëri, në sëmundje apo në shëndet. Ata myslimanë që sillen kështu, Zoti i do dhe është me ta, ashtu siç shprehet edhe në Kuran:

"**Me të vërtetë, Allahu i do besimtarët e devotshëm**"[92]. "**Padyshim që Allahu është me të devotshmit dhe me punëmirët**"[93].

Devotshëria është frikërespekti ndaj Allahut në kuptimin e plotë të fjalës. Ndërsa personi që devotshmërinë e ka bërë filozofi të jetës së tij dhe, ndjenjat, mendimet e punët i orienton në bazë të këtij kriteri, quhet i devotshëm. Për të arrirë në devotshmërinë e vërtetë mund të thuhet se ka një rol të rëndësishëm këndvështrimi i kësaj bote. Kjo botë ka dy anë që njeriun e tërheq edhe nga e mira edhe nga e keqja. Njeriu ka rastin

91. Tirmidhi
92. Teube, 9:4
93. Nahl, 16:128

që të vijë një herë të vetme në këtë botë dhe çfarë do të mbjellë këtu do të korrë në botën tjetër. Të gjitha begatitve të Zotit si, rinia, shëndeti, pasuria, jeta, koha etj., duhet t'ia dimë vlerën dhe duhet t'i vlerësojmë para se të na ikin prej durësh. Ky vlerësim duhet të bëhet duke jetuar në bazë të kritereve që na ka bërë të ditur i dërguari i Allahut dhe duke qëndruar larg tepricave dhe mangësive në fe.

Shprehja 'Veprën e keqe pasoje me vepër të mirë që ta fshijë atë (të keqen)' tregon detyrimin që kemi ndaj vetes për t'i fshirë veprat e këqia duke bërë të mira. Përderisa njeriu është i urdhëruar për devotshmëri në fshehtësi dhe haptazi, patjetër që do të ndodhë ndonjëherë pakujdesi. Me veprën e keqe janë kuptuar gjynahet e vogla dhe me veprat e mira janë kuptuar obligimet, pendimi dhe lëmosha. Profeti Muhamed (s.a.s.) shprehet kështu:

"*Pesë namazet, ai i xhumasë deri në xhumanë tjetër dhe agjërimi i Ramazanit deri në Ramazanin tjetër, janë falje për mëkatet që bëhen ndërmjet tyre, përveç mëkateve të mëdha*"[94].

Me anë të këtyre të mirave Allahu e fshin njollën e mëkatit nga zemra e besimtarit dhe fletorja e shënimeve. Nuk duhet harruar se në çdo gjynah ekziston një rrugë që të çon në mohim. Sepse njollat e gjynaheve të vogla duke u shtuar mund t'a errësojnë të gjithë zemrën. Për këtë arsye është thënë se këmbëngulja në gjynahet e vogla është gjynah i madh. Myslimani i devotshëm e merr me seriozitet pastrimin e gjynahut të vogël dhe pa u vonuar pendohet me sinqeritet tek Zoti. Të tillët Zoti i përmen në Kuran kështu:

"**Dhe nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e toka, përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqënie edhe kur janë në vështirësi, e frenojnë zemërimin dhe i falin njerëzit. Allahu i do bamirësit**"[95].

94. Muslim
95. Al'Imran, 3:133-134

Shprehja 'sillu mirë me njerëzit' tregon detyrimin që kemi ndaj tyre, pasi shumë veta mendojnë se devotshmëria është të kryesh detyrat ndaj Allahut dhe jo ato ndaj njerëzve. Në këtë mënyrë neglizhohen të drejtat e njerëzve. Është transmetuar prej të parëve myslimanë se sjellja e mirë janë bujaria, sakrifica, durimi, fytyra e qeshur dhe përmbajtja e zemërimit për hir të Allahut. Vetëm në zbatimin e këtyre virtyteve përmbushim besimin tonë, ashtu siç thotë edhe i dërguari i Zotit:

"*Besimtari me besimin më të plotë është ai me sjellje më të mirë*"[96].

Myslimani i cili është i buzëqeshur, tolerant, falës, i edukuar në të folur dhe veprime, fiton zemrat e njerëzve dhe krijon një atmosferë të ngrohtë mes tyre. Nuk ka një element të dytë që ta lartësojë njeriun sa morali i bukur. Morali i bukur është morali i Allahut dhe pajisja e njeriut me moralin e bukur do të thotë pajisja e tij me moralin e Allahut.

Përveç kësaj që thamë, devotshmëria ndaj Allahut shtrihet në një rrafsh akoma më të gjërë. Zbulimi i ligjeve që ka krijuar Allahu në këtë botë, si ligji i fizikës, kimisë, biologjisë, astronomisë etj., rrespektimi dhe vënia e tyre në dobi të njerëzimit, është gjithashtu devotshmëri për besimtarin. Sepse të gjitha çka bota, janë krijuar nga Allahu i Lartë për njeriun dhe në shërbim të tij. Nga njeriu kërkohet punë dhe sakrificë për zbulimin e tyre, gjë që do ta çojë njeriun drejt Krijuesit, sigurisht për ata që mendojnë. Kur u pyet Profeti (a.s.) se cila është ajo që i fut njerëzit më shumë në xhenet? Ai u përgjigj:

"*Devotshmëria ndaj Allahut dhe sjellja e mirë*"[97].

96. Ebu Daud; Ahmed
97. Tirmidhi; Ibn Maxhe; Ahmed; Ibn Hiban

MEDITIMI, RRUGA NDRIÇUESE E BESIMIT NË ZOT

Kurani urdhëron e thotë: "**Thuaj: 'Çdo lavd e falënderim i përket Allahut, i Cili nuk ka bir, nuk ka ortak në pushtet dhe nuk është i pafuqishëm, që të ketë nevojë për ndihmës' dhe madhëroje Atë, duke ngritur lart madhështinë e Tij!**"[98]

Allahu është më i madhi, Ai është i Lartësuari, Ai është i Gjithëmëshirshmi dhe Mëshirëploti, Ai është Krijuesi, Formëdhënësi, i Cili, nëpërmjet fuqisë së Tij, e krijoi dhe e modeloi njeriun në formën më të bukur. Allahu është i Gjithëdituri, Ai është i Drejti dhe Sovrani Absolut, i Cili e themeloi pemën e universit për gjashtë ditë në përputhje me parimet e urtësisë dhe dëshirës së Tij.

Zoti e ka krijuar njeriun me kapacitete të ndryshme fizike, emocionale, intelektuale dhe shpirtërore. Njëkohësisht kur e krijoi, nuk e la kuturu që rrugën ta gjejë vetë, por, nga mesi i njerëzve, Ai dërgoi profetë për të përcjellë mesazhet e Veta dhe për të bërë të qartë qëllimin e krijimit të njeriut, të ardhjes së tij në këtë botë. Përveç kësaj, në mënyrë të paimponuar, Allahu i ka dhënë vullnet të lirë njeriut që ta zgjedhë vetë rrugën e tij. Në të gjithë këtë proces, roli i njeriut është shumë i vogël, por

98. Isra, 17:111

Zoti e ka bërë vullnetin tonë një kusht elementar për te rruga e drejtë. Njeriu merr vetëm iniciativën, të tjerat janë dhurata hyjnore. Mjafton iniciativa jonë për kafshatën e bukës dhe proceset e shijimit, bluarjes, tretjes etj., janë dhurata nga Zoti, të cilat veprojnë në mënyrë automatike. Pra, vetëm një shtypje butoni kah ana e besimit, bëhet shkak për ndezjen e dritave të udhës së drejtë.

Njeriu duhet të trokasë në derë me cilësinë e të kërkuarit diçka. Si rruga e drejtë, ashtu edhe ajo e gabuar janë nga krijimi i Zotit. Allahu udhëzon ose jo, por edhe kjo ka pretekstet e veta. Për shembull, ç'mund të thuhet për iniciativën e njeriut që shkon në xhami apo në biseda fetare dhe për atë që shkon në pijetore apo në shtëpi publike?! Kjo do të thotë që njeriu ka në dorë një gjë aq të vogël, saqë nuk mund t'i bëhet shkak i vërtetë as për ta udhëzuar, as për ta devijuar. Këtë nënkupton edhe ajeti:

"**Atë që e udhëzon Allahu, ai është vërtet udhëzuar, e atë që e humb, ti nuk do të gjesh për të ndihmës që do ta udhëzonte**"[99].

Në Kuran thuhet: "**Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt**"[100].

Me të vërtetë, në lindjen dhe perëndimin harmonik të hënës e diellit, në rregullsinë marramendëse sipas së cilës ndodhin dukuritë, ka shembuj domethënës për ata që thellohen në mendim. Në lidhje me çështjen e meditimit, ky ajet është një argument i qartë. Ky dhe shumë ajete të tjerë të ngjashëm, që konsiderohen një portë e hapur për meditimin dhe arsyetimin, kanë rëndësi shumë të madhe për të treguar se cilat janë dimensionet e jetës së besimtarit në Islam.

Vetëm se, në fillim, është e nevojshme të dihet se ç'është meditimi. Pikësëpari, meditimi duhet të mbështetet në një informacion fillestar.

99. Kehf, 18:17
100. Al'Imran, 3:190

Ndryshe, me një meditim të varfër, të rëndomtë dhe të pa orientuar, nuk mund të arrihet askund. Një meditim i tillë i mbyllur, me kalimin e kohës sjell ngopje, mërzitje e lodhje dhe pastaj njeriu arrin deri në atë gradë sa të mos mendojë më dot.

Fillimisht, njeriu duhet ta njohë mirë subjektin mbi të cilin do të meditojë, si dhe specifikat që do të përbëjnë bazë për meditim, domethënë duhet t'i serviret ose të ketë në dispozicion një informacion të qëndrueshëm, në mënyrë që të mundet të mendojë rregullisht e sistematikisht. Nëse njeriu i njeh qoftë edhe pak lëvizjet dhe ciklin e trupave qiellorë, marrëdhëniet e tyre me njeriun, lëvizjen dhe veprimtarinë e grimcave që përbëjnë trupin e njeriut; kur mendon rreth tyre; ky mendim mund të quhet meditim. Vërtet ka pasur njerëz që i kanë ardhur rreth e rrotull materies dhe ekzistencës së saj, por kurrë nuk kanë mundur ta njohin të vërtetën e saj. Ndërsa ata që, duke vështruar lëvizjet e hënës e të diellit, ndiejnë diçka, dhe përpiqen po kështu të thonë diçka, nuk janë mendimtarë, por poetë apo ëndërrimtarë, që shprehin frymëzimet dhe iluzionet e tyre. Pra, nuk është e mundur të quhen meditues, ata që se vrasin mendjen për të vërtetën. Për shembull, në shprehjet e poetëve të dashuruar pas natyrës, njeriu bëhet sikur po ndien parajsën, sikur po ndodhet në mesin e saj, shushurima e ujërave që rrjedhin, fëshfërima e gjetheve të pemëve, kënga e zogjve... Kënaqen me ato që shohin dhe i servir kjo botë, por nuk shkojnë përtej saj. Në të gjitha anët e mendimeve të tyre mbi jetën ka një ngecje, një shteg të mbyllur dhe ajo çka këta quajnë meditim, nuk është gjë tjetër veç një mendim dhe ankth i pashpresë. Sigurisht që një meditim i tillë nuk ka asnjë dobi!

Për të medituar, së pari duhet një e dhënë fillestare, duhen analiza dhe sinteza të reja në përputhje me bazën, me mendimin për të kërkuar të vërtetën. Personi që mendon me këtë sistem, mund të arrijë konkluzione gjithnjë të reja e të vazhdueshme. Pastaj, duke i bërë këto konkluzione

bazë për hapa të tjerë, mendimi mund të bëjë përpara dhe me kohë njeriu thellohet e dimensionohet në meditimin e tij.

99. Kehf, 18:17
100. Al'Imran, 3:190

Si bazë fillestare në procesin e të menduarit, mund të radhisim specifika të tilla si leximi, aftësimi për të kuptuar librin e gjithësisë dhe vështrimi i ekzistencës nën objektivin e Kuranit që konsiderohet interpretuesi më i mirë i saj. Ndryshe, konstatime të tilla si ylli polar qëndron këtu, dielli perëndon kështu, vështrimi në fytyrën e materies pa ndonjë synim të përcaktuar e në mënyrë vulgare, jo vetëm që nuk mund të jenë meditim, por as që ekziston mundësia për të arritur diku me këtë lloj meditimi. Edhe fitimi i ndonjë të mire prej tij, është çdo herë diçka e diskutueshme. Kjo nënkupton që njeriu meriton disa gjëra sipas mundit që ka dhënë. Duke arsyetuar mbi këtë bazë, njeriu pa meditimin në fjalë, e ka kryer detyrën e adhurimit të Zotit si rob i Tij, pavarësisht se në ç'formë, dhe konsiderohet të ketë kaluar në disa lloj marrëdhëniesh me Të. Vetëm se nuk ka mundur të përftojë gjërat që prodhohen prej meditimit. Në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejre (r.a.) thuhet:

"*Meditimi i një ore, është më i vlefshëm sesa adhurimi vullnetar i gjashtëdhjetë viteve*"[101].

Domethënë, në sajë të një ore meditimi, te njeriu shfaqet besimi i plotësuar, në shpirtin e tij përshndrisin dritëzat që e afrojnë atë me njohjen dhe të ndierët e Zotit. Ndërkohë në zemër shfaqet dashuria hyjnore dhe njeriu arrin një kënaqësi shumë të madhe shpirtërore. Mirëpo, një pyetje na vjen ndërmend: A e zëvendësojnë meditimin ajetet kuranore që nxisin për meditim dhe lutjet e bëra në heshtje? Ashtu si në leximin dhe kuptimin e Kuranit, Fjalës së Krijuesit, edhe kjo varet nga të qenët i vetëdijshëm për çka po bën. Lutja e vetëdijshme, përgjërimi i vetëdijshëm disa herë në botën e brendshme të njeriut, mund të hapë edhe drynat më të ndryshkur. Nëse ato s'kuptohen dhe njeriu nuk thellohet në to, nuk ka meditim. Ka të mirë, por jo meditim. Meditimi vjen nga të vrarët e mendjes. Meditim do të thotë të bashkosh dukuri të reja me ato ekzistueset dhe t'i analizosh ato. Që të arrijmë të meditojmë, duhet të kemi parasysh se sa e vëmë në punë zemrën dhe shpirtin, se sa qëndrojmë dhe kërkojmë mbi objektin që merret për meditim, se sa i thellojmë dhe i përforcojmë marrëdhëniet me Zotin. Fatkeqësisht gjëja më e paktë e më e rrallë në ditët tona është meditimi!

101. Isbahani, Kitabu'l-Adhame, v. I, f. 299

Meditimi i Profetit Ibrahim (a.s.)

Të medituarit rreth krijesave të Zotit, është një ritual që largon preokupimet dhe shqetësimet, sepse pas kësaj, njeriu e ndjen se kjo botë, me gjithë hallet e saj, është shumë e vogël në krahasim me universin, e ndjen se problemet dhe vuajtjet janë shumë të vogla në krahasim me madhështinë e universit dhe të Krijuesit. Meditimi është një ritual që praktikohej nga të gjithë profetët.

Ibrahimi (a.s.) që në moshë të re, nuk pajtohej me gjendjen ekzistuese besimore të popullit të tij dhe duke medituar, ai tentoi ta njohë Krijuesin Absolut. Natyra e tij e pastër, intelekti i tij i fuqishëm dhe besimi i tij i sinqertë, bënë që ai ta fitojë dritën e Allahut:

"**Dhe kështu, ne ia treguam Ibrahimit mbretërinë e qiejve dhe të tokës, që të jetë i bindur mirë**"[102].

Kureshtja e tij për të vërtetën, e provokuar me shikimin e yllit në qiell të hapur, e shtyu të thotë:

"**Ky është Zoti im!**"[103], dhe të heq dorë nga ky "zot" porsa ta konstatojë perëndimin e yllit duke thënë:

"**Nuk i dua ata që perëndojnë**"[104].

Ngjashëm ndodhi edhe me Hënën e Diellin. Meqë populli i tij në Haran e adhuronte Hënën e Diellin, Ibrahimi (a.s.) i qorton:

"**O populli im, unë jam larg nga idhujt që ju ia shoqëroni Allahut në adhurim! Unë e kthej fytyrën time, si besimtar i vërtetë, nga Ai i cili i ka krijuar qiejt dhe Tokën, dhe unë nuk jam nga idhujtarët**"[105].

102. Enam, 6:75
103. Enam, 6:76
104. Enam, 6:76
105. Enam, 6:78-79

Këtu shohim meditimin e Profetit Ibrahim (a.s.), i cili me thellësinë e mendimit të tij dhe duke u bazuar në logjikën e gjërave, e kupton shumë mirë se çdo send, që lind e perëndon, lëviz në rrugën e përcaktuar nga një fuqi më e madhe, e cila i vë në lëvizje këta trupa. Dhe kjo fuqi i përket të Plotfuqishmit.

Përcjellja e mesazhit dhe reagimi i Ibrahimit (a.s.)

Ndër adhuruesit e idhujve ishte edhe babai i Ibrahimit (a.s.), Azeri. I vetëdijshëm për gjendjen e babait, ai, me gjithë fuqinë e besimit, i drejtohet:

"**O babai im, përse e adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh e as që mund të të sjellë ndonjë dobi?**"[106]

Më tej, në suren Enam, me dëshpërim e brengosje Ibrahimi (a.s.) i drejtohet babait të tij, Azerit:

"**A do t'i adhurosh idhujt si zotat e tu?! Unë vërtet po shoh se ti dhe populli yt jeni në humbje të madhe**"[107].

Edhe pse në shikim të parë Ibrahimi (a.s.) shfaq vrazhdësi dhe rreptësi ndaj idhujve, ai shpërthen nga dhembshuria, butësia, kujdesi ndaj të gjithëve, e sidomos ndaj babait. Ai edhe pse tregonte bindje ndaj babait, në çështjen e besimit e këshillonte, sepse besimi i kapërcen lidhjet biologjike:

"**O babai im, mua më ka ardhur dije që ty nuk të ka ardhë, ndaj më paso dhe unë do të udhëzoj në rrugën e drejtë**"[108]. "**O babai im, kam frikë se mos të vjen ndonjë dënim nga i Gjithëmëshirshmi...**"[109]

Mirëpo, babai refuzon thirrjen e të birit, madje refuzimi i tij karakterizohet edhe me presion:

106. Merjem, 19:42
107. Enam, 6:74
108. Merjem, 19:43
109. Merjem, 19:45

"**O Ibrahim! Si guxon t'i hedhësh poshtë zotat e mi?! Nëse nuk heq dorë, unë do të të mbys me gurë; andaj, largohu prej meje për një kohë të gjatë!**"[110]

Edhe pse kërcënimi ishte real, Ibrahimi (a.s.) nuk hoqi dorë nga kujdesi për babanë e tij. Madje premtoi se do t'i lutet Zotit për të:

"**Shpëtimi qoftë mbi ty. Do ta lus Zotin tim të të falë. Me të vërtetë, Ai është i mirë me mua**"[111].

Shembulli i sjelljes së Ibrahimit (a.s.) ndaj babait të tij mohues, tregon njeriun plot besim, dhembshuri e shpresë, por edhe këmbëngulës në idealet e tij; besimin në Zotin Një dhe të Vetëm.

Meditimi i Profetit Muhamed (a.s.)

Meditimi është i tillë që të afron më shumë me Zotin, i forcon lidhjet e tua me Zotin dhe të bën prej të dashurve të Tij. Meditimi ndahet në dy pjesë: E para, të njohësh dhe të besosh se Zoti ekziston, gjë që e besojnë shumica e njerëzimit. E dyta, të njohësh cilësitë e Zotit, madhështinë e Tij, të njohësh autoritetin, ta duash dhe të jesh në vazhdimësi i lidhur me Zotin. Dallimi i njerëzve në këtë pjesë, varet sipas meditimit të tyre lidhur me krijesat e Zotit në univers.

Profeti Muhamed (a.s.) çdo ditë shkonte në shpellën Hira dhe mendonte për veprat dhe shenjat e mëshirës së Allahut Fuqiplotë. E shikonte Qaben, vështronte thellë në dimensionet e qiellit e përkujtonte thellësitë e tokës, deteve, shkretëtirave, maleve dhe luginave. Kur i shihte gjithë këto madhështi, thellohej në mendime rreth fuqisë së paskajshme të Zotit. Në çdo gjë që shihte vërente urtësinë dhe madhështinë e pafundme hyjnore.

Tregon gruaja e tij, Hatixheja (r.anha): "...më pas ai (profeti) filloi të pëlqente vetminë, shkonte në shpellën Hira dhe adhuronte Zotin

110. Merjem, 19:46
111. Merjem, 19:47

natën…"[112] Transmeton Aishja (r.anha): Profeti (a.s.) u ngrit dhe filloi të falej. Gjatë këndimit të Kuranit qante. Ra në ruku dhe qau, u ngrit prej saj dhe vazhdonte të qante. Ra në sexhde dhe qau, u ngrit nga sexhdja dhe qau. Vazhdoi të falej në atë formë, derisa erdhi Bilali për të thirrur ezanin e sabahut. Kur e pa duke qarë, Bilali e pyeti: "Çfarë të ka bërë të qash, o i dërguari i Allahut?!" Profeti (a.s.) ia ktheu*:*

"E si të mos qaj o Bilal, ndërkohë që sonte më janë shpallur këto ajete:

"**Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjur ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës** (duke thënë:) "**O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh** (nga çdo e metë)**! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit**"[113]. Pastaj, Profeti (a.s.) shtoi:

"*I mjeri ai që i lexon dhe nuk mediton rreth tyre*"[114].

Një numër i madh sahabesh i kanë dhënë rëndësi ritualit të meditimit duke treguar se meditimi është drita e besimit. Kur Omer ibnu Abdul Aziz u pyet: "Cili është adhurimi më i mirë?" u përgjigj: "Të meditosh mbi krijesat e Zotit." Transmetohet nga Ibni Abasi se ai ka thënë: "Dy rekate të thjeshta, por me meditime, janë më të vlefshëm sesa falja gjithë natën, nëse zemra është indiferente"[115].

Reflektimi si pasojë e meditimit

Mungesa e vëmendjes dhe nënvleftësimi i gjynaheve është mëkati më i madh. Parë në këtë këndvështrim, nuk duhet të harrojmë dhe duhet të jemi të vëmendshëm që, nëse bëjmë një gjynah, të mos vazhdojmë të

112. Buhari
113. Al'Imran, 190-191
114. Buhari; Muslim
115. Isbahani, Kitabu'l-Adhame, v. I, f. 297, nr. 42

bëjmë të dytin... sepse gjynahu është si shkëndijë dëmtuese, që ndërpret lidhjen e njeriut me Zotin dhe është një goditje e rëndë për besimin. Madje, në këtë pikë, Said Nursi thotë se "Brenda çdo gjynahu ka një rrugë që të çon në mohim". Për rrjedhojë, njeriu duhet të bëjë teube sa më parë, duke ndjerë brenda vetes një pendesë të sinqertë. Nëse gjynahu është një shformim në krijim, pendimi dhe pendesa janë rikthim në origjinalin e krijimit.

Gjynahu duhet ndjerë në shpirt si një ankth, ndërsa ndërgjegjja duhet të ndjejë urrejtje, neveri dhe përbuzje ndaj atij gjynahu. Nëse njeriu nuk shqetësohet e nuk vuan për shkak të gjynahut, edhe sikur ta shprehë me gojë si rutinë, kjo lloj pendese nuk është pendesë, ajo mbetet thjesht një varg fjalësh të padobishme. Siç thotë edhe Profeti (a.s.):

"*Ndjenja e pishmanllëkut, shenja e pendesës, në vetvete, është teube*"[116].

Kur ne dalim prej rrugës së Tij, Zoti na i mbyll të gjitha dyert e kalimet nga të cilat Ai sheh kah ne. Por kur ne ndjejmë pendesë dhe fillojmë të marrim në llogari veten tonë e themi: Pse e bëra këtë? Pse veprova kundër urdhëresave të Krijuesit tim? Kjo do të thotë që ne filluam ta korrigjojmë veten dhe, sapo të fillojmë të meditojmë mbi këtë gjë, sapo nisim të angazhohemi nën shtypjen e ndjenjës së pendesës, menjëherë shohim se kanë nisur të hapen të gjitha "portat e dritaret".

Shkurt, nëse ne mbajmë lidhje të vazhdueshme me Zotin tonë, edhe Ai nuk do të na braktisë në dorë të djallit, të armikut tonë. Personit, i cili e rinon vazhdimisht lidhjen me Zotin e vet me anë të meditimit, djalli nuk gjen dot rrugë për t'i shtënë dyshim e lëkundje. Për këtë arsye, duhet të kërkojmë rrugët për rinovimin e vetes. Kjo mund të bëhet disa herë me anë të meditimit, disa herë me anë të mendimit për vdekjen, disa herë me anë të leximit, disa herë duke kënduar Kuran... Nuk ka ndonjë kufi për këtë gjë, por ne kemi shumë nevojë për këtë, po aq sa kemi nevojë për ajrin, ujin dhe bukën.

116. Ahmed; Ibn Maxhe

Në botën e tij të brendshme, njeriu është një krijesë që ka nevojë të emocionohet çdo ditë, madje disa herë në ditë. Parë në këtë këndvështrim, detyra jonë në këtë mes është të mos rrimë larg shokëve të mirë, sepse shoku i mirë, në çdo kohë, me këshillat dhe porositë e tij të dobishme, mund të na zgjojë emocione dhe të na e ngrejë zemrën peshë.

Në çdo kohë, lutja jonë, me të cilën i drejtohemi Allahut, duhet të jetë që të na mbrojë nga e keqja e egos dhe e djallit, në mënyrë që të mund ta vazhdojmë jetën në atmosferën e mirësisë hyjnore. Njëkohësisht lusim Allahun (xh.sh.), që nëpërmjet meditimit, t'i kuptojmë dhe t'i konceptojmë mirë, në pikëpamje shumëdimensionale, mesazhet e Islamit dhe, duke i përfaqësuar në mënyrë dinjitoze, të fitojmë kënaqësinë e Krijuesit tonë.

GJITHÇKA ËSHTË PRONË E KRIJUESIT

Vendi ynë po kalon ditë të vështira nga fatkeqësia e tërmetit. Si në çdo cep të botës, për çdo lloj fatkeqësie qofshin tërmete, përmbytje, sëmundje, epidemi etj., është normale që besimtari të ndjejë dhimbje e dëshpërim. Por, nuk është normale për një besimtar të mirë, që fatkeqësitë të kthehen në ankth, mërzitje dhe urrejtje deri aty sa të lëshojnë rrënjë në zemrën e tij.

Çdo gjë që ndodh në univers nuk është rastësi. Gjithçka ndodh brenda dijenisë së Krijuesit dhe përcaktimit të Tij. Dhe kaderi, është një nga kushtet e besimit që çdo mysliman duhet dhe i ka besuar plotësisht. Edhe e dobishmja, por edhe e dëmshmja që kanë si faktor natyrën apo dorën e njeriut, vijnë sipas një përcaktimi hyjnor.

Kjo botë me gjithçka brenda, përfshi edhe vetët tona, janë pronë e Krijuesit. Pronari i gjithësisë vepron si të dojë me autoritet absolut mbi pronën e Tij. Parë në këndvështrimin e besimit, besimtari nuk i gjuan kaderit me gurë, por vrapon në ndihmë të shoqërisë dhe këtë e bën sipas një morali profetik. Sepse ky është morali i të gjithë profetëve dhe ky është morali i të gjithë pasuesve të tyre. Por nga ne, kërkohet të lutemi me shpirt në një mënyrë të përvuajtur dhe jo me protestë e me ton ankues.

Të ankohesh duke kundërshtuar vendimin e Zotit, do të thotë të kritikosh dhe të akuzosh kaderin dhe mëshirën e gjerë hyjnore.

Një njeri apo një shoqëri që është goditur me fatkeqësi, nëse do t'i përgjigjej me ankesë e protestë, fatkeqësia e saj vetëm do të shtohej. Sepse ashtu siç e shton falënderimi mirësinë e Zotit, po ashtu ankesa e rrit fatkeqësinë dhe largon mëshirën për shoqërinë që është goditur. Por në qoftë se dëshpërimi largohet nëpërmjet pranimit të kaderit hyjnor dhe mbështetjes tek Allahu, fatkeqësia fizike do të zvogëlohet, thahet e zhduket, ashtu sikurse thahet pema, të cilës i janë prerë rrënjët.

Po ti hedhim një vështrim të përgjithshëm historisë së njerëzimit dhe fatkeqësive të ndodhura, do të vëmë re se të gjitha kanë një segment të përbashkët: Largimin nga besimi dhe shtimin e gjynaheve. Mund të kujtojmë këtu fatkeqësitë e ndodhura te populli i Nuhut, Hudit, Musait etj, (paqja dhe bekimi Zotit qofshin mbi to). Nisur nga kjo, Allahu (xh. sh.) thotë:

"**Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë 'të shijojnë' pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmisim)**"[117].

Pra, një pjesë e atyre fatkeqësive janë paralajmërime nga i Gjithmëshirshmi për ta zgjuar dhe qortuar njeriun nga pakujdesia. Në këtë mënyrë shkrin gjendjen e pakujdesisë duke i kujtuar njeriut dobësinë e varfërinë e tij dhe duke i dhënë kështu një formë qetësie.

Në rast se besimtari, duke menduar shpërblimin e Zotit, i përballon fatkeqësitë me durim, lutje dhe përgjërim, do të thotë se ai kryen një formë të pastër adhurimi, në të cilën nuk futet fare hipokrizia. Në këtë mënyrë, jeta e tij e shkurtër bëhet e gjatë dhe e begatë. Nëse besimtari do të mendonte për shpërblimin që rezulton nga fatkeqësia dhe për

117. Rum, 30:41

sevabin që e pret në ahiret, nëse ai do ta kuptonte se jeta e tij e shkurtër me fatkeqësi do të transformohet në një jetë të gjatë, atëherë ai nuk do të ishte thjesht dhe vetëm durimtar, por do të ngjitej në shkallën e mirënjohjes ndaj Zotit dhe do të ishte i kënaqur me kaderin e Tij. Gjuha e tij do të niste të falënderonte duke thënë: Lavdi Zotit për çdo gjendje përveç mohimit dhe devijimit.

Vetë tradita profetike hedh dritë mbi faktin, se çështja për fatkeqësitë, qëndron tek mënyra se si sillemi, si reagojmë dhe si i pranojmë ato. Në hadith është transmetuar, se profeti (a.s.) ka thënë:

"*Është çudi çështja e besimtarit. Gjithë çështja e tij është tërësisht në të mirën e tij, gjë që i ndodh vetëm besimtarit. Nëse e prek një e mirë, falënderon dhe kjo është në të mirën e tij dhe nëse e prek një e keqe, duron dhe kjo (sërish) është në të mirën e tij*"[118].

Në përfundim, le të vazhdojmë t'i ndihmojmë të dëmtuarit dhe t'i lutemi Allahut Fuqiplotë e të Gjithmëshirshëm, që të prekurve nga tërmeti t'u japë forcë e durim në përballimin e situatës, kurse ne të tjerëve të na mundësojë reflektimin për tu bërë më të përgjegjshëm e të vetëdijshëm për fjalët dhe punët tona.

118. Muslim

NA NEVOJITET PAFUNDËSISHT MËSHIRA E TIJ

Falënderime të panumërta i qofshin Zotit që në mesin e njerëzve na ndriçoi me besim. Me anë të këtij besimi ndryshuan jetët tona, si dhe konceptet për mënyrën se si duhet t'i shohim dhe gjykojmë fenomenet e ndryshme. Por besimi nëse nuk mirëmbahet, ashtu si çdo gjë, vjetërsohet dhe Zoti na ruajt, rrezikon të humbasë. Që ky besim të mbahet i gjallë, që të rifreskohet, të rinovohet apo të forcohet më tej, ka nevojë për ushqim shpirtëror, për adhurim, punë të mira dhe lutje të ndryshme drejtuar Krijuesit.

Njeriu, krijesa më me vlerë, më e vyer dhe më e bukur e Allahut (xh.xh.) në rruzullin tokësor, është po aq gjynahqare. Nuk mund të jetë ndryshe kur mëkati është pjesë e jetës së njeriut. Pikërisht kjo e bën njeriun, njeri dhe jo engjëll. Në një hadith kudsi, i Madhi Zot shprehet kështu: "*Nëse ju do të ishit popull që nuk gabon, Unë do ju fshija nga sipërfaqja e dheut e do të krijoja njerëz që gabojnë. Në mënyrë që t'më njihnit Mua si të Mëshirshëm*"[119].

Mirëpo për besimtarin, gjynahet kanë peshë të rënda, të cilat bëhen pengesë në rrugën drejt Zotit. Sepse pas dhuratës më të madhe, që

119. Muslim

është besimi, Zoti na urdhëron të thellohemi në besim. Njeriu hyn në gjynahe me dashje apo pa dashje, ndonjëherë edhe si kupton gjynahet e vogla. Për këtë arsye, Allahu me Madhnin e Vet, ka krijuar shumë mundësi dhe sebepe për njeriun (abdesi, namazi, kurani, sadakaja, sjellja e mirë etj.) që nëpërmjet tyre t'i falen gjynahet dhe të fitojë mëshirën e Krijuesit. Profeti (a.s.) thotë se vetëm me mëshirën e Zotit hyjmë në xhenet. I thanë shokët: Edhe ti o i dërguari i Allahut? Po ju përgjigj ai. Edhe unë.

Allahu kërkon nga ne besimtarët që dita ditës të përmisojmë diçka nga vetët tona, të përkushtohemi më shumë, të ecim drejt hapave të devotshmërisë. Ai (xh.sh.) na mëson që gjynahet prejnë lidhjen që kemi me Të. Për këtë arsye, mbështetur edhe në jetën e vet Profetit (a.s.) duhet të pendohemi shumë dhe të vazhdojmë rrugën drejt Zotit, duke qëndruar larg gjynaheve. Mirëpo ka njerëz, të cilët nuk po i shmangen disa gjynaheve apo veseve të këqija, megjithëse përpiqen. Ata kërkojnë përgjigje, kërkojnë qetësi, ngushëllim apo forcë në përballjen e situatave të pakëndshme që i kanë trazuar shpirtin. Dhe shejtani, që është armiku i vërtetë i njeriut, kënaqet kur e sulmon atë nga dobësitë që ka. Por kënaqësi më e madhe për shejtanin është kur besimtarin e bën të dorëzohet, kur e bën pesimist derisa ai të marrë rrugën e qoftëlargut. Prandaj gjithmonë duhet t'i kthehemi Allahut, sepse dera e pendimit është e hapur për të gjithë ata, që shpresojnë tek falja e Zotit (xh.sh).

Hz. Vahshiu, i cili kishte bërë një punë të shëmtuar duke u bërë vrasësi i xhaxhait të profetit hz. Hamzait, kërkonte një drite shprese dhe shpëtimi. Ai i dërgon një letër profetit (a.s), ku i thotë: "O profet i Zotit! Unë dua të pendohem por ia kam frikën një ajeti në Kuran, ku thotë se ai që i ka vënë shok Allahut (xh.sh.), që ka bërë imoralitet dhe që ka vrarë tjetrin pa të drejtë, do ta marrë dënimin e tij. Unë kam vrarë Hamzain, kam bërë imoralitet dhe i kam vënë shok Allahut (xh. sh.), prandaj kam frikë se Zoti nuk m'i fal gjynahet". Atëherë i dërguari i

Zotit i shkruan në letrën e dërguar ajetin kuranor ku thotë:

119. Muslim

"**Përveç atij që është penduar, beson dhe bën vepra të mira, të tillëve Allahu të këqijat ua shndërron në të mira. Allahu është Falës e Mëshirëplotë**"[120].

Vahshiu në vazhdim tha: "Allahu (xh.sh.) ka vënë kusht që të bëjmë punë të mira, mirëpo unë nuk bëj punë të mira, prandaj kam frikë se Zoti nuk do të më falë". Atëherë profeti i dërgon ajetin:

"**Thuaj: O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut. Pa dyshim, Allahu i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti**"[121],

tregon gjerësinë dhe pafundësinë e mëshirës së Krijuesit për të gjithë mëkataret dhe është bërë një dritë shprese për të gjithë ata që nuk gjejnë asnjë mundësi shpëtimi në jetën e tyre.

Pika më e fortë në të cilën mbështetet njeriu, drejtimi më i saktë ku ai orientohet, është mëshira e Allahut. Asnjëherë njeriu nuk i pret shpresat nga kjo mëshirë. Ai beson në mënyre të prerë se cilido qoftë gjynahu që ka bërë, çfarë do lloj padrejtësie të ketë kryer, dera e faljes dhe e mëshirës së Allahut është gjithmonë e hapur, mjafton të trokasësh e të kërkosh falje nga Ai. Me mëshirën e Allahut do të kalojmë me sukses këtë jetë, me mëshirën e Tij do të kalojmë pa vështirësi llogarinë për veprat tona, me mëshirën e Tij do të kalojmë me lehtësi inshallah urën e siratit, si dhe me mëshirën e Tij do të trokasim në dyert e xhenetit. Në një hadith kudsi Zoti i Lartëmadhëruar thotë: "*O bir i Ademit! Përderisa t'më drejtohesh Mua e t'më lutesh Mua, çfarëdolloj mëkati të bësh unë do të ta fal. O bir i Ademit! Edhe sikur mëkatet e tua të arrijnë kufijtë e qiellit Unë përsëri do të t'i fal ato. O bir i Ademit! Nëse më vjen me mëkate sa e gjithë dynjaja, pa më bërë shirk, do të t'i fal të gjitha ato*"[122].

120. Furkan, 25:70
121. Zumer, 39:53
122. Tirmidhi

Krijuesi ynë kërkon prej nesh një pendim të sinqertë, kërkon vetëm një lëvizje zemre dhe në atë moment do ta gjejmë pranë Allahun (xh. sh). Prandaj vazhdimisht dhe për çdo gabim që kemi bërë, të pendohemi te Zoti, t'i japim fjalën për të mos u kthyer më në ato gjynahe që kemi bërë, si dhe të kërkojmë me sinqeritet të plotë mëshirën dhe faljen e Tij të pafund. Kjo është mëshira e Zotit prej së cilës nuk pritet asnjëherë shpresa. Në këtë drejtim, i dërguari i Allahut (a.s.) në njërën prej perlave të tij na tregon kështu:

"Allahu shtrin dorën e Tij natën që të pendohet kush bën mëkate ditën, dhe shtrin dorën e Tij ditën që të pendohet kush bën mëkate natën, derisa dielli të lind andej nga perëndon"[123].

123. Muslim

PENDESA, KY FRYT I VETGJYKIMIT TË DËLIRË

Profeti (a.s.) thotë: "*Vërtetë Allahu i Madhërishëm gjatë natës e mban të shtrirë dorën për të pranuar pendimin e mëkatarëve të ditës dhe, e shtrin dorën gjatë ditës për të pranuar pendimin e mëkatarëve të natës. Kjo vazhdon kështu derisa të lindë dielli nga perëndimi*"[124]

Në terminologjinë islame, ajo që Zoti pret prej nesh dhe që duhet të bëjmë bazuar në fjalën e profetit të sipërcituar, quhet teube (pendesë). Teube do të thotë: "Të ndjesh shqetësim në zemër për shkak se ke dalë kundër Zotit dhe, ta rrëfesh këtë ndjenjë me fjalët e caktuara të pendesës e kërkimit të faljes, duke qenë i ndërgjegjshëm për mëkatet e bëra dhe duke iu drejtuar derës së Zotit me gjithë ndjesinë tënde". Ne fakt, çdo person që e sheh rrjedhën e jetës së vet me një sy vetgjykimi, pavarësisht nivelit që ka, mund të gjejë përherë hapësira ku detyrohet të thotë një "estagfirullah". Ndoshta shikimit të tij i është pleksur diçka e ndaluar. Kur i është folur për cilësitë e mira të dikujt, i shqetësuar nga lëvdimi i atij, mund të ketë hedhur një llaf ashtu. Ndoshta është zhytur në batakun e përfoljes, për të cilën as që ka qenë i vetëdijshëm. Në çdo rrethanë apo në çdo mënyrë qoftë ai mëkat, dera e pendimit është e hapur ditë-natë për njeriun deri në frymën e fundit të tij dhe deri në shenjën e madhe të Kiamentit, pra kur dielli të lind nga perëndimi.

124. Muslim

Ajo që pritet nga besimtari ideal është që ai, me gjuhën e Kuranit, të bëjë teube-i nasuh. Kjo teube përbëhet nga bashkimi i tre elementeve me të cilën merr një kuptim të plotë. Ato janë dituria-gjëndja –vepra (ilim-hal-amel). Teube-i nasuh do të thotë pendim individual i personit sipas gjëndjes së tij natyrale në mënyrë të sinqertë, serioze, i vendosur nga thellësia e zemrës, me një nijet të pastër e mendime të mira, duke u bërë kështu një shembull i mirë për të tjerët sikurse t'i këshillonte ata. Edhe Kurani Famëlartë duke thënë:

"**O ju që keni besuar! Pendohuni tek Allahu me një pendesë të sinqertë**"[125],

na jep një shenjë rreth pendesës së vërtetë. I dërguari i Allahut në një thënie të tij thotë:

"*Ai që bën teube është i dashuri i Allahut dhe ai që bën teube prej gjynahut është sikur nuk e ka kryer atë gjynah*"[126] e më pas këndoi këtë ajet:

"**Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen**"[127].

Ndërsa ata që e lënë teuben për më vonë përballen me dy rreziqe. Duke vazhduar me gjynahe zemra i errësohet derisa kjo gjëndje i bëhet natyrë duke mos u pastruar më. Si dhe ardhja e sëmundjes e vdekjes në mënyrë të papritur dhe ai nuk gjen rast për të pastruar zemrën.

Pendesa dhe kërkimi i faljes nga njëra anë i pret hovin prirjes së njeriut drejt së keqes, nga ana tjetër përfërcon prirjet e tij për të kryer vepra të mira. Madje Allahu (xh.sh.) në Kuran thotë:

"**Përjashtim bën ai që pendohet, beson dhe bën vepra të mira. Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqia në të mira. Allahu është Falës e Mëshirëplotë**"[128].

125. Tahrim, 66:8
126. Ibn Maxhe
127. Bakara, 2:222
128. Furkan, 25:70

Sipas këtij ajeti, një njeri që është deformuar shpirtërisht si pasojë e gabimeve dhe gjynaheve, i cili pendohet e kërkon falje, që e rifreskon besimin dhe drejtohet kah punët e mira, Allahu do t'ia fshijë të gjitha mëkatet që ai mund të ketë bërë nëpërmjet dorës, këmbës, syrit, veshit, mimikës apo gjesteve të ndryshme; madje edhe do t'i shkruajë të mira në vend të tyre. E kjo është një tjetër pasqyrim i faktit se mëshira e Allahut qëndron mbi ashpërsinë e Tij.

Në fakt çdo njeri duhet të tregojë kujdes të veçantë për të ndaluarën përpara se të hedhë hapa në të. Ai duhet të përpiqet që t'i formojë vetes një ambjent të pastër, ku të mos bjerë dot në gjynah, madje duhet të largohet prej vendeve që janë të hapura prej gjynaheve. Sa e sa mirë do të ishte sikur njeriu të ngrinte prita për t'u mbrojtur prej dëmeve të këtyre situatave, përpara se të shqetësohej se si të bëjë restaurimin e jetës së tij materiale dhe shpirtërore! Sepse restaurimi i diçkaje pasi është shkatërruar është shumë e vështirë. Ta kthesh diçka të prishur në identitetin e saj autentik, është më e vështirë sesa ta ndërtosh atë nga fillimi. Nuk është e lehtë që një njeri që ka pësuar deformim prej mëkateve të tij të kapë edhe njëherë gjëndjen e mëparshme.

Pas një mëkati njeriu ndjen një dëshpërim në vetvete. Dëshpërimi i zemrës është jashtë vullnetit të tij. Nuk e zgjedh njeriu dëshpërimin, ai është i detyruar të vi, sepse krijesa po humb dashurinë e Krijuesit. Sepse njeriu me mëkatin që bëri hodhi një hap më tej për t'iu larguar Allahut. Nëse në zemër nuk formohet një neveri ndaj mëkatit, mund të thuhet se ajo zemër është e vdekur. E për këtë shkak, një zemër që beson, tregon medoemos njëfarë reagimi ndaj mëkatit. Dhe reagimi më parësor që duhet të tregojë, është pendesa dhe të kërkuarit falje.

NË FRYMËN E AUTOKRITIKËS

Allahu i ka dhënë njeriut që në krijim vullnetin dhe dëshirën për të vepruar çdo gjë. Gjithashtu i ka dhënë edhe mendjen për të dalluar të mirën nga e keqja. Ky është edhe tipari, i cili e bën njeriun të ngrihet në gradën më të lartë të krijimit e të bëhet krijesa e zgjedhur nga të tjerat.

Kjo botë në të cilën jetojmë do të përfundojë dhe do dalë në shesh çdo e fshehur. Ashtu siç na e ka treguar Allahu në Kuran dhe ashtu siç na ka thënë profeti me fjalët e tij, do të ndodhin ngjarjet njëra pas tjetrës dhe njerëzit të ringjallur grupe grupe do ti drejtohen sheshit të Mahsherit. Do të dalin para Allahut për të parë përfundimin e punëve të bëra në dynja. Për këtë arsye, besimtari i mirë është i vëmendshëm në çdo fjalë, veprim e hap të jetës së tij. Pa dyshim se një ditë do të largohemi nga kjo jetë dhe do të dalim para Allahut duke dhënë llogari për çdo vepër, qoftë ajo sa grimca më e vogël. Këtë e besojmë bindshëm, sepse Allahu (xh.sh.) urdhëron e thotë:

"**Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë**, **e kush ka bërë ndonjë të keqe qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë**"[129].

129. Zelzele, 99:7-8

Kështu që, ai i cili beson Allahun e Lartësuar dhe në Ditën e Gjykimit, duhet të marrë në llogari veten e tij çdo ditë për fjalët që flet dhe punët që vepron. Imam Rabbani, (Zoti qoftë i kënaqur prej tij), thoshte kështu: "Njerëzit e dashur tek Allahu, para se të flinin, bënin llogarinë e punëve me të cilat ishin angazhuar, fjalëve që kishin folur dhe mendimet që kishin kaluar nëpër mendjet e tyre. Për veprat e këqija ulnin kokën, pendoheshin me dëshpërim dhe i kërkonin falje Allahut. Ndërsa për veprat e mira falënderonin Allahun që ua kish bërë të mundur ti kryenin".

Në ditën e gjykimit do të ketë prej atyre njerëzve, të cilët ia kanë bërë gjykimin vetes që në këtë botë. Ata kanë qenë të kujdesshëm në fjalët dhe punët e tyre. Çdo ditë kanë kontrolluar marrëdhënien me Allahun e Lartësuar dhe janë përgatitur për të dalë para kësaj gjykate, e cila nuk neglizhon asgjë. Për ata njerëz, të cilët janë përpjekur vazhdimisht për të qenë koherent me kënaqësinë e Allahut, Ai (xh.sh.) thotë:

"**Atë Ditë do të mbeteni zbuluar dhe asnjë fshehtësi e juaja nuk do të mbetet pa u shfaqur: Ai, të cilit do t'i jepet libri i veprave të tij nga ana e djathtë, do t'u thotë (njerëzve të tij): Ja, lexoni librin tim! Vërtetë, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari. Kështu, ai do të ketë jetë të lumtur, në një kopsht të lartë**"[130].

Besimtari i devotshëm, i drejtohet Allahut jo me mendjemadhësinë e punëve të mira që ka bërë, por me vuajtjet e brendshme të punëve të padobishme që ka vepruar. Në këtë drejtim, Ebu Bekri, (Zoti qoftë i kënaqur prej tij), e dorëzoi shpirtin brenda vuajtjeve të mëdha. Gjatë 23 viteve të profetësisë se Muhamedit (s.a.s) dhe 2.5 viteve të hilafetit, ai ishte i qartë në punët e veta dhe çdo hap i tij ishte në të mirë. Shokët e vet thonë se në këto vite të jetës së tij, sexhdet e namazeve të falura ishin të mbytyra në lot. Një mburojë e fuqishme në këtë çështje është edhe autokritika e hz. Omerit, (Zoti qoftë i kënaqur prej tij), i cili shprehet kështu: "Bëni llogarinë e vetëve tuaj, përpara se të merreni në llogari". Kur i lexon autokritikat e sahabëve, mendon se këta njerëz kanë mbi supe një mal me

130. Hakka, 69:18-22

mëkate, ndërkohë që janë përfaqësuesit e majave të devotshmërisë. Nga ana tjetër, nuk e mbyllnin derën e shpresës prej Mëshirëplotit duke thënë: "Megjithatë, asnjëri nuk është kthyer prej Teje duarbosh".

Njeriu e bën mirë llogarinë përpara se t'i hyjë një pune në këtë dynja; sa humb e sa fiton. Ashtu siç e bën për këtë dynja, duhet ta bëjë edhe për ahiretin, madje në këtë çështje, ai duhet të tregohet më serioz e më i kujdesshëm. Si rezultat i autokritikës që bën besimtari, vjen pendesa dhe istigfari, lutja për falje. Istigfari është një rigjallërim, një rilindje, për të cilin Profeti (s.a.s.) thotë:

"*Kush dëshiron që fletorja e veprave të tij ta gëzojë në ditën e kiametit, të shtojë istigfarin*"[131].

Si përfundim, ajo që kërkohet nga ne është që të jemi vigjilent në këtë botë të përkohshme, duke jetuar të vetëdijshëm se aty është vendi, ku mbjellim atë që do të korrim në ahiret. Të bëjmë herë pas here llogarinë e punëve tona, ashtu si na mësoi i dërguari i Allahut (s.a.s) dhe si e praktikuan sahabët e nderuar, sepse kjo do të jetë rruga e suksesit tonë në këtë botë dhe në tjetrën. Ndërsa hapi i fundit, është që t'i mbështetemi Allahut, sepse lutja dhe mbështetja tek Ai (xh.sh) fuqizojnë ndjenjat për mirësi, kurse pendesa dhe istigfari ja presin krahët ndjenjave për ligësi.

131. Kenzu'l-Ummal

VEPRIMI MË I FRIKSHËM

Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: "*Më e frikshmja e gjërave për të cilat trembem për umetin tim është hipokrizia*"[132]. Shedad bin Eusi rrëfen: Një ditë e pashë Profetin duke qarë. Kur e pyeta për arsyen, më dha këtë përgjigje: "*Kam frikë për umetin tim për një vepër: shirkun (T'i bësh ortak Zotit). Por umeti im nuk do t'u falet idhujve, diellit, hënës, gurit etj... Mirëpo do të fusin hipokrizi në veprat e tyre. E pra kjo është më e frikshmja e gjërave që u trembem*"[133].

Hipokrizia mbart kuptimet e dyfytyrësisë, të mungesës së sinqeritetit, të shfaqjes së jashtme të rreme dhe dëshirës për t'u dukur. Pra, dukuria në të folur, në veprime e në sjellje me qëllimin që ta vënë re të tjerët, domethënë për hir të të tjera qenieve përveç Allahut duke synuar të fitohen lëvdatat dhe dashuritë e njerëzve. Në rastin e hipokrizisë kemi të bëjmë me një gënjeshtër të dyfishtë. Hipokriti, duke thënë se po e kryen për hir të Allahut një punë që, në të vërtetë po e kryen për hir të njerëzve, thotë një gënjeshtër. Po ashtu, duke pohuar se e pret shpërblimin nga Allahu ndërkohë që në të vërtetë e pret nga njerëzit, shpreh edhe një gënjeshtër të dytë. Kjo është një rënie dhe degradim i plotë i personalitetit. Pyetjes ç'është shpëtimi? Profeti ynë (a.s.) i është përgjigjur në këtë mënyrë:

132. Tirmidhi; Ibn Maxhe; Ahmed
133. Ahmed

mëkate, ndërkohë që janë përfaqësuesit e majave të devotshmërisë. Nga

131. Kenzu'l-Ummal

"*Shpëtimi mbërrihet kur njeriu me adhurimin e tij ndaj Allahut, nuk synon admirimin e njerëzve*"[134].

Kjo lloj hipokrizie është e rëndë. Kemi të bëjmë me një hipokrizi të lehtë kur në nënshtrimin e adhurimin ndaj Allahut synojmë edhe sevapin e Zotit edhe admirimin e njerëzve, duke i bashkuar të dyja këto në zemër. Nga Ebu Hurejre transmetohet se Profeti ynë ka thënë:

"*Allahu thotë: Unë nuk kam kurrfarë ortaku. Nëse dikush, në veprën e kryer për mua, përzien edhe të tjerë, unë jam larg asaj vepre. Ajo vepër është për atë që është përzier në atë mes*"[135].

Këtu është shprehur një lloj hipokrizie në të cilën vepruesi dëshiron edhe Allahun, edhe njerëzit. Pra, hipokrizi e rëndë është synimi i admirimit të njerëzve në adhurimin ndaj Allahut, ndërsa hipokrizi e vogël është synimi i admirimit të Allahut dhe të njerëzve njëkohësisht. Sidoqoftë, hipokrizia është një veprim shumë i rrezikshëm dhe shumë i frikshëm, madje është veprimi më i dënuar nga Zoti. Jo më kot Allahu na paralajmëron në Kuran kur thotë:

"**Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehenemit dhe ti kurrsesi nuk do t'u gjesh atyre ndihmës**"[136].

Hipokrizia në marrëdhëniet me njerëzit mund të kuptohet nga disa shenja. Për shembull, mund të vërehet dikush që me gjuhën, me sjelljen, me të folurin dhe edukatën e tij duket si një njeri shumë i thjeshtë, por sapo ndodhet mes njerëzve që janë nën nivelin e tij, shihet se ndryshon sjellje e qëndrim. Kjo do të thotë se ai nuk është vërtetë i thjeshtë. Ai vetëm sa përulet kundrejt njerëzve që janë në nivele më të larta se ai. Ndërsa shenjë e sinqeritetit, e pastërtisë shpirtërore, është kur njeriu është i njëjtë dhe mban të njëjtën qëndrim si në vetmi ashtu edhe mes njerëzve, si natën ashtu edhe ditën. Ai tregohet kryelartë kundrejt dhunuesit dhe kryeulur kundrejt besimtarëve.

134. Buhari; Ebu Daud; Nesai
135. Muslim; Ibn Maxhe; Tirmidhi
136. Nisa, 4:145

Në ditët tona hipokrizia është shumë e përhapur. Mbase që nga koha kur është krijuar bota mund të mos ketë ekzistuar ndonjëherë kaq dëshirë për t'u dukur sa ç'ekziston në kohën tonë, sepse në ditët tona faktorët që çojnë në hipokrizi janë të shumtë: çmimet, pllakatat, duartrokitjet, lëvdatat, komplimentet, shpikjet, krenaritë kombëtare, krenaritë e lidhura me përkatësitë e ndryshme... aq të ndryshme janë, saqë duket sikur askush nuk e llogarit Allahun në të gjitha këto. Njeriut i mundësohet çdo sukses - që në të vërtetë nuk i përkasin fare atij - dhe ai tregohet mosmirënjohës e egoist, duke i kthyer të gjitha këto në mjete për të harruar Allahun. Zoti zbret mirësi pa masë, ndërsa njerëzit në vend që t'i përdorin këto mirësi për të arritur te Ai, vendosin perde mes vetvetes dhe Allahut. Ndërkohë që një njeri i zgjuar, për çdo mirësi të vogël dhe suksesi në jetë, duhet të drejtohet me përgjërim duke thënë: "Allahu im, kjo është prej Teje dhe falënderimi të takon vetëm Ty".

NDJENJA MË MIZORE, SMIRA

Profeti (a.s.) thotë: "*Në një zemër nuk mund të gjenden së bashku edhe besimi (iman), edhe smira (hased)*" [137].

Smira në fjalor, është ndjenjë e lakmisë dhe e keqdashjes, që ngjallet kur shohim dikë më mirë se veten. Në kuptimin fetar, smira (hased) ka kuptimin e të ushqyerit të dëshirës që një njeri të humbasë diçka të vlefshme që poseidon.

Dijetarët myslimanë e kanë kategorizuar kështu këtë ndjenjë që buron nga zemra e njeriut: Smirë, ambicie dhe konkurencë. Smira është një ndjenjë, që e bën zemrën të digjet nga lakmia dhe urrejtja për t'i parë të mirat e privilegjet e dikujt të shuhen përfundimisht. Ambicia është kur uron dhe përpiqesh që të mirat e privilegjet e ngjashme të dikujt, t'i kesh edhe ti, pa u privuar tjetri nga ato. Kurse konkurenca, është kur i konkuron bamirësit në veprat e mira.

Smira nganjëherë trazohet me ambicie, ndërsa ambicia është një anë e pranueshme te njeriu. Nëse ambicia kthehet në sëmundje dhe trazohet me inat, lind smirën. Profeti ynë (paqja qoftë mbi të!), duke tërhequr vëmendjen tek ky dallim mes smirës dhe ambicies, ka thënë se besimtari admiron, kurse hipokriti ushqen smirë.

137. Nesai

Kurani e paraqet smirën si një sjellje të dëmshme dhe burim të keqeje, prej së cilës duhet të kërkojmë mbrojtjen e Allahut. Abdullah ibn Abasi tregon se i dërguari i Zotit, u këndonte suren Felek dhe Nas dy nipave të tij, Hasanit dhe Husejnit. Ndërsa në një ajet urdhërohet kështu:

"**A i kanë smirë ata njerëz për atë që Allahu u ka dhuruar prej mirësive të Veta? Ne u patëm dhënë pasardhësve të Ibrahimit Librin e urtësinë dhe u patëm siguruar pushtet të madh**"[138].

Në hadithin e sipërcituar Profeti (a.s.) e shpreh qartë që smira është e kundërta e besimit dhe kundërshtare e tij. Por mund të ndodhë që edhe një besimtar të ketë zili dhe smirë. Sepse është në natyrën e njeriut që të mos ndihet mirë, kur sheh që të tjerët kanë dhe ai jo. Por e rëndësishme këtu është që këto ndjenja të kalojë tangent në mendim dhe të mos ngulitet në karakterin e në natyrën e njeriut. Imam Gazzali thotë: "Edhe pse është ziliqar, besimtari kurrë nuk do e ndërmerrte hapin për t'a privuar tjetrin nga të mirat dhe privilegjet, nëse e ka në dorë diçka të tillë. Sepse besimtarin e kontrollon dhe e orienton besimi në Zot, si dhe vlerat në të cilat beson."

Smira në vetvete, është një sëmundje dhe një vepër e ulët, sidomos kur kalon cakun e mendimit dhe veprohet sipas saj. Smira është sjellja e atyre shpirtrave të mjerë e zemërngushtë që në vend që të kërkojnë prej thesarit të Allahut, i gëzohen humbjes së asaj që ka një tjetër në zotërim. Pas të gjitha të këqijave në shoqërinë njerëzore si lufta, dhuna, shpifja, kaosi, vrasja, shthurja etj., thuajse në çdo rast qëndron e fshehur smira. Edhe ndër arsyet kryesore të kundërshtimit e të mohimit ndaj Profetëve sipas Kuranit Fisnik, qëndron smira.

"**Shumë nga ithtarët e Librit, prej zilisë që kanë në vete, dëshirojnë që t'ju kthejnë nga besimi në mosbesim, tani që e vërteta është e qartë për ata**"[139].

138. Nisa, 4:54
139. Bekare, 2:109.

Bediuzzaman Said Nursi, në lidhje me smirën shprehet kështu: "Vëllezërit e mi! Në punën tonë, drejtimi më i rrezikshëm i egoizmit është smira. Nëse puna nuk është veç për hir të Allahut, zilia ndërhyn dhe e prish. Sikurse te njeriu ku dora nuk e ka smirë dorën tjetër, syri nuk e ka smirë veshin, sikurse zemra nuk garon me mendjen, edhe në qenien shpirtërore të bashkimit tonë, secili prej jush është në pozitën e një ndjenje, të një gjymtyre. Detyra juaj morale e shpirtërore nuk është që të keni zili njëri-tjetrin, por që të krenoheni me vlerat e njëri-tjetrit, që t'u gëzoheni atyre."

Në jetën e amshuar, Allahu, duke u dhuruar banorëve të Parajsës mirësi që syri s'i ka parë, që veshi s'i ka dëgjuar e që biri i njeriut nuk i ka imagjinuar as në ëndërr, do t'u bëjë një dhuratë edhe më të madhe, siç është ç'rrënjosja dhe zhdukja prej tyre e ndjenjës urrejtjes dhe smirës. Kurani e shpreh kështu këtë të vërtetë:

"**Ne do ta shkulim urrejtjen nga kraharori i tyre**"[140].

Mbështetur në rregullin "shpërblimi është sipas llojit të punës", sikurse në jetën e kësaj bote, edhe në jetën e përjetshme njeriu do të shpërblehet sipas vështirësive e brengave që ka hequr, duke iu dhuruar kësaj radhe një jetë pa vështirësi e brenga. Sikurse uria dhe etja në këtë botë kanë si përfundim një jetë pa uri dhe etje në jetën e amshuar, po ashtu, njeriu që ka kapërcyer vetveten duke luftuar kundër ndjenjave e pasioneve që janë quajtur "sëmundje të zemrës", do të shpërblehet duke u çliruar përgjithmonë prej tyre në jetën e amshuar.

Smirëtari, nuk gjen qetësi dhe nuk e shijon jetën, derisa t'i shohë të mirat e personit që urren, të shuara. Është për të ardhur keq që lakmia dhe smira të përhapen kaq shumë mes njerëzve të afërm, mes kolegëve të punës, në familje, mes komshinjve etj. Kjo është kaq e rrezikshme, sa edhe veprat e mira i përpin si zjarri. Në lidhje me të Profeti ynë (paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

140. Araf, 7:43

"*Ju bëj thirrje të shmangeni prej smirës, sepse smira i shfaros veprat e mira të njeriut siç e shfaros zjarri drurin*"[141].

Nëse zemra nuk ushqehet me bindje dhe dashuri për Allahun, atëherë tek ajo do të mbizotërojë smira, inati, zemërimi, urrejtja, lakmia, egoizmi e të tjera si këto. Këtë nënkupton edhe profeti ynë kur thotë:

"*Në trup gjendet një copë mishi. Nëse ajo është mirë, i gjithë trupi është mirë, nëse ajo është e prishur, i gjithë trupi është i prishur. Kjo copë mishi është zemra*"[142].

141. Ebu Daud; Ibn Maxhe.
142. Buhari; Muslim

PËRFOLJA DHE PASOJAT E SAJ

Hz. Muhamedi (a.s.) i thotë sahabëve: "*A e dini ç'është përfolja"?* Sahabët i thanë: Allahu dhe i dërguari i tij e dinë më mirë. Profeti i tha: "*Përfolja është përmendja e vëllait tënd mysliman në një mënyrë të cilit nuk i pëlqen*". U drejtua një pyetje. Po nëse ajo veçori që them gjendet në vëllaun tim ç'urdhëroni? Profeti (a.s.) iu përgjigj: "*Në qoftë se ajo gjë që ke thënë ndodhet tek ai, atë patjetër e ke përfolur. Nëse ajo gjë që ke thënë nuk ndodhet tek ai, atëherë ke shpifur*"[143].

Secila fe vjen me qëllimin që të mundë të keqen e t'i japë pushtet të mirës. Për këtë arsye, çdo fe synon së pari të përmirësojë moralisht besimtarët e vet dhe më pas të rregullojë shoqëritë e t'i lartësojë ato moralisht. Të gjitha urdhrat dhe këshillat e Islamit në këtë drejtim kanë për qëllim të shpëtojnë njeriun nga veset e këqija. Profeti Muhamed (a.s.) në fjalën e tij të lartpërmendur e ka përkufizuar më së miri përfoljen (përgojimin) si një ves shumë të shëmtuar që dëmton shoqërinë dhe vëllazërinë Islame në veçanti. Themeli i armiqësisë, i hidhërimit, i mosshkuarjes mirë me njëri tjetrin, është përfolja. Ajo që i përçan myslimanët, që i largon nga ndjenja vëllazërore është përfolja dhe burimi kryesor i saj është smira.

143. Muslim; Ebu Daud; Tirmidhi

Përfolja siç bëhet me gjuhë, ashtu bëhet edhe me zemër, me mimika të fytyrës, me shenjat e syve apo vetullave, me shkrim dhe me veprime. Në çdo lloj mënyre qoftë, një mysliman të përfolë vëllaun e tij mysliman është haram. Allahu (xh.sh.) në Kuran e ka ndaluar këtë ves me një shprehje jashtëzakonisht të rëndë:

"**Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë**"[144].

Ky ajet përmend shkatërrimin që sjell përgojimi në shpirtin e njeriut dhe në trupin e shoqërisë. Ai tregon se përgojimi është lëndim i nderit dhe i personalitetit të njeriut, që është si mishi dhe gjaku i tij. A janë të hidhëruar komshiu me komshiun, shoku me shokun? Atje patjetër ka hyrë përfolja. A e shohin njerëzit njëri-tjetrin me ndjenjë urrejtjeje? Atje ka përfolje. Profeti (a.s.) e tregon hapur përfoljen si një dëfrim i njerëzve me shpirt të dobët në këtë hadith:

"*O ju që keni besuar me gjuhë, ju njerëz që nuk ju ka zbritur besimi në zemrat e juaja. Mos i përfolni myslimanët, mos bëni kërkime në çështjet e tyre të fshehta. Sepse kush kërkon të metat e fshehta të vëllaut të tij mysliman, edhe Allahu do t'ia nxjerr hapur të metat e tij dhe e poshtëron atë brenda në shtëpi*"[145].

Të flasësh mbrapa krahëve duke e marrë nëpër gojë tjetrin është diçka shumë e ligë në plan të mendjes e të zemrës, të njerëzores e të shpirtërores, të natyrshmërisë e të përkatësisë. Profeti (a.s.) ka thënë:

"*Kur u ngrita në miraxh kalova pranë një populli. Ata po e çirrnin fytyrën dhe gjokset e tyre me thonj prej bakri. Në ndodhi e sipër pyeta: O Xhibril, kush janë këta?! Ai u përgjigj: "Këta janë ata të cilët hanin mishërat e njerëzve dhe merrnin nëpër gojë nderin e tyre*"[146].

144. Huxhurat, 49:12
145. Ebu Daud; Tirmidhi

146. Ebu Daud

143. Muslim; Ebu Daud; Tirmidhi

Kishte prej sahabëve dhe myslimanëve të mëparshëm që ndalimin e gjuhës nga përgojimi e shikonin si një adhurim më të lartë se falja dhe agjërimi, për vet fundin e tij të hidhur. Të frikësuar nga ndëshkimi i Allahut, kishte prej tyre që pothuajse çdo ditë agjëronin dhe i luteshin Zotit për të mos rënë viktimë e fjalëve të këqija. Gjithmonë largoheshin nga tubimet e grumbullimet e njerëzve ku objekti i bisedave ishin thashethemet.

Përgojimi është një armë e ulët që shfytëzohet më së shumti prej atyre që kërkojnë e ushqejnë armiqësi, smirë e urrejtje. Njerëzit shpirtmëdhenj e me vlera nuk bien kurrë aq poshtë sa të kapen pas kësaj arme të fëlliqur e ta vënë në shfrytëzim. Një mysliman siç nuk duhet vetë të përgojojë, ashtu dhe nuk duhet të ulet me njerëz që përgojojnë; ose nëse është i ulur, të bëhet pengesë për këtë gjë. Profeti (a.s.) në një hadith thotë:

"*Një njeri nëse e mbron nderin e vëllaut nga përgojimi, ditën e kiametit Allahu i Lartësuar e largon atë nga zjarri i xhehenemit*"[147].

Dijetarët janë të mendimit se përgojimi në disa çështje të veçanta mund të jetë i lejuar sipas kritereve si më poshtë:

1- Nëse njeriu që përgojohet është një mëkatar i hapur. Pra dikush që nuk i vjen aspak turp e nuk i skuqet faqja nga ligësia e vet, madje ndihet krenar prej së keqes. Kur ky person kryen dhunë e mizori hapur pa kurrfarë ndrojtjeje. Profeti (a.s.) thotë: "*Nuk ka përfolje për mëkatarin*"[148].

2- Nëse qëllimi nuk është që të poshtërohet e të turpërohet dikush, por në domosdoshmëri për ta dalluar mund përshkruhet si p.sh. i verbër, i çalë etj.

3- Nëse dikush dëshiron të kryejë një punë të përbashkët me dikë dhe për këtë vjen e këshillohet me ty. Në këto rrethana, pa qëllim të keq, në mënyrë që ti japësh hakun e vet këshillimit, mund të thuash: Mos bëj punë me të sepse do të dëmtohesh.

147. Tirmidhi
148. Taberani

4- Nëse dikush paraqet përshkrimin e një ankese tek autoriteti i duhur, me qëllimin që të përfitojë ndihmë për të shpëtuar nga e keqja e një njeriu të lig duke marrë prej tij të drejtën që i takon.

Pikërisht për këto çështje dhe larg egoizmit, pa ndonjë qëllim tjetër përveç të drejtës dhe çështjeve të punës, diskutimi rreth një personi mund të jetë i lejuar. Përndryshe, siç e konsumon zjarri drurin, ashtu edhe përgojimi i konsumon e i zhduk të gjitha veprat e mira. Nëse dikush ka përgojuar vepron kështu: a) Duhet të lutet në këtë mënyrë: "O Allah im, më fal mua dhe njeriun që unë kam përgojuar". Pastaj, b) Në rastin më të parë duhet t'i thotë atij: "Ma bëj hallall".

BRAKTISJA E KOTËSISË

Profeti (a.s.) thotë: "*Braktisja e kotësive është ndër bukuritë e Islamit të personit*"[149].

Kotësi do të thotë të merresh me gjëra të panevojshme dhe të tilla ku as personi vetë, as familja e tij dhe as shoqëria nuk do të kishin dobi, qofshin këto fjalë, vepra, mendime, ndjenja apo imagjinata. Një njeri që merret me kotësira nuk mund të gjejë rast që të merret me gjërat që atë vetë e interesojnë. Ai nuk do të gjejë asnjëherë kohë të përkujdeset me çështje jetike e të domosdoshme. Të merresh me kotësira do të thotë të preokupohesh me çështje të panevojshme, që s'kanë lidhje ose nuk e interesojnë asnjëherë individin, që s'përbën dobi as për të sotmen e as për të ardhmen e tij. Prej këtij modeli të shtrembër nuk shpresohet as që të bëjë ndonjë gjë të dobishme e me vend, sepse ky person ngatërrohet në çdo çështje, pa parë nëse është detyra e tij apo jo, apo nëse është kompetent apo jo në atë fushë. Një person, i cili e din mirë se të gjitha organet e tij do të japin llogari, jo vetëm fjalën dhe veprën, por edhe mendimet e imagjinatën duhet ta ndërtojë në pajtim me kënaqësinë e Zotit. Ndërkohë që dashje apo padashje merremi me gjëra që nuk janë në kompetencën tonë dhe fillojmë debatin duke lënduar njëri-tjetrin.

149. Tirmidhi

Në shpalljen hyjnore Allahu lavdëron mëshirën dhe butësinë. Krijuesi ynë në Kuranin Famëlartë thotë:

"**Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje**"[150].

Fjalët e Profetit janë në të njëjtin kontekst, në hadith përmendet:

"*Mos u përçani që të mos përçahen zemrat tuaja*"[151].

E them me bindje se kush sheh në shoqërinë tonë gjen se ne jemi të ashpër me njëri-tjetrin, jemi të ashpër me ata që kemi kontradikta, nuk jemi të drejtë kur gjykojmë, veprojmë pa menduar, nëse nuk na pëlqen mendimi, sulmojmë të zotin e tij pa kufi. Sikur u kërkohet njerëzve që të bien dakort me ne në gjithçka, të arrijnë kënaqësinë tonë, të na e bëjnë qejfin për gjithçka sikur të ishin mendimet tona shpallje hyjnore, e sikur e drejta të na shoqëronte kudo që të shkonim.

Një njeri që merret me kotësira, edhe në një ambient serioz shpirtëror mundohet ta ndryshojë atmosferën e ta ktheje në diçka joserioze. Por humbja e seriozitetit është një dëm i madh. Njeriu që humb seriozitetin përbrenda e shfaq atë edhe përjashta me njerëzit. E shfaq atë madje edhe në adhurime. Ai, sado që të mundohet të duket serioz kur i drejtohet namazit, kjo do të shkojë deri diku, por nuk do të zgjasë shumë gjatë. Herët a vonë ky person do të pasqyrojë karakterin e tij të vërtetë. Zgjidhja e kësaj çështjeje është që ai ta kthejë seriozitetin në natyrën e tij të pandryshueshme. Kjo arrihet me anë të vetëkontrollit dhe kthimit në shprehi të gjërave serioze. Nëse njeriu mbështetet nga bota e tij e brendshme, atëherë kjo përgatitje do të gjejë pasqyrim edhe në paraqitjen e jashtme. Në legjislacionin islam ka ura bashkëpunimi dhe afrimi më shumë nga c'mund të përshkruhet. Ne jemi të mëshirshëm, të mirë me vetët tona, lavdërojmë çdo gjë që bëjmë, justifikojmë çdo gabim tonin, e mbrojmë veten prej çdo veprimi, kurse nga ana tjetër gjykojmë gabimet e të tjerëve, qortojmë me të madhe çdo gabim të tjetrit, e nganjëherë nuk e pranojmë pendimin, e aq më pak justifikimin e tyre.

150. Bekare, 3:159
151. Ebu Daud

Nëse do të arrihet diçka, besimtari duhet të ketë për qëllim gradën më të lartë të saj. Në hadithin e mësipërm thuhet që me braktisjen e kotësive arrihet bukuria e mirësia e Islamit. Dhe padyshim që grada më e lartë e bukurisë dhe mirësisë së Islamit është ihsani, përkufizimin e të cilit Profeti (s.a.s.) e bën kështu në hadithin e Xhibrilit (a.s):

"*Ihsani është adhurimi i Allahut sikur po e sheh Atë. Sado që ti mos ta shohësh Atë, Ai të sheh ty*"[152].

Atëherë mirësia më e lartë është të jetosh porsi një rob i denjë i Krijuesit, Zotëruesit të gjithçkaje. Aty e gjen lirinë e vërtetë njeriu. Dhe kjo në krye arrihet nga brenda dhe pastaj pasqyrohet edhe në paraqitjen e jashtme. Duhet të arrijë në një gradë të tillë që, kur ta shohësh besimtarin diku ai të të kujtojë Allahun. Ky është përfaqësimi i duhur i mëkëmbësit të Zotit në sipërfaqen e tokës, emërtim i bërë nga vetë Allahu për njeriun. Atëherë detyra është që të arrihet pikërisht kjo pikë.

Njeriu serioz, që ka braktisur kotësitë, që ka arritur ose është afër gradës së ihsanit, fiton gjithashtu siguri në çdo gjë. Ai është i sigurt në çdo punë e sjellje, sepse vetëdijen e tij e ka mbështjellë ideja që në çdo veprim ai vështrohet nga Krijuesi. Njeriu duhet ta kalojë kohën e tij me punë të dobishme. Në ajetin 105 të sures Teube thuhet që veprën e besimtarit do të shohë Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët. Këtë mund ta mendojmë si një inspektim, për të cilin duhet të bëjmë përgatitje. Këtu besimtari nuk duhet të dalë i turpëruar, prandaj veprat e tij duhet të jenë të shëndosha e të sakta. E pra, me ihsan veprimet e njeriut do të jenë të përsosura dhe ai kurrë nuk do të bëjë kotësira. Nëse vazhdon drejt kësaj rruge, Allahu (xh.sh.) thotë në një hadith kudsij: "Nëse robi im afrohet tek Unë me një pëllëmbë, i afrohem atij një krah dhe, nëse afrohet tek Unë një krah, i afrohem atij një pash. Nëse vjen tek Unë duke ecur, do të shkoj drejt tij duke vrapuar"[153].

152. Muslim
153. Buhari

Në librin e tij El-Muatta, imam Maliku shkruan: Dikush e pyeti Llukmanin e urtë se si e kishte arritur gjithë atë pozitë të lartë si njeri. Llukmani përgjigjet: "Duke folur gjithnjë të vërtetën, duke plotësuar amanetet dhe duke mos u marrë me atë që nuk më përket". Po e mbyll shkrimin me këshillën e Profetit (a.s.), i cili thotë:

"*Ndonjëherë njeriu flet ca fjalë për t'i bërë të tjerët të qeshin, por prej tyre hidhet në xhehenem, në një thellësi sa distanca ndërmjet qiellit dhe tokës*"[154].

154. Ahmed

TURPI, SHENJË E BESIMIT

Profeti (a.s.) thotë: "*Turpi nuk sjell tjetër veçse të mira*"[155]

Turpi për të cilën i dërguari i Zotit (a.s.) bën fjalë është ajo që ndërhyn ndërmjet njeriut dhe të shëmtuarës duke e penguar personin nga ajo punë që e turpëron. Është i lavdërueshëm morali i atij personit, të cilit i sillet në kokë të bëjë një vepër amorale dhe turpi e pengon ose i vjen të ofendojë ndonjë njeri dhe turpi e frenon. Një njeri i tillë, kur rastis me një vajzë të bukur ul shikimin dhe, nuk merr pjesë në ato biseda ku njerëzit përgojohen. Sepse ky person e njeh Allahun si Zot të vetëm dhe duke e ditur se është nën mbikqyrjen e Tij në çdo moment, i vjen turp të veprojë në kundërshtim me pëlqimin e Zotit. Këtë nënkupton Profeti ynë kur i thotë shokëve:

"*Kini turp nga Allahu ashtu siç e meriton*". Ata thanë: Lavdi Zotit, ne kemi turp o i dërguari i Zotit! Profeti iu përgjigj:

"*Nuk është ashtu. Ai që turpërohet nga Allahu ashtu siç e meriton, duhet të ruajë kokën dhe çka brenda saj* (pra të ruajë mendimin, shikimin, gjuhën dhe dëgjimin nga harami), *të ruajë barkun dhe ç'ka përmban ai, të përkujtojë vdekjen dhe tretjen nën dhé. Kush vepron kështu, ka vërtet turp nga Allahu*"[156].

155. Buhari; Muslim
156. Tirmidhi; Ahmed

Turpi është dy llojesh: a) Turpi i vendosur në natyrën e njeriut që në lindje dhe jo i fituar më vonë. Ai është prej virtyteve më të mëdha që Allahu ia dhuron robit. Ai e pengon njeriun nga kryerja e veprimeve të turpshme dhe të ulta duke e nxitur atë drejt sjelljeve fisnike e të larta. Në këtë kuptim është prej cilësive të besimit. b) Turpi i fituar nga njohja e Allahut dhe Madhështisë së Tij. Kjo është prej cilësive më të larta të besimit dhe prej gradëve të larta të mirësisë. Transmetohet nga Eshexh el-Asari: Pejgamberi më tha mua:

"*Ti ke dy virtyte të bukura të cilat Allahu i don*". Thashë: Cilat janë ato? Profeti tha: "*Vetpërmbajtja dhe turpi*". Thashë: A më janë dhuruar apo i kam fituar vetë? Profeti u përgjigj: *"I ke të dhuruara"*. Thashë: Falenderimi i takon Allahut që më bëri me dy cilësi që i don Ai Vetë[157].

Nëse njeriut i mungon turpi i fituar apo i lindur, nuk i mbetet atij çfarë ta ndalojë nga kryerja e mëkateve të shëmtuara dhe sjelljeve të pahijshme. Kush nuk u turpërua bëri çfarë deshi, pasi pengesa prej kryerjes së veprimeve të turpshme është turpi. Ai që nuk ka turp t'i shkelë kufijtë e Zotit, i ka njëlloj si mëkatet e vogla ashtu edhe mëkatet e mëdha. Ai zhytet në çdo imoralitet dhe paturpësi, prej të cilave ndalohen ata që kanë turp. Ashtu siç thotë edhe Zoti në Kuran:

"**Bëni ç'të doni, se Ai i sheh të gjitha çfarë punoni ju**"[158],

ose Profeti Muhamed (a.s.) kur thotë:

"*Nëse nuk ke turp bëj çfarë të duash*"[159].

Sigurisht këto thënie nuk janë në kuptimin e urdhërit që ky njeri të bëjë çfarë të dojë, por në kuptimin e qortimit dhe të ndalimit prej kësaj, pasi Allahu padyshim do ta gjykojë për këtë.

157. Nesai; Ahmed

158. Fusilet, 41:40
159. Buhari

155. Buhari; Muslim
156. Tirmidhi; Ahmed

Duhet theksuar edhe njëherë se në thëniet e Profetit bëhet fjalë për turpin e lavdëruar dhe jo për atë që është frikë, ose që në mënyrë alegorike i themi turp. Kështu përshembull, ai turp që të ndalon të thuash të vërtetën, të ndalon për punë të mira, nuk të frenon nga e keqja, të ndalon të pyesësh për ndonjë çështje që nuk e ke kuptuar dhe veprime të tjera të ngjashme me të, është i qortueshëm. Profeti (a.s.) ka qenë shumë i turpshëm, por kur shihte diçka që nuk ishte në përputhje me fenë ose me normat njerëzore nuk turpërohej ta pengonte atë të keqe, nuk heshte kur shihte gabime por i përmisonte. Dhe këshillat e tij për njerëzit janë gjithnjë në këtë drejtim.

Turpi dhe besimi shkojnë paralelisht me njëri tjetrin, nëse hiqet turpi e ndjek tjetri. Për këtë arsye Hz. Muhamedi (a.s.) e bëri turpin prej besimit, sikurse në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejre ku thotë:

"*Turpi është pjesë e besimit*"[160]

160. Buhari; Muslim

BESIMTARI PËRBALLË SFIDAVE TË KOHËS

Shekulli i 21 mund të quhet me plot gojën shekulli i teknologjisë. Besimtari e gjen veten përballë sfidave të ndryshme në çdo kohë, por duket se zhvillimi i madh teknologjik që po jetojmë, është duke e sfiduar njeriun në përgjithësi dhe besimtarin në veçanti, në një formë më të dukshme. Përveç mediave vizive e të shkruar, janë rrjetet sociale ato, nga të cilat kërkohet që besimtari të jetë i kujdesur dhe i matur. Sepse si çdo gjë, edhe ato mund të shërbejnë për mirë e për keq, në varësi të përdoruesit. Dua të hedh vëmendjen më tepër te debatet dhe komentet në rrjetet sociale, sepse aty vë re një gjuhë të ashpër kur bie fjala për debat apo kur shprehim mendimet tona. Pyetja që i shtrojmë vetes ne si besimtarë ka të bëjë me qëndrimin dhe ekuilibrin që duhet të mbajmë në raste të ndryshme kur është i nevojshëm mendimi ynë. Pse duhet që të shfryjmë dufin, inatin apo të shprehemi me ndjenjë hakmarrjeje?! Apo më keq, pse duhet që komentet të marrin përmasa duke shkuar deri në ofendime dhe gënjeshtra?!

Sot, me shqetësim ndjekim informacione të gabuara, përplot me gënjeshtra e shpifje që shëtisin e përhapen kudo, duke nëpërkëmbur të drejtën, nderin dhe privatësinë e individit. Më e keqja është se shohim edhe myslimanë, të cilët bëhen pjesë e këtij zullumi që shkatarron

vëllazërinë e harmoninë ndërmjet njerëzve. Mirëpo besimtari i mirë, nuk duhet të bie pre e këtyre fenomeneve dhe përballë këtyre sfidave qëndron në vlerat e larta të islamit, që janë manuali më i mirë dhe i pa gabuar për njerëzimin. Nga ai kërkohet që ta ushqejë veten në çdo kohë e moment me mësimet dhe këshillat universale, të cilat Allahu i Lartësuar i dërgoi njerëzimit me anë të profetëve. Vetëm duke u kalitur me këto vlera, ai i bën ballë me lejen e Zotit dhe i kapërcen me sukses si durimtar çdo pengesë, sprovë apo rrezik që i kanoset, duke u bërë në të njëjtën kohë falënderues për mirësitë, gëzimet e lumturitë që i janë dhënë.

Në debate apo komente të ndryshme, ku kërkohet mendimi i një besimtari mysliman, ai duhet të sillet në koherencë me mësimet e Islamit duke përfaqësuar fytyrën paqësore të tij. Ai e ruan këtë gjendje edhe kur ofendohet nga të tjerët, sepse rrezaton urdhrin e Krijuesit kur thotë:

"**Robërit e të Gjithmëshirshmit janë ata që ecin me thjeshtësi dhe kur të padituri i sulmojnë me fjalë, ata i përgjigjen: paqe**"[161].

Parë gjithnjë në këtë optikë, besimtari në çdo moment të jetës së tij promovon dhe demostron paqe, siguri e drejtësi. Ai pavarësisht se ka të drejtë apo jo, përdor një gjuhë të butë duke iu përmbajtur të vërtetës. Nga ai pritet ta konsiderojë veten shumë larg sharjes, ofendimit dhe përfitimit të padrejtë. Në një hadith të transmetuar nga ibn Mesudi Profeti (a.s.) ka thënë:

"*Jini të drejtë sepse drejtësia ju shpie në mirësi. Ndërsa kjo e fundit, ju shpie në xhennet. Nëse njeriu bëhet i drejtë dhe gjithmonë bën punë të drejta, te Allahu shkruhet si besnik. Largohuni nga gënjeshtra sepse ajo e shpien njeriun në mëkat. Ndërsa ky i fundit e shpie në xhehennem. Nëse njeriu gënjen vazhdimisht dhe punon duke gënjyer, te Allahu shkruhet si gënjeshtar*"[162].

161. Furkan, 25:63
162. Buhari

Prandaj në rradhë të parë të kërkojmë më të mirën në moralin tonë dhe pastaj të kontribuojmë në mënyra të ndryshme edhe në rregullimin e brezave të rinj e të shoqërisë në të cilën jetojmë. Sepse nëse duam rend, siguri, qetësi dhe drejtësi, zgjidhja është në parimet universale që e përsosin njeriun dhe e shpien drejt tyre.

FATIME ZEHRA, MODEL I VAJZËS, GRUAS DHE NËNËS MYSLIMANE

Fatimja, Zoti qoftë i kënaqur prej saj, erdhi në jetë nga dy prindër të mrekullueshëm, Profeti Muhamed (a.s.) dhe gruaja e tij Hz. Hatixhe (r.anha). Rritja dhe prania e Fatimes pranë babait profet dhe zonjës së madhe Hatixhe, bënë që vajza e tyre të arrijë një shkallë të lartë në besim, dituri dhe përkushtim. Prindërit e saj punuan shumë për edukimin e Fatimes që ta stolisnin atë me virtyte të bukura. Ajo u edukua me cilësi të larta profetike të babait të saj, ku dalluan dashuria, respekti, humanizmi dhe bindja e thellë te Krijuesi i gjithësisë. Ndërkohë që nëna përpiqej të ndriçonte mendjen e saj me dituri dhe hijeshi në sjellje, babai i saj i mësonte citime kuranore që kishin të bënin me besimin te Zoti, me sjelljen dhe ligjet e zhvillimit të shoqërisë. Me kalimin e kohës, te Fatimja filluan të shfaqeshin frytet e para të sinqeritetit, durimit, çiltërsisë, optimizmit, frymëzimit dhe gëzimit që u dhuronte njerëzve.

Fatimja ishte një vajzë e zgjuar, e këndshme dhe gazmore. Bota e saj e pasur me emocione, e bënte atë shumë të ndjeshme përballë ngjarjeve të hidhura, sidomos kur këto ngjarje kishin të bënin me babin e saj. Ajo tmerrohej kur dëgjonte lajme që do të vrisnin profetin apo kur merrte vesh për njerëz të pafajshëm që ishin marrë peng, torturoheshin apo vriteshin për shkak se kishin pranuar fenë islame. Gjatë fazave të jetës,

ajo u përball me frikën, tiraninë, humbjet, varfërinë dhe dhimbjet që Zoti i Lartësuar kishte përcaktuar në kaderin e saj. Me këto përjetime e vuajtje, te shpirti i saj u zgjua forca e vetëmohimit, sakrificës, ndershmërisë dhe e rezistencës në përballimin e vështirësive të ndryshme. Fatimja asnjëherë nuk u ankua për vuajtjet e mundimet që përjetonte, por përpiqej të ishte e gëzuar dhe të jepte shpresë. Ajo e shihte se si mbrojtësit e familjes së profetit kishin dhënë prova të guximit dhe sakrificës së tyre për dashurinë dhe mirësinë ndaj profetit të Zotit, Muhamedin (a.s.)

Me gjithë sprovat e ndryshme, Profeti ynë i nderuar e qetësonte gjithmonë Fatimen dhe e bënte të qeshte e të gëzohej. Kjo u vu re madje edhe në momentet e fundit të jetës së profetit tonë, kur ai i tha diçka asaj dhe ajo në fillim qau, por kur pastaj i tha diçka tjetër, ajo u gëzua dhe qeshi. Ajo qau në fillim kur mori vesh nga profeti që do të ikë nga kjo botë, dhe u gëzua kur ai i tha se do të ishte ajo e para që do ta takonte në botën tjetër. Profeti (a.s.) për të ka thënë:

"*Fatimja është pjesë e imja. Kush zemëron atë, më ka zemëruar mua*"[163].

Profeti ynë i nderuar e martoi vajzën me mashkullin e parë që pranoi islamin, nipin e tij hz. Aliun (r.a.). Kështu që Fatimja ishte më se e kënaqur dhe e gëzuar, sepse rrethohej nga meshkujt më të mirë të botës, me babin e saj të përkryer profetin Muhamed (a.s.) dhe burrin e saj të lartësuar në virtyte, hz. Aliun, Zoti qoftë i kënaqur prej tij.

Si grua dhe bashkëshorte, Fatimja mbajti barrën dhe përgjegjësinë e ndërtimit të një jete të qetë e të lumtur. Allahu i Madhërishëm ia shpërbleu duke i dhuruar dy djem të përkushtuar dhe të devotshëm, Hasanin dhe Hysejnin, si dhe dy vajza të mrekullueshme Zejnebin dhe Ummu Kulthum, të cilët patën fatin të edukoheshin edhe nën prehrin e ngrohtë të gjyshit të tyre, Profetit Muhamed (a.s.). Fatime Zehra i dhuroi familjes së vet dashuri, butësi, mirësi dhe harmoni. Ajo ishte një nënë e dashur, e dhembshur dhe fisnike, e cila i rriti me një bujari shpirtërore

163. Buhari

fëmijët e saj, duke dhënë një përkujdesje totale për një edukim të mirëfilltë të tyre. Familja e saj edhe pse ishte e thjeshtë dhe e varfër, aty gjendej, besimi, dashuria, morali i lartë, respekti, dhembshuria, solidariteti dhe humanizmi. Me qëndrimin, sjelljen dhe peshën e fjalës, në çdo rast, Fatimja përcolli respektin tek të gjithë ata që e rrethonin. Fatime Zehra (Zoti qoftë i kënaqur prej saj) është modeli i plotë i femrës myslimane. Nga sjellja e saj duhet të frymëzohen sidomos gratë, sepse rreth saj ishin të kristalizuara të gjitha llojet e sakrificës, mirësisë, adhurimit, durimit dhe spiritualitetit të lartë.

NJË FAMILJE E NDËRTUAR SI MODEL MBI VLERAT ISLAME

E dimë shumë mirë që zhvillimi i njerëzimit është projektuar dhe ndodh vetëm mbi strukturën familjare, sepse ky është një nga ligjet e Zotit. Prandaj këtu bëhet fjalë për modelin e ndërtimit dhe funksionimit të familjes dhe jo për konceptin e saj. Thuajse të gjithë sociologët, pavarësisht rrymave të mendimit filozofik, janë të unifikuar në domosdoshmërinë e njësisë familjare. Kjo është sanksionuar me konsensus ndërkombëtar si në Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, ashtu edhe në Kodet e Familjes që aplikohen në sistemet juridike të të gjithë shteteve në botë. Debati ideor zhvillohet në prizmin e ndërtimit, funksionimit dhe eficencës së modeleve alternative, që ofrojnë zhvillimet shoqërore në kohë të ndryshme.

Familja është një institucion hyjnor, origjina e së cilës të çon deri në krijimin e çiftit të parë njerëzor, që shumoi shoqërinë njerëzore. Në Kuran thuhet:

"**O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra**"[164]. Dhe në një vend tjetër thuhet: "**Dhe**

164. Nisa, 4:1

një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë"[165].

Ashtu siç Krijuesi caktoi Ademin dhe Nuhun si zanafillës të individualitetit njerëzor dhe besimit të kulluar, po ashtu Allahu i Gjithëditur përzgjodhi mes njerëzisë familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit, si përfaqësueset më të mira të modelit të familjes. Ato janë familje tërësisht besimtare, që shërbejnë me përkushtim për fenë e Zotit dhe që janë përkujdesur e kanë lënë pasardhës të kapur fort pas besimit të pastër. Ismaili, Is'haku, Jakubi, Jusufi dhe Isai, qenë disa nga Lajmëtarët e dalluar, pasardhës të këtyre dy familjeve të nderuara[166]. Përmes ajeteve kuranore, që përshkruajnë copëza domethënëse nga jeta e këtyre dy familjeve, Allahu na orienton në rrugën më të mirë të modelimit hap pas hapi të një familje të shëndetshme.

Sipas Islamit familja qëndron mbi bazën e lidhjeve të forta të partnerëve bashkëshortorë për të rritur dhe edukuar fëmijë me moral të pastër e të orientuar drejt në jetë. Megjithatë, sot, në sajë të lirisë dhe të drejtave të njeriut, jeta e tyre po ndryshon dhe po priret gjithmonë drejt jetës së lirë private, duke u shkëputur nga edukata familjare dhe pastërtia e saj morale. Në sajë të kësaj lirie edhe bashkëshortët, burrë e grua, po priren për të bërë jetë të pavarur, duke u dhënë pas pasioneve të shfrenuara, gjë që ka çuar e po çon gjithnjë e më shumë drejt shkatërrimit të familjes.

Jeta e njeriut, si individ apo edhe në familje e shoqëri, duke anuar gjithmonë nga ana materiale dhe sigurimi i tyre në rrugë nga më të ndryshmet, të drejta e të padrejta, ka lënë pas dore vlerat morale. Civilizimi modern që duam të jetojmë ka sjellë me vete edhe mjaft probleme sociale që nga mbrojtja e fëmijëve, e jetimëve, tradhtia

165. Rum, 30:21

166. Al'Imran, 3:33-34

164. Nisa, 4:1

bashkëshortore dhe shpërbërja e familjes, dhuna ndaj femrës, trafikimi, prostitucioni, droga, etj., e deri te mbrojtja e kujdesi për të moshuarit. Këto janë dilema që vërehen sot në Shqipërinë tonë dhe Islami mund të bëhet faktor i rëndësishëm për qartësimin e tyre, sepse ofron besnikëri ndaj marrëdhënieve ndërnjerëzore, ndershmëri, mirësjellje dhe sinqeritet, jo vetëm në familje ndërmjet pjesëtarëve të saj, por edhe midis anëtarëve të shoqërisë, pa dallim gjinor, duke respektuar të drejtat e secilës gjini. Morali që kultivohet sot në shoqërinë tonë është shkëputur plotësisht nga cilësitë fetare, duke humbur karakteristikat e vlerave shpirtërore si humanizmi, dashuria, vëllazëria, bamirësia, etj.

Sociologu Will Durant shkruan: "Jeta në qytetet e civilizuara nuk lejon njeriun as të mendojë për martesën, ndërkohë që pasionet seksuale rriten, ndërsa konditat e bëjnë kënaqësinë tepër të afërt… Kështu pastërtia që dikur është konsideruar virtyt, është bërë objekt i përbuzjeve dhe poshtërimeve. Në një atmosferë të tillë tretet edhe turpi, i cili dikur i ka stolisur të gjitha bukuritë e njeriut, ndërsa njerëzit krenohen me mëkatet e tyre, nën mbulesën e barazisë me mashkullin, femrat hyjnë në lidhje të pakufishme jashtëmartesore, ndërsa marrëdhëniet e ndaluara paramartesore bëhen diçka e zakonshme"[167].

Besimi në Zotin është themeli i jetës së njeriut dhe pikërisht ky besim do të bëhet faktor shumë i rëndësishëm për t'i larguar njerëzit nga jeta e shthurur, do të përmirësojë moralin shoqëror dhe do ta ruajë atë të pastër. Sado që feja me ligj është e ndarë nga shteti, ajo është integrale në shoqëri, luan rolin e saj në jetën e përditshme, e shoqëron njeriun në lindje e në vdekje, në gëzime e hidhërime. Kjo nuk duhet të përdoret thjesht si garniturë e jashtme vetëm për ceremonitë e ndryshme, por duhet të bëhet pjesë aktive në jetën e përditshme të njeriut.

Feja islame shumë shpesh fokusohet te rëndësia e familjes dhe e konsideron atë si kala mbrojtëse përballë jetës së shthurur, sepse është vendi ku natyra njerëzore mund ta shprehë veten në mënyrën më të

169. Ra'd, 13:38

mirë, mund t'i realizojë dhe kthejë në praktikë vlerat e larta si: dashuria, respekti, dhembshuria, sakrifica, besnikëria dhe bindja. Sistemi i familjes islame i vendos të drejtat e burrit, gruas, fëmijëve dhe të të afërmve në një ekuilibër të përsosur dhe këto marëdhënie nga aspekti juridik dhe moral janë të shpjeguara deri në detajet më të imëta.

Rreth një e treta e normave juridike që përfshihen në Kuran i referohen familjes dhe përcaktojnë rregullat e funksionimit të saj. Struktura familjare në fenë islame është e ndërtuar mbi baza të shëndosha, me qëllim të suksesit dhe vazhdimësisë së saj. Këto baza janë:

E para. Besimi. Me anën e besimit dhe legjislacionit Islam, secili nga bashkëshortët i di të drejtat dhe obligimet e veta dhe ka para vetes një program të qartë për zgjidhjen e problemeve të tyre. Burri dhe gruaja plotësojnë njëri-tjetrin dhe respektimi i përbashkët i vlerave të martesës dhe besnikëria në mes bashkëshortëve janë elementet kryesore që e fuqizojnë paqen dhe harmoninë në jetën bashkëshortore. Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë:

"*Vërtet besimin më të plotë e ka ai besimtar që ka moralin më të lartë dhe sillet mirë me familjen e tij*"[168].

E dyta. Martesa me pëlqim të dyanshëm, sepse vetëm një martesë e tillë do të jetë e sukseshme. Islami e ndaloi imoralitetin dhe ndërrmori masa të ashpra për ndalimin e tij, sepse imoraliteti është sulm i hapur ndaj sistemit të familjes dhe shenjtërisë së saj. Kështu, Islami hapi dyert për formimin e familjeve duke iu përgjigjur natyrës së njeriut me të cilën Allahu i krijoi njerëzit. Kurani shpjegon se martesa ishte traditë e pejgambereve në ajetin vijues:

"**Vërtetë, edhe para teje Ne kemi sjellë të dërguar, të cilëve u kemi dhënë gra dhe pasardhës**"[169].

168. Tirmidhi

167. Will Durant, "Mrekullitë e Filozofisë"

E treta. Përgjegjësia e përbashkët. Martesa obligon përgjegjësi të caktuara, të cilat i përkufizon legjislacioni Islam. Këtu përfshihen të drejtat e burrit, të drejtat e gruas dhe përgjegjësitë që kanë për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve. Hulumtimet e shumta shkencore vërtetojnë se shumica e atyre që kanë devijuar dhe janë zhytur në rrugën e kriminalitetit, janë ata që nuk kanë pasur rastin të shijojnë ngrohtësinë familjare, si dhe nuk kanë pasur rast të edukohen me vlerat dhe ndjenjat e jetës së familjes së shëndoshë. Feja islame ka për qëllim të krijojë familje të shëndosha në shoqëri. Këto familje të shëndosha nuk mund të shkatërrohen lehtë dhe nuk bien lehtë nën ndikimin e streseve shoqërore dhe morale. Familjet e ngritura mbi vlera të larta si besimi, besnikëria, dashuria e sinqertë, bindja e vetëdijshme dhe morali i bukur, janë garancia më e madhe e shoqërisë.

Sigurisht, një fole familjare pa synim, e ngritur mbi dëshira, pasione, qejfe, zili apo smira, jo vetëm që nuk do të premtojë të ardhme, por do të mbetet në trup të popullit si një element potencial negativ. Po qe se femra dhe mashkulli nuk kanë lidhje me Zotin, nuk ka mundësi që fëmijët që do të vijnë prej tyre të jenë të vetëdijshëm, të ndjeshëm, të ekuilibruar e të bartin ndjenjën e përgjegjësisë.

Allahu i Lartësuar, nëpërmjet Kuranit, na përkujton lutjet e Zekerijes dhe Ibrahimit, për të na mësuar se prindërit, që në krye të herës dhe vazhdimisht, duhet t'i luten me sinqeritet Zotit për fëmijët. Lutjet duhet të jenë si për zhvillimin shpirtëror individual e familjar, ashtu edhe për përparimin material e civilizues. Lutjen dhe përgjërimin me ndjenjat më të sinqerta të profetit Zekerija drejtuar Allahut, Kurani e përshkruan kështu:

"**Aty Zekerija iu lut Zotit të vet e tha: Zoti im, dhuromë nga ana Jote një pasardhës të mirë! Pa dyshim, Ti je dëgjues i lutjes!"**[170]

Po ta vëmë re me kujdes, profeti Zekerija nuk kërkoi vetëm një pasardhës çfarëdo, por "të mirë"! Ai donte të thoshte: Më fal një

170. Al'Imran, 3:38

pasardhës të mirë që ta bëjë Allahun të kënaqur, të atin të lumtur e që të bëhet një njeri i dobishëm për shoqërinë! Edhe Hz. Ibrahimi me të birin, Hz. Ismailin, kur po ndërtonin Qaben, i luteshin Zotit kështu:

"**Zoti ynë! Na bëj të dyve (babë e bir) të bindur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të bindur ndaj Teje! Na trego ritet e adhurimit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimeve, Mëshirëploti!**"[171]

Të njëjtën esencë imani përmbante edhe lutja e gruas së nderuar të Imranit për foshnjën ende të palindur (Merjemen):

"**Zoti im! Këtë që është në barkun tim, vendosa ta kushtoj vetëm për shërbimin Tënd. Pra, pranoje këtë prej meje!**"[172]

Si këta, edhe në tekste të tjera të shenjta mund të vërehet se kërkohen breza të pastër si fryte të krijimit të familjes. Pra, në të gjitha këto lutje është tërhequr vëmendja mbi breza të pastër, të pafajshëm, të pamëkatë, besimtarë e të bindur.

Roli i familjes mbetet i paplotësuar, nëse nuk realizon rritjen e fëmijëve të vet, me edukatë të islame, si dhe me arsim e kulturë të përgjithshme. Prindërit duhet të synojnë rritjen dhe formimin e personalitetit të shëndoshë të fëmijës, si nga ana fizike ashtu edhe nga ana mendore e shpirtërore, për ta bërë atë të aftë si besimtar, qytetar, por dhe për mbrojtjen e vendit të tij. Zoti (xh.sh.) në Kuran urdhëron e thotë:

"**O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri...**"[173]

Ky ajet i Kuranit përmbledh një dispozitë me rëndësi edukative, me normat morale të fesë islame, për fëmijën që në moshë të njomë. Në arsimimin dhe edukimin e fëmijës, familja është vatra më e parë, shkolla më e parë, mjedisi më i parë. Pa diskutim, kohën që veçojnë prindërit

171. Bekara, 2:128
172. Al'Imran, 3:35
173. Tahrim, 66:6

për mësimin dhe edukimin e fëmijëve, duhet ta parapëlqejnë ndaj kohës që veçojnë për disa detyra personale, individuale. Në rritjen e fëmijëve, mësimi mbi Allahun, shtresimi në zemrat i idesë së besimit mbi Allahun sipas moshës dhe nivelit kulturor të fëmijëve, kanë prioritet jo vetëm në begatimin moralo-shpirtëror të prindërve, por edhe në shumë detyra vetjake të tyre.

Ndikim më të madh kanë shembulli dhe qëndrimi i prindërve në marrëdhënie me fëmijët se sa efekti i fjalës edukuese. Çdo nënë e baba mysliman, në mënyrë mjaft të natyrshme, mendojnë t'i edukojnë fëmijët në formën e përkryer të asaj shoqërie ideale, të cilën përpiqemi ta përfytyrojmë dhe përvijojmë sipas Kuranit. Mirëpo, nëse këto ndjenja të tyre nuk reflektohen në jetën praktike dhe nuk thellohen me adhurime të tilla si namazi, agjërimi, haxhi, zekati, ose, në edukimin e mirë të tipareve të caktuara morale e fetare si ndershmëria, drejtësia, dashuria, vëllazëria etj., rezultati do të jetë i dobët ose i paqenë. Pa le kur prindërit bëjnë të kundërtën e atyre që thonë apo këshillojnë! Prindërit që dëshirojnë që fjalët e tyre t'u shkojnë tek fëmijët, më së pari duhet t'i jetojnë vetë thellësisht.

Po përcjell këtu një rrëfim që i atribuohet imam Adhamit, Ebu Hanifes:

Në atë kohë, na ishte një djalë që i bënte dëm mjalti dhe, me gjithë këshillat për të mos ngrënë, djali vazhdonte të hante. Ndërkaq, një ditë, e marrin djalin për dore, e çojnë te Imami dhe i thonë: "Këtij djali i bën dëm mjalti, por ai, megjithëse e këshillojmë, vazhdon të hajë!" Imam Adhami u thotë: "Merreni djalin e shkoni dhe sillmani pas 40 ditësh!" Pas dyzet ditësh e çojnë përsëri djalin te imami, i cili e merr djalin para vetes dhe e këshillon të mos hajë mjaltë. Djali ngrihet nga vendi, ia puth dorën të atit dhe i thotë: "Baba, nuk kam për të ngrënë më mjaltë!" Atëherë, të pranishmit e pyesin imamin: "O imam, pse nuk e këshillove djalin kur e prumë për herë të parë por na bëre të prisnim dyzet ditë?!" Dhe ja ç'përgjigje u jep imam Adhami:

"Atë ditë që ma prutë djalin, unë kisha ngrënë mjaltë. Po qe se do të përpiqesha ta bëjë djalin të hiqte dorë nga një gjë që e kisha bërë vetë, ka shumë mundësi që të mos dukesha i besueshëm para tij dhe fjala ime të mos zinte vend. Gjatë këtyre dyzet ditëve, unë jo vetëm që s'hëngra më mjaltë, por e hodha atë krejtësisht nga trupi. Në këtë gjendje desha ta këshilloj djalin!"

Te fëmijët nuk ka ndikim vetëm familja, por edhe faktorë të tjerë të mjedisit social e kryesisht mediat, që mund të sjellin shumë pasoja negative nëse nuk kontrollohen mirë emisionet dhe mesazhet e tyre. Po kështu në mjediset shoqërore, në rrugë e kudo, ndeshemi me fenomene të ndryshëm, si sharje, fyerje, fjalor banal, mungesë respekti e sjellje të tjera të papëlqyeshme. Për të përballuar me sukses këtë ndikim negativ, familja ka rolin dominues nëpërmjet ndërhyrjeve aktive për të bërë sqarimet e nevojshme mbi dallimin e së mirës nga e keqja dhe për të mos i lënë të bëhen viktimë e këtyre ndikimeve të këqija.

Është detyrë e prindërve që t'ua thellojnë besimin fëmijëve të tyre dhe t'i ruajnë ata nga fjalori i pahijshëm e shoqëria e keqe, që i tërheq ata drejt veseve negative, si gënjeshtra, vjedhja, dëmtimi i pronës së tjetrit, etj. Të ushqyerit e besimit islam te fëmijët bëhet kryesisht me shembullin e prindit. Një familje me edukatë islame është e preokupuar që fëmija të asimilojë çdo veprim në shërbim të besimit islam. Formimit të koncepteve morale elementare, si dhe të adhurimit të fesë islame, duhet t'u jepen rëndësi që në moshën kur fëmija përgatitet për të shkuar në shkollën fillore, që më vonë ai të bëhet i vetëdijshëm për veprimet që kryen.

Pavarësisht se ka shumë punë për të bërë, është një e vëretë që në shoqërinë e lirë të sotme, nëpërmjet të moshuarve, por edhe nëpërmjet studimeve, ka depërtuar në familjet e tyre besimi islam, duke luajtur një rol të madh për edukimin e brezit të ri. Ky depërtim i ndjenjave dhe mësimeve fetare ka zënë vend edhe te shumë të rinj, që ka ndryshuar shumë mentalitetin e tyre në drejtim të realitetit islam në vendin tonë.

Edhe ne tashmë si brez i mesëm, duke dhënë orientimet e duhura, shpresojmë që këta të rinj, me krijimin e familjeve të reja, do të japin një kontribut të çmueshëm në forcimin e besimit islam në vendin tonë.

DUKE SHOQËRUAR UDHËTARIN NË PËRJETËSI

Një nga misteret më të mëdha dhe më të thella për njeriun është stacioni i parë në vendbanimin e përjetshëm. Gjithsekush përgatitjen për atje e bën në bazë të besimit që ndjen dhe që aplikon në jetën e përditshme plot sprova. Kultura shpirtërore më me rëndësi e njerëzimit fillon me zgjidhjen e misterit nën dhè. Po qe se idetë, përpjekjet, kërkimet, thellësitë ndjesore dhe ndijimet e brendshme, nuk mblidhen rreth të vërtetës së vdekjes, e vërteta e këtij vendi misterioz e quajtur "varr", nuk mund të bëhet e qartë. Me të vërtetë, në jetë janë dy këshilluesit më të rëndësishëm për njeriun. Njëri nga këta flet, tjetri hesht. Këshilluesi që flet është Kurani, ndërsa ai që këshillon me heshtjen e tij të thellë, është vdekja.

Vdekja është një moment vendimtar për njeriun, sepse ai në atë moment sheh rezultatin e tij, sikurse sheh edhe atë që e pret në të ardhmen e tij. Njeriut përmes vdekjes i hapet një derë që më kurrë nuk i mbyllet. Vdekja është ajo nga e cila askush nuk shpëton dhe çdo krijesë dorëzohet. Shumë njerëz dëshirojnë të shmangen prej saj, por ajo në të vërtetë nuk shmanget prej nesh dhe vjen në kohën e caktuar.

Profeti (a.s.) ka paralajmëruar se do të vijë një kohë që umeti do të ketë një sëmundje. I thanë shokët e tij: Cila është ajo sëmundje o i dërguari i Zotit? Tha:

"*Dashuria për dynjanë dhe urrejtja ndaj vdekjes*"[174].

174. Ebu Daud; Ahmed

Kjo do të thotë që njeriu i sotëm po ndërton këtë botë dhe të gjithë përpjekjet e tij po i drejton në këtë kahje. Ndërkohë botën e ahiretit e harron, ndoshta me mendimin që një ditë do ta ndërtojë edhe atë, por vitet kalojnë dhe koha merr tatëpjetën. Më pas vjen një kohë kur njeriu me harxhimet dhe mundin ka ndërtuar pothuajse gjithçka këtu dhe i vjen shumë keq ta braktisë e të shkëputet prej saj.

Megjithëse njeriu e kujton shumë larg vdekjen e tij, ajo është e pranishme gjithmonë në pritje të urdhrit në zbatim. Nuk dihet që vdekja të ketë gjuhë, por ç'kuptime madhështore ka groposur ajo në një heshtje të thellë! Varret janë plot me adresat e prindërve, fëmijëve, të dashurve, kushërinjve, të afërmve dhe miqve, që e kanë konsumuar jetën e përkohshme! Sa foshnja ajo i përqafoi ende pa e njohur këtë botë, sa fëmijë ajo i zuri në lojë e sipër e sa të rritur ajo i mori duke qenë të hutuar! Sa e sa njerëz i gdhiu mëngjesi, por nuk i zuri mbrëmja, dhe sa njerëz i ngrysi nata, por nuk i zuri mëngjesi! Duke reflektuar për këtë fenomen na vijnë ndërmend objektivat e ndryshëm afatgjatë dhe afatshkurtër të njeriut, i cili me këmbëngulje punon dhe përpiqet në realizimin e tyre gjithmonë për një jetë më të mirë, më komode dhe më të rehatshme. Duke filluar nga pranimi në një universitet të mirë, mbarimi i tij me sukses me mendimin për master, gjetja e një pune të mirë, martesa me një bashkëshorte të denjë për të, krijimi i familjes duke vazhduar me arsimin e edukimin e fëmijëve në vite, që janë ndër synimet kryesore të njeriut.

Njeriu në jetën e tij herë pas here hyn në një proces ndryshimi. Është tepër e rëndësishme që drejtimi i këtij ndryshimi të kthehet kah e mira, e dobishmja dhe e drejta. Allahu i Madhëruar i ka siguruar të gjitha kushtet për jetesë dhe i ka dhuruar njeriut të gjitha mirësitë, pavarësisht se kjo botë ku ne jetojmë është kalimtare dhe vitet e jetës sonë këtu janë të kufizuara. Të gjitha këto, Allahu i bën që të fitojë dashurinë e krijesave dhe që të njihet prej tyre.

Mëshira e Allahut është e pafund dhe mëshira që paraqet Ai në këtë botë është vetëm një pjesë e vogël e mëshirës së Tij. Prandaj, asnjë të mos dyshojë në mëshirën e Allahut, sepse është Ai që do t'i shpërngulë krijesat në një botë të përjetshme, në një "atdhe" ku do t'i kënaqë me

flladet e mëshirës së përjetshme, në Xhenetin e përjetshëm, në të cilin gjenden mirësi që as syri nuk i ka parë, as veshi nuk i ka dëgjuar dhe as mendja nuk i ka menduar. I madhëruari Zot atje ka përgatitur kopshte plot me fruta, me lule e gjelbërim... Bukuritë e kësaj bote janë vetëm shembuj të thjeshtë që shërbejnë për t'i tërhequr vëmendjen njerëzve.

Në këtë gjithësi përparësi ka jeta dhe cilësia kryesore e jetës është shpirti. Më i lartësuari prej krijesave që kanë shpirt është njeriu. I gjithë universi është i gjallë dhe punon për njeriun, kurse gjallesat e tjera janë dërguar që ta ndihmojnë dhe t'i shërbejnë atij.

Njeriu në veten e tij që nga lindja përmban dashuri ndaj Krijuesit, por edhe Krijuesi e do dhe ka krijuar të gjitha këto mirësi që të fitojë dashurinë e tij. Qëllimi i aftësive dhe i cilësive shpirtërore të njeriut është jeta e përjetshme. Zemra e njeriut e do jetën e përjetshme me gjithë fuqinë e saj dhe gjuha e tij i lutet Krijuesit për jetën e përjetshme. Pra, Allahu Fuqiplotë nuk do t'i mbysë përjetësisht njerëzit që i ka krijuar për t'i shërbyer Atij. Ai nuk do që ata të hidhërohen duke menduar se kanë vetëm jetën e kësaj bote, sepse jeta këtu është vetëm një preokupim dhe shqetësim. Allahu i Madhëruar i mundëson njeriut jetën e kësaj bote në mënyrë që të fitojë provimin e ditës së fundit dhe të përjetojë lumturinë përrallore në Xhenet.

O Fuqiplotë i Përjetshëm! Të gjithë qeniet që kanë shpirt janë nën sundimin Tënd dhe në qoftë se përulen dhe të binden Ty, e bëjnë vetëm me anë të fuqisë, drejtimit, vullnetit, mëshirës dhe dijes Tënde. Ata kryejnë detyrat e tyre duke iu bindur urdhrave të Tu. Çdo gjë me ndihmën e mëshirës Tënde është vënë në shërbim të njeriut. Njeriu është krijuar i dobët e i varfër dhe në këtë univers janë të paktë ata të cilët me gjuhën e gjendjes të falënderojnë dhe dëshmojnë se je larg çdo të mete. Çdo krijesë dëshmon Krijuesin dhe Adhuruesin e saj, dëshmon se Allahu (xh.sh.) nuk ka ortak dhe e falënderon për mirësitë e dhëna...

FITIMI I RINISË SË PËRJETSHME

Rinia është mosha ku njeriu ndihet më i shëndetshëm dhe më i guximshëm. Në këtë moshë, ai është i gatshëm për të përballuar gjithçka, duke mos e menduar asnjëherë plakjen dhe vdekjen. Por, ashtu si vera që ia lë vendin vjeshtës e dimrit, si dita, mbrëmjes e natës, sigurisht edhe rinia do ia lërë vendin pleqërisë e vdekjes. Ky është ligji i Zotit dhe askush nuk mund ta ndryshojë atë. Por, ç'duhet të bëjmë për të fituar rininë e përjetshme?!

Është e vërtetë se të rinjtë ndjekin më shumë ndjenjat sesa mendjen. Çdo i ri e vërteton me përvojën e tij se kënaqësitë dhe dëshirat rinore, jashtë rrethit të së lejuarës, në fund shkaktojnë dhimbje, vuajtje dhe strese të shumta. Nëse i riu lihet i lirë të zgjedhë, a është e nevojshme të thuhet se çfarë do të zgjedhë e çfarë do të lërë? Gjer në çastin kur t'i shkohet në ndihmë me anë të edukimit, i riu është satelit i dëshirave dhe i kënaqësive boshe të mjedisit ku është rritur, një "i marrë" që rrotullohet shumë larg logjikës. Ndërkohë që ne, jemi të detyruar t'i përgatisim ata si besimtarë, miq të virtytit dhe kundërshtarë të imoralitetit.

Të gjithë ne jemi predikues të Islamit, e në veçanti rinia besimtare. Ajo duhet të mbartë mesazhin e Islamit kudo në popull, duke e praktikuar në radhë të parë ata vetë, me vepra dhe me një komunikim të mirë me njerëzit.

Sot, prej të rinjve kërkohet që të braktisin ashpërsinë e vrazhdësinë në predikim dhe të ndjekin urtësinë dhe këshillën e bukur. Prej tyre kërkohet gjithashtu që të përkrahin butësisë, sepse aty ku mbretëron butësia, ka paqe e harmoni, ndërkaq, sa herë që vendin e saj e ka zënë ashpërsia, kanë lindur problemet. Për këtë qëllim Allahu i Madhëruar i drejtohet Profetit të Tij në suren Al'Imran:

"**Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai**"[175].

Myslimanët në shekujt e parë e përhapën Islamin me veprat dhe moralin e tyre. Puna, sjellja dhe morali janë ato të cilat e përhapën dritën e Islamit në botë. Ndër të parët, mbi të cilët bie ky obligim, është rinia, shpresa e çdo kombi, shtylla dhe e ardhmja e tij. Sot, njerëzit kanë nevojë për një platformë të re, e cila do t'u forcojë besimin, por nuk do t'ua rrëmbejë shkencën; do t'u dhurojë ahiretin, por nuk do t'ua ç'rrënjosë dynjanë; do t'u paraqesë thelbin e adhurimit, por nuk do t'i privojë nga të mirat e kësaj jete. Ata kanë nevojë për një platformë të balancuar, të cilën e posedon feja jonë, prandaj duhet të kemi konsideratë ndaj saj dhe ta njohim vlerën e vetes sonë, kurse i pari që është i thirrur ta bëjë këtë, është i riu.

Çdo komb që i ka dhënë vlerë brezit të ri është lartësuar, ndërsa ata që kanë neglizhuar edukimin e tij, e kanë vuajtur shumë rëndë pasojën e këtij nënvleftësimi. Nëse shoqëria e sotme lëngon nga fenomenet negative, kjo është pasojë e nënvleftësimit të edukimit të rinisë. Prandaj lartësimi ose rënia poshtë e një kombi varet nga shpirti dhe vetëdija me të cilat ushqehet gjenerata e re, nga arsimi dhe edukata që do të marrë. Për një bashkësi, të rinjtë i përngjajnë gjakut që i jep jetë trupit. Për këtë qëllim, ata

175. Al'Imran, 3:159

duhet të nxiten që ta përgatisin veten seriozisht, ta zgjerojnë horizontin e tyre me dije të dobishme, shpirtin me adhurim, trupin me ushtrime fzike, moralin me virtyte të larta; pra të bëhen pjesë e shoqërisë, në mënyrë që t'i shërbejnë dhe të jenë pjesë vitale e saj.

Prandaj, nëse i riu kërkon të arrijë gëzimin dhe kënaqësinë e jetës, le t'i japë kuptim jetës së vet përmes besimit, ta zbukurojë atë me kryerjen e detyrave fetare dhe ta mbrojë duke iu larguar gjynaheve. Nëse ai do e ndërtojë jetën e tij duke u bazuar në ndershmëri, dëlirësi, drejtësi e bindje, duke vepruar sipas udhëzimeve të Islamit dhe duke i shprehur mirënjohjen Zotit, atëherë ajo do të bëhet shkak për të ftuar rininë e përjetshme në parajsën e amshuar.

ETIKA ISLAME NË MBROJTJE TË JETËS DHE DINJITETIT NJERËZOR

Njeriu është një qenie shoqërore dhe e detyruar të jetojë në shoqëri. Për rrjedhojë, nuk mund të sillet si të dojë. Ai është i detyruar të sillet sipas disa rregullave dhe normave të caktuara. Etika, si tërësia e rregullave dhe e normave që përcaktojnë sjelljen e njeriut në shoqëri, është pjesë përbërëse e moralit. Shoqëria është shumë e interesuar për zbatimin e rregullave dhe normave të etikës për të mirën e saj. Një vend të rëndësishëm në moralin e shoqërisë dhe në mbarëvajtjen e saj ka edhe feja. Ndihmesa e fesë në përmirësimin e moralit të shoqërisë, është jo vetëm shumë e madhe, por edhe vendimtare. Feja me pak fjalë, mund të përcaktohet si shuma e rregullave dhe e parimeve të cilat janë dërguar nga Zoti për ta udhëhequr njerëzimin drejt lumturisë në këtë botë dhe në botën tjetër.

Etika publike është e themeluar në bazë të mbrojtjes së pasurisë dhe pasardhësve. Kjo etikë nënkupton mbrojtjen e shëndetit, mendjes dhe shpirtit nëpërmjet vendosjes së disa rregullave, që garantojnë sjelljen e mirë në shoqëri. Ndëshkimet, të cilat kanë për qëllim nxitjen e punëve të mira dhe parandalimin e punëve të këqija, përbëjnë mbrojtjen me mënyra të tilla që të mbajnë larg realitetit të shoqërisë dhe individit elementët negativë. Pesë janë qëllimet kryesore të legjislacionit të fesë islame: Ruajtja e besimit, e jetës, e pasurisë, e pasardhësve dhe e mendjes. Është për t'u theksuar se në të gjitha fetë, këto

elemente bazë konsiderohen si të drejta themelore të cilat duhen të mbrohen. Është fakt i qartë se njeriu është krijesa më e vlerësuar. Në Kuran thuhet:

"(**bijtë e Ademit)… dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar**"[176] dhe në një tjetër ajet: "**Ne e kemi krijuar njeriun në trajtën më të përkryer**"[177].

Elementi i cili i bën njerëzit që të kenë një rëndësi dhe vlerë të tillë, është struktura shpirtërore dhe ajo fizike. Me vëmendjen në konstruktin fizik, ne bashkohemi në shumë karakteristika me krijesat e tjera. Ashtu si organizmat e tjerë, edhe trupi ynë është i përbërë nga qeliza, gjene dhe inde. Por ajo që na bën të veçantë është aftësia jonë e të menduarit, të besuarit dhe e përfitimit të dijeve si dhe fakti që ne jemi të vetëdijshëm për këto aftësi.

Prandaj thuhet se njerëzit janë qenie të ndërgjegjshme. Ata janë krijuar me të dyja tendencat: të mirën dhe keqen dhe të aftë të zgjedhin. Atyre u janë dhënë të dyja, edhe arsyeja edhe liria për të bërë këto zgjedhje. Kështu ata duhet të dallojnë të bukurën dhe të dobishmen me mendjen e tyre dhe të zgjedhin atë me vullnetin e tyre të lirë. Fakti që ata janë krijesa të përgjegjshme për punët që kryejnë, rrjedh pikërisht nga këto cilësi.

Veprimet e arsyeshme dhe vlerat positive nuk mund të vijnë gjithmonë si rezultat i vetëdijes personale. Ato duhet të bëhen gjithashtu vlera morale dhe shpirtërore. Morali përmban një sërë parimesh të larta lidhur me sjelljet e njeriut, të cilat që të gjitha burojnë prej nivelit të lartë shpirtëror. Duke u mbështetur në këtë, mund të themi se personat që nuk kanë siguruar afrimitetin e duhur me shpirtin e tyre, e kanë mjaft të vështirë t'i bëjnë të vetat rregullat morale për një kohë të gjatë. Në ditët tona, morali nuk kuptohet ashtu siç e kuptonin të parët, si një tërësi virtytesh. Njeriu i ditëve të sotme kërkon ta kuptojë atë më shumë në formën e etikës dhe edukatës shoqërore. Eh, sikur ta shihnim moralin te çdo njeri, qoftë edhe në këtë formë!...

176. Isra, 17:70
177. Tin, 95:4

Besimi islam në një Zot të vetëm, e vë individin në pozitën e përgjegjësisë para Tij, për rrjedhojë, duke ia lartësuar ndërgjegjen dhe moralin në shkallën më të lartë, siguron mbrojtjen e të drejtave të individit, dashurinë dhe respektin reciprok, marrëveshjen dhe paqen shoqërore. Një mysliman edhe gjatë zbatimit të xhihadit, nuk mundet, kurrsesi, të prekë apo të cënojë nderin dhe dinjitetin njerëzor. Profeti ynë i nderuar edhe në rastet kur ka qenë i detyruar të luftojë, gjithmonë ka theksuar se myslimani duhet të ruajë kufijtë dhe rregullat që i përcakton feja. Profeti në krye dhe të gjithë kalifët e tjerë, sa herë që dërgonin ushtri ndokund, u përcaktonin mirë grupin që kishte statusin e kundërshtarit në luftë dhe u këshillonin gjithmonë:

"*Mos luftoni me një njeri të pa armatosur, mos prekni gratë dhe fëmijët. Mos prekni të moshuarit dhe mos digjni pemë*"[178].

Kush dëshiron ta përsosë moralin e tij, le të marrë shembull prej natyrës dhe sjelljeve të shkëlqyera të figurës së Muhamedit (a.s.), i cili që prej 14 shekujsh e njohu njerëzimin me cilësitë më të larta të moralit. Figura e tij ofron edhe sot rregulla dhe direktiva mbi moralin të cilat i mungojnë shumë njeriut bashkëkohor, i cili, duke ndjekur dhe duke imituar lloje të ndryshme të etikës, është zhveshur nga normat humane. Kjo do ta ndihmojë njeriun e sotëm që të kuptojë dhe të bëhet qenie humane sipas etikës së Muhamedit (a.s.) dhe vëllezërve të tij, pejgamberëve të tjerë.

Problemi më i madh me të cilën përballohet sot shoqëria moderne, nuk është ekonomik, politik apo social, por etik. Është e pamundur për një shoqëri së cilës i mungojnë shtyllat etike të qëndrojë në këmbë. Perëndimi, i cili vuan nga marramendja falë suksesit të tij material, e ka lejuar materializmin dhe superioritetin tregtar që vjen krahas tij, të mbizotërojë mbi çdo gjë tjetër. Sot po adhurohet paraja e njeriu dhe vlerat e tij janë lënë pas dore. Në Shqipëri shihet haptazi një shkujdesje ndaj jetës dhe dinjitetit njerëzor duke e kushtëzuar çdo gjë me para. Për fat të keq ky fenomen ka hyrë deri në fushën e mjekësisë, duke e ditur më

178. Buhari; Muslim

së miri se shëndeti është tepër i rëndësishëm për njeriun. Por objektivat duhet të shihen tek humanizmi, qytetaria dhe shoqëria e mirë. Dhe këto cilësi më së miri t'i jep një besim i shëndoshë. Në rrënjët e zhvillimit të shoqërisë dhe progresit qëndron ndjenja e besimit, prandaj mirëqenia sociale nuk mund të arrihet pa një ndjenjë të tillë.

Njerëzimi si dje dhe sot, në shumicën e vet ka jetuar dhe jeton në ankth dhe vuajtje. Dihet se shkaku kryesor i kësaj është dashuria e madhe për këtë botë dhe harrimi i Zotit e i botës së përtejme. Vetëm sistemi hyjnor është ai që e zhvillon dhe e përsos njeriun bashkë me të gjitha mendimet, ndjenjat dhe mundësitë shpirtërore të tij, e që e bën të arrijë virtytin dhe përjetësinë.

Islami është një sistem i plotë jete. Ai e tregon karakterin e tij hyjnor në jetë dhe e udhëheq atë përmes një drejtimi etik. Ai i ngre kornizat, kufijtë shtetërorë dhe kufizimet që qeverisin lëvizjen dhe qëllimin e jetës, duke e mbajtur gjithmonë njeriun në rrugë të drejtë dhe duke e mbrojtur atë nga kurthet dhe humbja e udhës. Për këtë qëllim, Islami përbëhet prej parimesh që pasurojnë mendjen, prej adhurimesh që pastrojnë zemrën, prej vlerash që pastrojnë shpirtin, prej ligjesh që vendosin drejtësinë dhe sjelljeve që zbukurojnë jetën.

BAMIRËSIA NDAJ JETIMIT SI TIPAR I HUMANIZMIT ISLAM

Në kulturën dhe qytetërimin e popujve, pa dyshim që feja ka luajtur rolin e saj të rëndësishëm. Gjatë gjithë rrjedhave historike, prijësit dhe intelektualët e besimeve të ndryshme, ideologë, diplomatë, shkencëtarë e shkrimtarë, janë bashkuar me zërin e kombit dhe të shqiptarit, duke u bërë zëdhënësit shpirtërorë të edukatës, ndërgjegjes dhe të sentencave hyjnore.

Besimi islam, historia dhe kultura e tij plot dritë, është pjesë organike e qytetërimit dhe mbijetesës shqiptare, duke qëndruar në harmoni të plotë me të gjitha interesat kombëtare të sotme dhe perspektive. Në këto hapësira, mjedisi intelektual shqiptar i besimit islam, kulmohet me figura të shquara si: Hoxha Tahsini dhe Sami Frashëri në rrafshin iluminist-shkencor, ndërsa me Abdyl Frashërin dhe Ismail Qemalin në diplomaci.

Po kështu fizionomia e afërt e moralit shqiptar do të kulmohet me plot figura të tjera fetare, politike e atdhetare, që jetuan në gjirin e asaj lëvizje kulturore shqiptare, ku renditet edhe Haxhi Zyber Hallulli. Personaliteti i Haxhi Zyber Hallullit u shpalos fuqishëm në aspektin fetar, por akoma më shumë në çështjen e madhe jetike për kombin shqiptar gjatë rilindjes kombëtare e më pas.

I diplomuar për teologji dhe filozofi, Zyber Hallulli iu përkushtua me pasion hapjes së shkollës shqipe dhe mësimit të besimit islam, sepse sipas tij, pa çlirim mendor e shpirtëror, nuk mund të bëhej çlirimi kombëtar. Si kryetar i parë i Bashkisë së Tiranës, krahas shumë detyrave të tjera të mëdha, atij i lindi ideja e arsimimit dhe edukimit të fëmijëve jetimë, të cilët për rrethanat historike që po kalonte populli ynë, ishin shtuar shumë.

Ngritja e "Strehës Vorfnore" kërkoi formimin e një komisioni me bamirës të njohur të qytetit të Tiranës, ku përfshiheshin fetarë, përfaqësues të parisë, tregtarë e zejtarë, që do të financonin veprimtarinë e këtij institucioni. Nga burimet historike citojmë se, më 28 nëntor 1917, me rastin e 5 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, ai së bashku me patriotët Rauf Fico, Mytesim Këlliçi, Ismail Ndroqi, Luigj Shala, Xhelal Toptani, etj., hapën për herë të parë këtë institucion, duke grumbulluar fëmijë nga e gjithë Shqipëria, pa dallim krahine e besimi fetar. Zyber Hallulli, i quajtur ndryshe "baba i jetimëve", iu përkushtua aq shumë "Strehës Vorfnore", saqë me dëshirën dhe vullnetin e tij, para se të vdiste, i dhuroi asaj të gjithë pasurinë e vet personale.

Feja Islame i ka kushtuar një vëmendje të madhe shtresës së jetimëve, ku shumë versete kuranore dhe thënie profetike, inkurajojnë që ndaj kësaj shtrese të tregohet kujdes i veçantë. Këshilluesi më i mirë, vet Zoti ynë na porosit në Kuran:

"**Prandaj, mos e shtyp jetimin**"[179] .

Krijuesi i gjithësisë, Allahu i Madhërishëm, krijesën më të përsosur të mbarë njerëzimit, profetin Muhamed – paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të – e solli në këtë botë jetim. Ai i cili u lind dhe u rrit si jetim, dha përgëzimin, sihariqin dhe premtimin më të madh për të gjithë ata që kujdesen për fëmijët jetimë, duke thënë:

"*Kush kujdeset për jetimët, do të jetë me mua në Parajsë*" dhe bashkoi dy gishtat e dorës[180].

179. Duha, 93:9
180. Buhari

Jetimi, i cili ka humbur dashurinë prindërorë, duhet të gëzojë një status tjetër mes njerëzve, duhet trajtuar me butësi e dashamirësi, larg ashpërsisë dhe abuzimit. Nisur nga kjo, kur Profetit Muhamed (a.s.) iu ankua dikush se zemra e tij është vrazhdësuar, ai u përgjigj:

"*Përkëdhele kokën e jetimit dhe furnizoje të ngratin*"[181].

Bazuar në këto argumente, por edhe të tjera të ngjashme me to, në vendet të ndryshme myslimane, janë ngritur shoqata dhe organizata, të cilat përkujdesen për shtresën e jetimëve në fusha të ndryshme. Edhe këtu në Shqipëri, fondacionet dhe shoqatat myslimane që operojnë në vendin tonë, ka bërë të mundur t'iu sigurojë mbi 15.000 jetimëve, shërbime kryesisht në ushqim, veshmbathje dhe pensione mujore. Kjo ndihmesë konsiston gjithashtu në shërbime të ndryshme ditore për fëmijët, në arsim e edukim, në qendra sociale për të rinjtë, për familjet në nevojë etj.

Dhe për të theksuar edhe njëherë tolerancën fetare, për të cilën vendi ynë krenohet në të gjithë botën, në lestimin e këtyre 15.000 jetimëve, nuk është parë dhe nuk është marrë parasysh përkatësia fetare, por nevoja që ata fëmijë kanë si bijë dhe bija të këtij populli.

Le të shërbejë ky jubile, 100 vjetori i themelimit të "Strehës së Parë Vorfnore" në Shqipëri, si një homazh për të gjithë heronjtë shqiptarë të bamirësisë dhe humanizmit, se të tillë meritojnë të quhen, të cilët në kohë të ndryshme, dhanë ndihmesën e tyre të vyer e të pakursyer për zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë dhe kombit shqiptar.

181. Ahmed

BESA PËR ITHTARËT E LIBRIT

Kur Profeti Muhamed (a.s.) ishte duke ndërruar jetë i tha të pranishmëve:

"*Unë po i lë në besën tuaj Ehli Kitabin (Ithtarët e Librit, të Krishterët dhe Hebrenjtë)*"[182].

Kjo ishte besa që kërkoi Profeti nga myslimanët dhe të cilën e mori prej tyre. Nisur nga tradita profetike në këtë drejtim, myslimanët historikisht kanë qenë të kujdesshëm në raportet e tyre me ithtarët e librit. Sigurisht, të gjithë këtë frymëzim besimtarët myslimanë e marrim fillimisht nga Kurani Famëlartë, ku Zoti i këshillon dhe i orienton se si duhet të ndërtohen marrëdhëniet me ta:

"**Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!**"[183] Në një ajet, i fton ithtarët e librit për bashkim me këto fjalë: "**Thuaj: O ithtarët e Librit, ejani të bashkohemi në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Zotin, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!**"[184].

182. Ebu Daud
183. Nahl, 16:125
184. Al'Imran, 3:64

Në dialogun që duhet të kemi me ithtarët e feve të tjera, kemi aq shumë të përbashkëta, saqë është e panevojshme t'i mëshojmë dallimeve. Kurani nuk bën kurrfarë dallimi mes profetëve, duke filluar prej Ademit (Adamit), duke vazhduar me Ibrahimin (Abrahamin) e Musain (Moisiun) dhe për të përfunduar deri tek Muhamedi (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi ta). Ndërsa për Isain (Jezusin), të birin e Merjemes (Marisë), vërtetues i Teuratit (Toras), Kurani thotë:

"**Pas atyre profetëve, Ne dërguam Isain, të birin e Merjemes, si vërtetues të Teuratit që kishte ardhur para tij. Dhe i dhamë atij ungjillin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë, si përmbushje të asaj që ishte shpallur para tij në Teurat dhe si udhërrëfim e këshillë për ata që i frikësohen Allahut**"[185].

Isai a.s. (Jezusi) është quajtur Abdullah (rob i Zotit), kurse Merjemja (Maria) është e vetmja grua e thirrur me emrin e saj në Kuran, madje citohet 34 herë. Në këtë kuptim, duhet të përkujtojmë gjithmonë vargun kuranor, i cili thotë:

"**Vërtetë, ata që besuan, por edhe hebrenjtë, të krishterët dhe sabi'inët*, që i kanë besuar Zotit dhe botës tjetër dhe kanë bërë vepra të mira, do të shpërblehen nga Zoti i tyre. Për ata nuk ka frikë, as nuk kanë përse të pikëllohen**"[186].

Ndërsa shembullin konkret, përsa i përket marrëdhënieve me ithtarët e librit, e jep vet Profeti Muhamed (a.s.), ku mund të veçojmë këto raste: Duke i quajtur hebrenjtë dhe të krishterët "Dhimijj", "të mbrojturit", d.m.th. ata që shteti islam e ka për detyrë t'i mbrojë, Profeti thotë:

"*Kush vret një besëtar (dhimijj-me të cilët kemi besë dhe është nën mbrojtjen tonë) nuk do ta ndjejë aromën e parajsës dhe aroma e saj ndjehet në një largësi prej 40 vitesh*"[187]. Në një letër që ua dërgon hebrenjve dhe të krishterëve të Nexhranit, Profeti (a.s.)

185. Maide, 5:46
* Një sekt judeo-kristian
186. Bekare, 2:62
187. Buhari

thotë: "*Nexhrani dhe fqinjësia e tij, nga Zoti dhe profeti i Tij Muhamed e kanë të mbrojtur - pasurinë e tyre, kishat e tyre dhe gjithçka që kanë në pronësi*". Një delegacion i të krishterëve të Nexhranit kishte shkuar në Medine dhe atje kishte zhvilluar diskutime të gjata me Profetin në xhami. Gjatë kohës së takimit të tyre, të krishterët kërkuan pushim për kryerjen e riteve të tyre fetare, por nuk dinin se ku mund t'i kryenin ato. Muhamedi (a.s.) e kuptoi shqetësimin e tyre dhe i ftoi të kryejnë shërbesën e tyre fetare në xhami, në njërin nga vendet më të shenjta të Islamit. Ky është një shembull i tolerancës, zemërgjerësisë dhe mirëkuptimit, i ofrimit të vendit të shenjtë për lutje, i cili në të ardhmen do të bëhet normë e sjelljes islame[188].

Këtë praktikë të Muhamedit (a.s.) do ta ndjekin më vonë edhe kalifët e parë dhe drejtuesit e tjerë myslimanë pas vdekjes së tij, të cilët në pajtim me dispozitat e legjislacionit islam dhe porosive profetike, do të japin shembuj të shumtë të tolerancës fetare në histori. Kjo, duke filluar që nga kalifi i dytë pas profetit, Hz. Omeri (r.a.) kur thotë: "Unë po i lë Ithtarët e Librit që gjendet midis nesh, në besën tuaj. Frikësojuni Zotit në lidhje me ta dhe silluni me drejtësi ndaj tyre"[189].

Edhe gjatë historikut të Shqipërisë kemi raste të shumta harmonie dhe bashkëjetese fetare. Lidhur me këtë, zonja britanike Edith Durham (fillim shek. XX), thotë: "Luftërat e dëgjuara ndërmjet shqiptarëve janë gjithmonë për grindje ndërmjet bejlerëve kundërshtarë. Të krishterët në këtë rast luftojnë kundër të krishterëve dhe muslimanët kundër muslimanëve", madje ajo thekson se "Shqiptarët muslimanë e të krishterë, para armikut të përbashkët bashkohen"[190]. Ndërsa Faik Konica e vlerëson këtë fenomen si historik të traditës dhe vlerave të shqiptarëve. Ai me të drejtë shprehet në shkrimet e tij duke thënë se: "Dihet botërisht që shqiptarët janë tolerantë ndaj besimit të tjetrit dhe se Shqipëria është i vetmi vend në Europë ku nuk janë zhvilluar kurrë luftëra fetare"[191].

188. Ibn Hisham, es-Siratun-Nebeuijje, II, 574
189. Jahja bin Adem, Kitabu'l-Haraxh, 54
190. Edith Durham, Brenga e Ballkanit, Tiranë 1991
191. Faik Konica, Shqipëria kopsht shkëmbor i Europës juglindore, Tiranë 1993

Këtë traditë shqiptare të shkëlqyer e shohim në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, në 28 nëntor të vitit 1912 në Vlorë, ku firmëtarët kryesorë e me peshë ishin klerikë të ndryshëm, madje ata ishin të shumtë. Por bashkëjetesa mes besimeve të ndryshme arriti kulmin në Kuvendin e Vlorës, kur u mor vendimi se Qeveria e Ismail Qemalit do të ketë në kabinetin e tij pjesëtarë të të katër besimeve fetare. Kuvendi i Pleqësisë, i cili drejtohej nga hoxha i nderuar Vehbi Agolli (Dibra), do ta votonte këtë Kabinet Qeveritar.

Të gjithë myslimanët shqiptarë ndjehen shumë krenarë që historikisht, por edhe sot, vazhdojnë ta mbajnë besën e Profetit Muhamed (a.s.) duke u kujdesur për këtë pasuri të vyer, trashëguar nga paraardhësit tanë, përsa i përket harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare dhe, sot e kësaj dite e konsiderojnë si një detyrë tepër madhore ruajtjen dhe forcimin e kësaj ngrehine në vazhdimësi. Përveç traditës në popull dhe mënyrës klasike siç janë predikimet e ndryshme dhe në veçanti e së premteve, kjo harmoni zhvillohet edhe nëpërmjet botimeve të librave e revistave tona zyrtare, me trajnime të ndryshme, si dhe me biseda e orientime që KMSH u jep stafit të vet në çdo rreth të Shqipërisë.

Nisur nga kjo, në vazhdën e bashkëpunimit mes komuniteteve tona fetare, duke menduar edhe zhvillimet kohore, për ta bërë më të konsoliduar këtë traditë të vyer, u themelua në vitin 2007 organizata Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë (KNFSH), me qëllim që të promovojmë vlerat dhe parimet tona ndërfetare në ndërtimin e një shoqërie më paqësore dhe më të drejtë, duke u bërë një model social, kulturor dhe profesional për popullin tonë, por dhe më gjerë. Kjo organizatë nëpërmjet programeve, projekteve dhe veprimtarive të ndryshme përpiqet të integrojë më shumë komunitetet fetare në jetën shoqërore, duke diskutuar dhe dhënë opinione për fushat e interesit, të bazuara në angazhime morale të përbashkëta në Shqipëri....

Në përfundim, jo vetëm në Shqipëri dhe jo vetëm myslimanët, por të gjithë ithtarët e besimeve dhe feve të ndryshme, e kanë si obligim sot dhe gjithmonë, që të bashkëjetojnë në paqe dhe harmoni në këtë botë, ta pranojnë njëri-tjetrin, t'ua njohin njëri-tjetrit të drejtat bazë dhe, duke qenë gjithmonë të ndërgjegjshëm se askush nuk ka pushtet të gjykojë besimet e të tjerëve.

ROLI I PRIJSAVE MYSLIMANË PËR SIGURINË DHE PAQEN

Nisur nga termi "Islam", kuptojmë që në thelbin e tij ka paqen. Kjo për faktin se njeriu i nënshtrohet vetëm Krijuesit, Zotit të Lartësuar, dhe nëpërmjet Tij besimtarët fitojnë dinjitet, qetësi, barazi e liri, duke u mbrojtur të gjithë në mënyrë të barabartë. Islami është feja e kënaqësisë, sigurisë dhe paqes. Këto principe janë aq të zakonshme në jetën e myslimanëve, saqë kur ata fillojnë faljen, shkëpusin të gjitha lidhjet me botën, përkulen dhe i bëjnë sexhde Zotit duke qëndruar në shenjë respekti. Kur ata lënë faljen, është sikur kanë filluar një jetë të re. Fillojnë të përshëndesin të tjerët në të djathtë e në të majtë dhe duke u uruar atyre shëndet, siguri e paqe, shkojnë dhe kryejnë punët e tyre.

Përshëndetja e të tjerëve dhe urimi i tyre për paqe janë konsideruar ndër aktet më të pëlqyeshme që mund të kryhen në Islam. Në të vërtetë, kur Profeti Muhamed, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, ishte pyetur, "Cili është veprimi më i pëlqyeshëm në Islam?" ai përgjigjej:

"*Dhënia e ushqimit për të tjerët dhe përshëndetja e të gjithë atyre që njihni dhe nuk njihni*"[192].

192. Buhari; Nesai

Ne si njerëz, jemi dërguar në këtë botë që me anë të dijes dhe besimit, të kuptojmë atë që është e vërtetë. Duke vënë re ndryshimin që ne kemi me krijesat e tjera dhe duke parë mundësitë që na janë dhënë, ne si njerëz na takon që me anë të rrugës së dijes dhe besimit të ndërtojmë botën e të vendosim paqen, dhe ky qëllim, na ngarkon me përgjegjësi të ndryshme ndaj Krijuesit të gjithësisë dhe krijesave të tjera. Islami duhet kërkuar përmes burimeve të tij dhe përfaqësuesve të vërtetë përgjatë historisë, dhe jo nëpërmjet veprimeve të një minoriteti të vogël që e shtrembëron atë. E vërteta është që në Islam nuk ka fanatizëm apo detyrim. Islami është plotësisht një fe e paqes, mirëkuptimit dhe e tolerancës.

Dikur myslimanët dalloheshin shumë më tepër se sot për mëshirën, devotshmërinë, korrektesën dhe nderin. Ata ishin më të përgatitur të mbizotëronin në fusha të ndryshme në gjithë botën, falë horizontit të tyre shoqëror e politik, si dhe mënyrës së tyre të të menduarit që ishte më përparimtare dhe e sofistikuar. Ata e praktikonin fenë e tyre pa gabime apo dështime, duke përsosur moralin e duke kuptuar vendin dhe vlerën e shkencës e dijes, gjithmonë të aftë për të qenë në ballë të përparimit në dije për standardet e epokës në të cilën jetonin; duke vlerësuar në të njëjtën kohë siç duhet e duke ekuilibruar lidhjen dhe ndërthurjen ndërmjet frymëzimit, arsyes e përvojës.

Intelektualët myslimanë shqiptarë, krahas rilindësve të tjerë, pa dallim feje e krahine, kanë dhënë një kontribut të fuqishëm në drejtim të lirisë dhe emancipimit të vendit. Shqiptarët gjatë historisë së tyre, nuk i kanë njohur konfliktet fetare. Edhe sot ekziston një respekt i ndërsjellë midis tyre. Por, ajo që kërkohet tani është që intelektualët dhe teologët myslimanë, të posedojnë më shumë vetëdije e ndjenjë të lartë përgjegjësie për t'i drejtuar besimtarët drejt një shoqërie të civilizuar e bashkëkohore. Intelektualëve të pajisur me kulturë fetare e veçanërisht teologët, të cilët janë angazhuar me detyra fetare, u bie detyra të zbërthejnë me kompetencë dallimet ideologjike dhe fetare, duke i interpretuar drejtë mesazhet e fesë. Kjo do të arrihet gjithashtu edhe nëpërmjet një sërë botimesh, si islame ashtu

edhe për problematikat sociale të shoqërisë, që do të jenë dokumente të rëndësishme në historinë e zhvillimit të shoqërisë shqiptare e ndikimit të Islamit në të.

Feja islame nuk i përket ndonjë fraksioni të posaçëm dhe nuk mbështetet në mendimin e individit. Ajo kërkon bashkimin e mendimeve dhe të ideve, me qëllim që aktiviteti i Islamit të jetë sa më efektiv dhe frytdhënës për një shoqëri demokratike dhe të civilizuar. Islami nuk është i ngjyrosur, sepse është gjithmonë me të vërtetën, dëshiron bashkimin dhe urren përçarjen. Zoti e dërgoi këtë fe që të jetë e përshtatshme për të gjitha kohërat dhe shoqëritë, për këtë arsye ajo është fe e ekuilibrit dhe e butë, nuk është statike dhe as e vrazhdë. Islami u bën thirrje dijetarëve, intelektualëve, teologëve dhe gjithë besimtarëve që mendimet t'i analizojnë së bashku, në një atmosferë të pastër plot dashuri e mirëkuptim.

Është e vërtetë që feja sot përballet me mendje konservatore, me zemra të sëmura, me fuqi të dhunshme të individëve të veçantë, apo grupeve, që frymëzohen nga egoja e pasioni. Për të përballuar këto sfida të kohës, intelektualët myslimanë dhe teologët në veçanti, duhet të jenë njerëz me potencial të fuqishëm fetar e kulturor, që t'u përgjigjemi të gjitha situatave, t'u paraprijmë atyre për të ndriçuar mendjet e vetëdijen e njerëzve dhe t'i mbushim zemrat e tyre me besim e optimizëm për jetën praktike të përditshme. Me ajetin në Kuran:

"**Ne ta shpallëm librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për myslimanët**"[193],

kuptojmë Islamin e pastër pa asnjë lloj shtese, të plotë dhe jo të pjesshme, Islamin si drejtim i posaçëm i jetës individuale, familjare, shoqërore, materiale e shpirtërore.

Ka shumë të rinj që kanë studiuar jashtë në shkollat islame, por duhet të njohin edhe historikun e Islamit në Shqipëri për të vazhduar me ato

193. Nahl, 16:89

tradita e jo për të kopjuar e importuar nga jashtë zakonet dhe mentalitetet, që bien ndesh me shoqërinë tonë. Shumë besimtarë e kanë keqkuptuar fenë, e cila është shpirti i ekzistencës sonë dhe sekreti i jetës. Janë intelektualët dhe teologët që duhet të rrënjosin te besimtarët vetëdijen islame, për t'i bërë ata më të dobishëm për shoqërinë në të cilën jetojmë, sepse ata konsiderohen si trashëgimtarë të profetëve, predikues të së vërtetës e udhëzues të njerëzve. Shembulli i tyre do të provojë se Islami nuk është fe e nivelit të ulët, por fe e përparimit dhe zhvillimit, fe e qytetërimit dhe civilizimit.

Besimtari i orientuar sipas parimeve të Islamit është i aftë t'i përgjigjet nevojave materiale e shpirtërore të shoqërisë dhe në të njëjtën kohë të përballet, në çdo moment të tij, me realitetin social. Ai i hap perspektivë të re e të vazhdueshme, vlerave, sjelljeve dhe dijeve social-kulturore, për të zgjedhur më tej modelin racional të jetesës. Kjo do të thotë se Kurani, Fjala e Zotit, renditet në të parën kushtetutë islame për besimtarin, që hap horizonte të sigurta e që shërben si bazë për kapërcimin e vështirësive, në sajë të një ndërgjegjësimi të thellë shpirtëror të besimit te Zoti. Një besimtar i tillë vishet me një personalitet, gjuha e të cilit flet për korrektësi, bashkëpunim, solidaritet në marrëdhënie të ndërsjella etiko-shoqërore dhe që bëhet shembull për të tjerët.

Kurani, si statut hyjnor, e orienton njeriun të veprojë me korrektësi në zgjedhjen e drejtimit në jetë; në angazhimin për të mos iu nënshtruar veseve e pasioneve negative, që dëmtojnë individin, familjen e shoqërinë. Me ajetin:

"**Është e vërtetë se ky Kuran udhëzon për atë rrugë, që është më se e vërteta**"[194],

Zoti synon të realizojë çlirimin dhe emancipimin e njeriut pa dallime, për njohjen dhe realizimin e plotë të personalitetit të tij, në potencialin përkushtues ndaj Zotit dhe ligjeve të Tij. Ndërsa Profeti (a.s.) në haxhin e lamtumirës ndër të tjera, tha:

194. Isra, 17:9

"*Mos lëndoni njeri, kështu askush nuk mund t'ju lëndojë juve. Mbani mend që vërtetë ju do të takoni Zotin tuaj dhe Ai vërtetë do t'i llogarisë veprat tuaja*".

Me pak fjalë, ky është Islami i vërtetë, Islami i paqes, sigurisë e zhvillimit dhe ky është roli i liderëve të besimit Islam në këtë drejtim.

HYRJE NË VITIN E RI SHKOLLOR

Një nga qëllimet kryesore të njeriut në jetë është të mësojë, të kuptojë dhe t'u mësojë të tjerëve ato që di. Njeriu, ndryshe nga krijesat e tjera, vjen në këtë botë me një ftesë për mësim e zhvillim. Ajetet e para të zbritura të sures "Alek", na orientojnë në këtë drejtim. Kurse kafsha, vjen në këtë botë e parapërgatitur. Asaj i mjaftojnë dy orë, dy ditë apo dy javë për t'i mësuar të gjitha ligjet dhe kushtet e natyrës që i nevojiten për të jetuar. Atë aftësi e relacion me botën, që një njeri e arrin për njëzet vjet, një bletë apo një trumcak e përvetëson, më saktë i mësohet, për njëzet ditë. Pra, ushtrimi i detyrës së kafshës, nuk është zhvillim intelektual dhe kërkesa e saj për ndihmë, nuk është një lutje si e jona. Përkundrazi, ajo kafshë kryen detyrën e saj dhe adhuron në mënyrë aktive.

Njeriu vjen në këtë botë i paditur ndaj ligjeve të jetës dhe i detyruar të mësojë gjithçka. Aq sa shpesh, njëzet vjet, edhe nuk i mjaftojnë për t'u njohur me kushtet e jetës. Ka raste që deri në fund të jetës nuk i mëson dot. Ai dërgohet në këtë botë i brishtë dhe i dobët, pas një apo dy vitesh mund të ngrihet në këmbë, pas pesëmbëdhjetë vitesh arrin ta dallojë dëmin nga dobia dhe, gjatë gjithë jetës së tij jeton në mes të shoqërisë, për t'u mbrojtur e për të përfituar prej saj.

Shkolla është vendi ku jepet mësim dhe edukatë. Aty mësohet gjithçka në lidhje me jetën e më tej. Në fakt, edhe vet jeta është një shkollë. Ajo është institucioni që hedh dritë mbi evenimentet jetësore dhe u jep nxënësve mundësinë të kuptojnë atë që ndodh rreth tyre. Shkolla dhe edukimi që jepen aty, përfshijnë pothuajse të gjithë jetën e njeriut. Ai gjatë gjithë jetës zbaton e përsërit mësimet që merr në shkollë dhe, virtytet e aftësitë e fituara aty, janë udhërrëfyesi i tij gjatë rrugëtimit të saj.

Mësuesi është një udhërrëfyes shembull që i jep njeriut formë, si dhe njëkohësisht është krijesa "e shenjtë" e tempullit të edukimit. Vet fjala e Profetit Muhamed (a.s.):

"*Unë jam dërguar si mësues*"[195],

e shpjegon më së miri këtë. Ndikimi i mësuesit mbi individin është më i madh se ndikimi i prindërve apo i shoqërisë. Në një shkollë të mirë, mësuesi është ai që mbjell dhe që ruan farën e pastër e të pafajshme. Nxënësit mund t'i bëhet shembull i mirë dhe udhërrëfyes i saktë, një mësues që e ka perceptuar të vërtetën dhe që e ka kaluar çdo dituri më parë nga porta e ndjenjave të veta.

Librat që i jepen nxënësve në shkolla, qofshin libra të lëndës, qofshin libra me karakter fetar, romane apo poezi, duhet të jenë të tillë, që të arrijnë të zhvillojnë vullnetin, t'i japin forcë mendjes, vendosmëri shpirtit dhe shkëndijë shpresës. Çdo e dhënë e mësim përmendësh që nuk premton ndriçim të mendjes e çlirim të shpirtit, është një goditje që i jepet zemrës. Një dituri që nuk ka për qëllim zbërthimin e enigmës mes personalitetit tonë dhe materies, nuk i sjell asnjë lloj dobie nxënësit, përveç njehsimit me botën e jashtme e distancimin nga vetvetja.

Në jetën shkollore, nxënësit i duhen mësuar së pari gjuha, besimi, morali e karakteri, pastaj duhet synuar ndërtimi i një personaliteti të shëndoshë mbi këto themele. Qëllimi i mësimit duhet të jetë përgatitja

195. Ibn Maxhe

intelektuale e sociale në përshtatje me kohën dhe vendin ku jeton. Nxënësi duhet të shtyhet drejt përditësimit të dijeve, drejt një mënyre të menduari që nxit zhvillimin dhe suksesin në çdo fushë. Pasi të arrihen këto objektiva, duhet përgatitur specializimi i nxënësit për fe, art, shkencë, financë teknikë... E gjitha kjo është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimin në paqe të shoqërisë, me moralin dhe besimin e saj, me sukseset në fushat e ndryshme, si dhe me përpjekjen për të zënë vendin e duhur në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

COPËZA NGA JETA E SAHABËVE

Këtu po flasim për disa sekuenca të shkëputura nga jeta e sahabëve, për faktin se umeti ynë është larguar nga vlerat dhe civilizimi islam. Që ta bëjmë këtë, na lipset që tu tregojmë njerëzve mbi vlerat dhe thesaret e kësaj feje. Herë pas here, ne kemi nevojë të shohim pas, atje, në historinë tonë të parë, në të shkuarën tonë të largët me qëllim që të përmirësojmë të tashmen. Me këto copëza nga jeta e tyre prezantojmë një njohje më nga afër me përmasën e të qenurit sahab i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), të cilën e garanton larmia e vetëm e disa ngjarjeve të treguara në të.

Kur sahabët vuanin nga uria

Një ditë, Ebu Xhihadit, njërit prej sahabëve të Profetit (a.s.), i afrohet pranë i biri dhe i thotë: "Babai im i dashur, ju e keni parë të Dërguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe shumë herë keni pasur edhe mundësi që të bisedoni me të. Për Zotin, sikur unë ta kisha parë Profetin, qoftë edhe njëherë të vetme, ç'nuk do të kisha bërë!" I ati e dëgjoi dhe i tha: "Biri im, frikësoju ndëshkimit të Allahut dhe fol drejtë! Të betohem për Allahun, se më kujtohet shumë mirë njëherë: Ajo natë e asaj dite kur u zhvillua Lufta e Hendekut, ishim të gjithë pranë të Dërguarit të

Allahut. Ai na pati thënë: "Kush shkon deri në afërsi të armikut dhe merr informacione e na i sjell, në ditën e kiametit, Zoti do ta marrë atë dhe do ta sjellë menjëherë si komshi timin në Xhenetin e amshuar!" Kur asnjëri prej atyre që ishin të pranishëm nuk u ngrit dot, nga uria dhe të ftohtit, i Dërguari i Allahut e përsëriti tri herë premtimin e Tij dhe, në fund, tha: "Shko ti, o Ebu Hudhejfe".

Ibni Mesudi (radijallahu anh) na tregon: Profeti ynë (salallahu alejhi ue selem) i pa njëherë mirë fytyrat e të gjithë të pranishmëve, në të cilat lexohej uria që kishin ata sahabë të tij dhe u tha: "Po ju jap një sihariq! Shumë shpejt secilit prej jush do t'u shtrohen enë plot shkëlqim, me dollmë e me mish." Sahabët, të habitur, thanë: O i Dërguari i Allahut, 'domethënë, kur të vijë ajo ditë, ne do të jemi shumë më mirë se sa sot'." I Dërguari i Allahut tha: "Përkundrazi! Kjo gjendje e juaja sot është më e mbarë për ju, se sa gjendja në të cilën do të jeni në atë ditë!"

Muhamed bin Sirini ka thënë: "Kishte kohë të atilla, që ndonjë nga sahabët e Krenarisë së Gjithësisë, kalonin tri ditë njëra pas tjetrës, e ai nuk arrinte të gjente dot asgjë për të ngrënë, aq sa gjente ndonjë lëkurë kafshe dhe e skuqte dhe me të hiqte urinë. Po të mos e kishte as këtë, atëherë merrte ndonjë gur dhe e lidhte fort pas barkut, për të mos e ndierë urinë".

Edhe kjo nuk ishte parë

Meka u çlirua….

Deri atë ditë kishte jetuar me sy mbyllur larg Islamit për shkaqe të ndryshme. Menjëherë pas çlirimit erdhi tek Profeti ynë, paqja qoftë mbi të dhe u bë mysliman. Megjithëse i biri, Ebu Bekri, ishte i pari mysliman nga burrat, Ebu Kuhafe, babai i tij, i cili deri atë ditë kishte jetuar i verbër jo vetëm fizikisht por edhe shpirtërisht, erdhi e deklaroi pranimin e Islamit.

Ishte i verbër, i vjetër, e kishin sjellë nga larg për të pranuar Islamin. Profeti e lavdëroi dhe u tha: "E keni munduar plakun. Po të më kishit lajmëruar, I shkoja deri në shtëpi dhe e pranoja dëshminë e tij."

Ka një person që e kishte ndihmuar shumë Profetin, paqja qoftë mbi të, njëkohësisht dhe gjendjen shpirtërore të tij, por që nuk kishte hyrë kurrë në rrethin e Islamit, Ebu Talibi. Sidoqoftë…

Ebu Kuhafe, duke thënë shehadetin me dëshirë shumë të madhe, në prani të Profetit, paqja qoftë mbi të, shpalli kthimin në mysliman. Të thënët e shehadetit të atit në një anë…Në anën tjetër, djali i tij, Ebu Bekr, nuk i mban dot ngashërimet. Vazhdon ashtu në një kohë.

A nuk e di Profeti i Allahut? A nuk e njeh ai atë burrë? A nuk e lavdëron atë mik? Për këtë mik dhe për këtë miqësi sakrifikonte shpirtin:

"O Ebu Bekr! Pse po qan? Shih babain tënd që u bë mysliman. A duhet të mërzitesh, apo të qash nga gëzimi?"

"O I Dërguari i Zotit! Ajo që më bën të qaj është kjo: Ju u munduat dhe ç'nuk bëtë që Ebu Talibi të bëhej mysliman. Ai nuk u bë ashtu siç donit ju. Dhe për këtë jetonit dhe jetoni me zemër të thyer. Tani, në këtë moment që babai im pranoi Islamin dhe u bë mysliman, do të doja shumë që në vendin e tij të ishte Ebu Talibi dhe t'ju gëzonte dhe ju të mos jetonit më i mërzitur për këtë. Ja, kjo më bën të qaj".

Ç 'ishte kjo besnikëri?! E bekuar qoftë jeta që jetuat dhe lotët që derdhët. Sa jetë të ëmbël dhe paqësore që jetuat! Nuk di a e morët gjithë mirësinë e kësaj bote me vete dhe na latë neve vetëm pjesën e hidhur? Jo, jo nuk është kështu.

Ai që do e që kërkon, mund të zotërojë besnikëri, dashuri, e lidhje aq të fortë në jetë, saqë do i bënte edhe engjëjt ta kishin zili. Me ndihmën e Allahut, dëshiroj shumë për veten time dhe brezin tim që Allahu i Madhëruar të na japë një ndjenjë dhe karakter të tillë.

Lotët e Hz. Omerit

Transmetohet se një ditë xhumaje në hutbe, kur Hz. Omer (r.a.) këndoi nga Kurani ajetet:

"Kur dielli të mblidhet dhe të humbë shkëlqimin, kur yjet të rrëzohen dhe malet të lëvizin tutje, kur devetë barrse të braktisen dhe egërsirat të tubohen, kur detet të vlojnë dhe shpirtrat të bashkohen (me trupat), kur foshnja e varrosur për së gjalli të pyetet për çfarë faji ishte vrarë, ku fletoret të shpërndahen dhe qielli të zhvishet, kur xhehenemi të flakërojë dhe xheneti të afrohet, atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur (për këtë Ditë)"[196], nisi të qajë aq shumë, saqë nuk mundi të vazhdojë më tej.

Njeriu që i ruante fëmijët nga harami

Ishte një baba që i donte fort fëmijët e tij. Çdo mëngjes kur ngrihej herët për të shkuar në xhami, mundohej të mos bënte zhurmë që të mos zgjonte fëmijët. Në xhami e ndëgjonte me ëndje Profetin kur këndonte Kur'an dhe dilte i fundit nga xhamia.

Mirëpo u bënë disa ditë që nuk po vepronte më kështu. Sapo në namazin e sabahut Profeti jepte selam, i bënte lutjet me të shpejta dhe dilte prej xhamie pa e dëgjuar Kur'anin. Kur kjo gjëndje vazhdoi disa ditë Profeti e thirri dhe e pyeti:

- Ti vije në xhami më përpara se të gjithë dhe dilje i fundit. Por u bënë disa ditë që vjen në xhami i fundit dhe del i pari. Sikur jashtë të shqetëson një punë që duhet ta mbarosh shpejt. Babai edhe i turpëruar, por edhe i dëshpëruar filloi t'i tregonte shkakun:

- O i dërguari i Allahut! Jemi në një stinë të nxehtë kur hurmat piqen dhe degët e tyre mbërrijnë deri në tokë. Dhe degët e hurmës së komshiut tim varen në oborrin e shtëpisë sime. Natën nga pjekja, këto hurma bien pikërisht në

196. Tekuir, 81:1-14

kopshtin tim dhe kam frikë se fëmijët e mi zgjohen kur unë jam ende në xhami dhe hanë nga hurmat. Për këtë arsye dal më shpejt nga xhamia që fëmijët e mi mos të hanë nga këto hurma që janë haram për ne. Unë i kam premtu Allahut që nuk do t'u jap fëmijëve ushqim nga harami. Kjo është edhe arsyeja që dal herët nga xhamia, mbledh hurmat dhe ia hedh komshiut nga muri. Në këtë mënyrë edhe komshiun nuk e shqetësoj, edhe fëmijët e mi i shpëtoj nga harami. Ky sahab është Ebu Derda, Profeti ynë lutet për të dhe e përgëzon për këtë veprim.

Njeriu larg smirës

Profeti (a.s.) ndodhej në praninë e një grupi besimtarësh dhe bashkëkohësish. Kishte tri ditë rrjesht, që ai u bënte të njëjtën pyetje shokëve: "*Tani do vijë mes nesh, një burrë nga banorët e xhenetit*". Personi për të cilin Profeti (a.s.) thoshte këtë fjalë, nuk ishte dikush që dallohej për shumë punë të mira, tepër i veçantë apo të ishte ndonjë nga shokët e tij më të ngushtë. Abdullah ibn Omer, kureshtar për atë që e kishte bërë këtë person një nga banorët e xhenetit që në këtë botë, shkon në shtëpinë e tij me qëllim që të zbulojë shkakun. Ai qëndroi në shtëpinë e tij tri ditë rresht, por nuk vërejti diçka të veçantë dhe madhore që e bënte të fitojë një privilegj të tillë. Ai ishte një mysliman i zakonshëm, falte namazet farzë e synetet çdo ditë dhe nuk kishte asgjë tjetër të veçantë. Ditën e tretë, Abdullahu e pyeti:

"Kam dëgjuar të dërguarin e Zotit të thotë për tri ditë rresht: "*Tani do vijë mes nesh, një burrë nga banorët e xhenetit*". Dhe ai person je ti. Çfarë pune të mirë ke vepruar dhe vepron, që ke fituar një privilegj të tillë? Burri iu përgjigj:

"Për Zotin, nuk veproj asgjë më shumë nga ato që ke vënë re këto tri ditë." Atëherë, Abdullah ibn Omer u largua. Burri, u mendua pak mbi një vepër të veçantë që mund të bënte dhe i thirri Abdullahut: "O Abdullah! Eja se do të tregoj atë që më ka bërë të fitoj këtë gradë dhe privilegj!" Kur Abdullahu u afrua ai i tha:

"Nuk veproj asgjë më shumë se ato që pe, veçse nuk ia kam me hile asnjë besimtari dhe nuk kam zili e smirë askënd që Zoti i ka dhënë privilegje e të mira." Atëherë Abdullah ibn Omeri i tha: "Është pikërisht kjo, ajo që të dalloi dhe të bëri nga banorët e xhenetit që në këtë botë."

Përkushtim i vërtetë

Ebu Bekri kishte një shërbëtor që i sillte çdo ditë ushqimin, të cilin gjithmonë e pyeste se me ç'para e kishte blerë atë ushqim dhe pastaj hante. Një ditë, i lodhur nga vapa e shumë i uritur, nisi të hante pa pyetur. Pas pak shërbëtori i tha që atë ushqim e kishte marrë si shpërblim për një fall që kishte bërë para se të bëhej mysliman.

"Për pak sa s'më shkatërrove", i tha Ebu Bekri dhe futi gishtat në fyt për ta vjellë atë që kishte përcjellë, por me gjithë mundimet, kafshata nuk doli. Kur ata që ndodheshin aty pranë i thanë se mund t'i dilte vetëm me ujë, ai kërkoi t'i sillnin një tas ujë. E piu dhe filloi ta villte. Më në fund e nxori dhe e flaku.

"Të mishëroftë Allahu", i tha shërbëtorit.

"Gjithë ky shqetësim vetëm për një kafshatë?" e pyetën ata.

"Edhe sikur të ishte duke më dalë shpirti, unë prapë do ta nxirrja atë kafshatë", u përgjigj Ebu Bekri, duke kujtuar që njëherë Profeti Muhamed i kishte thënë:

"*Një trup që rritet e zhvillohet me ushqim haram, e ka vendin në zjarr*". Prandaj u frikësova se mos ndonjë qelizë e trupit tim rritej nga ajo kafshatë".

O vëlla i dashur! A është e nevojshme që të shtojmë gjë tjetër? Si je? Ku je? Cili është materiali dhe natyra e gurëve të themelit në trupin tënd? A e ke menduar ndonjëherë? Të dhëntë Allahu drejtësi dhe zgjuarsi për të kuptuar!

Një kriter tjetër

Halifi i dytë, Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, ndërsa po udhëtonte një ditë me shokët e tij, pa që drejt tyre po vinte një grua plakë, ajo i tërhoqi dorën Halifit dhe kaluan mënjanë të bisedonin. Halifi si shenjë dashurie e ngrohtësie i hodhi asaj krahun mbi shpatulla. Kishte përkulur kokën e ia mbante veshin pranë gojës, duke pritur në këmbë me orë të tëra plot respekt nën diellin përvëlues.

Nga ana tjetër shokët që po e prisnin...Në të njëjtin pozicion...Nën diellin përvëlues...

Gruaja plakë i thoshte hallin, i shpjegohej, dukej që edhe zemërohej ndonjëherë dhe i fliste Halifit me një gjuhë të ashpër. Kur iu mbush mendja, ia lëshoi dorën dhe iku në punën e saj. Hz. Omer u kthye pranë shokëve.

Njëri nga shokët i tha: "O prijësi i besimtarëve! Sot nuk bëre mirë. Le edhe veten, por edhe neve në diell. A s'qe e mundur që t'ia zgjidhje problemin shpejt e shpejt asaj të moshuare e të vije pastaj?"

Kur dëgjoi këto fjalë, Hz. Omeri u step dhe tha: "Keq për ty! A s'e njeh këtë grua? Ajo është gruaja, hallin e të cilës Allahu e dëgjoi përtej shtatë qiejsh, pa ia thyer zemrën. Edhe sikur kjo grua të mos ma lëshonte dorën deri natën vonë e të më mbante në të njëjtin pozicion, betohem që prapë nuk do kisha kërkuar leje për t'u larguar. Do shkoja të falesha e prapë do shkoja ta dëgjoja".

Ç'ia jepte prijësit të myslimane këtë ndjenjë? Ç'e bëri kryetarin e qeverisë që të priste për një grua të vjetër në diell pa u ankuar fare? Po ne, ç'kriter duhet të ndjekim? Çfarë duhet të themi, përse dhe si duhet të sillemi, të duam e të veprojmë?

Mbikëqyrësi suprem

Hz. Omeri (r.a.) e kishte dërguar Hz. Muadhin (r.a.) si nëpunës të mbledhjes së zekatit (lëmosha vjtore për të pasurit) në fisin Beni Kilab. Muadhi (r.a.) zekatin që mblodhi aty, ua ndau të varfërve. Madje edhe kafshën me të cilën udhëtonte, ia dha një nevojtari. Prandaj, përveç postiqes që kishte mbi kafshë, nuk i kishte mbetur gjë tjetër.

Hz. Muadhi (r.a.) pasi kreu detyrën që kishte, mblodhi postiqen mbi supe dhe u nis për në Medine. Me atë pamje prekëse mbërriti në shtëpinë e tij. Gruaja po e priste dhe pyeti:

"Nëpunësit kur kthehen nga detyra, u sjellin dhurata familjarëve të tyre. Ku e ke dhuratën tënde? Nuk na ke sjellë asgjë?!"

Muadhi i përgjgjijet: "Pranë meje qëndronte një ruajtës i sigurte që më kontrollonte. Prandaj atë që mora nga të pasurit, ua ndava të varfërve dhe nuk mora dot asgjë si dhuratë as për vete, as për ju".

"Ti njiheshe si një njeri i besueshëm edhe nga i dërguari i Zotit, paqja qoftë mbi të, edhe nga Ebu Bekri (r.a.). Si është e mundur që Hz. Omeri (r.a.) të vendosë një vëzhgues që të kontrollojë? Dhe iu ankua disa grave për Hz. Omerin (r.a.), i cili kur i dëgjoi këto fjalë, e thirri Hz. Muadhin (r.a.) pranë dhe e pyeti:

"Unë paskam dërguar dikë që të të kontrollojë?!" Hz. Muadhi (r.a.) iu përgjigj:

"O i Pari i Besimtarëve! Vetëm me një justifikim të tillë munda të shpëtoja nga gruaja ime, që priste dhuratë prej meje".

Hz. Muadhi (r.a.) me kontrollues të tillë nënkuptonte Allahun e Madhëruar. Por ngaqë nuk ishte shprehur hapur, gruaja e tij e kishte kuptuar sikur ai vëzhgues ishte një nëpunës i shtetit.

Me të vërtetë, Ata Shpirtra të Lartë ishin me besim të përsosur, bënin punë të lavdërueshme dhe ruheshin si nga mëkatet, ashtu dhe nga gjërat e dyshimta. Njerëzit e tillë, ashtu si i kërkojnë kënaqësitë vetëm brenda rrethit të lejuarës, ashtu dhe çdo qetësi dhe lumturi përpiqen ta gjejnë brenda këtij rrethi. Nderi që kanë marrë nga besimi dhe Islami, nuk i afrohen. Si përfundim edhe vetë janë të qetë, edhe njerëzit që i rrethojnë janë të qetë.

Besnikëria e Ebu Bekrit (r.a.)

Hz. Ebu Bekri ishte një njeri i pasur dhe i nderuar që merrej me tregti. Ishte një person që i ndihmonte të varfrit e të dobëtit. Në kohën kur iu shpall detyra e profetësisë, Muhamedit (s.a.s.), ai gjendej në Jemen për qëllime tregtare. Kur u kthye, Ebu Xhehli, Utbe bin Muait dhe të parët e tjerë të kurejshëve, e rrethuan menjëherë, sepse e dinin që ai ishte shoku më i ngushtë i Muhamedit (s.a.s.).

- Ç'të mira kemi? A ka ndonjë lajm të ri në Mekë? Iu drejtua atyre Ebu Bekri.

- Muhamedi ka shpallur pretendimin se është profet, ia kthejnë idhujtarët.

- Këtë, vetë Muhamedi e ka thënë? U tha Ebu Bekri.

Pasi merr përgjigjen "po", thotë: "Nëse e thotë ai vetë, është e vërtetë" dhe vrapon menjëherë drejt tij. Pasi e gjeti Profetin (s.a.s.) dhe mësoi që ishin të vërteta ato që thuheshin, pa vonuar dëshmoi shehadetin. Kur numri i myslimanëve shkoi në 38, Hz. Ebu Bekri me myslimanët e tjerë shkuan në Qabe, duke i ftuar njerëzit të besojnë në Zotin që është Një. Idhujtarët e rrahën derisa i ra të fiktë. Kur e sollën në shtëpi dhe u përmend, pyetja e parë e tij ishte: "Çfarë i ndodhi të Dërguarit të Allahut?" Edhe pse këmbëngulën që të hante e të pinte, ai u tha: "Pa parë atë, nuk bëj asnjë gjë". Dhe në atë gjendje, duke u mbajtur për krahësh nga të afërmit, shkoi të shihte të dërguarin e Allahut (s.a.s.).

Për çfarë përgjigjeni po?

Gjatë besëlidhjes së Akabes, medinasit që kishin ardhur për të dhënë besën, para se ta jepnin atë, Abbasi (xhaxhai i Profetit), i cili akoma s'ishte bërë mysliman u thotë:

- O medinas! Duke bërë besëlidhje me atë (s.a.s.), merrni kundër jush bizantinët, iranianët dhe fiset tuaja. Përgjigjuni "po", nëse do ta mbroni si shpirtin tuaj dhe nëse pasurinë tuaj do ta jepni me dëshirë në rrugën e tij! Mendoni për çfarë përgjigjeni dhe pastaj vendosni! – u tha.

Medinasit e pyetën Profetin tonë (s.a.s.):

- Nëse po, ç 'është fitimi ynë?

Profeti iu përgjigj:

- Shpëtoni në ahiret, në këtë çështje s'kam ndonjë fitim tjetër për ju.

Medinasit që ishin aty nga thellësia e zemrës thanë "po", duke dhënë kështu besën.

Çështja është mjaft e qartë. Detyrimet që sjell besimi është në të njëjtën kohë lumturia e përjetshme. Sahabët e pranuan Islamin duke e ditur dhe e dashur atë. Në rrugën e fesë ata sakrifikuan pasuritë dhe shpirtrat e tyre. Historia është dëshmitare se asnjë nga sahabët nuk është ankuar për sakrificat që ka bërë, për fëmijët që ka humbur, apo për pasuritë e shpenzuara, sepse ata i hynë kësaj rruge me vetëdije të plotë dhe të sigurt në shpërblimin e Zotit.

QËNDRIMI I EBU HANIFES GJATË ZHVILLIMEVE POLITIKE TË KOHËS

Sipas pikëpamjes së përgjithshme, një dijetar nuk është ekspert vetëm në një fushë të caktuar të disiplinave fetare. Për të qenë i tillë, ai jo vetëm që është hulumtues në të gjitha shkencat e fesë, por duhet të njësohet me të gjitha këto dituri. Krahas kësaj, një dijetar në kuptimin e plotë të fjalës, do të ishte ai që përveç asaj që u përmend më lart, di të marrë mesazhe nga historia e popujve të kaluar, di të lexojë kohën në të cilën jeton dhe ka largpamësi për të ardhmen. Duke iu referuar hadithit të Profetit Muhamed (a.s.):

"*Përqendrohuni në rrugën e drejtë, por do ta keni të vështirë*"[197],

dëshmohet se qëndrueshmëria në rrugën e drejtë mund të arrihet vetëm nga njerëzit e mëdhenj, sepse qëndrueshmëria në rrugën e drejtë nuk pranon devijime dhe lëkundje. Ajo arrihet vetëm duke u sforcuar mbi mundin e zakonshëm dhe duke qëndruar para Allahut të Madhëruar me sinqeritet të vërtetë[198]. I këtyre përmasave ishte edhe Imam Adham, Ebu Hanife.

197. Ebu Daud; Ahmed Ibn Hanbel

198. El Feshnij, Ahmed bin Shejh Hixhazi, *Kuvendet e Ndritshme*, Tiranë 2004, f. 191

Numan bin Thabit bin Zuta bin Mah, i njohur si Imam Adham Ebu Hanife, ka lindur në Kufe të Irakut në vitin 699/80 hixhri, gjatë kohës kur sahabet më të rinj ishin ende gjallë. Ebu Hanife rridhte nga një familje me gjendje të mirë ekonomike dhe në fillimet e tij është marrë me tregti, duke ndjekur gjurmët e të atit. Kufa dhe Bagdadi ku jetoi Ebu Hanifja, ishin qytete me shumë kultura religjioze, rryma dhe ideologji të ndryshme, si dhe ndër qendrat më të mëdha të botës islame, ku diskutohej jo vetëm rreth çështjeve të fesë, por edhe atyre sociale e politike.

Ebu Hanifja ishte një person shumë i zgjuar, mendjemprehtë dhe me forcë argumentuese racionale. Për dhuntitë logjike të tij Imam Shafiu thotë: "Nuk ka lindur nëna një njeri më të zgjuar se Imam Adhami." Metodat e fik'hut ai i mbështeste në traditat logjike që përfaqësonin disa sahabe të mëdhenj si Hz. Omeri, Hz. Aliu, Abdullah ibn Mesudi dhe Ibn Abasi (r.a.). Ebu Hanifja nuk ishte vetëm një dijetar i zgjuar, ai jetonte me të vërtetat e jetës shoqërore, ishte social dhe tregonte shumë interes për marrëdhëniet ndërnjerëzore. Ai na del përpara si një personalitet që e vlerëson mendimin e të tjerëve dhe si një njeri i dijes që vazhdimisht prodhon ide e krijimtari[199].

Mënyra se si është rritur e edukuar Ebu Hanifja, na tregon qartë lidhjen dhe respektin që ai kishte ndaj autoriteteve fetare e politike, por njëkohësisht tregon edhe ndjenjën e fortë për liri e pavarësi. Lidhjen që ka pasur me autoritetet, e ka mbështetur në drejtësi e logjikë dhe kurrsesi në besim të verbër. Këtë qëndrim ai e ka treguar edhe në marrëdhëniet me nxënësit e vet apo në shprehjet e tij fetare e politike. Ebu Hanifja nuk ua ka imponuar nxënësve mendimet e tij, nuk ka dashur ta imitojnë qorrazi dhe asnjëherë nuk është paraqitur para tyre si një autoritet i pagabueshëm. Ai besonte se problemet e kohës kërkonin përgjigje të rrahura jo nga një mendje, por nga shumë mendje dhe për këtë arsye

199. Hökelekli, Hayati, İmam-ı Azam Ebu Hanife'nin kişilik yapısı, İmam-ı Azam Ebu Hanife ve Düşünce Sistemi (sempozyum tebliğ ve müzakereleri), Bursa 2005, V. I, f. 104-105

ai u mësonte nxënësve të tij mënyrat e gjykimit dhe jo përgjigjet e gatshme. Imami dëshironte që ata të shtrydhnin mendjen e mendimet dhe të dilnin vetë në përfundimet e drejta[200].

Ebu Hanifja ka jetuar 52 vjet nën qeverisjen Emevite dhe 18 vjet nën qeverisjen Abaside. Ai mbi të gjitha, është një personalitet që ka bërë një jehonë të madhe në botën islame për ndërtimin e një sistemi mendimi dhe formimin e një shkolle juridike. Mirëpo, përveç kësaj, ai ka dhënë një kontribut shumë të madh gjatë zhvillimeve politike të asaj kohe dhe është shquar për reagimet e tij ndaj praktikave të jashtëligjshme të sunduesve Emevi dhe Abasidë. Ndër faktorët kryesorë që përcaktojnë pozicionin e tij, janë praktikat totalitare të sunduesve Emevi dhe Abasidë, si dhe qëndrimet e tyre të padrejta ndaj Ehli Bejtit.

Dijetari i njohur Xhessas (v. 370/980) thotë: "Sipas Ebu Hanifes, midis gjykatësit dhe halifes nuk ka ndonjë ndryshim dhe tek të dy këta kërkohet një kusht i përbashkët, që është drejtësia. Siç nuk mund të bëhet një mëkatar halife, ashtu dhe nuk bëhet dot gjykatës."[201] Edhe Ibn Hazmi (v. 456/1064), mbështetur në vijën e kësaj teorie, mendon se, nëse nuk ka rrugë tjetër për 'emri bil maruf ue nehji anil munker'[202], duhet të ndërhyhet fizikisht[203].

Ky është koncepti fetar e shoqëror i Ebu Hanifes, i cili ka përkrahur haptazi dhe ka ndihmuar në fetva e materialisht Zejd bin Ali Zejnelabidin kundër dhunës së halifes së shtetit Emevi, Abdulmelik bin Mervan (v. 86/705). Madje midis kësaj ngjarjeje dhe luftës së Bedrit ka formuar një lidhje shpirtërore. Po ashtu, ai ka ndihmuar në fetva dhe materialisht Muhamed Nefsuzekije në Medine dhe vëllain e tij Ibrahimin në Basra, kundër udhëheqjes tirane Abaside[204].

200. Hökelekli, *Po aty*, f. 109
201. Xhessas, Ebu Bekir, *Ahkamu'l- Kur'an*, Bejrut 1993, 1/99
202. Urdhërimi në të mirë dhe largimi nga e keqja
203. Ibn Hazm, *el-fisal fi'l-milel ve'l-ehvai ve'n-nihal*, Bejrut 1985, V, 20-23
204. Yaman, Ahmet, *Ebu Hanife ve Reel Siyaset*, İmam-ı Azam Ebu Hanife ve Düşünce Sistemi (sempozyum tebliğ ve müzakereleri), Bursa 2005, V. II, f.32

Me të vërtetë Ebu Hanifja ishte i mendimit dhe e shihte si detyrë që ndaj një pozite, e cila ka një karakter tiran dhe e cila ka humbur legjitimitetin, duhet bërë diçka. Ai besonte bindshëm se e drejta në vazhdimin e Hilafetit i përkiste djemve të Hz. Aliut dhe për këtë arsye e ka kritikuar hapur udhëheqjen Emevite. Ndërkaq, me vrasjen e djemve të Hz. Aliut nga Emevitët, pakënaqësitë dhe kritikat e ashpra të shtresave të ndryshme të shoqërisë, bënë që të lëkundet shumë udhëheqja Emevite. Për të sheshuar këto revolta, Halifja Abdulmelik bin Mervan, mori disa masa duke thithur në gjirin e shtetit disa dijetarë me influencë në popull.

Emevitët, duke parë diturinë e thellë dhe rrethin e gjerë të ndikimit në popull të Ebu Hanifes, menduan ta tërhiqnin pas vetes duke i propozuar postin e gjykatësit. Këtë propozim, nga Emevitët, e ka bërë guvernatori i Irakut Omer bin Hubejra (v. 132/750). Këtë gjë Ibn Hubejra e bëri edhe me disa dijetarë të tjerë, të cilët, jo me shumë dëshirë, pranuan dhe morën disa poste në qeverisje. Mirëpo Ebu Hanifja e kuptoi qëllimin e dhënies së këtij posti dhe nuk e pranoi detyrën. Guvernatori u nxeh nga ky qëndrim dhe urdhëroi goditjen e imamit me kamxhik. Djali i Ebu Hanifes, Hamadi dhe studenti i imamit, Ebu Jusufi, tregojnë se Ibn Hubejra e torturoi Ebu Hanifen duke urdhëruar gardianin që për 10 ditë me radhë t'i gjuajnë atij me kamxhik 10 herë në ditë. Ka të dhëna që si rezultat i torturave koka e tij i është ënjtur dhe frymëmarrja i është vështirësuar. Atyre dijetarëve që pranuan postet (Ibn Ebu Lejla, Ibn Shubrume dhe Daud ibn Ebu Hind) që thonin: Mos rreziko veten, pranoje këtë detyrë, Ebu Hanifja u është përgjigjur kështu: "Edhe sikur guvernatori të kërkojë prej meje një punë të thjeshtë si numërimin e dyerve të xhamisë, përsëri nuk do të pranoja. Si mund ta pranoj këtë detyrë?! Ai do të vendoste për ekzekutimin e një njeriu dhe unë u dashka ta miratoj! Betohem në Allah që nuk e mbaj mbi vete këtë përgjegjësi"[205].

Nisur nga kjo, respekti i popullit ndaj qeverisë, duhet përpjekur të fitohet jo me dhunën e nëpunësit të qeverisë, por me seriozitetin e qeveritarëve

205. Yaman, *Po aty*, f. 34

në sjelljet dhe veprimet e tyre, me sinqeritetin në punët dhe shërbimet e tyre. Gjer tani, me despotizmin e nëpunësve mizorë, apo me mashtrimin e masave, askush nuk ka dalë i fituar. Sundimi i forcës është kalimtare. I përjetshëm është sundimi i së drejtës dhe drejtësisë. Edhe nëse jo sot, është jashtë çdo diskutimi se në një të ardhme të afërt, këta do të dalin fitues. Prandaj, politika më e madhe duhet kërkuar në anësinë ndaj së drejtës dhe drejtësisë, sepse drejtësia është një nga rrugët për të qenë pranë Zotit.

Pas këtyre ngjarjeve Ebu Hanifja e kuptoi që nuk mund të rrinte më në Kufe dhe u largua në Mekë duke qëndruar atje më shumë se 6 vjet, derisa erdhën në fuqi Abasidët. Me ardhjen e Abasidëve në fuqi, imami gëzohet duke shpresuar në mirëqeverisjen e tyre dhe në premtimin që ata dhanë në mbrojtjen e të drejtave të djemve të Hz. Aliut. Për këtë arsye së bashku me shokët e vet kthehet në Kufe dhe i japin besën halifes së shtetit Abasid Ebu'l Abas es-Safah[206]. Sigurisht ky gëzim i tij nuk zgjati shumë, sepse edhe ata filluan të përndiqnin dijetarët dhe njerëzit fisnikë e me merita, duke u bërë padrejtësi apo edhe duke i vrarë. Për t'u mos u bërë vegël e së keqes dhe e padrejtësisë së tyre, Ebu Hanifja ndryshoi qëndrim duke këmbëngulur në rrugën që e konsideronte të drejtë, sepse në konceptin e Ebu Hanifes, ndaj diçkaje që duket e keqe, nuk ka bindje, qoftë fundi i këtij veprimi edhe burgosja.

Fetvatë civile të Ebu Hanifes kishin një pëlqim dhe miratim më të madh në popull se sa fetvatë e dijetarëve të pushtetit si Euzai apo Ibn Ebu Lejla. Për këtë arsye, halifja e Abasidëve Ebu Xhafer el-Mansur (v. 775), nuk ka ushtruar presion ndaj pikëpamjeve të tij fetare, me kusht që imami të mos ndërhyjë në udhëheqjen e qeverisë. Kur gjykatësit e tjerë i dhanë të drejtë halifes për shtypjen e rebelimit të popullit të Mosulit, Ebu Hanifja e kundërshtoi duke i bërë të ditur halifes se, gjaku i myslimanëve nuk mund të merret, sipas legjislacionin islam, përveçse në tre raste. Këtë imami e ka thënë haptazi duke iu përmbajtur edhe hadithit të Profetit (a.s.):

206. Uzunpostalcı, Mustafa, *Ebu Hanife*, TDV İslam Ansiklopedisi, İstanbul 1994, V. 10, f. 133

"*Xhihadi më i mirë është të thuash të drejtën përballë sunduesit tiran*"[207].

Megjithëse pa dëshirë, halifja ka pranuar mendimin e Ebu Hanifes për të mos dënuar popullin e Mosulit. Kjo ka qenë arsyeja përse gjykimet e Ebu Hanifes ishin të mirëpritura në popull, sepse ato ishin të ndërthurura në shumë dimensione me në krye drejtësinë[208].

Për çdo njeri ka një lloj xhihadi që është 'më i miri'. Kurse hadithi i lartpërmendur, xhihadi më i mirë është të thuash të drejtën përballë sunduesit tiran, tërheq vëmendjen se pothuajse për të gjithë ky lloj xhihadi është 'më i vështiri', sepse në xhihadin e zakonshëm (në luftë), del përballë armikut dhe ke shpresë të dalësh fitimtar. Ndërsa të thuash të drejtën përballë sunduesit tiran, që zotëron të gjithë fuqinë dhe autoritetin, do të thotë të shkatërrosh vetveten, do të thotë t'i hysh një pune, përfundimi i së cilës është i ditur që në fillim. Por njëkohësisht me fjalën e drejtë, duke penguar një të keqe që mund të bëjë sunduesi, bën një dobi shumë të madhe dhe i shpëton njerëzit nga padrejtësia. Pra, të thuash të drejtën përballë sunduesit tiran është me rrezik për atë që e thotë dhe dobi për shoqërinë. Për këtë arsye është cilësuar si xhihadi më i madh, xhihadi më i mirë dhe xhihadi më fisnik[209].

Njëherë halifja Ebu Xhafer el-Mensur dhe gruaja e tij kishin një mosmarrëveshje. Ai e pyeti atë se kë pranonte ajo si gjykues për këtë çështje? Ajo iu përgjigj: Ebu Hanifen. Halifja iu drejtua Ebu Hanifes duke i thënë: "Ebu Hanife, kjo grua e lirë ka një mosmarrëveshje me mua. Më jep mua të drejtën time kundër saj." Përgjigjja që i dha Ebu Hanifja kësaj çështjeje ishte më tepër në favor të gruas dhe halifja qëndroi i heshtur për një kohë të gjatë. Ebu Hanifja u largua. Kur imami arriti në shtëpinë e tij, gruaja e halifes i dërgoi atij një shërbëtor me para, rroba,

207. Ebu Daud; Tirmidhi; Nesai; Ibn Maxhe; Ahmed; Beyhaki

208. Uyanık, Mevlüt, İslam düşüncesinin teşekkül döneminde Ebu Hanife'nin siyasi duruşu, İmam-ı Azam Ebu Hanife ve Düşünce Sistemi (sempozyum tebliğ ve müzakereleri), Bursa 2005, V. I, f. 128

209. Çakan, Ismail Lütfü, *Hadislerle Gerçekler*, İstanbul 1990, f. 255, 257, 259

një robëreshë etj. Ebu Hanifja e refuzoi dhuratën dhe i tha shërbëtorit: "Përcilli përshëndetjet e mia gruas së halifes dhe thuaji që dhurata rrezikon besimin tim. Unë mbrojta të drejtën dhe këtë e bëra për hir të Allahut duke mos pritur asgjë nga askush"[210].

Tregohet që Ebu Hanifja u thirr nga halifja el-Mensur për ta bërë kryegjykatës, dhe ai e refuzoi. Halifja i tha: "Mos dëshiron atë që kemi ne?" Ebu Hanifja ia ktheu: "Jo, por unë nuk jam i përshtatshëm". Halifja i tha: "Gënjen". Imami tha: "Pra, ashtu si thoni edhe ju, një person që gënjen nuk mund ta marrë përsipër këtë detyrë, nëse unë them të vërtetën, atëherë nuk jam i përshtatshëm për këtë detyrë."[211] Kështu, duke përdorur zgjuarsinë e tij, imami refuzon t'i japë legjitimitet punëve të halifes. Në kohën kur jetoi Ebu Hanifja, ka pasur nga ata dijetarë, fetvatë e të cilëve, për sa i përkasin fushave publike, janë ndikuar nga politika. Të njëjtën gjë nuk mund të themi për Ebu Hanifen. Nëse ai do të sillej politikisht, pra, duke dhënë fetva në favor apo në disfavor të një personi ose disa personave, atëherë fetvatë e Ebu Hanifes nuk do t'i rendisnim nën devizën 'emri bil maruf ue nehji anil munker'. Në këtë kontekst, me fetvatë civile apo individuale, imami ka qenë në kërkim të së drejtës dhe drejtësisë duke mbrojtur në këtë mënyrë strukturën shoqërore.

Ashtu si ka kritikuar halifen, Ebu Hanifja ka kritikuar edhe gjykimet e gabuara të dijetarëve dhe gjykatësve të kohës, si për shembull, vendimet e gjykatësit të Kufes, Ibn Ebu Lejla. Ebu Hanifja së bashku me nxënësit e tij, i kanë diskutuar në mësimet dhe organizimet shkencore duke kritikuar ato vendime të gabuara. Madje, për të kuptuar dimensionet e pikëpamjeve të ndryshme mes Ebu Hanifes dhe Ibn Ebu Lejlës, është me vlerë të përmendim librin e shkruar nga nxënësi i imamit, Ebu Jusufi me temë: 'Ihtilafu Ebi Hanife ue Ibn Ebi Lejla'[212].[213]

210. Ebu Zehra, Muhamed, *Ebu Hanife* (përkth. O. Keskioğlu), Konya 1981, f. 57-61
211. Ebu Zehra, *Po aty*, f. 13.
212. Ndryshimet në pikëpamje mes Ebu Hanifes dhe Ibn Ebi Lejla
213. Uzunpostalcı, *Po aty*, f. 134

Megjithëse ishte oponent, besueshmëria e imamit ishte rritur aq shumë, saqë i ishte propozuar edhe përgjegjësia e thesarit të shtetit, por Ebu Hanife nuk ka pranuar duke zgjedhur mësimin dhe rrugën e diturisë. Madje, halifja El-Mensur e mbështeti imamin duke i dhënë atij dhurata, por Ebu Hanifja i refuzonte me etikë. Ky qëndrim i imamit ishte shumë produktiv duke ndikuar jashtë mase te njerëzit. Duhet të theksohet që këto zgjedhje kanë qenë personale dhe nuk kanë ndikuar te nxënësit e vet. Këtë e shohim më vonë kur nxënësit e imamit kanë marrë detyra shtetërore[214].

Mirëpo të gjitha këto ngjarje nuk do të kalonin lehtë për imamin, sepse do të kishte edhe nga ata të ditur fanatikë, që do të shpreheshin negativisht për të. Mund të përmendim këtu Ebu Hatim bin Hiban El-Busti, i cili për të ulur imazhin në popull të Ebu Hanifes, e akuzoi atë sikur ka dalë nga feja dhe për këtë duhet të pendohej. Kemi edhe raste të tjera ku Ebu Hanifen kanë dashur ta vënë në pozitë të vështirë përballë halifes me raportime në disfavor të tij, por imami nuk iu është përgjigjur me të njëjtën monedhë duke u munduar të qëndrojë larg çdo lloj përgojimi. Një rast tjetër është ai i Ebu'l-Abas Tusit, i cili e provokon Ebu Hanifen në prezencë të halifes duke i thënë: "Nëse kryetari i shtetit kërkon prej nesh ta ekzekutojmë një njeri pa pyetur shkakun, a është e lejuar ta bëjmë këtë"? Duke kuptuar qëllimin e keq të tij, Ebu Hanifja me mendjemprehtësi ia kthen: "Apliko të drejtën, mos pyet arsyet." Për këtë sulm dhe dredhi kundër tij, Ebu Hanifja do të shprehet: "Tusi donte të më zinte ngushtë, mirëpo unë e lidha fort atë." Pra, shohim se edhe në këto raste të vështira imami nuk iu është ndarë të vërtetës dhe të drejtës[215].

Njerëzit e mëdhenj që shënon historia, dalin në pah pikërisht në kohën kur çrregullimet në shoqëri arrijnë kulmin. Për të vënë rregull në botën e jashtme, njeriu në fillim duhet të vendosë rregull dhe ekuilibër

214. Uyanık, *Po aty*, f. 124
215. Uyanık, *Po aty*, f. 127-128

brenda vetes së vet. Parë në këtë këndvështrim, Ebu Hanifja ishte njeri i rrugës së mesme dhe para së gjithash ishte një personalitet me ekuilibër e vendosmëri të lartë. Po të analizojmë kohën në të cilën ai jetoi, do të gjendemi përballë problemeve të mëdha politike e shoqërore, për më tepër përplasje dhe konflikte ndërmjet grupeve të besimeve e sekteve të ndryshme fetare. Ai shumë mirë mund t'i binte shkurt duke u bërë palë, por që nga fillimi, ai nuk e ndryshoi asnjëherë vijën e rrugës së vet duke sakrifikuar shumë për tek e drejta, si dhe duke u përpjekur që t'ua jetësonte edhe të tjerëve këtë të drejtë. Nisur nga kjo, nuk është gabim të themi se Ebu Hanifja jetoi ashtu si mendoi e besoi, si dhe besoi ashtu si jetoi e mendoi.

Është i padiskutueshëm fakti që bota islame sot dhe përgjithmonë ka nevojë të jashtëzakonshme për njerëz si Ebu Hanifja. Duke mbështetur mendjen njerëzore me traditën profetike, trashëgimia që ai la pas, është një burim reference për të mbajtur qëndrim të drejtë ndaj fenomeneve dhe një mesazh për mënyrën e të gjykuarit në zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Ebu Hanifja ndërroi jetë në vitin 150/767 H në Bagdad. Vetë falja e namazit të xhenazes, gjashtë herë, nga një numër shumë i madh njerëzish, tregon qartë për pozitën dhe autoritetin e tij të lartë në popull.

MEVLANA XHELALUDDIN RUMI SIMBOL I DASHURISË (I)

Megjithëse kanë kaluar gati tetë shekuj nga koha e tij, mesazhet e Mevlanës nuk dinë të vjetrohen, duke ruajtur freskinë e gjallërinë akoma midis nesh. I destinuar që të bindë njerëzit se me dashuri mund të bëjnë mrekulli, Mevlana ka arritur që të studiohet ndër shekuj nga shumë universitete dhe studiues me emër në mbarë botën. Dashuria hyjnore, sipas tij, nënkupton dashurinë e dyanshme: Dashurinë e Zotit ndaj njeriut dhe të njeriut ndaj Tij. Një dashuri e tillë e dyanshme, ndërmjet Zotit dhe njeriut, ka një natyrë të përbashkët, ajo është dritë që ndriçon gjithkund dhe gjithmonë, ajo paraqet dritën e sinqertë të ekzistencës dhe të ftesës për ekzistencë në realitet. Sipas Mevlanës, rrugët që të çojnë te Krijuesi janë të hapura për të gjithë ata, që përpiqen mjaftueshëm. E vetmja gjë që duhet bërë, është të flaken përtej thesaret e kësaj bote, për tu pasuruar me dashurinë e Zotit. Ashtu siç e theksonte gjithmonë ai: "Njeriu ka nevojë për dy gjëra: Dashuri dhe sy të përlotur".

Në tekstet dhe poezitë e Mevlanës, gjejmë një realizim artistik që mishëron tërësinë e vetive shpirtërore të njeriut dhe veçori tipike të jetës shoqërore. Aty gjejmë edhe fjalë e shprehje të përdorura me kuptime të figurshme me një stil metaforik për të shprehur një ide, një ndjenjë etj., e cila i jep ligjërimit gjallëri të veçantë. Ata që erdhën më pas, gjetën tek Mevlana një reformues epokal të mendësisë njerëzore, të botëkuptimit të njeriut,

të raporteve të tij me hyjnoren, me tokësoren, me jetën dhe vdekjen, me pavdekësinë dhe amshimin. Në objektivin final të tij, Mevlana kërkonte nga vetja dhe ndjekësit, afrimin me Zotin përmes njohjes së thellë. Njohja është prezente në forma të ndryshme: Njohje me inteligjencë, njohje me intuitë, njohje me entuziazëm, njohje me mëshirë dhe së fundi njohje me dashuri. Sigurisht të gjitha njohjet kanë rëndësinë e tyre. Për Mevlanën, për të arritur në njohjen e drejtpërdrejtë, duhen flakur kufijtë e arsyes. Funksioni i mendjes është që ta dërgojë njeriun deri në kufirin e dashurisë. Mendja të njeh me themelin e çështjeve, nuk shkon përtej. Ajo na dorëzon te dashuria dhe është dashuria ajo që na bashkon me Zotin. Ashtu si te gjithë sufistët[216], por me një dimension më të gjerë, mjeti që përdori Mevlana në kërkimin e së vërtetës, ishte aftësia e njohjes me dashuri. Sipas A. J. Arberry, në veprat e Mevlanës mund të gjejmë ngushëllimet dhe kurat shpirtërore për sëmundjet e shekullit tonë. Kurse Irene Melikoff thotë: "Nëse popujt e botës të përkthenin dhe të lexonin në gjuhët e tyre veprat e Mevlanës, nuk do të ekzistonte në botë e keqja, lufta, armiqësia, urrejtja, përbuzja".

Jeta dhe vepra e Mevlanës, duhet të interpretohet në suaza të Kuranit dhe Sunetit, sepse sufizmi[217] i tij, aty i ka rrënjët. Te veprat e Mevlanës dallojmë besim, urtësi, moral, art, filozofi, predikim, praktikë, porosi e këshillë. Këshillat e tij bazohen në mësime që kanë fuqinë për të frymëzuar dhe për të pasur një jetë më origjinale, të bukur, të dashur dhe kuptimplotë. Para se të njihej me Shemsi Tebrizin, Mevlana ishte një dijetar i madh dhe me zë. Por, pasi njohu Shemsin, brenda tij shpërtheu dashuria ndaj Zotit e njerëzores dhe poezinë e artin, ai e përdori në shërbim të fesë e frymëzimit.

Mevlana Xhelaluddin Rumi, një biografi e shkurtër

Më 30 shtator të vitit 1207, lindi Mevlana Xhelaluddin Rumi, në qytetin Belh, në veri të Afganistanit. Në ato kohë, ky qytet ishte ndër qendrat e rëndësishme të zonës së Horasanit. E ëma quhej zonja Mumine, kurse i

216. Mistik mysliman
217. Misticizmi islam

ati Bahauddin Veled, i mbiquajturi 'Sultanu'l-ulema'[218], i përkiste një brezi familjar të zgjedhur e fisnik. Vëllai i madh quhej Alauddin Muhammed, kurse e motra, zonja Fatime.

Babai i tij Behauddin Veled, për shkak se gëzonte autoritet të madh në popull, sunduesi i Havarizmit, sulltan Muhamedi, e urdhëroi atë që të shpërngulet nga qyteti i Belh'it. Ai frikësohej se autoriteti i tij mund t'ia rrezikonte pushtetin. Në këtë kohë Mevlana ishte vetëm 12 vjeç. Disa thonë se në mendimin për ta shpërngulur të atin e Mevlanës është përfshirë jo vetëm sunduesi, por edhe dijetari i tij Fahruddin Raziu. Sidoqoftë, edhe vetë Mevlana e kritikuar Raziun për përdorimin e tepruar të logjikës në shpjegimin e të vërtetave të fesë. Ai, duke kritikuar dialektikën thotë: "Sikur dialektika të mund t'a zbulojë vetë të vërtetën e frymës, Raziu do ta arrinte të gjithën, por këmbët e dialektikëve janë drurëzuar dhe këmbët prej druri janë më të luhatshmet".

Babai i Mevlanës u largua nga Belhi së bashku me familjen dhe një grup nga farefisi. Zonja Fatime u martua dhe mbeti në Belh me të shoqin. Ata dolën në udhë me synimin për të shkuar në haxh. Në çdo vend që arrinin, priteshin me interesim dhe respekt të madh. Ata si fillim shkuan në Nishabur dhe përveç tij vizituan edhe Kufën e Bagdadin. Në Nishabur takuan sufiun e madh Feriduddin Attarin. Attari iu drejtua Bahaeddin Veledit: "Çmoje këtë fëmijë, se pa kaluar shumë, ka për të lëshuar zjarr në zemrat e ashikëve[219] të botës!". Më vonë familja e Mevlanës u vendos në Bagdad, ku do të jetonin për gjashtë muajt vijues. Pastaj me të shkuar në Mekë, kryejnë haxhin. Më pas kthehen në Damask, ku takohen edhe me një dijetar të madh nga Andaluzia, Muhjiddin ibn Arabiun. Po kështu, edhe Ibn Arabiu, kur e pa Mevlanën e ri që po ecte pas të atit, tha: "Lëvduar qoftë Zoti, oqeani po ecën pas liqenit".

Pas Damaskut, familja udhëtoi për në qytetin Larend, në Kahramanin e sotëm, ku jetuan atje për shtatë vjet. Në vitin 1226, në moshën 19

218. Mbreti i dijetarëve
219. Dashuruesve

vjeçare, Mevlana u martua me zonjën Xhevher. Nga kjo martesë lindën dy djem, Sulltan Veledi dhe Alauddin Çelebiu. Pas vdekjes së gruas së parë, Mevlana u martua me gruan e dytë, Kira Hatun, martesë nga e cila lindën djali Emir Alim dhe vajza Melike.

Shumë shpejt Mevlanës i vdes nëna dhe vëllai i madh. Kjo i solli dëshpërim. Në këto kohë, vizitoi qytetin një delegacion nga sunduesi i selxhukëve Alauddin Kejkubadit. Aty dëgjuan ligjërata mjaft tërheqëse. Pas raportimit te sunduesi i tyre për këtë rast, Sunduesi Alauddin e ftoi babanë e Mevlanës, Behaudinin, dhe tërë familjen e tij në Konja. Bahauddin Veledi u shpërngul me familje në vitin 1229 nga Kahramani në Konja. Sunduesi dhe mjedisi i tij e pritën familjen me respekt të madh, i treguan vendin për të banuar dhe bënë gjithçka që ata të ndjeheshin sa më mirë. Ato kohë, Konja, kryeqytet i Selxhukëve të Anadollit, ishte një vend ku për shkak të interesimit dhe inkurajimit që tregonin qeveritarët, shtegtonin dhe strehoheshin shumë dijetarë, sufistë, poetë, zejtarë dhe artistë, si dhe njerëz që iknin nga sulmet mongole. Sunduesi e vendosi familjen e Behauddinit në pallatin e tij, ku qëndruan përgjithmonë. Aty ai kreu detyrën e myftiut dhe myderrizit dhe formoi një rreth të gjerë simpatizantësh. Mirëpo, Behauddini, "Mbreti i dijetarëve", në vitin 1230 vdes në Konja. Kur i vdiq babai, Mevlana ishte vetëm 23 vjeç. Mevlana, krahas gjuhës arabe dhe persiane, mësoi edhe gjuhën greke. Pasi Bahaeddin Veledi vdiq në Konja në moshën 80-vjeçare, deshën ta vënë Xhelaluddinin e ri në vend të tij. Përkundër kërkesave të simpatizuesve dhe miqve, Mevlana nuk e zuri postin e babait.

Në vend të postit, ai u dha pas disa mësimeve sufiste nga nxënësi i babait të tij shejh Burhanuddin Muhakkik Tirmidhiu. Ai e mori mbi vete edukimin moralo-shpirtëror të Xhelaluddinit, i cili deri në atë kohë kishte marrë mësime nga vet babai i tij dhe kishte arritur një nivel të përparuar në dituritë formale. Më vonë, sipas kërkesës së shehut, për ta plotësuar arsimimin, Xhelaluddini shkoi në Halep dhe Damask që ishin qendra arsimore me rëndësi të asaj kohe. Pas një jete të gjatë studentore, Xhelaluddini u kthye në Anadoll.

Shejh Burhanuddin Muhakkik Tirmidhiu ishte i mahnitur me dijen e Mevlanës dhe i sugjeroi që të kalojnë në njohjen e halit[220] dhe në fuqinë e oratorisë. E gjithë kjo periudhë mësimi e aftësimi zgjati gati 10 vjet. Kur Mevlana mbushi 33 vjeç, zuri postin e babait të tij. Ndërkohë dijetari dhe sufisti i madh Shejh Burhaneddin Muhakkik vdes në Kajseri në vitin 1240.

Periudhën vijuese, Mevlana e kaloi si profesor në Medrese. Ai filloi të japë mësim në Konja në dituritë fetare dhe të udhëheqë orientimin shpirtëror të popullit. Kishte arritur një gradë të lartë veçanërisht në dituritë e Fikhut dhe Hadithit. Ai kishte arritur në postin e Fetvasë, autoritetit të vendimit juridiko-fetar. Siç tregohet, kishte qindra nxënës. Fama i ishte përhapur gjithandej dhe studentët, pasuesit, i ishin shtuar. Mevlana, nga njëra anë angazhohej me mësim dhe edukim, nga ana tjetër preokupohej me bazat e sufizmit, të unifikuara me parimet fetare të Imam Gazzalit.

Në një rast, kur po kthehej nga medreseja, u takua me një dervish endacak që quhej Shemsi Tebrizi. Si njohës i mirë i ilm'ul-batinit[221] ai ndikoi te Mevlana, madje aq shumë, sa ai i braktisi miqtë dhe mësimet në medrese, për t'iu përkushtuar jetës asketike dhe qëndrimit me Shemsi Tebrizin. Kjo gjendje i preku djemtë e Mevlanës, nxënësit e tij, por edhe qytetarët, të cilët u ankuan te sunduesi kundër Shemsi Tebrizit që ai të largohet nga Konja. Në këtë gjendje, Shemsi u largua nga Konja dhe u vendos në Damask.

Në anën tjetër, Mevlana ra në dëshpërim të thellë nga largimi i mësuesit të tij shpirtëror, u izolua nga jeta dhe vazhdonte të mos shkonte në medrese. Për ta shmangur këtë gjendje, Sulltan Veledi shkoi në Damask dhe e ftoi Shemsi Tebrizin që të kthehet. Madje i dërgoi dhurata nga nxënësit, si shenjë e kërkimit të faljes. Në maj të vitit 1247 Shemsi kthehet në Konja. Sërish më vonë, nën trysninë e miqve të Mevlanës,

220. Gjendjes shpirtërore
221. Dijeve të brendshme

Shemsi do të largohet nga Konja duke mos lënë gjurmë dhe duke mos u gjetur më kurrë. Ka mendime se Shemsi është vrarë. Kjo ndodhi në vitin 1247. Në këtë mënyrë u zhduk nga sytë e botës Shemsi Tebrizi, por detyrën e frymëzimit ai e kreu siç duhej ndaj mikut të tij, i cili u bë shkak që Mevlana të zinte një vend dhe pozitë të lartë. Ndërsa Mevlana vetë, pas një sëmundjeje që vazhdoi disa kohë, ndërroi jetë më 17 dhjetor 1273. U varros pranë varrit të babait të tij në Konja të Turqisë.

Njohuri rreth veprave të Mevlanës

Mevlana Xhelaluddin Rumi është një dijetar dhe poet i madh, veprat e të cilit meritojnë të studiohen me seriozitet të plotë. Ai është një nga poetët më të mëdhenj të botës islame, i cili me poezitë e tij mistike dhe të shkruara me gjuhën universale të shpirtit, vazhdon edhe sot të lexohet anekënd në botë. Shumë dijetarë i kanë vlerësuar poezitë e Mevlanës si poezi të dashurisë hyjnore, të pasionit mistik dhe të dritës sekrete. Dhe, sigurisht, një nga arsyet pse pëlqehet kaq shumë, është aftësia e tij e shprehjes së qartë, të drejtpërdrejtë, e të biseduarit thellë brenda vetes rreth çështjeve të botës shpirtërore e të misticizmit. Poezia e Mevlanës ka fuqinë të tejkalojë mendjen dhe të derdhet drejtpërdrejt në zemër. Ky ishte një dijetar i shquar dhe poet, i cili me poezitë e tij mistike ka ngrohur shpirtrat e ashikëve për të vërtetën. Gjithashtu në poezitë dhe rrëfimet e Mevlanës, shprehet mirë ndjenja e mëshirës ndaj të varfërve, të dobëtëve ose atyre që janë në pozita të vështira. Brendia e poezive të Mevlanës dallohet qartë nga tone epike-lirike, të përshkruara nga filozofia e sufistëve që donin të pajtonin botën materiale me shpirtin.

Pas takimit me Shemsin, Mevlana u hodh në oqeanin e botës mistike dhe në mënyrë të natyrshme iu drejtua poezisë, si mjet i vetëm që mund t'u japë përgjigje emocioneve të një shpirti të pasionuar me ashk[222]. Ai me poezitë shprehu emocionet, entuziazmin, gëzimin dhe dëshpërimin, me to kërkoi ngushëllim e qetësi. Ai ligjëroi, predikoi, mbajti hutbe dhe këshilloi. Të gjitha këto, ai i shkroi në një mënyrë të veçantë, impresionuese. Veprat e tij

222. Këtu: Dashuri hyjnore

vazhdojnë të impresionojnë jo vetëm myslimanët, por edhe lexuesin e jashtëm jomysliman. Rol të madh për të njohur më gjerë veprat e Mevlanës, luajti djali i tij Sulltan Veledi, i cili ishte edhe poet. Ai ka shkruar se Mevlanës i përkasin 7745 poezi të shkruara persisht. Ndërsa të parat përkthime që erdhën në shqip janë ato që solli të përshtatura poeti ynë i madh, Naim Frashëri si: "Fyelli", "Zogu dhe djali" e përshtatur nga poezia e Mevlanës, si dhe "Këshillat e një zogu...".

Divan-i Kebir (Divani i madh). Kjo vepër përmban më tepër gazelet dhe rubairat e Mevlanës. Është një vepër e madhe e përbërë prej afro 40000 vargjesh dhe prej 21 divanesh. Mevlana, si te "Divani" dhe "Mesnevija" ka përdorur si gjuhë persishten popullore. Megjithëse pak, aty gjenden poezi edhe në gjuhën arabe e greke. Në këtë vepër Mevlana ka përdor pseudonimin Shemsi, në shenjë respekti për të, prandaj edhe vepra gjendet me emrin "Divan-i Shemsi-i Tebrizi". Pavarësisht së në lindje dhe në perëndim është e njohur më shumë "Mesnevija", personalitetin e tij të vërtetë e paraqet vepra "Divani-i Kebir" apo "Divan-i Shemsi-i Tebrizi", sepse në këtë vepër përshkruhet në hollësi transformimi i Mevlanës dhe, vetë ai tregon thellësitë shpirtërore të ndjera dhe të përjetuara gjatë këtij rrugëtimi. Kjo vepër ka ardhur me poezi të zgjedhura në gjuhën shqipe si botim i dytë në vitin 2011 nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Fondacioni Kulturor "Saadi Shirazi".

Mesnevi Manevi. Mesnevija është një kryevepër me afër 26000 vargjesh, ku përmblidhet pjesa më e madhe dhe më me interes e Mevlanës, në trajtimin e temave fetare, filozofike, moralo-etike dhe shoqërore. Në këtë vepër zë vend pothuajse çdo lloj çështje që i intereson individit dhe shoqërisë, me interpretimet më të bukura, me krahasime e shembuj të pashoq, si dhe me argumentet më të efektshme e bindëse. Mesnevija nuk mund të lexohet në rrafsh drejtvizor. Kuptimi i shqiptuar i tyre është kuptimi më i sipërfaqshëm. Kuptimet më të thella, gjenden të mbuluara prej fjalës së jashtme dhe kërkon kulturë letrare e fetare, njohje të historisë së qytetërimeve dhe të besimeve, si dhe njohje të stileve klasike. Kjo është arsyeja që zakonisht thuhet se Mevlana lexohet në mënyra të ndryshme, në mjedise kulturore të ndryshme.

Kjo vepër është lexuar nga myslimanët dhe të huajt, është përkthyer në gjuhë të ndryshme, si në anglisht, gjermanisht, frëngjisht.., kurse me poezi të zgjedhura ka ardhur në gjuhën shqipe në vitin 2007 nga Fondacioni Kulturor "Saadi Shirazi" dhe e plotë në vitin 2010 nga botuesi Logos-A, Shkup.

Fihi ma Fih (Gjëja brenda gjësë). Kjo është një vepër e shkruar në prozë që përfshin bisedat dhe pyetje-përgjigjet nga Mevlana. Vepra reflekton ngjarje të ndryshme, mendime, jetën, bindjet e tij, por edhe të kohës. Vepra përbëhet nga 75 kapituj, ku gjashtë prej tyre janë në gjuhën arabe dhe të tjerat në gjuhën perse. Kjo vepër është përmbledhur pas vdekjes së Mevlanës nga nxënësi dhe djali i tij, Sulltan Veledi, të cilët më parë i kishin mbajtur shënim bisedat e tij.

Mexhalisi seb'a (Shtatë kuvende). Kjo është një vepër që përmban predikime dhe ligjërata të Mevlanës nëpër xhami dhe ka shtatë kapituj, të shkruara si shënime nga nxënësit e tij. Përveç komentimit të ajeteve dhe haditheve sipas tematikave, në këtë vepër iu është dhënë hapësirë poezive të Senait dhe Attarit, disa tregimeve nga Mesnevija, si dhe poezive nga Divan-i Kebir.

Mektubat (Letrat). Kjo është një vepër që përbëhet nga letrat që u ka shkruar Mevlana shumë personave për shkaqe të ndryshme. Një pjesë të tyre ua ka dërguar të afërmeve, fëmijëve dhe nxënësve. Ndërsa pjesën më të madhe të tyre ua ka dërguar drejtuesve dhe personaliteteve të rëndësishëm, për ti njoftuar në lidhje me kërkesat e nevojtarëve.

Koncepti i dashurisë sipas Mevlanës

Vetëm kjo frazë e Mevlanës në fakt flet shumë: "Çdo gjë që them duke përshkruar dashurinë, kur prapë vij përpara dashurisë, turpërohem për fjalët e thëna më parë". Efektin dhe llojin e kësaj dashurie, djali i Mevlanës, Sulltan Veledi, e shpjegon kështu në librin e tij "Veledname":

"Qysh prej kohës së profetit Adem e këtej, kanë ardhur në botë shumë 'njerëz të plotësuar'[223] dhe ashik të mbaruar, por mbi këta, ka edhe një botë shpirtërore tjetër, pozita e së cilës është më e lartë, sepse përmban 'ashikun' dhe 'mashukun'[224] bashkërisht. Përpara daljes së Shemsi Tebrizit, kjo lloj bote e kësaj lloj dashurie, nuk dihej publikisht dhe nuk predikohej haptazi. Prandaj, mund të thuhet me plot gojën se Shemsi Tebrizi ishte një nga përfaqësuesit e fshehur të kësaj bote të panjohur, i cili erdhi dhe ja zbuloi këtë sekret Mevlanës, për ta pajisur me të. Në këtë mënyrë, Shemsi u paraqit dhe doli jo si 'mbreti i ashikëve', por si 'mbreti i mashukëve' dhe e frymëzoi Mevlanën me këtë frymë të re.

Parimi sufist i Mevlanës dhe vija e tij, mund të shpjegohet në këtë mënyrë: Më parë dashuria hyjnore në sufizëm ishte e njohur me gjithë kuptimin e fjalës dhe e tretur në shpirtin e 'dashuruesit', i cili ia afronte këtë lloj dashurie Zotit të tij. Por Mevlana, me frymëzimin e Shemsi Tebrizit, nuk e la këtu. Dashurinë e Zotit e pajisi edhe me një kuptim të ri, ku tregonte se, jo vetëm 'njeriu i plotësuar' është 'dashuruesi' i Zotit, por edhe Zoti vet, kur i afrohet kjo dashuri nga njeriu, bëhet njëkohësisht edhe Ai 'dashurues' i tij. Ashtu siç shprehet edhe Zoti në Kuran:

"**Allahu i do ata dhe ata e duan Allahun**"[225],

kuptojmë që dashuria në fillim i përket Allahut dhe Ai më mëshirën e Tij të pafundme e kthen atë te njeriu. Deri në atë kohë, kjo lloj dashurie reciproke nuk ishte komentuar dhe shprehur në këtë mënyrë si Mevlana, i cili frymëzohet siç thamë nga udhëheqësi i tij shpirtëror Shemsi Tebrizi.

Kurrë nuk është vonë të pyesësh veten: "A jam gati ta ndryshoj jetën që po bëj? A jam gati të ndryshoj nga brenda?" Pavarësisht moshës që

223. Insani-kamil
224. Të dashuruarin
225. Maide, 5:54

kemi, sado që kemi gabuar në jetë, është gjithnjë e mundur të rilindim. Nëse çdo ditë e re e jetës tënde është kopje e ditës së kaluar, është për të ardhur keq. Çdo frymëmarrje është një mundësi për të rilindur. Ka vetëm një mënyrë për të lindur në një jetë të re: Të vdesësh para vdekjes. Meqenëse e dinte shumë mirë prirjen e njeriut për tu zhytur në gjumin e shpërfilljes, Mevlana ka përdorur gjithnjë një stil tronditës. Çdo fjalë e tij është një shpatë 'plot perla ribashkimi'. Një shpatë kjo që i 'rilind' njerëzit. Ai i fton të gjithë 'të vdesin përpara vdekjes fizike'. Ja pra, në këtë thënie fshihet një nga perlat më rrezatuese dhe një nga temat më të thella të oqeanit të diturisë, sepse ai që e vret në zemrën e tij këtë botë, e cila nuk është gjë tjetër veçse një fushë loje, do të lindë në një jetë krejtësisht të re. "Kjo botë është një burg, thyeji prangat dhe çliroje veten", - thotë Mevlana. Njeriu do të rilind dhe do të fitojë gjallërinë e vërtetë, vetëm kur të ketë mposhtur egon, pra botën e tij të brendshme. E thënë ndryshe, njeriu që fiton betejën me botën e tij të brendshme, do të ketë një diell, që do të ndriçojë me risi botën e vjetër.

Që të mund t'i kuptosh fjalët shumë të thella të arifëve[226] si Mevlana, nën drejtimin e një të 'plotësuari' në atë fushë, duhet ndjekur një rrugë e tillë, ku të përjetohen përvojat shpirtërore. Sepse misticizmi është një dije që i përket gjendjeve shpirtërore. Prandaj Mevlana është i vetëdijshëm se jo të gjithë njerëzit mund t'i kuptojnë këto sekrete të zemrës dhe, kjo varet nga shkalla e aftësisë perceptuese dhe e ngritjes shpirtërore. Për më tepër, të kuptuarit vështirësohet akoma më shumë kur Mevlana në veprat e veta flet me simbolika dhe metafora. Për këtë, Mevlana ankohet shpesh dhe gjithnjë shpreh brengën se mund të keqkuptohet, apo se nuk do të kuptohet. Kjo duhet të jetë edhe arsyeja kur ai thotë: "Duhet të hesht. Të hesht. Dhe ta lë dashurinë të përshkruajë vetveten; nën një përshkrim të lumtur, të gëzuar që s'merr fund kurrë". Le ta ilustrojmë këtë ide me disa vargje të shkëputura nga Mesnevija e Mevlanës:

226. Gnostikëve

Vetëm Zoti e di se ç'është dashuria

Lëngatë zemre është dashuria,

një bashkim zemrash, - thotë njerëzia.

Gjersa s'e dimë nga vjen, është intime,

origjin' e saj na thonë është Divine.

Sa herë mundohem ta shkruaj, ta shpjegoj,

nga turpi skuqem, nuk mundem ta tregoj.

Ndonjë i ditur rreh që ta shpjegojë,

po dashurin' s'gjen fjalë që ta tregojë.

Nëse nxiton më parë atë ta shkruash,

bën prapa kthehu edhe fillon të vuash.

Mendimi bije si një gomar në baltë,

të dyja i ka ajo, dhe helm, dhe mjaltë.

Si diell rrëfehet, në botë nuk ka të dytë,

po ta vështrosh në sy, të dhembin sytë.

MEVLANA XHELALUDDIN RUMI SIMBOL I DASHURISË (II)

Në vitin 1244, Mevlana takohet me Shemsin, një dervish endacak, me sjellje të habitshme. Ky takim ua ndryshoi të dyve jetën. Në të njëjtën kohë, shënoi fillimin e një miqësie të fortë e të veçantë, të cilën, sufistët e shekujve të vonë, e shihnin si bashkimin e dy oqeaneve. Pas takimit me këtë mik të jashtëzakonshëm, Mevlana u shndërrua nga një dijetar me famë në një mistik të përkushtuar, poet plot pasion dhe në një simbol të dashurisë. Mund të thuhet se kjo ishte arsyeja që Shemsi e ndau Mevlanën nga të gjithë shokët dhe ndjekësit e tij. Kjo do të thotë se deshi t'i mësonte atij një qasje të re të dashurisë, me të cilën pasurohet jeta mistike spirituale. U kuptua gjithashtu, se ky ishte edhe shkaku që Mevlana sakrifikoi gjithë miqtë dhe veten e tij, duke qëndruar i vetmuar bashkë me të, deri sa e asimiloi mirë këtë dritë të vërtetë të misticizmit spiritual. Një gjë e tillë ishte një dhuratë e madhe prej Zotit, të cilën nuk ishin në gjendje ta çmonin besimtarët e thjeshtë, përveç atyre që ishin të asaj rruge.

Gjendja e shekullit XIII

Shekulli i XIII shkruhet në histori si kohë e keqkuptimeve fetare dhe kulturore, si dhe e një farë pasigurie e frike ndaj tjetrit. Në kohëra si këto,

nevoja për dashuri është më e madhe se kurrë, sepse dashuria është vetë thelbi dhe qëllimi i jetës. Siç na e kujton Mevlana, ajo godet këdo, përfshi edhe ata që i shmangen, madje edhe ata që e përdorin fjalën 'romantik' në formë talljeje.

Beteja të pafundme për pushtet, zënka fetare dhe politike mbushnin shekullin e XIII, i cili qe një periudhë vërtet e turbullt në Anadoll. Selxhukët, shteti më i fortë mysliman në atë kohë, ishte lodhur nga problemet e brendshme ndërmjet disa sunduesve myslimanë, që luftonin për fron, madje disa herë deri në vrasje të njëri-tjetrit. Në perëndim, kryqtarët, rrugës për në Jerusalem, pushtuan dhe plaçkitën Kostandinopojën, duke çuar në ndarjen e Perandorisë Bizantine. Në lindje, ushtritë Mongole u shtrinë në toka të gjera nën drejtimin e komandantit ushtarak Xhengis Kan. Ndërsa Bizanti përpiqej të fitonte tokat e humbura, pasuri e pushtet. Ishte koha e një kaosi të paparë, ku të krishterët luftonin kundër të krishterëve, të krishterët luftonin myslimanët, myslimanët luftonin myslimanët. Ngado ku ta ktheje kokën shihje vetëm armiqësi, ankth e frikë të madhe për atë që mund të ndodhte.

Mes këtij kaosi, jetonte një dijetar i shquar mysliman, i quajtur Xhelaluddin Muhamed, i njohur si Mevlana ose me emrin Rumi. Në Konja, në vendin ku ai jetoi, por edhe më gjerë, emri i tij qëndron në një lartësi të tillë, që edhe sot e kësaj dite, tetë shekuj nga koha kur jetoi, njerëzit nuk ia lejojnë vetes t'i drejtohen atij në emër, sepse u duket sikur ia errësojnë lavdinë. Mjafton të përmendim se sa rëndësi të madhe ka ai ndërmjet elitës myslimane, të cilët, kur e përmendin emrin e tij, përdorin epitetin: "Mevlana", që do të thotë "Zotëria ynë". Ndërsa Rumi nënkupton Bizantin, pjesën lindore të perandorisë Romake.

Kush ishte Shems-i Tebrizi

Që të tregosh për Mevlanën, më përpara duhet të dimë për Shemsin, sepse nëpërmjet këtij dijetari të madh shpirtëror, Xhelaleddin Rumiu hyri në rrugën e dashurisë hyjnore dhe pastaj u bë Mevlana. Emri i tij i

plotë është Shemsuddin Muhammed bin Alij bin Malek, lindur rreth vitit 1180 në Tebriz të Iranit. Shemsi ka qenë në shërbimin e shejh Ebu Bekr Selebaf'it për një periudhë kohore, por ka marrë pjesë edhe nëpër bisedat e shumë sufistëve të tjerë. Megjithatë, etjen për njohuri dhe përvoja më të thella nuk mundi t'ia shuante as shejhu i tij dhe as të tjerët. Ai ishte një sufist impulsiv dhe i papërmbajtur që nuk ia shtrinte dorën askujt përveç Allahut, që e thoshte haptazi pa u frikësuar atë që e konsideronte të drejtë dhe që nuk pëlqente njeri lehtë. Shemsi Tebrizi kishte studiuar fusha të ndryshme të shkencës, sidomos misticizmin në nivele të larta. Ai kishte njohuri të thella për teologjinë, astrologjinë, astronominë, filozofinë dhe logjikën, por e fshihte gjithë këtë njohuri nga sytë e të paditurve. Ai kishte shkollim solid islam, në gjuhën arabe, dhe ishte mysliman suni. Shemsi ndiqte medhhebin shafi', por shprehej me madhështi edhe për Ebu Hanifen. Ai ishte kritik ndaj disa mjeshtërve të mirënjohur sufistë, bashkëkohës dhe më të hershëm, sepse ata nuk e ndiqnin mjaftueshëm shembullin e profetit.

Nasir Shemsi shkruan: "Shems-i Tebrizi nuk i pëlqente mistikët, ngaqë ata kishin braktisur sheriatin. Ai nuk i donte fekihët, sepse ata jepeshin pas polemikave të padobishme dhe akuzimeve. Ai shmangej nga qëndrimi në seminare dhe teqe. Në vend të kësaj, Shemsi qëndronte në bujtinat e tregtarëve, duke e treguar veten si tregtar udhëtues. Ai hante shumë pak. Një porcion me bukë dhe supë ishte e mjaftueshme për disa ditë. Ai praktikisht e ngordhte urie veten e tij, si mohim ndaj unit". I biri i Mevlanës, Sulltan Veledi, e përshkruan Shemsin si njeri të ditur dhe të urtë, elokuent dhe të formuar. Ndërsa Baba Zamani, kryetar i strehës së dervishëve në Bagdad, ku dhe Shemsi qëndroi për disa muaj, në vitin 1242, e përshkruan atë si një burrë të gjatë, thatanik, me një hundë të mprehtë, sy të thellë e të zinj dhe flokë të errët, që i binin me kaçurrela të dendura përmbi sy. Baba Zamani thotë: "Nëse dervishëve të tjerë u duheshin muaj, ndonjëherë vite, për të mësuar një gjë të re, atij (Shemsit) i duheshin vetëm pak javë, ndonjëherë edhe ditë. Kishte një kureshtje shumë të madhe për gjithçka të re e të panjohur dhe ishte vëzhgues mjaft

i dhënë pas natyrës. Ai admironte simetrinë e rrjetave të merimangës, ose pikat e vesës që vareshin nga petalet e luleve. Insekte, bimë e kafshë sikur i interesonin dhe e frymëzonin shumë".

Në fakt, më mirë për përvojën e jetës së tij shprehet vetë Shemsi kur thotë: "Që kur isha djalë i vogël kam pasur vegime. Fqinjët ankoheshin te prindërit e mi, duke më akuzuar se sillesha çuditshëm dhe u trembja fëmijët. Njeriu i parë që i gjykoi keq vegimet e mia ishte im atë. Por vegimet nuk mu zhdukën as kur u rrita, madje u bënë më të dendura. E dija që prindërit merakoseshin dhe ndihesha fajtor që i mërzisja, por e vërteta është se nuk dija si t'u jepja fund këtyre vegimeve, madje edhe po të dija, nuk doja t'u jepja fund. Kaloi njëfarë kohe dhe ika njëherë e mirë nga shtëpia. Që nga ajo kohë nuk reshta së qeni dervish endacak, gati 40 vjet. Nuk fjeta dy herë në një vend, nuk hëngra dy herë në një çanak, nuk pashë dy herë të njëjtën fytyrë para vetes. Kështu u enda në lindje e në perëndim, që të gjeja një jetë që ia vlente të jetohej dhe një dituri që ia vlente të dihej. Ngaqë nuk hodha rrënjë asgjëkund, mund të shkoja gjithandej. Gjatë shtegtimeve kam ndjekur lloj lloj rrugësh, nga rrugët e mëdha e të rrahura tregtare deri te shtigjet e harruara, ku nuk shkëmbeheshe me asnjë shpirt të gjallë për ditë të tëra. Nga brigjet e Detit të Zi deri te qytetet e Persisë, nga stepat e gjera të Azisë Qendrore deri te dunat e rërës së Arabisë, kam kaluar mes pyjeve të dendura, në kullota të sheshta dhe shkretëtira, kam qëndruar në hane të mëdha dhe bujtina, jam këshilluar me njerëz të ditur nëpër biblioteka të lashta, kam diskutuar shkrimet e shenjta dhe logjikën me nxënësit e medreseve, kam vizituar tempuj, manastire e faltore, kam medituar bashkë me eremitët nëpër shpella, kam përkujtuar Zotin bashkë me dervishët, kam agjëruar me të urtët dhe kam ngrënë me mohuesit, kam njohur popuj nga të gjitha besimet, moshat e zanatet dhe kam qenë dëshmitar i fatkeqësive, po aq sa edhe i mrekullive. Kam parë fshatra të rrënuara nga varfëria, fusha të nxira nga zjarri dhe qytete të plaçkitura ku lumenjtë ishin të skuqur dhe ku nuk kishte mbetur gjallë asnjë mashkull mbi dhjetë vjeç. Kam parë më të keqen dhe më të mirën e njeriut. Asgjë nuk mund të më habisë

më. E di se po më vjen fundi në këtë botë. Nuk më shqetëson edhe aq shumë vdekja, sepse atë nuk e shoh si fund, por vdekja pa lënë pas vetes trashëgimtarë. Më duket sikur brenda gjoksit mbaj botë të tëra, histori që presin të tregohen. Dua që gjithë këtë njohuri t'ia kaloj një njeriu tjetër, i cili të mos jetë as mësues dhe as nxënës i imi. Më duhet një i barabartë me veten, një shok. 'O Zot, pëshpërita një herë mes errësirës së dhomës. Gjithë jetën shëtita nëpër botë dhe ndoqa rrugën Tënde. Çdo njeri më është dukur si një libër i hapur që ecën. U qëndrova larg kullave të fildishta të dijetarëve dhe zgjodha ta kaloja kohën me të shtypurit, mërgimtarët dhe të dëbuarit. Tani po plas. Më ndihmo që t'ia kaloj diturinë Tënde personit të duhur. Pastaj, bëj me mua ç'të duash'. Për vite me radhë, iu luta Zotit për një shok që t'i jepja diturinë e mbledhur brenda vetes. Më në fund, në një vegim në Samarkandë, kuptova se duhej të vija në Bagdad që të përmbushej fati im". Shemsi kishte arritur në të gjashtëdhjetat dhe vazhdonte të ishte rrugëve, duke kërkuar shpirtin binjak. Dhe një natë, me këtë dëshirë të madhe, i përgjërohet Zotit kështu: "O Zot! Më trego një nga të dashurit e Tu të fshehur". Në vegimet që pati ai u pyet: Për çfarë je i gatshëm si falënderim për këtë? Shemsi, pa hezituar, u përgjigj: Kokën.

Pozita e Mevlanës para takimit me Shemsin

Bashkëkohësit e përshkruanin Mevlanën një burrë të pashëm, me trup të gjatë dhe të hollë, me sy të mëdhenj e të ndritshëm, me lëkurë ngjyrë gruri, me mjekër dhe flokë të rrallë. Mevlana ishte një njeri me mjaft ndikim në Konja që e admironin dhe e respektonin shumë njerëz. Edhe sundimtarët e asaj kohe kishin një respekt shumë të madh për të. Kishte shkëlqyer në ligje, teologji, filozofi, astronomi, histori, kimi dhe algjebër. Me mësimet në medrese dhe predikimet në xhami, Mevlanës iu dha rasti të shprehte zotësinë e tij të madhe dhe kulturën e gjerë. Ai mori famë të madhe dhe nga ç'do anë mblidheshin njerëz e studentë për të përfituar nga dituritë e tij. Aq shumë iu shtuan ndjekësit, saqë, jo

vetëm në xhami, rreth tryezës apo bankave të shkollës, por edhe gjatë rrugës nga shtëpia në medrese dhe e kundërta, ai ishte i rrethuar gjithnjë nga turma njerëzish, të cilët dëgjonin bisedat e tij të këndshme dhe e pyesnin për çdo gjë që kishin nevojë të dinin. Këta ndjekës nuk ia bënin fjalën dysh Mevlanës dhe e shihnin atë si udhërrëfyes, i cili do të sillte ndryshime pozitive dhe domethënëse në jetët e njerëzve.

Letra e Sejjid Burhanuddinit

Emri i parë që të vjen ndërmend nga personat që ndikuan te Mevlana është i ati, Bahauddin Veledi, i mbiquajtur "Mbreti i Dijetarëve". Pas vdekjes së tij, ndikim te Mevlana pati zëvendësi i të atit, njëkohësisht mësuesi i Mevlanës, Sejjid Burhanuddin Muhakkik Tirmidhiu. Ndërsa njëri nga personalitetet që ndikuan me veprat e tyre te Mevlana, veçanërisht para Shemsit, ishte imam Gazzali. Në këtë çështje, duhet theksuar ndikimi dhe rëndësia e Shemsi Tebriziut, i cili përbën një pikë kthese në jetën e Mevlanës. Ai u bë shkak që te Mevlana të shpërthejnë urtësitë e dashurisë.

Ndërkohë që Shemsi Tebrizi vazhdonte të qëndronte te streha e dervishëve për një kohë të pacaktuar, në vitin 1243, Sejjid Burhanuddini i dërgon, nga qyteti i Kajserisë, mikut të tij Baba Zamanit, kryetarit të strehës së dervishëve në Bagdad, një letër me këtë përmbajtje:

"Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim. I dashur vëlla Baba Zaman, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi ty...

Në Konja jeton një dijetar, për të cilin nuk e di në ke dëgjuar. Quhet Mevlana Xhelaluddin Rumi. Kam studiuar me të, fillimisht si mësues pastaj, pasi i vdiq i ati, si kujdestar i tij dhe, pas shumë vitesh u bëra nxënës i tij. Aq i talentuar dhe i mençur ishte, saqë erdhi një kohë kur nuk kisha ç'ti mësoja më dhe nisa të mësoja unë prej tij. Edhe të atin e kishte dijetar të shkëlqyer, por Mevlana ka një cilësi, që pak dijetarë e kanë:

aftësinë për të gërmuar thellë nën mbështjellën e fesë dhe për të nxjerrë nga thelbi i saj atë xhevahir që është gjithëpërfshirës dhe i vazhdueshëm. Mevlanën e kam pasur si birin tim. I premtova të ndjerit, të atit të tij, se do të kujdesesha për të, por tani që jam plakur dhe më kanë ardhur ditët e fundit, dua të sigurohem që ta lë në shoqëri të mirë. Kështu pra, sado i shquar dhe i suksesshëm që është, Rumiu ndonjëherë më është hapur e më ka thënë se ndihet i pakënaqur nga vetja. Sikur i mungon diçka në jetë, ka një lloj zbrazëtie që nuk ia mbush dot as familja dhe as ndjekësit e vet. Një herë i thashë se ishte ende i njomë dhe nuk po e digjte zjarri, që duhet ta hapte portën e shpirtit dhe ujërat e dashurisë të rridhnin sa jashtë, aq edhe brenda. Kur më pyeti se si ta bënte këtë gjë, i thashë se kishte nevojë për një shok, një mik për të udhëtuar, dhe i kujtova çfarë thotë Profeti:

"*Besimtari është pasqyra e besimtarit*"[227].

Në fakt, nuk e di nëse gjendet ndonjë person i tillë në strehën tuaj, por nëse gjendet, ta lë ty në dorë që t'ia bësh të ditur fatin që e pret. Nëse ti dhe unë mund të luajmë ndonjë rol sado të vogël dhe t'i ndihmojmë këta dy lumenj të takohen e të rrjedhin së bashku në oqeanin e dashurisë hyjnore, nëse mund t'i ndihmojmë këta dy miq të Zotit të takohen, unë e quaj veten të bekuar..."

Shejh Sejjid Burhaneddin

Bashkimi i dy oqeaneve

Nuk ishte shumë e vështirë që Baba Zamani ta kuptonte se për këbëhej fjalë në letër për të cilin kishte nevojë Mevlana. Ai e kishte kuptuar me kohë se Shemsi kishte një mision të veçantë në rrugëtimin e tij të vështirë. Gjithashtu e dinte shumë mirë se Shemsi po e priste një rast të tillë, sepse ai i kishte folur që në fillim Baba Zamanit për qëllimin e tij

227. Ebu Daud

dhe lutjet që i bënte Zotit për një shok, ashtu si thoshte ai, të barabartë me veten. Dhe me të marrë njoftimin nga Baba Zamani, Shemsi niset për në Konja.

Mevlana, duke ushqyer gjithnjë idenë dhe dëshirën për të plotësuar brenda vetes boshllëkun shpirtëror që po e mundonte, në vitin 1244 rastis një dervish endacak i quajtur Shemsuddin Tebrizi. Takim si ky ndodh njëherë në jetë. Për Mevlanën, njëherë në 38 vjet. Këtë dervish me pamje të çuditshme, Mevlana e rroku me dashuri të madhe. Me lutje e përgjërime, e ftoi Shemsin në shtëpinë e tij dhe kuvendonte me të ditë e natë. Vetëm me të rrinte, me askënd tjetër nuk shihej e nuk takohej. Mësimet, predikimet dhe medresenë i braktisi. U largua nga shoqëria dhe filloi të shëtiste fushave, bashkë me dervishin, duke biseduar gjithnjë për njohuritë e brendshme dhe frymën mistike spirituale. Mevlana nuk i hiqte nga duart librat e të atit. Ai e donte shumë divanin e Mutenebbiut[228] dhe përparonte me Mesnevitë e Senait[229] dhe Attarit[230]. Mirëpo këto ishin librat dhe fjalët e të tjerëve. Shemsi nuk duronte që Mevlana të flasë me fjalët e të tjerëve dhe të merrej me librat e tyre, sepse e shihte mirë potencialin shpirtëror që ai kishte. Mevlana ishte si një vullkan gati në shpërthim, prej të cilit njerëzit mund të përfitonin më shumë. Mjafton që ai t'i kthehej vetvetes dhe të dëgjonte zërin e zemrës. Shemsi ushtroi mbi Mevlanën një efekt të fuqishëm dhe transformues. Ai e shkëputi Mevlanën nga admiruesit, pastaj nga paria sunduese dhe e bashkoi atë me njerëzit e thjeshtë. Me besimin se çdo "idhull" që qëndron mes njeriut dhe Zotit duhet shkatërruar, përfshi famën, pasurinë, shtresat shoqërore, etj. Shemsi ia preu Mevlanës të gjitha lidhjet me jetën që ai njihte më parë. Pas një shoqërimi që vazhdoi me muaj në këtë mënyrë, Mevlana ndryshoi. Tashmë kishte veshur pelerinën e sufizmit dhe recitonte poezi,

228. Ebu Tajib Mutenebbiu është një nga emrat më të rëndësishëm në poezinë arabe që ka jetuar në shekullin e 10.

229. Hakim Senai është një poet dhe sufist pers që ka jetuar në shekullin 12. Ai është themeluesi i stilistikës së mesnevisë mistike perse.

230. Feriduddin Attari është një poet dhe sufist i njohur pers që ka jetuar në shekullin 12. Ai njihet edhe si doktor e farmacist.

i dhënë në ashkun ose pasionin mistik. Në një nga bisedat me Shemsin, Mevlana kuptoi se sufistët nuk i motivon as frika e ndëshkimit në ferr, as dëshira e shpërblimit në parajsë. Ata e duan Zotin thjesht sepse e duan, pastër dhe thjesht, pa kushte dhe pa pretendime. Dashuria është arsyeja. Dashuria është qëllimi. Kur e do Zotin kaq shumë, kur e do secilën nga krijesat e Tij vetëm për shkak të Tij dhe vetëm falë Tij, pjesët e dukshme thjesht treten në ajër. Duke u nisur nga kjo pikë, nuk ekziston më fjala 'unë'. Gjithçka që mund të jesh atëherë është një zero aq e madhe saqë mbulon të gjithë qenien tënde. Mevlana tregon: "Që kur u fut Shemsi në jetët tona, njerëzit më pyesnin se çfarë më duket kaq e veçantë tek ai. Po nuk kam si të përgjigjem. Në fund të fundit, ata që bëjnë pyetje janë ata që nuk e kuptojnë, sepse kush e kupton nuk bën pyetje të tilla. Si mund t'ua shpjegoj dhe si t'ua mbush mendjen familjes, miqve dhe nxënësve të mi që të kuptojnë të veçantën e Shemsi Tebrizit?! A ka ndonjë mënyrë për ta kapur kuptimin e dashurisë pa rënë së pari në dashuri? Ajo vetëm jetohet. Dashuria nuk mund të shpjegohet, por ajo i shpjegon të gjitha".

Në një kohë fanatizmi të thellë dhe përplasjesh, Mevlana mbështeste spiritualitetin universal, u hapte dyert njerëzve nga çdo lloj shtrese. Në vend të një xhihadi të orientuar nga jashtë, të përkufizuar si luftë kundër mohuesve, ai mbështeste xhihadin e orientuar nga brenda, qëllimi i të cilit ishte beteja kundër sundimit të egos. Jo të gjithë i mbështetën këto ide, njësoj siç ndodh kur jo të gjithë njerëzit i hapin zemrat për dashurinë. Kur e do aq shumë dikë, pret që edhe të tjerët ta duan njësoj, duke iu bashkuar gëzimit e ngazëllimit tënd. Kur ajo nuk ndodh, habitesh, pastaj ndihesh i fyer e i tradhtuar. Kështu ndodhi me ata të dy. Lidhja e fuqishme shpirtërore mes Shemsit dhe Mevlanës u bë shënjestër zërash, talljesh dhe sulmesh. I keqkuptuan, i patën zili, i fyen dhe së fundi, edhe më të afërtit i tradhtuan. Atëherë, Shemsi, të cilit i ishte thyer zemra nga fjalët dhe sjelljet e tyre, një ditë prej ditësh u largua papritmas nga sytë dhe ashtu i dëshpëruar, në vitin 1245, iku në Sham.

Kthimi i Shemsit

I biri e Mevlanës, Sulltan Veledi, thotë në librin e tij se miqësia e Mevlanës me Shemsin i ngjason shoqërisë së Hz. Musës me Hizrin. Hz. Musa a.s. megjithëse ishte profet, pati një kohë kur kërkonte një shoqërues shpirtëror, që t'i hapte "syrin e tretë". Dhe ky shoqërues doli se ishte Hizri, ngushëlluesi i të shtypurve dhe të përjashtuarve. Shoqëria e shkurtër me Hizrin ishte një përvojë që ndikoi shumë tek Hz. Musaja gjatë gjithë jetës. Njësoj si kjo, edhe Mevlana e ndjente nevojën e Shemsit. Këtë miqësi njerëzit e thjeshtë nuk e kuptojnë, por në fakt në të përfshihet mençuria më e thellë.

Ata që shpresonin se pas ikjes së Shemsit, Mevlana do të kthehej në gjendjen e mëparshme, që do të bëhej ai i cili kishte qenë më parë, u gabuan! Qëllimi për të cilin u përpoqën njerëzit ta ndanin Mevlanën nga dervishi, ishte që ta kishin për veten e tyre, por përsëri kjo masë nuk dha asnjë fryt, sepse Mevlana, jo vetëm që nuk iu afrohej atyre, por si i dërrmuar shpirtërisht dhe si një i dashuruar, e kërkonte Shemsin andej këndej, recitonte poezi dhe nuk e zinte vendi. Sado që ata e larguan dervishin prej tij, dashuria spirituale midis tyre ishte aq e madhe, sa nuk mund të rrinin të ndarë nga njëri-tjetri.

Atëherë ndjekësit u bindën se kishin vepruar gabim dhe i kërkuan ndjesë Mevlanës. Ai e pranoi ndjesën e tyre. Dhe kur pas 15 muajsh, më në fund, mori lajmin se Shemsi ndodhej në Damask, e dërgoi të birin, Sulltan Veledin, së bashku me disa të afërm, për ta ftuar në Konja. Djali arriti ta gjejë dhe pas shumë lutjesh, mundi ta sjellë përsëri në Konja. Kthimi në Konja i Shemsit, të ndezur nga ndjenjat e dashurisë dhe miqësisë, e gëzoi jashtëzakonisht Mevlanën. Studentët e Mevlanës i kërkuan falje Shemsit dhe ai i fali. Çdo ditë dikush e ftonte Shemsin me Mevlanën diku. Pothuajse të gjithë përpiqeshin, me sa kishin mundësi, të shtronin gosti për ta. Por kjo gjendje nuk vazhdoi gjatë. Si për të kompensuar kohët e humbura, Mevlana u mbyll përsëri disa herë të tjera në kuvend kokë më kokë me Shemsin.

Nisën përsëri thashethemet kundër tij. Në këtë intrigë të dytë, shumë më të ashpër se ajo e para, u përzije edhe djali i dytë i Mevlanës, Alaeddin Çelebiu. Në vitin 1247, një grup i përbërë nga studentët dhe të afërmit e Mevlanës u hodhën në veprim për ta zhdukur Shemsin. Kur dikush e njoftoi Shemsin për komplotin që kishin ngritur për të, Shemsi i ktheu këtë përgjigje: "Bota është e ndërtuar mbi parimet e të ndërsjellave. Mos ki frikë nga komplotet, mashtrimet apo dredhitë e të tjerëve. Nëse dikush po ngre një kurth, mbaj mend që edhe Zoti po ngre kurthin e tij.

"**Allahu është planifikuesi më i mirë**"[231].

As edhe një gjethe nuk bie nga pema pa dijeninë e Zotit. Besoje pa pikën e dyshimit këtë. Çfarëdo që bën Zoti, e bën për mrekulli". Shemsi e kuptoi urrejtjen që kishte mbërthyer një grup njerëzish, u mërzit shumë dhe u zhduk fare nga sytë e tyre. Askush nuk e mori vesh se ku shkoi, sepse nuk la asnjë gjurmë. Këtu u përhap fjala se dervishin e vrau djali tjetër i Mevlanës, Alauddini, por vëllai i tij, Veledi, në librin e vet e përgënjeshtron kategorikisht këtë gjë. Zhdukja e dytë dhe e papritur e Shemsit, ndodhur në vitin 1247, ka mbetur një pikëpyetje deri në ditët tona.

Mevlana pas zhdukjes së Shemsit

Zhdukja e papritur e Shemsit e çorientoi Mevlanën. Vetë ai shkoi në Sham dhe shëtiti lagje më lagje duke e kërkuar Shemsin shtëpi më shtëpi, por më kot. Ky kërkim zgjati gati dy vjet dhe pastaj Mevlana filloi ta pranojë këtë gjendje. Ai e kuptoi që ndarja përgjithmonë nga Shemsi ishte një sprovë, apo një hap tjetër që duhet të ndërmerrte në rrugëtimin e tij drejt Zotit. Mevlana e dinte mirë se çdo gjë që ndodh, pavarësisht e vogël apo e madhe, dhe çdo vështirësi që del përpara, është pjesë e një plani hyjnor që punon në këtë drejtim. Nuk ka asgjë

231. Enfal, 8:30

rastësore në kaderin e Zotit. Nuk qe rastësi as kur Shemsi i Tebrizit i doli përpara në 1244. Pavarësisht kësaj, ai natë e ditë recitonte poezi, s'e zinte vendi, s'gjente dot prehje e qetësi asnjë çast. Shumicën e vargjeve të Divanit të Madh prej afro 40 mijë vargjesh, e përbëjnë ato të recituara pikërisht në këtë gjendje shpirtërore. Për nderin e Shemsi Tebrizit, Mevlana filloi të shkruajë poezi mistike, të cilat të grumbulluara së bashku përbëjnë divanin e madh. Kësaj vepre nuk i vuri emrin e vet, por përdori në çdo gazel emrin e udhëheqësit shpirtëror, Shemsi Tebrizit. Ndërsa, kur me ndikimin e Shemsit, Mevlana arriti në një pozitë të lartë shpirtërore, filloi të shkruajë "Mesnevinë", e cila nga pikëpamja mistike, njihet si një kryevepër.

Në 23 vitet e fundit, pas zhdukjes së Shemsit, Mevlana vazhdoi të mos merrej me nxënësit dhe këtë detyrë ia ngarkoi miqve të tij të formuar në pikëpamje shpirtërore. Në fillim argjendarit Salahuddinit dhe me vdekjen e tij, këtë detyrë ia ngarkoi kryetarit të fisit Ahi, Husameddin Çelebiut.

Mevlana ndërron jetë

Nga fundi i vitit 1273, Mevlana u sëmur rëndë dhe zuri shtratin. Doktorët nuk mundën t'ia ulnin dot temperaturën dhe as nuk mundën t'ia përcaktonin diagnozën. Në fakt, vet ai nuk kishte dëshirë më të jetonte. Këtë gjë e kishin vënë re edhe mjekët, të cilët dalëngadalë po i humbnin edhe shpresat. Të gjithë njerëzit e qytetit të Konjës prisnin të shqetësuar, ndërkohë që Mevlana ishte i kënaqur në gjendjen e vet. Një ditë, shejh Sadreddin Konevi[232] i vjen për vizitë dhe kur i uron shëndet, ai i thotë: "Tashmë shërimi dhe shëndeti qoftë i mbarë për ju, ndërmjet dashuruesit dhe të dashuruarit ka mbetur shumë pak". Edhe kur të tjerët vinin dhe i uronin jetë e shëndet, atij nuk i vinte

232. Sadreddin Konevi është një sufist i madh, nxënës dhe pasues i shejhut Muhyiddin Arabiut. Ai është themelues i misticizmit teorik dhe ka jetuar në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin qytet me Mevlanën.

mirë. Një herë kur gruaja e vet i thotë: - Ah sikur të jetoje nja 400 vjet dhe ta mbushje botën me dritat e së vërtetës, ai i përgjigjet: "Po pse, Firauna apo Nemruta jemi ne që të kërkojmë jetë të gjatë?! Ne nuk kemi ardhur në burgun e botës për të jetuar gjatë. Dëshira jonë është që një orë e më parë të mbërrijmë në kuvendin e Profetit (a.s.)".

Para se të ndërronte jetë Mevlana i la këto porosi atyre që kishte përreth: "Frikësojuni Allahut kudo që të ndodheni. Ju porosis të hani pak, të flini pak, të flisni pak, të ruheni nga mëkatet, të vazhdoni me namaz dhe agjërim, të shmangeni gjithmonë nga dëshirat trupore, të tregoheni të duruar ndaj mundimeve të njerëzve, të qëndroni me njerëz të mirë e të mëdhenj nga shpirti, si dhe të qëndroni larg njerëzve të ulët. Më i dobishmi prej njerëzve është ai që u sjell dobi atyre, ndërsa më e dobishmja e fjalëve është ajo që është e paktë dhe e saktë. Lavdërimi i përket vetëm Allahut. Paqe njerëzve të teuhidit".

Varrimi i Mevlanës

Kur u dëgjua lajmi për vdekjen e Mevlanës, e gjithë Konja u ngrit në këmbë. Të gjithë, i madh e i vogël, fshatarë, qytetarë, grekë, hebrenj, turq... vrapuan në xhenazen e tij. Sipas porosisë së lënë nga Mevlana, namazin e tij të xhenazes do ta falte shejh Sadreddin Koneviu. Por kur këtij të fundit i ra të fikët, pak para namazit, atëherë faljen e drejtoi njëri prej dijetarëve të mëdhenj të asaj kohe, Kadi Siraxhedin Urmeviu. Përveç myslimanëve, në varrimin e tij morën pjesë edhe njerëz të besimeve të tjera. U mblodh një turmë shumë e madhe saqë myslimanët kërkuan që njerëzit e besimeve të tjera të shpërndaheshin. Mirëpo jomyslimanët dolën kundër kësaj kërkese duke thënë: "Nga fjalët e tij ne kuptuam të vërtetat për Musanë, Isanë dhe të gjithë profetët e tjerë..." Dhe: "Mevlana është si buka. A ka njeri që të mos ketë nevojë për bukë? A keni parë ndonjë të uritur që të ikë nga buka?!" Pas namazit të xhenazes, trupi i Mevlanës u varros pranë të atit, në Konja, në vendin e quajtur Trëndafilishte. Në

Kubenë e Gjelbër, ku është varrosur Mevlana, qëndron i shkruar ky epitaf: "Kur të vdes, mos e kërkoni varrin në tokë, por e gjeni atë në zemrat e njerëzve".

Disa thënie të përzgjedhura të Mevlanës

- Eja, eja. Kushdo që të jesh, përsëri eja!

  Edhe po të jesh mohues, zjarradhurues apo idhujtar, përsëri eja!

  Selia jonë nuk është seli e pesimizmit!

  Edhe njëqind herë ta kesh prishur pendimin, përsëri eja!

- Bëhu si ujëvarë në bujari dhe ndihmë!

  Bëhu si diell në dhembshuri dhe mëshirë!

  Bëhu si natë për t'i mbuluar të metat e të tjerëve!

  Bëhu si i vdekur në nervozizëm dhe zemërim!

  Bëhu si dhé në thjeshtësi dhe përulësi!

  Bëhu si det në mirëkuptim!

  Ose duku ashtu si je, ose bëhu ashtu si dukesh!

- Prej dashurisë ndaj trëndafilit, do i gëlltis gjembat.

- Dashuria nuk është në epërsi, në aftësi, në dituri, në fletore, në faqet e librave. A nuk bëjnë njerëzit thashetheme? Ajo rrugë nuk mund të jetë rruga e të dashuruarve.

- Jo vetëm ata që flasin të njëjtën gjuhë, por edhe ata që ndajnë të njëjtat ndjenja e kuptojnë njëri- tjetrin.

- Fillo një projekt të madh, pa mend, si Nuhu[233] (nga syri i të tjerëve) dhe do ta shihni se njerëzit do si do prapë do të flasin për ju, në të mirë dhe në të keq. A duhet të më shqetësojë kjo?! Asnjëherë. Le të shqetësohen ata që humbin kohën duke më gjykuar mua.

- Detyra juaj nuk është që të kërkoni dashuri, detyra juaj është të jepni dashuri. Vetëm atëherë do të shihni se si do të largohen pengesat në rrugën tuaj, askush nuk mundet ta injorojë dashurinë për shumë gjatë. Përmes dashurisë gjithçka që është e hidhur do të bëhet e ëmbël, përmes dashurisë gjithçka që është e bakrit do të bëhet prej ari, përmes dashurisë e gjithë dhimbja do të kthehet në melhem.

- Vazhdoni e gërmoni në zemrën tuaj. Dhe mos harroni, kur dikush godet një qilim, goditjet nuk janë kundër qilimit, por kundër pluhurit në të.

- Nëse fjalët dalin nga zemra, ato do të hyjnë në zemër.

- Duke bërë si më thanë të tjerët, u verbova. Duke shkuar ku të tjerët më kërkonin, humba. Më pas u largova prej të gjithëve, edhe prej vetes. Kështu i gjeta të gjithë, edhe veten.

- Mos vajto. Çdo gjë që ti humbet, të vjen përsëri në një tjetër formë.

- Kur i bën gjërat nga shpirti, ndien një lumë që lëviz brenda teje, gëzimin.

- Mos u kënaq me histori, se si gjërat kanë ndodhur me të tjerët. Shpalos mitin tënd.

- Injoroji ata që të bëjnë të ndjesh frikë dhe trishtim, që të degradojnë e të shpien drejt sëmundjes e vdekjes.

233. Profeti Nuh (a.s.), kur po ndërtonte një varkë në tokë, të gjithë filluan ta quanin të marrë, sepse kujtonin se përmbytja që Hz. Nuhu i paralajmëroi më përpara, nuk do të ndodhte.

- Atje ku ka rrënoja, ka edhe shpresë për një thesar.
- Gjithçka në univers është brenda teje. Kërkoje gjithçka nga vetja.
- Kur kryen një gjynah menjëherë pendohu. Njeriu nuk mbytet kur bie në ujë, por kur nuk del prej tij.
- Në këtë botë, sprova jote është ajo çfarë dëshiron më shumë.
- Sa bukur e shpjegojnë flokët e dëborës mundësinë e bashkëudhëtimit pa dëmtuar njëri-tjetrin.
- Njeriu, ose duhet të ketë fjalë për të thënë, ose moral për të heshtur.
- Injoranti i ngjanë punës së daulles. Zhurmë ka shumë, por brenda është bosh.
- Njeriu me moral hesht prej moralit të tij, i pamoralshmi kujton se ishte ai që e bëri të heshtte.
- Mos e gjyko të kaluarën e askujt, mos harro se edhe elmazi, përpara se të përpunohej, ishte një copë qymyr.
- Mos e harro kurrë këtë o bir; drejtësia është një pasuri e shtrenjtë, nuk gjendet kurrë te njerëzit e lirë.

DREJT ZOTIT TIM

Kalova të njëzetat,
gjithashtu edhe të tridhjetat.
Duke hyrë për të dyzetat, tek vetja nuk po shoh ndryshim,
përjashtim bëjnë gjërat vetëm në konceptim.
Por çfarë dobie pata unë nga kjo!
Kur egoja ime vazhdon të triumfojë, thuajse kudo!
Mendova se me diturinë do të korrja fitore,
por jo, pa hyrë në oqean po shëtis nëpër bregore.
Më është rënduar shpirti nga gjynahet,
fryma po më merret, zemra kërkon të lahet.
Në këtë pikë, koha është për ndryshim,
që njeriu të përparojë e mos të bëjë më kthim.
Po vallë, si duhet ta kaloj unë këtë fazë?!

Ku prej meje pritet të bëhem njeri, e jo shtazë!
Ah, kur do të jetë ajo ditë që të ngjitem drejt Zotit pa u lëkund?!
Atë ditë kërkoj dhe dobësive të mia t'i jap fund!
Vallë, a është e mundur që ky shpirt të gjejë qetësi?!
Ta marrë shtruar dhe mos t'i shohë gjërat me kaq lemeri?!
Sigurisht, këto pyetje kanë përgjigje,
po ç'ti bëj shpirtit tim brënda, që ka dhimbje!
Nuk di më ç'të them, fjalët më kanë mbaruar,
kam për qëllim kohën e tashme dhe të shkuar.
Sepse besimtarin e sinqertë një e ardhme e mirë, e pret,
mjafton që ai të durojë dhe të punojë me veten e vet.
Më thoni ju dashamirës, si të veproj?
Si t'i lutem Zotit që rrugën unë të vazhdoj?
O Zot të qofsha falë, sa paskam gabuar!
Duke menduar vrapin, ecjen paskam nënvlerësuar!
O Allahu im! Më çliro prej burgut të unit,
më bëj të afërt me Ty, e jo si ata që rrinë pas gjumit.
Pranoje o Zot robin Tënd gjynahqar, por të penduar,
jepi sukses në gjërat që të kënaqin Ty, ende nga kjo botë pa kaluar.
Me shpirt të përvëluar "Allah më ndihmo", të thërres,
me emrin Tënd në gojë Zot, edhe kur të vdes.

FALEMINDERIT O ZOT

Kur zgjohem në mëngjes, e falënderoj Zotin shumë,
që edhe një herë më dha jetë, e nuk më la të vdes në gjumë.
E falënderoj Zotin që frymë po marr,
për ata që mendojnë, thotë Ai në Kuran.
Gjymtyrët i kam në rregull dhe mund të lëviz,
jam shumë mirë me shëndet dhe nuk kam paraliz.
E falënderoj Zotin që më jep mundësi fizike,
që më siguron po ashtu edhe mundësitë ekonomike.
Shikimi, dëgjimi, shijimi dhe nuhatja,
janë prej Teje o Zot, janë mirësi të mëdhaja.
Faleminderit o Zot për ajrin që thith,
na mëson i dërguari Yt i dashur në hadith.
O Zot të falënderoj për konceptin e kohës,

që ma bën ta kuptoj, e të mos jem mosmirënjohës.

Për ushqimin dhe pijen që na dhuron, duhet të të falënderojmë,

mos na bëj nga ata o Zot, që edhe Ty të mohojnë.

Faleminderit për pasuritë mbi e nëntokësore që na dhuron,

lavdet janë për Ty o Zot, që asnjëherë nuk na harron.

Faleminderit o Zot për këto dhe të tjera mirësi,

që më mbulon gjithmonë me të Tuat begati.

ME SY TË PËRLOTUR TË LUTEMI

"Dua", është një fjalë arabe dhe do të thotë thirrje, të thërrasësh dikë për ndihmë, t'i lutesh Allahut dhe ti kërkosh vetëm Atij. Njeriu e kupton se nuk ka fuqinë që të arrijë çdo gjë që dëshiron, por është në dijeni se Allahu është i plotfuqishëm që t'i japë atij çdo gjë që ai kërkon në lutje.

Duaja është prej adhurimeve me të rëndësishme në islam. Profeti (a.s.) në një hadith thotë:

"*Duaja është vetë adhurimi*"[234].

Kështu që kur i drejtohemi Allahut me lutje, t'i drejtohemi Atij me seriozitetin dhe përkushtimin e faljes se namazit apo të kryerjes së ndonjë adhurimi tjetër. Lutja drejtuar Zotit të Madhëruar është një adhurim i mbushur plot me mistere, i fshehtë dhe i shenjtë. Ajo është sjellja më e sinqertë e adhuruesit. Është gjendja ku njeriu i drejtohet dhe kërkon diçka nga Zoti i tij me çiltërsi dhe sinqeritet.

Në ajetet si "**Kur robërit e Mi të pyesin për Mua, thuaju se Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit kur ai më lutet Mua**"[235],

234. Tirmidhi
235. Bekare, 2:186

"**Lutmëni Mua se do t'ju përgjigjem!**"[236], "**Zoti im nuk do t'ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj**"[237],

tregohet qartë rëndësia e lutjes. Edhe i Dërguari i Zotit (s.a.s) i ka këshilluar shokët dhe të afërmit e tij të luten, dhe vetë nuk ka pushuar së luturi Zotit përgjatë gjithë jetës së tij. Lutja e përshkruar dhe treguar me kaq madhështi zë një vend shumë të rëndësishëm në jetën e besimtarit.

Ejani së bashku t'i kthehemi kënaqësisë që na ofron Allahu - I Vetmi, I Plotëfuqishmi, I Pasuri, I Gjalli dhe Mëshiruesi i pakufishëm. Le t'i afrohemi derës së mëshirës së Tij dhe Atij t'ia shtrijmë duart duke kërkuar Atë dhe ndihmën e Tij. Ai është Shëruesi, Krijuesi, Furnizuesi dhe Ai është që jep jetë e vdekje.

Një njeri i cili i ngre duart lart, i drejtohet Zotit kështu: "Të gjitha shkaqet kanë heshtur. Asnjë ngjarje nuk mund të ndikojë në rrjedhën e natyrës dhe askush nuk mund të më zgjasë dorën dhe të zgjidhë hallet e mia. Unë i ngrita duart dhe po i lutem Atij, Më të madhëruarit, Atij që vazhdimisht zërin ma dëgjon, frymëmarrjen ma ndjen, Ai i cili më thotë se është më afër se damari im i qafës, më premton se do t'i përgjigjet lutjes sime:

Zoti ynë, paqja je Ti, paqja dhe shpëtimi janë tek Ti, dobia dhe begatia Jote janë pambarim. O i Madh e Dhurues! Ti je i pastër nga të gjitha cilësitë që tregojnë mangësi! Të gjitha lavdet dhe lavdërimet janë për Ty, nuk ka Zot tjetër veç Allahut, Ai është më i madhi, fuqia dhe forca janë të Allahut që është i Lartë e i Fuqishëm!

O Mëshiruesi i Mëshiruesve, kërkojmë prej Teje falje në këtë botë dhe në tjetrën. Zoti ynë, kërkojmë prej Teje falje dhe largimin e së keqes prej nesh në këtë botë dhe në tjetrën. Zoti ynë, dërgo mbi Profetin tonë Hz. Muhammed (a.s.) dhe vëllezërve të tij profetë, përshëndetje sa numri i krijesave të Tua, i pëlqimit Tënd, i peshës së arshit Tënd.

236. Gafir, 40:60
237. Furkan, 25:77

Zoti ynë, pastroji gabimet dhe mëkatet tona, ashtu siç pastrohet rroba e bardhë nga papastërtitë, si dhe largona nga mëkatet siç largon lindjen dhe perëndimin nga njëri-tjetri. Zoti ynë, të mbështetemi Ty nga dobësia dhe pamundësia, nga përtacia dhe kopracia, nga frika dhe plakja. Zoti ynë, mbështetemi tek Ti nga zemërashpërsia, indiferentizmi, varfëria, nga poshtërimi dhe meskiniteti; mbështetemi tek Ti nga mohimi dhe herezia, nga shkaktimi i armiqësisë, nga inati dhe smira, nga veprimi për dukje dhe sëmundjet e tjera të këqija.

Zoti ynë, mbështetemi tek Ti nga hidhërimi dhe ankthi, nga dituria që s'jep dobi, nga zemra që s'dridhet, nga lutja e papranuar dhe nga uni i pangopur. Zoti ynë, bëje burim begatie fenë që e kemi mbrojtjen e gjendjes sonë, bëje për ne të begatë jetën tjetër ku është kthimi ynë, bëje këtë jetë për ne pretekst për shtimin e të gjitha llojeve të mirësive e begative. Zoti ynë, kërkojmë prej Teje një jetë krejt të pastër dhe një kthim tek Ti që të mos të turpërohemi para Teje me të metat dhe mangësitë tona.

O Strehuesi i të pamundurve! O Burim fuqie për të dobëtit! O Shërues i të brengosurve! O Orientues i të humburve! O Zot i Lartëmadhëruar që i përgjigjesh çdo lutjeje! Ti je Falës, e do faljen, na fal neve! Na i fal mëkatet dhe gabimet tona që nuk reshtin së përfunduari! Na bëj njerëz të plotësuar nga ana trupore, mendore dhe shpirtërore. Bashkë me dijen na shto pasurinë e zemrës dhe pastërtinë e shpirtit!

Zoti ynë! Na bëj njerëz të angazhuar në jetën shpirtërore, këmbëngulës për të qëndruar larg nga papastërtitë materiale e shpirtërore, vigjilentë ndaj dëshirave trupore, modestë e të gatshëm për të luftuar kundër sëmundjeve si urrejtja, hakmarrja, fiksimi, zilia e egoizmi!

Zoti ynë! Na bëj të durueshëm dhe të kujdesshëm! Na bëj njerëz të besimit dhe aksionit, të cilët në vend të të folurit të tepërm, t'i jetojnë ato parime në të cilat besojnë dhe që me jetesën e tyre bëhen shembull i mirë për njerëzit e tjerë!

Zoti ynë! Në qëllimin tonë qoftë gjithnjë e përtejmja! Na bëj prej njerëzve të besimit, të cilët janë të lidhur fort pas kënaqësisë Tënde, e që vazhdimisht avancojnë në këtë udhë deri sa të mbërrijnë tek dashuria absolute.

Zoti ynë! Na bëj prej njerëzve të sakrificës, në të mirë të besimtarëve dhe mbarë njerëzimit. Vendos midis nesh vëllazërinë, respektin, dashurinë e dhembshurinë! Të mos përçahemi asnjëherë! Por të jemi si ndërtesa të mbështetura njëra tek tjetra, duke e ndihmuar njëri-tjetrin! Na ruaj o Zot nga çdo sprovë e fitne, e cila të çon në prishjen e vëllazërisë. Vendos harmoninë midis nesh! Sjelljet tona mos lëndofshin askënd! Mos të mbajmë inat dhe mëri me asnjë njeri! Mos të ndiejmë armiqësi ndaj askujt! T'i duam besimtarët e çdo njeri tjetër që kontribuon në lumturinë e këtij populli!

Zoti ynë! Veç përpjekjeve tona, t'i japim shumë rëndësi edhe ndihmës Tënde! Në çdo vepër e në çdo lëvizje të kërkojmë vetëm e vetëm kënaqësinë Tënde!

Zoti ynë! Asnjë herë mos i hap vend në jetën tonë mendimeve të papranueshme si "ta bëj unë", "ta arrij unë suksesin", "të arrij unë rezultat"! Kushdo që ta bëjë të mirën e të bukurën, ne të gëzohemi njësoj sikur ta kishim vepruar vetë! Suksesin e të tjerëve ta pranojmë edhe si suksesin tonë!

Zoti ynë! Na udhëzo që të mos merremi me mangësitë e gabimet e të tjerëve, duke mos arritur të shohim ato tonat! Na bëj prej atyre njerëzve që bëjnë vazhdimisht llogarinë e brendshme vetjake, e që mundohen t'i plotësojnë mangësitë e tyre! Të jemi përfaqësues të së mirës dhe një shembull i mirë për të tjerët!

I lartësuar është Allahu i Madhëruar nga përshkrimet e të tjerëve dhe vetëm Atij i takon falënderimi i pakufishëm. Paqja e bekimi i Zotit qoftë mbi të Dërguarit e Tij.

Ne lutemi për Profetin e njerëzimit gjithmonë, lutemi për familjen e tij, lutemi për shokët e tij që i ishin përkrah në çdo situatë të dhimbshme me një besnikëri dhe sinqeritet të paparë. Lutemi për ata njerëz që në të kaluarën dhe në të ardhmen do të ndjekin me devocion udhëzimet e Zotit, të përcjellura nga i dërguari i fundit.

PËRMBAJTJA

Parathënie 3
Hyrje 6
BËHU ROB I ZOTIT 8
QËLLIMI YNË, KËNAQËSIA E ZOTIT 11
BESIMI DHE RRUGA DREJT ORIENTIMIT 15
LEXO ME EMRIN E ZOTIT TË BOTËVE 19
VLERA E NIJETIT NË FENË ISLAME 22
KURANI OFRON SISTEMIN MË TË PËRKRYER PËR NJERËZIMIN 25
AI (A.S.), DHURATË E MADHE PËR BESIMTARËT 29
HUMANIZMI I PROFETIT MUHAMED (A.S.) 32
PËRKUJTIMI I HIXHRETIT PROFETIK 35
KREMTIMI I FESTAVE NË ISLAM DHE RASTI I MEVLUDIT 37
TRE MUAJT E BEGATË 49
NAMAZI ËSHTË DRITA E SYVE 52
AGJËRIMI I RAMAZANIT ME BESIM DHE BINDJE 56
LAMTUMIRË RAMAZAN 59
BAJRAMET, FESTA TË VYERA PËR MYSLIMANËT 62
VIZITA E QABES SË MADHNUESHME 69
KUPTIMI I RITUALEVE TË HAXHIT 72
NJERIU ËSHTË BASHKË ME ATË QË DO 76
FALËNDERIMI, VIRTYT I PAÇMUAR 79
DURIMI, DHUNTIA MË E MADHE 82
QËNDRIMI I EKUILIBRUAR DHE RUAJTJA E BARASPESHËS 85
RËNDËSIA E KONSULTËS NË FENË ISLAME 88
DEVOTSHMËRIA DHE SJELLJA E MIRË 91
MEDITIMI, RRUGA NDRIÇUESE E BESIMIT NË ZOT 94
GJITHÇKA ËSHTË PRONË E KRIJUESIT 104
NA NEVOJITET PAFUNDËSISHT MËSHIRA E TIJ 107
PENDESA, KY FRYT I VETGJYKIMIT TË DËLIRË 111

NË FRYMËN E AUTOKRITIKËS 114
VEPRIMI MË I FRIKSHËM 117
NDJENJA MË MIZORE, SMIRA 120
PËRFOLJA DHE PASOJAT E SAJ 124
BRAKTISJA E KOTËSISË 128
TURPI, SHENJË E BESIMIT 132
BESIMTARI PËRBALLË SFIDAVE TË KOHËS 135
FATIME ZEHRA, MODEL I VAJZËS, GRUAS DHE NËNËS MYSLIMANE 138
NJË FAMILJE E NDËRTUAR SI MODEL MBI VLERAT ISLAME 141
DUKE SHOQËRUAR UDHËTARIN NË PËRJETËSI 150
FITIMI I RINISË SË PËRJETSHME 153
ETIKA ISLAME NË MBROJTJE TË JETËS DHE DINJITETIT NJERËZOR 156
BAMIRËSIA NDAJ JETIMIT SI TIPAR I HUMANIZMIT ISLAM 160
BESA PËR ITHTARËT E LIBRIT 163
ROLI I PRIJSAVE MYSLIMANË PËR SIGURINË DHE PAQEN 168
HYRJE NË VITIN E RI SHKOLLOR 173
COPËZA NGA JETA E SAHABËVE 176
QËNDRIMI I EBU HANIFES GJATË ZHVILLIMEVE POLITIKE TË KOHËS 186
MEVLANA XHELALUDDIN RUMI SIMBOL I DASHURISË (I) 195
MEVLANA XHELALUDDIN RUMI SIMBOL I DASHURISË (II) 206
DREJT ZOTIT TIM 222
FALEMINDERIT O ZOT 224
ME SY TË PËRLOTUR TË LUTEMI 226

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë
Demetja, Dorian
ME ZOTIN MES NJERËZVE :
"Njeriu është bashkë me atë që do"
(Profeti Muhamed a.s.)
Dorian Demetja ;
red. Detin Kotrri, Mehmet Disha.
Tiranë : Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2020
234 f. ; 14.8x21cm.
ISBN 978-9928-194-82-4
1.Feja islame
2.Besimi 3.Zoti (feja islame)
28 -184.3